7 Udhëzues nëpër drejtësinë tranzicionale BeH, [www.undp.ba](http://www.undp.ba)

8 Udhëzues mbi reparacionet, përgatiti Pablo de Greiff, Beograd, 2011, faqja 51.

9 Ligji mbi bazat e mbrojtjes sociale, mbrojtjes së viktimate civile të luftës dhe mbrojtjes së familjeve me fëmijë, Gazeta zyrtare Federatës e Bosnjë dhe Hercegovinës, numër 36/99, 6 shtator 1999, me ndryshimet dhe plotësimet e publikuara në Gazetën zyrtare të Federatës së Bosnjë e Hercegovinës, numër 54/04 dhe 39/06.

10 Udhëzues nëpër drejtësinë tranzicionale në Bosnjë e Hercegovinë, [www.undp.ba](http://www.undp.ba)

11 Konventa e III e Gjenevës për trajtimin e robërve të luftës - 12.08.1949.

njeriut dhe shkeljet serioze të së drejtës humanitare ndër-kombëtare, siç janë:

- a) lëndimi i integritetit trupor dhe dhembjet shpirtërore;
- b) mundësia e humbur për punësim, arsim dhe privilegje sociale;
- c) dëmi material dhe humbja e të ardhurave, duke përfshirë humbjen e aftësisë për punë;
- d) dëmi moral;
- e) shpenzimet e përfaqësimit ligjor, mjekimit, këshillimit psikologjik dhe shërbimeve sociale.”<sup>12</sup>

Bosna dhe Hercegovina zbaton dy mënyra sa i përket të drejtës për dëmshpërblim. Mënyra e parë realizohet në bazë të vendimeve administrative, që do të thotë në bazë të ligjeve të entiteteve, të cilat rregullojnë të drejtat e viktimate civile të luftës dhe ushtarëve invalidë të luftës, kurse i dyti bazohet në iniciimin e padive civile në bazë të *Ligjit për marrëdhëniet detyrimore*, të cilat Federata e BeH dhe Republika Serbe i kanë marrë nga ish-Jugosllavia. Megjithatë, sistemi aktual i kompensimit në BeH është i ngarkuar me kufizime të shumta. Konkrektisht, nuk ekziston ndonjë qasje gjithëpërfshirëse për kompensimin e të gjitha viktimate të luftës në gjithë territorin e BeH, që rezulton me trajtimin e pabarabartë të disa kategorive të viktimate në raport me tjerat, dhe mungesën e plotë të kompensimit për grupe të caktuara të viktimateve, siç janë viktimat e torturës që nuk kanë pësuar lëndime trupore në përqindje të caktuar.

Gjatë procesit konsultativ me përfaqësuesit e shoqatave të viktimate dhe organizatat e shoqërisë civile, që merren më këto çështje, me rastin e përgatitjes së *Strategjisë së drejtësisë tranzicionale në Bosnjë dhe Hercegovinë* është theksuar në veçanti:

- Mosefikasiteti dhe paqëndrueshmëria e dëmshpërbimeve përmes vendimeve gjyqësore;
- Mungesa e konsistencës kur bëhet fjalë për dëmshpër-

blimin e viktimateve përmes vendimeve administrative: trajtimi i ndryshëm i viktimate civile të luftës në dy entitetet dhe dallimet në trajtimin e veteranëve dhe invalidëve të luftës dhe viktimate civile të luftës brenda entiteteve;

- Paqëndrueshmëria e sistemit ekzistues të pagesave së kompensimeve;
- Dëmshpërblimet për viktimat e torturuarët në vendet e burgosjes nuk janë siguruar sa duhet.

Sa i përket legjislacionit për reparacione, i vetmi ligj i tillë është Ligji (në nivel qendror) për personat e zhdukur<sup>13</sup>, i cili rregullon të drejtën e viktimate civile të luftës për kompensim. Legjislacioni i entiteteve rregullon kompensimin e luftëtarëve dhe viktimate civile të luftës. Në Federatën e BeH ligjet e tillë janë: Ligji mbi parimet e mbrojtjes sociale, mbrojtjes së gjithë viktimate civile të luftës dhe mbrojtjes së familjeve me fëmijë<sup>14</sup>, Ligji mbi të drejtat e luftëtarëve dhe anëtarëve të familjeve të tyre dhe Ligji për të drejtat e luftëtarëve të demobilizuar dhe familjeve të tyre.<sup>15</sup> Në Republikën Serbe kemi Ligjin për mbrojtjen e viktimate civile të luftës së Republikës Serbe<sup>16</sup> dhe Ligjin për të drejtat e luftëtarëve, invalidëve të luftës dhe familjeve të ushtarëve të Republikës Serbe.<sup>17</sup> Republika Serbe ka miratuar edhe Ligjin për të drejtën në dëmshpërblim për démet materiale dhe jomateriale, të shkaktuara si pasojë e luftës gjatë periudhës nga 20 maji 1992 deri më 19 qershor 1996,<sup>18</sup> por ky ligj rrallëherë shfrytëzohet në praktikë për kategoritë tjera, me përjashtim të luftëtarëve.

## Kompensimi

Ekzistojnë katër grupe të pagesave të kompensimeve në të dy entitetet e BeH: 1) kompensimi i invalidëve, veteranëve të luftës (kompensime individuale ushtarake), 2) pagesat për familjet e ushtarëve të vrarë dhe të zhdukur (kompensime familjare ushtarake), 3) kompensimet për viktimat civile të luftës (kompensime individuale civile) dhe 4) pagesat për familjet e civilëve të vrarë apo të zhdukur gjatë luftës (kompensimi familjare civil). Për dallim nga viktimat civile,

12 Parimet e përgjithshme dhe direktivat... (A/RES/60/147, 21. mars 2006), paragrafi 20.

13 Gazeta Zyrتare BeH, 50/04.

14 Gazeta Zyrتare FBeH, 36/99, 54/04, 39/06, i 14/09.

15 Gazeta Zyrتare FBeH, 61/06, 27/08 i 2/08.

16 Gazetat Zyrتare RS, 25/93, 32/94, 37/07, 60/07, 111/09, 118/09 i 24/10.

17 Gazetat Zyrتare RS, 46/04 i 53/04.

18 Gazetat Zyrتare RS, 49/05 i 1/09.

që duhet të vërtetojnë se kanë pësuar lëndime trupore të paktën në shkallën prej 60%, luftëtarët duhet të dëshmojnë lëndime trupore në shkallën prej 20%, për ta realizuar të drejtën në kompensim. Këto kriteri vlefjanë në të dy entitetet.

Në bazë të hulumtimeve të detajuara, të kryera nga Linda Popiq dhe Belma Panjete, të cilat merren me çështjet që kanë të bëjnë me luftën, në Federatën e BeH në vitin 2009 kishte 98.249 përfitues të kompensimeve nga kategoria e veteranëve, kompensime të kombinuara individuale dhe familjare, për dallim nga numri prej vetëm 10.950 përfituesve të kompensimeve civile, kompensime të kombinuara individuale dhe familjare.<sup>19</sup> Nga ky numër prej rreth 11.000 përfituesve të pagesave civile, vetëm 621 ishin viktima të dhunës seksuale. Gjendjen e keqëson më tej fakti se, siç është thënë më lartë, kjo kategori e viktimate haset vetëm në Federatën e BeH, nga viti 2006. Në vitin 2009, në Republikën Serbe kishte vetëm 3.843 përfitues të kompensimeve civile, individuale dhe familjare, natyrish se disa nga ato ishin viktima të dhunimit, por për këtë nuk ka të dhëna, ndërsa 69.451 persona përfitojnë paga ushtarake individuale dhe familjare.

Por, nuk janë shqetësuese vetëm shifrat. Siç theksojnë me të drejtë Popiq dhe Panjeta është e nevojshme të bëhet dallimi mes tre llojeve të kompensimeve: kompensimet, pensionet ushtarake dhe pagat për mirëqenie sociale. Popiq dhe Panjeta argumentojnë se pensionet ushtarake nuk i takojnë së kategorisë së kompensimeve e as asaj të mirëqenies sociale, sepse nuk kanë për qëllim rritjen e të ardhurave ose të sigurojnë zhëmëtimin por, vetëm të paguajnë për shërbimin e veteranëve, prandaj kompensimet e luftës dallojnë shumë nga ndihmat sociale.

Në rastin e ndihmave sociale e drepta për t'i gjuar ato varet nga lartësia e të ardhurave, pagesat bëhen shumë herë, është e mundur të humbet e drepta e gjëzimit të tyre, nëse realizohen të ardhura të kënaqshme, kurse qëllimi i përgjithshëm i tyre është ndihma për të varfrit.

Kompensimet e luftës janë një formë e reparacioneve, e drepta për to fitohet nëse individit i janë shkelur të drejtat e njeriut, ka vetëm një pagesë të vetme apo pagesa bëhet në dy-tre këste, ka për qëllim korrigimin e padrejtësisë së

bërë dhe nuk mund të humbet, sepse kjo e drejtë nuk mund të merret. Prandaj, duke njohur mirë dallimin mes këtyre kategorive, është evidente se kategorizimi i kompensimeve në BeH nuk është i përcaktuar. Ajo i trajton kompensimet e luftës për viktimat si një formë të përkujdesjes sociale.

Si kompensimet individuale ashtu edhe ato familjare të veteranëve paguhen në baza mujore, kurse kompensimet familjare civile dhe ato të veteranëve varen, të paktën pjesërisht, nga të ardhurat e tyre dhe e drejta për t'i gjuar ato bazohet në të ardhurat familjare, përpas faktorëve tjera. Kjo e dhënë në mënyrë të qartë e kategorizon këtë lloj të pagesave si formë të ndihmës sociale, ku nuk do të duhej të ishte duke pasur parasysh se qëllimi i tyre nuk është zgjidhja e problemeve të varférise, por kompensimi për shkeljen e të drejtave të njeriut. Kjo e drejtë mund të humbasë varësish nga shkalla e invaliditetit, që si rregull nuk ndodhë me rastin e kompensimeve të luftës, për shkak se konsiderohet që shkelja e të drejtave asnjëherë nuk mund të anulohet.

Për këtë arsyе mund të themi se sistemi i reparacioneve në BeH nuk njeh kompensime, të cilat në tërësi i përgjigjen kategorisë së përcaktuar ndërkombëtare të kompensimeve të luftës. Më të përaferta me këtë kategori janë pikërisht kompensimet për viktimat civile të dhunës seksuale në Federatën e BeH: këto kompensime nuk varen nga të ardhurat, qëllimi i tyre është përgjigja në shkeljet e të drejtave të njeriut e jo zbutja e varférise, kurse viktimat asnjëherë nuk mund ta humbin të drejtën në kompensim. Gjërat janë ndryshe në Republikën Serbe, atje kriteri për kompensim është invaliditeti trupor, kurse trajtimi i viktimateve të dhunës seksuale nuk dallon nga trajtimi i viktimateve civile të luftës.

Shkurtimisht, kompensimet e luftës në BeH nuk mund të konsiderohen si kompensime ashtu siç i përcakton e drejta ndërkombëtare “sepse pranueshmëria nuk bazohet në të drejtën e shkelur. Në vend të kësaj, e drejta në përfitim bazohet në shkallën e invaliditetit, e cila mundet por, nuk është e thënë t'i përgjigjet përvojës së viktimës së shkeljes së rëndë të të drejtave të njeriut dhe shkeljeve serioze të së drejtës ndërkombëtare humanitare.”<sup>20</sup>

Prandaj lind pyetja se në cilën formë të kompensimit të dëmit

19 Popiq, L. i Panjeta, B. (2010): “Kompensimi, drejtësia tranzicionale dhe kredia e kushtëzuar ndërkombëtarë në Bosnjë dhe Hercegovinë: Përpjekjet për të reformuar pagesat qeveritarë për viktimat dhe veteranët e luftës 1992-1995.” Publikimet e hulumtimeve të pavarura të mbështetura nga Ambasada e Mbretërisë së Norvegjisë në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Ambasada e Zvicrës në Bosnjë dhe Hercegovinë. Gusht 2009, Sarajevë.

20 Popiq i Panjeta (2010), vërejtja e mësipërme 9.

duhet vënë theksin? A duhet insistuar në prioritetin shoqëror për njohjen e viktimateve? Apo së pari duhet të ofrohet rehabilitimi, ndihma dhe mbështetja përkatëse mjekësore dhe psikologjike? Apo ndoshta hapi i parë që duhet bërë është forcimi financiar i viktimateve dhe privilegjimi i tyre në arsim dhe punësim? Në shumicën e shteteve të botës, kur u pyetën për formën e dëshiruar të kompensimit, viktimat e dhunës seksuale u përgjigjën se më shumë preferojnë shërbime që iu përgjigjen nevojave të tyre themelore dhe nevojave të familjeve të tyre se sa kthimin e pronës dhe kompensime në të holla.<sup>21</sup>

Problemi në Bosnjë e Hercegovinë është më i thellë. Viktimat nuk janë njohur në ligjet ekzistuese (të burgosurit e kampeve të përqendrimit), statusi i tyre nuk dallon në të dy entitetet (viktimat e luftës së dhunës seksuale) dhe asnjëherë nuk janë realizuar ato, përfundimisht, që ka një dispozicion shoqata, listave të ndryshme sipas komunave, vendeve të mbajtjes dhe një varg kriteresh tjera, si dhe bazës elektronike të të dhënavëve përfundimisht, apo vendet e ndalimit në Bosnjë dhe Hercegovinë, sipas ligjit nuk konsiderohen kategori e viktimateve. Pra, të dy entitetet e rregullojnë statusin e luftëtarëve dhe viktimate civile të luftës, por nuk e përfshijnë kategorinë e atyre që u mbajtën dhe u torturuan në kampet e përqendrimit nëse nuk plotësohen kriteret e lëndimeve trupore. Me fjalë tjera, bazuar në ligjet e entiteteve, nëse ndonjë person nuk ishte pjesëtar i asnjërisë nga ushtritë e BeH dhe nëse nuk mund të dëshmojë invaliditetin trupor në shkallën prej 60%, ai nuk mund ta realizojë të drejtën në asnjë formë të kompensimit përkundër faktit se është mbajtur, torturuar, rrahur apo nënshtruar formave më të tmerrshme të torturës. Meqenëse kjo e drejtë nuk ekziston as në nivel shtetëror, ish të burgosurit e kampeve të përqendrimit edhe sot ballafaqohen me shkelje të rënda të të drejtave të njeriut përfundimisht, që është mangësive në ligj.<sup>22</sup>

### Çdo të mirë, Bosnjë dhe Hercegovinë!

*"Civilizimi vlerësohet në bazë të asaj se si i trajtojmë grupet më vulnerabile."*

Kur flasim për kategorinë e të burgosurve të kampeve të përqendrimit gjendja është shumë komplekse. Ekziston një

numër i madh i organizatave të kësaj kategorie të viktimateve, të grumbulluara në tre shoqata.

Shoqata e të burgosurve në kampet e përqendrimit në Bosnjë dhe Hercegovinë me seli në Sarajevë përfaqëson 55.000 burra dhe gra, ish të burgosur të këtyre kampeve. Ky numër iu referohet të dhënavë që ka një dispozicion shoqata, listave të ndryshme sipas komunave, vendeve të mbajtjes dhe një varg kriteresh tjera, si dhe bazës elektronike të të dhënavëve përfundimisht, apo vendet e ndalimit në Bosnjë dhe Hercegovinë, sipas ligjit nuk konsiderohen kategori e viktimateve. Pra, të dy entitetet e rregullojnë statusin e luftëtarëve dhe viktimate civile të luftës, por nuk e përfshijnë kategorinë e atyre që u mbajtën dhe u torturuan në kampet e përqendrimit nëse nuk plotësohen kriteret e lëndimeve trupore. Me fjalë tjera, bazuar në ligjet e entiteteve, nëse ndonjë person nuk ishte pjesëtar i asnjërisë nga ushtritë e BeH dhe nëse nuk mund të dëshmojë invaliditetin trupor në shkallën prej 60%, ai nuk mund ta realizojë të drejtën në asnjë formë të kompensimit përkundër faktit se është mbajtur, torturuar, rrahur apo nënshtruar formave më të tmerrshme të torturës. Meqenëse kjo e drejtë nuk ekziston as në nivel shtetëror, ish të burgosurit e kampeve të përqendrimit edhe sot ballafaqohen me shkelje të rënda të të drejtave të njeriut përfundimisht, që është mangësive në ligj.<sup>22</sup>

Sa i përket numrit të vendimeve të plotfuqishme mbi paditë e të burgosurve në kampet e përqendrimit përfundimisht, kurse gjithë tjetër i nënshtronen rishikimit që shkon disa vite pas, me qëllim të parandalimit të keqpërdorimeve. Vlerësohet se nga numri i përgjithshëm i të burgosurve në kampet e përqendrimit, rrëth 20.000 prej tyre kanë ngritur padi. Shumica nga ata janë të regjistruar në databazën elektronike të shoqatës, kurse një pjesë janë persona që akoma nuk janë përfshirë në bazën elektronike të të dhënavëve, ndërsa përfshirja e tyre, nëse i plotësojnë kushtet, do të bëhet pas përpunimit suksesiv, respektivisht varësisht se si vijnë lëndët përfundimisht.

Deri më tanë janë shpallur rrëth 2.500 vendime të shkallës së parë në lidhje me paditë e të burgosurve në kampet e përqendrimit përfundimisht, qëndrimi i këtij vendimini është vënë re në fillim të punës me këtë lëndë, meqenëse disa gjykata/gjykatës morën një qëndrim të tillë. Mirëpo, pasi që Gjykata Supreme e Federatës së BeH vendosi se të burgosurit në kampet e përqendrimit kanë të drejtë në këtë formë të kompensimit të dëmit, pothuajse nuk pati më raste të refuzimit të kërkuesave, me përjashtim të disa rasteve spo-

21 Rubio Marín, Ruth (2009): *The Gender of Reparations. Unsettling Sexual Hierarchies while Redressing Human Rights Violations*, Cambridge University Press

22 *Viktimat e luftës dhe gjimia – e vërteta e ndjeshme, drejtësia, reparacionet dhe mospërsëritja në Bosnjë dhe Hercegovinë*, Maja Šoshtariq, Seri perspektive: raport hulumtues, Impunity Watch, 2012.

23 Shoqata e të burgosurve në kampet e përqendrimit në Bosnjë dhe Hercegovinë, mars 2013.

radike në disa gjykata të Republikës Serbe.

Numri i aktgjykimeve të plotfuqishme sillet mes 300 dhe 350, kurse janë ekzekutuar vetëm dy prej tyre: **Zijahudin Smailagiç, Banja Llukë dhe Samir Pojskiq, Travnik**. Gjatë vitit 2013 pritet një numër i madh i aktgjykimeve të plotfuqishme sikurse edhe fillimi i shumë procedurave të ekzekutimit. Megjithatë, kohëzgjatja e procedurave paraqet një shqetësim tjetër, procedura mund të zgjasë jashtëzakonisht shumë, për shembull, ekzekutimi i vendimit në rastin e cekur më lartë në Banja Llukë zgjati pothuajse 6 vjet.

Dega e Shoqatës kroate të të burgosurve në kampet e përqendrimit gjatë Luftës atdhetare në BeH në kantonin e Hercegovase-Neretvane numëron 2.860 ish të burgosur në kampet e përqendrimit, 1.277 nga të cilët janë ushtarë (branitelj – mbrojtës) dhe 1.583 civilë. Gjithsej janë ngritur 1.112 padi, për të cilat deri më tani nuk është marrë asnjë vendim i plotfuqishëm.<sup>24</sup>

Shoqata e të burgosurve në kampet e përqendrimit nga Republika Serbe e ka selinë në Banja Llukë. Në bazë të të dhënavë, me të cilat disponon, deri më tani janë ngritur padi individuale për 57 kampe të përqendrimit. 17 lëndë kanë përfunduar në shkallën e parë, ankesat janë në procedim në Gjykatën Kushtetuese të BeH, 4 aktgjykime janë negative, ankesat janë në proces, 9 janë refuzuar, kurse për 4 aktgjykimet pozitive nuk është bërë pagesa e dëmeve materiale. Aktualisht 27 lëndë janë në procedurë.<sup>25</sup>

Marrë në përgjithësi, rezultatet e të gjitha padive për dëmshpërbirim material janë shumë problematike. Proseset janë të shtrenjta kurse pagesat përfundimtare, madje edhe pas urdhrit të gjykatës, janë të pasigurta. Vendimet për shumën e pagesës varen në tërësi nga gjykimi i gjykatësit, me çka i hapet rruga manipulimit të qartë politik.

Federata e BeH dhe Republika Serbe e kanë shpallur kompensimin për ish të burgosurit e kampeve të përqendrimit si borxh publik, me ç'rast afati për kryerjen e pagesës në Republikën Serbe është 25 vjet, kurse në Federatë 50 vjet. Për t'i paguar borxhet, entiteteve do t'iu duhet të privatizojnë diçka nga prona shtetërore apo t'i japid me koncession. Duhet theksuar se të burgosurit kroatë në kampet e përqendrimit kanë të drejtë t'i marrin pensionet invalidore

nga BeH në rast se paraqesin prova të mjaftueshme (viktimë civile të luftës/veteranë të luftës), sikurse edhe pensionet kroate invalidore të luftës, në përpunë me marrëveshjen ndërshtetëre mes Kroacisë dhe BeH. Pensionet kroate janë jashtëzakonisht të larta bazuar në standartet e BeH.<sup>26</sup>

Ligji mbi të drejtat e viktimate të torturës dhe viktimate civile të luftës në nivel shtetëror, i cili duhet të rregullojë statusin e të burgosurve në kampet e përqendrimit dhe të sigurojë të drejta të barabarta për kompensim, është duke u hartuar qe disa vite. Në vitin 2005, të tre grupet e të burgosurve të kampeve të përqendrimit në BeH ia paraqitën reportin e tyre të parë Komitetit kundër torturës (CAT). Kishte edhe dy përpjekje të pasuksesshme (2006 dhe 2010) për hartin e projektligjit. Përkundër kësaj, me rastin e paraqitjes së raportit para Komitetit të Kombeve të Bashkuara kundër torturës (CAT), autoritetet e BeH përmendën miratimin së shpejti të ligjit kombëtar mbi të drejtat e viktimate të torturës dhe viktimate civile të luftës dhe themelimin e Fondit kombëtar për kompensimin e dëmit viktimate. Asgjë nga këto pretime nuk është realizuar. Projektligji i ri për momentin ndodhet në Ministrinë për të Drejtat e Njeriut dhe Refugiatë, e cila, së bashku me shoqatën e të burgosurve të kampeve të përqendrimit boshnjakë dhe kroatë, të udhëhequr nga organizata me përvjojë „Vive žene“ nga Tuzlla, që merret me terapinë dhe këndelljen e viktimate të luftës, e koordinoi këtë proces.

Ligji përmban formulën e zgjidhjes për çështjen e harmonizimit të kompensimeve ditore për të burgosurit e kampeve të përqendrimit. Shoqata e të burgosurve në kampet e përqendrimit nga RS refuzoi të marrë pjesë në përgatitjen e projektligjit, edhe pse disa organizata individuale morën pjesë në konsultime.

Viktimat e dhunimeve gjatë luftës dhe formave tjera të dhunës seksuale vazhdojnë të janë kategori problematike, që flet për diskriminim në aplikimin e ligjeve në BeH. Përderisa në Republikën Serbe viktimat e dhunës seksuale të luftës konsiderohen thjesht si viktima civile të luftës dhe duhet të kalojnë procedurën standarde për të dëshmuar dëmtimin trupor në masën prej 60%, në Federatën e BeH, nga viti 2006, këto viktima janë pranuar si kategori e posaçme.<sup>27</sup>

<sup>24</sup> Shoqata kroate e të burgosurve në kampet e përqendrimit gjatë luftës atdhetare në BeH, mars 2013.

<sup>25</sup> Shoqata e të burgosurve në kampet e përqendrimit nga Republika Serbe, mars 2013.

<sup>26</sup> *Viktimat e luftës dhe gjinia – e vërteta e ndjeshme, drejtësia, reparacionet dhe mospërsëritja në Bosnjë dhe Hercegovinë*, Maja Šoshtariq, Seri perspektive: raport hulumtues, Impunity Watch, 2012.

<sup>27</sup> Njëjtë.

Familjet e personave të zhdukur gjithashtu ballafaqohen me probleme dhe rrallëherë e shfrytëzojnë të drejtën e tyre për dëmshpërbllim. Ligji për personat e zhdukur në nivel shtetëror ka si grup të cakut familjet e civilëve dhe ushtarëve të zhdukur.<sup>28</sup>

Në mënyrë që të sigurohen pagesat përkompensim, Ligji për personat e zhdukur parashesh krijimin e Fondit për personat e zhdukur, që deri më tani nuk ka ndodhur. Familjet kanë të drejtë në pagesë retroaktive nga dita e miratimit të ligjit, kurse pas themelimit të Fondit shfrytëzuesit do të duhet të heqin dorë nga të gjitha kompensimet tjera, në mënyrë që të fitojnë të drejtën e përcaktuar me ligj. Për fat të keq, për shkak të mungesës së Fondit familjet ende nuk po i gëzojnë të drejtat e përmendura dhe kjo është një nga arsyet që ata i kanë paraqitur ankesat e tyre para organeve relevante kombëtare dhe ndërkombëtare. Familjet e të zhdukurkurve e kanë gjetur veten në një qark vicioz: përkundër ekzistimit të ligjit që u garanton kompensim financiar, mekanizmat financiarë që sigurojnë këto lloje të pagesave përmomentin nuk ekzistonë, duke i lënë ata pa asgjë. Në fund duhet thënë se vendimet e Gjykatës Kushtetuese të BeH në lidhje me çështjen e personave të zhdukur vazhdojnë të mos zbatohen.<sup>29</sup>

### Përfundimi

Ashtu siç thuhet në raportin Popiq-Panjeta, fakti që flasim për Bosnjë dhe Hercegovinën, e cila 18 vite më parë doli nga vuajtjet e tmerrshme të luftës dhe ku ende nuk është krijuar skema konkrete dhe gjithëpërfshirëse përkompensim, e bën të quartë pse grupet e ndryshme të interesit, duke përfshirë viktimat dhe ushtarët (branitelji), kanë qëndrime të ndryshme mbi nevojat për të ardhurat ekzistuese që lidhen me luftën dhe rrjedhimisht kanë këndvështrime të ndryshme

mbi ligjshmërinë e ndryshimeve dhe reformave.

Nga aspekti i së drejtës dhe praktikës ndërkombëtare, vetëm përfitimet e viktimate të dhunës seksuale dhe dhunimeve në Bosnjë dhe Hercegovinë kanë ngashmëritë e mjauftueshme me karakteristikat e kompensimit apo të ardhurat nga reparacionet. Gjitha pagesat tjera paraqesin një kompleks interesant të karakteristikave të nxjerra qoftë nga modelet e ndihmës sociale, qoftë nga modelet e reparacioneve apo masave kompensuese.

Për fat të keq, shumica e viktimate që pranojnë ndonjë formë të të ardhurave që lidhet me ngjarjet e luftës, në të vërtetë marrin kategorinë plotësisht të gabuar të kompensimit, atë që ka për qëllim zbutjen e varfërisë, e jo kompensimin për të cilin ata me të vërtetë kanë të drejtë, e që nuk varet nga invaliditeti apo lartësia e të ardhurave, por vetëm nga ajo që kanë përfjetuar.

Çështja e kompensimit të viktimate të luftës në Bosnjë dhe Hercegovinë në formë të barrës financiare paraqet shqetësim serioz. Cili është çmimi i drejtësisë në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe a do ta arrijnë ta përfjetojnë atë shumë nga viktimat?

Detyrimet ligjore dhe morale të shtetit të Bosnjë dhe Hercegovinës ndaj të gjitha viktimate nga lufta e kaluar nuk do të zhduken me reformën e sistemit të mbrojtjes shëndetësore dhe sociale. Qëndrueshmërinë e kërkeseve përkompensim e gjemë në shembujt nga gjithë bota, siç janë edhe shembujt konkret të kërkeseve që lidhen me ngjarjet nga Lufta e Dytë Botërore, madje edhe 60 vjet pas përfundimit të saj.

Sepse për drejtësi nuk është asnjëherë vonë, apo jo?

28 Gazeta Zyrta BeH, 50/04.

29 *Viktimat e luftës dhe gjinia – e vërteta e ndjeshme, drejtësia, reparacionet dhe mospërsëritja në Bosnjë dhe Hercegovinë*, Maja Šoshtariq, Seri perspektive: raport hulumtues, Impunity Watch, 2012.

# Memorialët në Bosnjë dhe Hercegovinë – reparacion simbolik apo manipulim politik

Seid Burić

## Hyrje

Bosnja dhe Hercegovina është shoqëri e pas konfliktit e cila ardhmërinë e saj duhet ta ndërtojë përmes ballafaqimit përfundimtar me të kaluarën dhe punës së vazhdueshme në tejkalinin e interpretimeve të ndryshme të historisë, të cilat i kontribuojnë ruajtjes së gjendjes aktuale dhe vazhdimit të mosbesimit në mes të qytetarëve të përkatësive të ndryshme etnike. Drejtësia tranzicionale si metodë që zbatohet në shoqëritë me histori të shkeljeve masive dhe të rënda të drejtave të njeriut dhe të drejtës humanitare, posedon mekanizma që ndihmojnë kalimin nga gjendja e pas konfliktit në gjendjen e sundimit të ligjit, paqes dhe demokracisë, duke parandaluar përsëritjen e krimeve dhe duke mundësuar zbutjen e pasojave të krijuara. Në mesin e mekanizmave të drejtësisë tranzicionale vend të veçantë zë reparacioni, i cili ka për qëllim satisfaksionin material dhe jo material të viktimit.<sup>30</sup> Më 16 dhjetor 2005, **Asambleja e Përgjithshme**

e Organizatës së Kombeve të Bashkuara miratoi Parimet dhe direktivat themelore për mjete juridike dhe reparacion për viktimat e shkeljeve të rënda të të drejtave universale të njeriut dhe shkeljeve serioze të së drejtës ndërkombëtare humanitare, me ç'rast janë definuar pesë forma kryesore të reparacioneve, të cilat në masë të ndryshme evidentohen në shoqëritë me histori shkeljesh të rënda të të drejtave të njeriut dhe krime lufte.

97

Në bazë të qëndrimit të Asamblesë së Përgjithshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, **format kryesore të reparacionit** janë:

1. *kompensimi*,
2. *restitucioni*,
3. *reabilitimi*,
4. *format e ndryshme të satisfaktionit* të cilat paraqesin metoda simbolike për zbutjen e dëmeve, e ku bëjnë pjesë

30 Në vendimin e Gjykatës Ndër-Amerikane për të drejtat e njeriut në rastin **Velásquez-Rodríguez kundër Hondurasit** (viti 1988) përmenden pesë detyrime kryesore të shtetit (1. shteti është i detyruar të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar shkeljen e të drejtave të njeriut; 2. në rast se ka ndonjë lëshim në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, shteti është i detyruar që të hetojë në mënyrë efikase të gjitha pohimet për krime; 3. shteti është i detyruar që të bëjë publike kush janë viktimat e kush kryesit; 4. shteti ka për detyrë të procedojë të gjithë ata për të cilët ekziston dyshimi i bazuar se kanë urdhëruar apo i kanë kryer personalisht krimet dhe të organizojë procedurë gjyqësore efikase dhe korrekte; 5. shteti ka për detyrë të pëргatisë programe të reparacionit për viktimat për shkak të vuajtjeve nëpër të cilat kanë kaluar, në mënyrë që të zgjedhohen pasojat e krimeve dhe krijohet ndjenja e plotë e drejtësisë), ndërsa janë definuar katër mekanizma të drejtësisë tranzicionale të cilat paraqesin bazën, por jo edhe listën përfundimtare të mekanizmave:  
**1. drejtësia penale, 2. tregimi i të vërtetës, 3. reparacionet, 4. reformat institucionale**, gjithmonë duke pasur parasysh se konteksti shoqëror dikton mënyrën e zbatimit të konceptit të drejtës tranzicionale. Duhet theksuar se asnje nga këta mekanizma si i vetëm nuk mund të arrijë qëllimet e drejtësisë tranzicionale. Për përmbrushjen e këtyre qëllimeve kërkohet vullnet politik, rol aktiv i shoqërisë civile dhe konsultime të gjera në relacionin shoqëri civile-pushtet.

zbardhja e fatit të personave të zhdukur dhe format e ndryshme të reparacioneve simbolike siç janë kërkim-falja, ngritura e monumenteve përkujtimore, verifikimi i fakteve mbi krimet e kryera dhe të ngjashme.

### **5. garantimi i mos përsëritjes.**

Bosnja dhe Hercegovina akoma nuk ka strategji për qasje sistematike dhe gjithëpërfshirëse ndaj reparacioneve, duke përfshirë këtu edhe qasjen ndaj memorialëve si një kategori e veçantë e reparacioneve simbolike. Mosekzistimi i një strategie në nivel të BeH ka rezultuar me gjendje kaotike në fushën e ngritjes së përmendoreve të cilat në të shumtën e rasteve u kushtohen pjesëtarëve të njërit grup etnik, përderisa numri i memorialëve „multietnike“ është i papërfillshëm.<sup>31</sup> Edhe pse memorialët janë kategorizuar në grupe të reparacioneve, ato duhet shikuar më tepër se njohje e vuajtjeve të viktimate, prandaj duhet të jenë të dukshme dhe publike dhe të nxisin biseda shoqërore për të kaluarën.

### **Gjendja e memorialëve në Bosnjë dhe Hercegovinë**

Në Bosnjë dhe Hercegovinë ekzistojnë tre apo katër histori zyrtare mbi të kaluarën, të cilat janë përfshirë në sistemin arsimor dhe ndikojnë në zhvillimin e kulturës së kujtimit. Historitë e tillë, në vend se të ndihmojnë në arritjen e pajtimit dhe ballafaqimin përfundimtar me të kaluarën, krijojnë konflikte të reja. Problemi kryesor në politikën e memorialëve në hapësirën e BeH është mungesa e koordinimit në nivel shtetëror, prandaj është evidente praktika e ngritjes së monumenteve që shënojnë ngjarje të caktuara pa vërtetim gjyqësor të fakteve për krimet e kryera gjatë konfliktit të armatosur. Monumentet zakonisht u kushtohen „heronjve lo-

kal“, të cilët për pjesëtarët e një grupi etnik janë heronj, kurse grupi tjetër etnik i sheh ata si kriminelë dhe kryes të vepgrave penale.<sup>32</sup> Memorialët e këtij lloji përpos që nxisin konflikte të reja, më së shpeshti të natyrës verbale dhe politike, si në nivelin lokal ashtu edhe në nivelet tjera, në të njëjtën kohë e vështirësojnë zbatimin e **Aneksit të VII-të të Marrëveshjes paqësore të Dejtonit**, duke ngjallur pasiguri te të kthyerit dhe ndjenjën se jeta e përbashkët është e pamundur.<sup>33</sup> Gjendja aktuale e memorialëve në BeH duhet të analizohet me kujdes në mënyrë që të mundësohet përshtatja e saj me dokumentet ligjore dhe programore. Qëndrimet në teorinë e drejtësisë tranzicionale për rolin e memorialëve janë të ndryshme. Nga njëra anë thuhet se memorialët duhet të ngrihen në vendet që mund të ngjallin reagime të caktuara, të kontribuojnë në nxjerrjen e mësimeve nga e kaluarë dhe të garantojë mos përsëritjen e ngjarjeve të tillë, kurse nga ana tjetër thuhet se kujtimi publik, e në këtë kuadër edhe ngritura e memorialëve, shkakton pasoja negative të cilat mund të çojnë në konflikte mes përfaqësuesve të grupeve të ndryshme etnike, posaçërisht kur bëhet fjalë për kujtesën që lidhet me versionet kundërthënëse të historisë së kohëve të fundit, gjë që bashkësive lokale në tranzicion nganjëherë mund t'i shkaktojë më tepër dëm se sa dobi. Dhënia e lejes për ngritjen e një monumenti nga departamenti për urbanizëm përgjithësisht është kompetencë e vetëqeverisjes lokale, me kusht që iniciativa të vijë nga institucionet, organizatat joqeveritare, bashkësitë fetare dhe elitat politike. Burimet e financimit për ngritjen e monumenteve apo memorialëve janë buxhetet komunale por edhe fondet e ndryshme në kuadër të ministritve kantonale dhe federale, të cilat janë të lidhura me mbrojtjen e veteranëve, invalidëve dhe viktimate civile të luftës. Në këtë fushë shpesh shfaqen situata ku

- 
- 31 Dallimet mes memorialëve dhe monumenteve kuptohen në përputhje me sqarimet e dhëna nga historiani James Young: „**Monumentet paraqesin një nëngrup të memorialëve: objekte materiale, skulptura dhe instalacione që shërbejnë për të përkujtuar një person apo ngjarje.**(...) Memoriali mund të jetë një ditë e caktuar, konferencë apo hapësirë, pra nuk është e thënë të jetë vetëm monument. **Monumenti nga ana tjetër gjithmonë është një lloj i memorialit**“. James Young. „Struktura e kujtesës“, në: Maja Brkljaçiq dhe Sandra Prlenda, „Kultura e kujtimit dhe historia“, Golden marketing – Libri teknik, Zagreb, 2006, faqe 201.
- 32 Gjykimet për krimet e luftës të kryera gjatë konfliktit të armatosur në Bosnjë dhe Hercegovinë po zhvillohen para Gjykatës Ndërkombëtare Penale për ish Jugosllavinë (GJNPJ/ICTY); 16 gjykata në Bosnjë dhe Hercegovinë (Departamenti për krimet e luftës dhe Gjykatat e B e H, dhjetë gjykata kantonale dhe pesë gjykata të qarkut dhe Gjykata themelore e Distriktit Brçko); Dhomën për krimet e luftës të Gjykatës së Qarkut në Beograd (Serbi) dhe në gjykatat e shteteve tjera, në përputhje me parimet e juridiksionit universal.
- 33 **Aneksi i VII-të të Marrëveshjes paqësore të Dejtonit** parasëthku kthimin dhe rindërtimin e pronës, që nënkupton kompensimin e drejtë të dëmit për pronën e shkatërruar dhe kthimin e të zhvendosurve në vendbanimet e tyre (kthimin fizik dhe të qëndrueshëm), dhe obligon institucionet e pushtetit që të krijojnë të gjitha parakushtet e nevojshme për përmbrashjen e dispozitiveve të përmendura. Parashihet mundësia e sigurisë dhe lëvizjes së lirë, zgjidhja e çështjes së personave të zhdukurve, heqjen e legjislacionit diskriminues në fuqi gjatë periudhës së luftës, ndalimin e gjuhës së urrejtjes në media, iniciimin e procedurave kundër atyre që kanë shkelur të drejtë të humanitare ndërkombëtare dhe atyre që e pengojnë kthimin.

ngritja e përmendoreve për pjesëtarët e formacioneve ushtarakë financohet nga buxheti, kurse përmendorët për viktimat civile, që janë në numër më të vogël, financohen ekskulzivisht nga familjet. Praktikë e shpeshtë me rastin e ngritjes së monumenteve përkujtimore është përkujtimi i përbashtë i ushtarëve dhe viktimate civile të luftës, me çka bëhet përpjekje të tregohet uniteti i këtyre dy kategorive krejtësisht të ndryshme. Bazën ligjore për ngritjen e monumenteve në Bosnjë dhe Hercegovinë e paraqet ligji i entiteteve dhe kantoneve për planifikimin hapësinor dhe shfrytëzimin e territorit dhe ligjet e sipërpërmendura të Distriktit Brčko, standardet dhe kriteret e të cilëve për ngritjen e memorialëve nuk janë në përputhje me ato të mekanizmave të drejtësisë tranzicionale. Përpos ligjeve të përmendura, në nivel shtetëror ekzistojnë dokumente të caktuar ligjore dhe programore sikurse edhe institucionale të cilat merren me çështje të memorialëve, por eliat politika ende nuk e kanë hartuar projektligjin që do ta rregullonte ngritjen e monumenteve.<sup>34</sup> Konsiderohet se për aprovinin e një ligji të tillë në Parlamentin e Bosnjë e Hercegovinës nuk mund të sigurohet shumica e nevojshme, meqenëse në këtë institucion janë të përfaqësuara partitë politike, anëtarët e të cilave mojnjë kryerjen e krimeve, sikurse edhe faktin se në Srebrenicë

nicë kishte gjenocidi.<sup>35</sup> Partitë politike në pushtet dhe anëtarët e shquar të tyre janë vendimarrësit kryesorë për këtë çështje, duke përcjellë në këtë mënyrë mesazhin e qartë për atë se kush është viktima e kush kryesi i krimit (ku shpeshherë qëndrimet e një partie politike paraqiten si qëndrime të popullit, sepse ajo veten e konsideron përfaqësuese të gjithë popullit). Përpos fyerjeve të kësaj natyre në adresë të viktimate, vendosja e monumenteve dhe ngritja e objekteve të kultit në disa raste është politizuar së tepërtimi dhe ato qëllimish ndërtohen në vendet e vuajtjeve të grupit tjeter etnik, veprime këto që cenojnë më tej dinjitetin e viktimate.<sup>36</sup> Në BeH objektet shkolllore dhe hapësirat e fabrikave, hoteleve, qendrave sportive, stadiumeve, shitoreve, restauranteve shpeshherë kanë qenë vende të ekzekutimit dhe keqtrajtimit si të individëve ashtu edhe të një numri të madh të pjesëtarëve të një grupe etnik. Në vende të tilla, që nga fillimi i konfliktit të armatosur e deri më sot vazhdimisht po ngrihen monumente, të cilët në të shumtën e rasteve kanë karakteristika religioze të popullit shumicë në atë vendbanim dhe promovojnë versionin e historisë sipas kuteve të tyre, duke injoruar të kthyerit, përkatësia etnike e të cilëve në monumentet në fjalë kualifikohet si kriminale apo agresore. Nuk duhet harruar as faktin se edhe monumentet e

<sup>34</sup> **Ligi për personat e zhdukur** (Dispozita e Nenit 20 të Ligjit për personat e zhdukur që parashevë të drejtën e familjeve të kërkojnë që "vendet e varrimit dhe zhvarrimit (individuale apo të përbashkëta) të shënohen, pa marrë parasysh nga numri i viktimate, respektivisht personave të zhdukur", pas miratimit paraprak nga Instituti për persona të zhdukur dhe me pajtimin e pushtetit lokal; Aneksi i VIII-të i Marrëveshjes së paqes së Dejtonit (Komisioni për ruajtjen e monumenteve nacionale) dhe Kriteret për emërtimet e shkollave dhe simbolet (Analiza e zbatimit të kritereve për emërtimin e shkollave dhe shënimin e ngjarjeve e vitit 2008, vërtetoi se ky ligj nuk po zbatohet dhe se 556 shkolla në BeH (27%) kanë simbole përkujtimore që kryesish kanë të bëjnë me monumentet e ngritura përluftëtarët e vrarë në luftën e fundit).

<sup>35</sup> „**Unë këtu pohoj se nuk është kryer gjenocid! Nuk ka pasur gjenocid!** Ka ekzistuar një plan sipas të cilës disa të huaj dhe politikanë të caktuar boshnjakë janë përpjekur të na lënë fajin dhe përgjegjësinë për diçka që nuk e kemi bërë. Qëllimi ishte i qartë, si do të mbijetonte Republika Serbe nëse ajo ka lindur nga gjenocidi...“ Milorad Dodik, Kryetar i Lidhjes së socialdemokratëve të pavarur-SNSD dhe Kryetar i Republikës Serbe- me rastin e promovimit të partisë SNSD në mitingun qendror paralektoral në Srebrenicë, në vitin 2012. (Dnevni avaz- 24.09.2012).

<sup>36</sup> **Srebrenica-** Rasti i ndërtimit të kishës ortodokse pranë varrezës masive „Budak 2“, nga e cila janë ekshumuar trupat e 137 viktimate të gjenocidit, pak mbi Qendrën Memoriale në Potoçare. Sipas informatave të Këshillit nismëtar kundër lokacionit për ndërtimin e kishës në Budak, nën objektin që po ndërtohet gjenden mbetje tjera njerëzore të viktimate të gjenocidit, me çka po bëhen përpjekje të mëtejme përmblimin e krimit.

**Sarajevë-** Rasti i iniciativës për ngritjen e kryqit përkujtimor dhe kishës në Zlatishte (Trebeviq) mbi Sarajevë, në përkujtim të serbëve të vrarë. Në këtë vend ndodhej një nga bastionet e Ushtrisë së Republikës Serbe nga ku është granatuar dhe është qëlluar në mënyrë jo selektive nga snajperët gjatë kohës së rrethimit të qyteti të Sarajevës, që rezultoi me vrasje e mijëra personave. Me vendimin e Gjykatës Ndërkombëtare Penale për ish Jugosllavinë është vërtetuar përgjegjësia e gjeneralit të Ushtrisë së Republikës Serbe, Stanislav Galiqit. Në hapësirat përreth Zlatishtes nuk është vrapë asnjë civil i përkatësisë serbe, prandaj analistët në B & H mendojnë se një monument i këtillë, me formën dhe lokacionin e caktuar, nuk do t'i kontribuonte të vërtetës dhe pajtimit, përderisa autoritetet e Republikës Serbe janë të mendimit se në këtë mënyrë shprehet respekti për serbët e vrarë në Sarajevë.

**Prijedor-** Rasti i ngritjes së monumentit për ushtarët serbë në Trnopolje, pjesëtarëve të njësive që po të njëjtin vend kanë torturuar dhe keqtrajtuar boshnjakët dhe kroatët e Prijedorit.

ngritura nga të kthyerit shpesh përmbajnë kualifikime të njëjtë apo të ngjashme, siç u theksuan më parë.<sup>37</sup> Përkundër numrit të madh të monumenteve të ngritura, ngritja e të cilave po vazhdon ende, ekzistojnë lokacione që deri më sot nuk janë shënuar si vende të kryerjes së krimit për shkak se këtë nuk e lejon qeveria lokale apo për shkak të privatizimit të objekteve, të cilëve u është kthyer funksioni që kanë pasur para konfliktit të armatosur.<sup>38</sup> Ngritja e monumenteve në këtë mënyrë po minon mundësitet për pajtim, dëmton procesin e ballafaqimit me të kaluarën dhe keqpërdor viktimat, nga e cila përfitojnë vetëm politikanët lokal. Përpas këtyre shembujve negativ, janë shënuar raste kur monumentet e ngritura në mënyrë të qartë e përbushin detyrën e shënimit të vendeve të vuajtjeve dhe krimeve, dhe nuk përmbajnë kurfarë simbole respektivisht tekste nacionaliste dhe religioze, që në ndonjë mënyrë ofendon të tjerët. Iniciativat për ngritjen e monumenteve për shénimin e krimeve ndaj pjesëtarëve të grupeve tjera etnike janë të rralla, por kemi edhe shembuj të tillë mes të cilave përmendet rasti i shënimit të vuajtjeve të popullsisë jo boshnjake në vendin e quajtur Kazan mbi Sarajevë.<sup>39</sup> Monumentet përkujtimore pa simbole fetare i karakterizon fakti se në to janë shkruar vetëm emrat e viktimate, data e vrasjes së tyre dhe se a bëhet

fjalë për viktimë civile të luftës apo pjesëtar të ndonjë njësie të caktuar ushtarake. Po të analizojmë numrin e këtyre monumenteve në territorin e njërit apo entitetit tjetër mund të konstatohet me siguri se memorialë të tillë mund të gjemë vetëm në hapësirën e Federatës së Bosnjë dhe Hercegovinës, përderisa në monumentet në Republikën Serbe gjithmonë dominojnë simbolet religioze dhe kombëtare. Bazuar në gjendjen aktuale në gjithë territorin e B e H del qartë se fusha e memorializimit duhet të rregullohet në mënyrë ligjore dhe atë në nivel shtetëror, në mënyrë që të pengohen manipulimet me numrin dhe ndjenjat e viktimate. Ligji në këtë fushë duhet të përcaktojë, para së gjithash, standardet dhe kriteret që duhet të plotësohen me rastin e ngritjes së monumenteve përkujtimore, por edhe për organizimin e gjithë aktiviteteve komemorative që kanë të bëjnë me këto memorialë. Anketa e kryer nga ana e Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara në B e H (UNDP) tregoi se zgjidhja e kësaj çështje përmes miratimit të ligjit dhe standardizimit të ngritjes së memorialëve ka mbështetjen e shumicës së qytetarëve të BeH, ku 75.1% e tyre janë të mendimit se duhet të miratohet ligji në nivel të BeH që do të rregullonte ndërtimin e monumenteve dhe memorialëve.<sup>40</sup> Në kuadër të përgatitjes së Strategjisë për drejtësinë tranzicionale në BeH

- 
- 37 **Kriteret për simbolet shkollorë definojnë se cilët janë simbolet e pranueshme shkollorë:** ‘Plakat përkujtimore të luftës me emrat e të vdekurve, vitin e tyre të lindjes dhe rënies, të cilat nuk përmbajnë interpretime dhe kualifikime të luftës, si dhe monumentet që nuk kanë mesazhe të shkruara me përbajtje ofenduese dhe të papranueshme.’ Kriteret për emërtimin e shkollave dhe simbolet, II Kriteret për simbolet shkollorë, 1. Simbolet e pranueshme shkollorë (C).
- Rogatica** – Monumentin e ngritur për viktimat serbe të vitit 1992 në vendin e quajtur Kukavice ka mbishkrinin se objekti është ngritur në shenjë të kujtimit të përhershëm për “patriotët serbë të vrarë në mënyrë mizore nga ana e kriminelëve myslimanë”; mbishkrime të ngjashme gjemë edhe në Federatën e BeH, zakonisht të formuluarë: „viktima të masakrave çetnike”, „të vrarë nga granatat e shkrehura nga pozitat e agresorëve“ dhe kështu me radhë.
- 38 **Vishegrad** - Hoteli „Vilina vlas“ gjatë konfliktit të armatosur shërbente si kamp për dhunimin e femrave, ndërsa sot në atë vend nuk ka asgjë që do të përkujtonte krimet e tmerrshme që kanë ndodhur aty. Kryetaria e Shoqatës së grave – viktima të luftës, Bakira Haseçiq mendon se hoteli në fjalë do të duhej mbyllur dhe të shndërrrohet në qendër memoriale, por meqë kjo nuk është e mundur sepse ai tashmë është privatizuar, aty të paktën duhet të vendoset një shenjë përkujtimi. Autori i udhëzuesve turistikë, Tim Clancy, në shenjë respekti ndaj viktimateve e ka hequr hotelin „Vilina vlas“ nga udhëzuesit turistikë të BeH. Këto vend duhet të promovohen si „vende të ndërgjegjës“ ashtu që në këtë hotel të mbahen konferenca për të drejtat e femrave dhe dhunën seksuale, bashkë me prezantimin e fakteve për atë që ka ndodhur në këtë vend në të kaluarën.
- 39 **Sarajevë** – Rasti i shënimit të krimeve kundër qytetarëve jo boshnjakë në rajonin e Kazanit, mbi Sarajevë, të kryera gjatë vitit 1993 nga Brigada e 10-të malore e Armatës së Republikës së B e H, me të cilën komandonte Mushan Topaloviq Caco. Pas lufte, nga shpella e Kazanit janë nxjerrë mbetjet mortore të 29 personave, kurse janë identifikuar vetëm dhjetë viktima. Iniciativa për ngritjen e monumentit në Kazan ka ardhur nga ana e Zëvendës-kryetarit të Federatës së B e H, Svetozara Pudariq, me përkrahjen e Kryetari të komunës së Qytetit të Sarajevës, prof.dr. Alija Behmen. Nga viti 1994 deri më sot, për krimet në Kazan janë dënuar me burgim në kohëzgjatje nga 10 muaj deri në gjashtë viete 14 pjesëtarë të Armatës së Republikës së B e H. Për këtë krim të luftës kundër popullatës jo boshnjake të kryer në Sarajevë e rrethuar mbahet përgjegjës komandanti i Brigadës së 10 malore Mushan Topaloviq Caco, i cili është i dyshuar kryesor për vrasjen e civilëve, por edhe bashkëluftëtarëve të tij. Caco u vra në vitin 1993 gjatë konfrontimit të Udhëheqjes së Armatës së Republikës së Bosnjë dhe Hercegovinës me, siç është thënë atëherë, “kriminelët nga radhët e veta”.
- 40 E shprehur sipas përkatësisë etnike të respondentëve, këtë qëndrim e ndajnë 84.1% e boshnjakëve, 70.8% e serbëve, 52.6% e kroatëve dhe 85.6% e pjesëtarëve të nacionaliteteve tjera. *Ballafaqimi me të kaluarën dhe qasja në drejtësi nga perspektiva e opinionit, UNDP, 2010*, faqe 28 ([www.undp.ba](http://www.undp.ba)).

është paraparë zhvillimi i një procesi konsultativ me të punësuarit në institucionet e shtetit, ekspertët dhe qytarët, në mënyrë që të definohen standartet për memorializim, të bëhet arsimimi i nevojshëm, të arrihet konsensus në lidhje me ditët e përkujtimit të përbashkët dhe ndërtimit të kompleksit të përbashkët memorial për të gjitha viktimat e luftës në BeH.<sup>41</sup> Dallimet mes qytetarëve shfaqen kur bëhet fjalë për ngritjen e një monumenti kryesor për të gjitha viktimat e luftës në BeH. Idenë e ngritjes së një memoriali të ri e përkrahin rreth 64% e respondentëve në BeH (84% e boshnjakëve, 58% e kroatëve dhe vetëm 39% e serbëve), rreth 75% e respondentëve nga Federata e Bosnjë dhe Hercegovinës dhe rreth 43% nga Republika Serbe, përderisa respondentët nga Distrikti Brçko e përkrahin këtë ide në përqindje shumë të lartë (mbi 90%).

Mendimi i qytetarëve për monumentet e ngritura deri tani është pozitiv dhe pak a shumë uniform. Kështu për shembull, 72% e respondentëve janë të mendimit se monumentet dhe memorialët e ngritura deri më tani janë të dobishëm për procesin e ballafaqimit me të kaluarën. Shikuar në bazë të entitete rezultatet duken kështu: 80% e të pyeturve nga Federata e BeH mendojnë se memorialët janë të dobishëm për procesin e ballafaqimit me të kaluarën, kurse kjo përqindje në Republikën Serbe është rreth 67, përderisa në Distriktin e Brçkos 63% e respondentëve theksuan se monumentet e tillë nuk janë të dobishme.<sup>42</sup> Nëse i analizojmë rezultatet e UNDP-së duket qartë qëndrimi pozitiv ndaj monumenteve të ngritura deri më tani, arsyen për këtë duhet kërkuar në faktin se shumica e monumenteve të ngritura reflektojnë pikëpamje të njëjanshëm për të kaluarën dhe ngjarjet që përkujtohen, që në asnjë mënyrë nuk i ndihmon ballafaqimit me të kaluarën e përbashkët dhe pajtimit përfundimtar.

### **Strategjia e drejtësisë tranzicionale dhe memorialët në Bosnjë e Hercegovinë**

Meqë ballafaqimi me të kaluarën është me rëndësi për një të ardhme të qëndrueshme në BeH dhe për shkak të interpretimeve të ndryshme të së kaluarës së kohëve të fundit, këtij problemi duhet qasur në mënyrë sistematike dhe

gjithëpërfsirëse, për të dhënë rezultate të caktuara. Këshilli i Ministrave të BeH ka nisur aktivitetet për hartimin e Strategjisë për drejtësinë tranzicionale në BeH e cila bazohet në *Raportin mbi konsultimet e kryera*, të cilin *Këshilli i Ministrave të BeH* e miratoi në maj të vitit 2009. *Ministria për të Drejtat e Njeriut dhe refugjatë e BeH, Ministria e Drejtësisë së BeH dhe Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim* (UNDP) mbajtën konsultime, gjatë të cilave përfaqësues të qeverisë, organizatave të shoqërisë civile dhe shoqatave të viktimate paraqitën qëndrimet e tyre, gjë që përkufizoi nevojën për zgjidhjen e problemeve nga e kaluara përmes përgatitjes së *Strategjisë* në nivel shtetëror. Në vitin 2010, UNDP-ja hulumtoi qëndrimin e opinionit publik, ku 90% e respondentëve u shprehën se qeveria e BeH duhet të përgatis një plan konkret për çështjet e ballafaqimit me të kaluarën. Strategjia e drejtësisë tranzicionale ka qëllime të definuar qartë, të cilat duhet të arrihen brenda periudhës së caktuar, ku qëllimi kryesor është korrigimi i padrejtësive të ndodhura gjatë konfliktit të armatosur prej vitit 1992 deri në 1995. Duhet theksuar edhe atë se strategjia është marrëveshje politike, në përputhje me rregullimin kushtetues dhe ligor të BeH dhe standardet ndërkombëtare që rregullojnë mbrojtjen e të drejtave elementare njerëzore. Strategjia e drejtësisë tranzicionale merret me çështjet relevante nga fusha e drejtësisë tranzicionale, posaçërisht ato të cilat deri më tani nuk janë shqyrtuar në mënyrë adekuate nga ana e institucioneve të qeverisë, ku vend të veçantë zënë memorialët.

Në bazë të rezolutës së *Asamblesë së Përgjithshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara*, satisfaksi i viktimate paraqet një nga format e reparacioneve, prandaj, në përputhje me këtë, çështja e memorializimeve në *Strategjinë e drejtësisë tranzicionale* klasifikohet në fushën e reparacioneve, ndonëse ajo është më e komplikuar në krasim me vetë reparacionet dhe vepron jashtë kësaj sfere, në fushën e vërtetimit të fakteve, të drejtave të njeriut, ndërtimit të besimit në institucionet qeverisëse, tregimit të së vërtetës dhe pajtimit.<sup>43</sup> Siç edhe është thënë, çështja e memorializimit në BeH paraqet një fushë e cila për momentin është tërësisht e pa organizuar, me rritje të vazhdueshme të pakënaqësi-

41 Në vitin 2011, në varrezat Vlakovo të Sarajevës është zbuluar **Monumenti i paqes**, kushtuar të gjitha viktimate që humbën jetën në BeH gjatë luftërave të kaluara si dhe pjesëtarëve të vrarë të misioneve paqësore në BeH.

42 Ballafaqimi me të kaluarën dhe qasja ndaj drejtësisë nga perspektiva e publikut - Raporti special i Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim në BeH (UNDP-ja BeH), 2010, faqe 27.

43 Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara më 16 dhjetor 2005 miratoi Parimet dhe direktivat themelore përmjete juridike dhe reparacion për viktimat e shkeljeve të së drejtës ndërkombëtare dhe shkeljeve serioze të së drejtës ndërkombëtare humanitare.

ve dhe kundërthënieve të shumta. Me rastin e hartimit të Strategisë për drejtësinë tranzicionale janë identifikuar këto probleme dhe është thënë se:

- 1. procesi i memorializimit është politizuar dhe shpreh pikëpamje të njëanshme mbi ngjarjet e së kaluarës;**
- 2. evidentohen mospërputhje dhe mos koordinim legjislativo-institucional sa i përket inicimit, aprovimit dhe financimit të ndërtimit të memorialëve.**

Gjendjen e tanishme më së miri e pasqyron fakti se familjet e viktimate të cilat duan të organizojnë komemoracione në vendet e kryerjes së krimeve vazhdojnë t'u nënshtrohen maltritimeve të ndryshme. Disa komuna në BeH kanë refuzuar të japid miratimin urbanistik për ngritjen e monumenteve edhe pse familjet e viktimate ishin të gatshme ta financojnë ndërtimin e tyre. Për pasojë, një numër i caktuar i vendeve ku janë kryer krime masive mbeten akoma të pashënuara. Monumentet e vendosura janë cak i shkatërrimeve, mohimeve, heqjeve dhe dëmtimeve të vazhdueshme, që shoqërohet me ofendime, përgojime të viktimate dhe mohim të statusit të tyre.<sup>44</sup> Memorialët e ndërtuara në BeH janë paraqitje statiko-fizike të një ngjarje të caktuar historike me karakteristika të theksuara sakralo-religioze, të cilat shpeshherë ngriten në afersi të objekteve të shenja të konfesioneve përkatëse. Funksioni kryesor i memorialëve do të ishte provokimi i reaksioneve emocionale si mes familjeve të viktimate ashtu edhe mes anëtarëve të bashkësisë etnike të cilës i takonin viktimat. Me këtë lidhet funksioni pedagogjik i memorialëve, i cili ende nuk realizohet për arsy se mungon dialogu për atë se çka paraqesin memorialët sikurse edhe për tema bashkëkohore shoqërore që kanë të bëjnë me çështjet e memorialëve.

## Memorialët dhe religjioni në BeH

Edhe pse deri më tani ndikimin më të madh në fushën e memorializimit në BeH e ka pasur politika, asnjëherë nuk duhet harruar rolin e madh që ka religjioni dhe bashkësitetë fetare në përcaktimin e pamjes së monumenteve, raportit ndaj viktimate dhe përkujtimin e një komuniteti. Institucionet fetare janë bërë qendra e kujtesës së një populli në ri-afirmimin e tij nacional dhe religjioz. Bashkësitetë e tre religjioneve monoteiste, kisha ortodokse dhe katolike si dhe bashkësia islamë, me shekuj të tërë kanë pasur rol të veçantë në shoqërinë e Bosnjës dhe Hercegovinës dhe rregullisht kanë përdorur simbolet universale fetare të njoitura në gjithë botën, siç janë kryqi, gjysmëhëna, citatet nga Bibla dhe Kurani, por edhe ato që tashmë kanë qenë të nacionalizuara. Po të nisemi nga qëndrimet themelore të religjionit, do të shohim se mësimet e tij lidhen me ngjarje dhe monumente, kurse luftërat gjithmonë janë të mbështjella me vellon mitologjike që ka të bëjë me trima, viktima, përmendore dhe fitore. Klerikët kanë pasur rol të veçantë gjatë kohës së konfliktit të armatosur sepse shpesh kanë mbajtur ceremoni fetare dhe kanë dhënë mësime religioze për ushtarët, në prezencë të fotografive të udhëheqësve të atëhershëm (shumica nga të cilët sot janë kriminelë lufte) ku nuk mungon simbolet dhe ikonografia fetare.<sup>45</sup> Formimi i identitetit kombëtar është i lidhur me konceptet të cilët përcaktojnë kufirin në raport me të tjerët, theksojnë dallimet (që në realitet janë minimale) dhe krimet që një bashkësi etnike i ka kryer ndaj tjetrës në të kaluarën e afërt dhe të largët. Konflikti i armatosur në BeH u zhvillua brenda një shoqërie multi-konfeksionale, në të cilën vetëm tash, nga një distancë e caktuar kohore, që ndoshta nuk është e mjaftueshme, mund ta shohim instrumentalizimin e religionit në luftë. Pas gjithë këtyre zhvillimeve, duket sheshazi se simbolet

44 Disa nga monumentet që kanë ngjallur reagime të shumta në opinionin e Bosnjë Hercegovinës, siç është rasti me vendosjen e monumentit në varrezën boshnjakë Strazhishët në Vishegrad, për të cilën inspektori komunal për urbanizëm dhe ndërtim mori vendim që të largohet sepse ishte ngritur pa leje përkatëse dhe në truallin që është pronë e Bashkësisë Islame të Bosnjë dhe Hercegovinës.

Mospajtime të mëdha në Republikën Serbe provokoi mbishkrimi ku thuhet se monumenti u kushtohet „të gjithë boshnjakëve të vrasë dhe të zhdukur, fëmijëve, grave dhe burrave, viktima të gjenocidit në Vishegrad“. Në rastin e kampit Omarska (në Prijedor) në vendin e vuajtjeve dhe torturimit nuk ekziston asnjë shenjë kujtimi. Familjet e viktimate kërkojnë që në vendin e kampit, që tani është në pronësi të Arcelor Mittal-it, të ngritet monumenti në mënyrë që të shënohen vuajtjet e përjetuara gjatë luftës së kaluar. Por, as Arcelor Mittal e as pushtetarët e Priedorit nuk lejojnë ngritjen e monumentit. Grumbullimi në këtë vend vuajtjesh lejohet vetëm një ditë në vit, më 6 gusht. Shoqata e popujve të rrezikuar kërkoi nga qeveritë evropiane që të ushtrojnë presion ndaj Arcelor Mittalit që të lejojë ndërtimin e monumentit.

45 Operacionet ushtarakë dhe vrasja e pjesëtarëve të komuniteteve tjera shpeshherë është paraqitur si luftë në emër të Zotit, si dëshmi e besimit, luftë e shenjtë, vetëmbrojtje, luftë në emër të kryqit të shenjtë, ndërsa të vrarët në këto operacione nga radhët e veta konsiderohen heronj të sakrifikuar përfshirë kombin. Shumica e monumenteve kushtuar atyre janë shndërruar në vende të shenjta, me një numër të madh të simboleve dhe mesazheve religioze.

religjioze të shoqëruara me mbishkrime me fjalët vuajtje, eksod dhe gjenocid, dominojnë në monumente, kurse për gjithë këtë fajtorë janë ekstremistët e kombit tjetër.<sup>46</sup> Arsyen e „monumenteve një nationale“ mund ta kërkojmë në faktin se luftërat në shoqëritë shumë-konfeksionale çojnë në homogenizim në të gjitha aspektet, duke përfshirë këtu edhe fushën e memorializimit, duke përhapur vazhdimisht idenë se një vend i caktuar paraqet fortësën e fundit të botës ortodokse, katolike apo myslimanë. Është interesant besimi i përhapur në BeH dhe në Ballkan se objektet që simbolizojnë përkatësinë religjioze mund të ndihmojnë në shmangien e fateve tragjike dhe arritjen e shenjtërisë së një vendi dhe për këtë arsyen në monumentet e ngritura janë prezentë simbolet religjioze (kryqi, gjysmëhëna dhe ylli, citatet nga librat e shenjtë etj.), praktikë kjo që është në kundërshtim me mësimet themelore të religjioneve konkrete. Prezenca e gjithë këtyre simboleve religjioze në procesin e memorializimit duhet kërkuar në lidhjen shkak-pasojë me parimin që dominonte gjatë kohës së konfliktit të armatosur në BeH, i cilin nënkupton se konfrontimi përfundimtar me armikun vjen vetëm pas konfrontimit paraprak me simbolet dhe objektet e tij, gjë që ndihmon në përcaktimin e territorit të ushtrisë dhe popullit fitimtar.<sup>47</sup> Pas lufte, objektet fetare ishin të parat në listë për rindërtim, e pas tyre vjen vendosja e monumenteve përviktimat e grupit përkatës etnik ne vend të caktuara. Simbolet religjioze nuk duhet të vlerësohen si diçka *a priori* të drejtuar kundër tjetrit dhe të huajës, e as si elemente të paqes. Atyre u japid domethënë interpretimet e çastit.

### **Qasje e re ndaj memorializimeve në BeH**

Sot në BeH ekziston një numër i shembujve të cilët e kanë arritur vlerën simbolike përmes shprehjeve të pastra artistike, pa përfshirje të panevojshme të religionit në gjithë këtë tregim.<sup>48</sup>

Më 9 maj 2009, në Ditën e Evropës dhe Ditën e fitores mbi fashizmin, në Sarajevë u zbulua monumenti kushtuar fëmijëve të vrarë në Sarajevën e rrëthuar, pavarësisht përkatësisë së tyre kombëtare. Monumenti është ndërtuar sipas zgjedhjes ideore të një skulptori sarajevas, i cili, së bashku me artistë tjerë, e punoi monumentin për më shumë se një vit dhe u përpoq që përmes punës së tij të dërgojë mesazhin simbolik për fëmijët e vrarë në luftë, derisa ishin duke luajtur, duke rrëshqitur me saja, duke mësuar në shkollë apo duke fjetur në shtrat. Ky shembull tregon qartë se si mund të dërgohet një mesazh i fuqishëm përmes një vepre artistike, pa u shërbyer me simbole fetare apo fjalë që në çfarëdo mënyre mund ta lëndojnë tjetrin. Në vitin 2012 në Sarajevë u shënua përkujtimi i një ngjarjeje nga koha e konfliktit të armatosur, që nuk nënkuonte patjetër vendosjen e monumentit si objekt fizik, por kjo u bë përmes veprave artistike. Manifestimi „*Vija e kuqe e Sarajevës*“, i ideuar nga një grup artistësh, është mbajtur me rastin e 20 vjetorit të fillimit të rrëthimit të qytetit nga ana e Armatës Popullore të Jugosllavisë dhe Ushtrisë së Republikës Serbe. Në qendër të qytetit janë vendosur 11.541 karrige të kuqe, përmes së cilës në mënyrë simbolike është paraqitur çdo qytetar i Sarajevës i vrarë gjatë kohës së rrëthimit. Me mijëra qytetarë dhe një numër i madh i zyrtarëve nga vendi dhe bota dolën në rrugë për t'i nderuar viktimat. Para Flakës së përhershme është mbajtur një koncert me pjesëmarrjen e një numri të madh të koreve dhe solistëve. Në vitrinat e të dy anëve të qytetit, qytetarët kanë mundur të shohin ekspozitën e posterëve nga koha e rrëthimit, që tregon përmënyrën se si zhvillohejjeta në ato kushte, ku përkundër 300 granatave, aq sa mesatarisht binin mbi Sarajevë brenda ditës, në qytet organizoheshin shfaqje teatrale dhe koncerthe, btoheshin gazeta ditore dhe mbaheshin festivale. Kjo ngjarje kishte jehonë të madhe në opinionin publik të gjithë botës, të atillë që nuk mund ta ketë asnjë monument i vendosur dhe që praktikisht paralajmëron një mënyrë të re të memorializimit për rajonin tonë. Projekti

- 
- 46 Sipas **Juergensmeyeru-it** një nga hapat kryesor në zhvillimin e nacionalizmit ideologjiko-religjioz është identifikimi i armiqve (duke vështruar politikën nga prizmi religjioz bëjnë që rrënjet e problemeve shoqërore dhe politike portretizohen me terminologji religjioze; armiqtë e tyre janë ose pjesëtarët e religionit tjetër ose janë jo religjiozë, por veprojnë kundër religionit, për shembull, sekularistët).
- 47 Sipas vlerësimeve të ndryshme gjatë kohës së konfliktit të armatosur në BeH u rrënuan mes 1000 dhe 1100 xhami, 340 kisha dhe manastire ortodokse dhe 450 kisha dhe manastire katolike.
- 48 Në vitin 2012 në Sarajevë u hap Galeria e parë memoriale në BeH “11/07/95”, në të cilën janë eksposuar në mënyrë të përhershme eksponate në shenjë kujtimi të gjenocidit të kryer në Srebrenicë, në vitin 1995. Projekti për këtë galeri është zhvilluar për disa vite nga fotografi Tarika Samaraha. Galeria ka hapësirë të duhur dhe është rregulluar sipas standardeve më të larta. Pjesa më e madhe e hapësirave të galerisë është dedikuar për ekspozitën e përhershëm, përderisa pjesa tjetër është paraparë për ekspozita të përkohshme. Fotografitë e autorit Tarika Samaraha bashkë me video dokumentet – hartat e gjenocidit dhe deklaratat e dëshmitarëve të mbijetuar, portretet e viktimateve dhe hartat e vendeve në të cilat deri më sot janë gjetur varrezat masive, të eksposuara në Galerinë “11/07/95”, janë në funksion të ruajtjes së kujtesës për vuajtjet e srebernicasve.

më i rëndësishëm nga kjo fushë në periudhën e pasluftës pa mëdyshje se është shënim i përhershëm i gjenocidit të kryer ndaj boshnjakëve në Srebrenicë. Me vendimin e Përfaqësuesit të lartë, Wolfgang Petrich, në vitin 2000 është siguruar trualli i përhershëm në Potoçare (Srebrenicë) për ngritjen e memorialit dhe varrosjen e të gjitha viktimate të gjenocidit. Në anën tjetër të rrugës, përballë hapësirës memoriale gjendet "Fabrika e akumulatorëve" – objekt i kohës së paraluftës, që shfrytëzohej si seli e batalionit holandez gjatë vitit 1994-1995 (baza Charlie). Me urdhëresën e vitit 2003 të Përfaqësuesit të lartë, Paddy Ashdown, është përcaktuar që ky lokacion t'i takojë "Qendrës Memoriale të Srebrenicës në Potoçari". Hapësira Memoriale në Potoçar, në kontekstin e çështjes së memorialëve, mund të përmendet si shembull i ekuilibrit të dukshëm në mes objekteve religioze/sakrale dhe memorialëve të cilat në plotësojnë njëri-tjetrin. Në Qendrën Memoriale të vitit 2010 është varrosur edhe një viktimë e besimit katolik, me çka u bë e qartë se në të njëjtin vend mund të kryhen rituale të ndryshme religioze, për t'i përkujtuar dhe nderuar përgjithmonë viktimat e gjenocidit, duke respektuar plotësisht identitetet e tyre fetare dhe nacionale pa tensione dhe manipulime të panevojshme.<sup>49</sup> Përpas këtyre shembujve të ndërtimit të objekteve përkujtimore, në shumë qytetet të garantuara pandërprerë kanë mbetur shenja të dukshme të eksplodimit të granatave në trotuare, asfalt dhe rrugët e qytetit, të cilat më pas janë mbushur me ngjyrë të kuqe, duke paraqitur në këtë mënyrë një formë të veçantë të memorializimit. Mbetjet e këtilla në Sarajevë quhen „trëndafilit sarajevas“, të cilat janë ruajtur deri më sot në pothuajse të gjitha pjesët e qytetit dhe paraqesin monumente të veçanta si vërejtje për gjeneratat e ardhshme.<sup>50</sup>

Në bazë të asaj që është thënë më lartë mund të përfundojmë se praktika e deritanishme e ngritjes së monumenteve

në BeH nuk është në përputhje me parimet e drejtësisë tranzicionale në shoqëritë e pas konfliktit. Gjendja aktuale i kontribuon thellimit të vazhdueshëm të mosbesimit, rritjes së tensioneve etnike dhe zvogëlimit të hapësirës për dialog konstruktiv në mes të grupeve të ndryshme etnike. Miratimi i ligjit në nivel shtetëror nuk do t'i zgjidhte në tërësi të gjitha çështjet që lidhen me procesin e memorializimit, por do të ndihmonte në përmirësimin e gjendjes së përgjithshme. Duhet përjashtuar mundësia e çfarëdo zhvendosjeje apo shkatërrimi të dhunshëm të monumenteve që tashmë janë vendosur, me qëllim që të parandalohen situata tjera të konfliktit. Kohëve të fundit duket se procesi i memorializimit po bartet nga hapësirat e parqeve të qyteteve, sheshive, kampave dhe vendeve tjera të vuajtjeve në libra dhe format e „memorializimit elektronik“, të cilët po bëhen gjithnjë e më të rëndësishëm në procesin e ballafaqimit me të kaluarën dhe përbushjen e qëllimeve të drejtësisë tranzicionale. Vend të rëndësishëm në kuadër të këtij procesi zë „**Libri boshnjak i të vdekurve**“, për të cilin françeskani boshnjak dhe profesor i Teologjisë françeskane në Sarajevë, at Ivan Sharçeviq thotë: „Para nesh janë katër libra të rendë, të rendë si e kaluara jonë. Por kjo është e vërteta jonë, e vërteta e rendë dhe çliruese. Ky është monumenti i parë i përbashkët për të gjithë në Bosnjë dhe Hercegovinë, libër kujtimi me emrat e boshnjako-hercegovasve - përkujtim (germanisht Denkmal) për të gjitha viktimat e luftës, monumenti si vërejtje (Mahnmal) për të ardhmen.“<sup>51</sup> Ky regjistër me 95.940 emra ndihmon në mënyrë origjinale që të parandalohet manipulimi duke ia kthyer identitetin dhe dinjitetin çdo viktimitë numëruar. Ngjashëm me shembullin e Jasenovcit dhe vendet tjera ku u kryen krimet gjatë Luftës së II-të Botërore, edhe në këtë rast mund ta shohim rëndësinë e përcaktimit të numrit dhe identitetit të viktimateve, në mënyrë që të pamundësohen manipulimet në të ardhmen.<sup>52</sup> „Libri boshnjak i të vdekurve“ paraqet një kulturë të re të kujtimit në BeH,

- 
- 49 Në hapësirat e Qendrës Memoriale „Srebrenica-Potoçari“ është varrosur edhe Rudolf Hren, viktimë e gjenocidit në Srebrenicë, i cili për herë të fundit është parë më 10 korrik 1995. Pesëmbëdhjetë vjet më pas, në vitin 2010, trupi i Rudolfit është identifikuar në një nga varrezat masive në rrëthinat e Srebrenicës.
- 50 Rrëthimi i Sarajevës ka zgjatur 44 muaj dhe konsiderohet një nga më të gjata në historinë bashkëkohore. Vlerësohet se gjatë kohës së rrëthimit në qytet kanë rënë mesatarisht 300 granata në ditë. Çdo granatë që ka eksploduar në rrugë, rrugë të betonuar apo ndonjë platformë të fortë ka lënë kratere në formë të lules.
- 51 Sharçeviq Ivan; Kultura e kujtimit: „**Libri boshnjak i të vdekurve**“; Gazetat elektronike. Mund të keni qasje në: <http://www.e-novine.com/drustvo/78460-Bosanska-knjiga-mrtvih.html>.
- 52 „Më nuk do të ketë lojë me numra se pse ne aplikojmë standarde në bazë të të cilëve ata që duan të flasin për numra duhet të thonë emra. Së dyti, përmes kësaj ne ruajmë kujtimin për bashkëqytetarët tanë dhe përpipemi ta lirojmë narrativin e përditshëm nga mitet ideologjike, interesat politike dhe nacionale, kurse gjërat t'i quajmë me emrin e vërtet – e këto janë emri dhe mbiemri i viktimitës“ - Mirsad Tokaça (<http://www.video.radiosarajevo.ba/novost/100710/bosanska-knjiga-mrtvih-95940-zrtava-bh-drzavljana>).

e cila nuk ka për qëllim ta barazojë krimin dhe njëkohësisht paraqet një monument trans-nacional dhe trans-religjioz për të gjitha viktimat e konfliktit të armatosur. Përpos kësaj forme të memorializimit kemi edhe versionet elektronike të shënimit të vuajtjeve dhe krimeve të kryera, përmes të cilëve njeriut bashkëkohor i mundësohet qasja në ngjarje, deklarata të dëshmitarëve, dokumente dhe vizita virtuale në vendet e krimit. Në hapësirat e BeH përmendet Muzeu virtual i rrethimit të Sarajevës - koleksioni FAMA, që paraqet një lloj banke të diturisë për përdorim gjerë, i cili është në dispozicion për të gjithë profesionistët që merren me antropologji, sociologji, marrëdhënie ndërkombëtare, të drejta të njeriut, histori, psikologji, art, filozofi dhe media. Koleksioni FAMA në të ardhmen duhet ta ketë vitrinë e vet në kuadër të Muzeut të rrethimit të Sarajevës, për të cilën komuna Qendër tashmë e ka siguruar truallin, kurse qyteti i Barcelonës ka shprehur dëshirën për të ndihmuar ndërtimin e hapësirave të muzeut.<sup>53</sup> Koleksioni gjithashtu ofron mundësi të krijimit të një modeli rajonal të edukimit për interpretimin e periudhës së shpërbërjes së Jugosllavisë gjatë viteve 1991 - 1999. Iniciativa e të rinjve për të drejta të njeriut në BeH gjithashtu ka dhënë kontributin e vet duke paraqitur në hartë gjenocidin në Srebrenicë, i cili i dedikohet edukimit të brezave të rinj përmes animacioneve dokumentare si një nga modelet e reja, në të cilat qasja është e lehtë përmes internetit.<sup>54</sup> Projekti është ndërtuar në fazë bazuar në faktet nga dokumentet e institucioneve që janë marrë me gjenocidin në Srebrenicë dhe në çdo hartë janë paraqitur pikat kryesore ku gjenden provat (dokumentet e shkruara, skicat, fotografitë, videot).

## Në vend të përfundimit

Mund të konkludohet në fund se problemet në fushën e me-

rialëve në hapësirat e BeH burojnë nga pamundësia për një qasje gjithëpërfshirëse ndaj kësaj çështjeje, si në kuadër të entiteteve ashtu edhe në Distriktin e Brçkos. Strategja për drejtësinë tranzicionale në BeH përcakton zgjidhjen përmes së cilave do të realizohet vizioni i memorialëve si formë e reparacionit simbolik.<sup>55</sup> Praktika e deritanishme në ngritjen e monumenteve ka treguar mosnjohje të plotë të konceptit të drejtësisë tranzicionale, duke thelluar vazhdimi të tensionet dhe mungesën e dialogut në mes qytetarëve. Miratimi i rregullores ligjore në nivel shtetëror dhe vendosja e kritereve të caktuara do ta përmirësonë gjendjen posaçërisht në fushën e memorialëve, të cilët janë ngritur pa verifikimin paraprak të faktave nga ana e gjykatës dhe do ta bartte vendimmarrjen nga niveli lokal në atë qendror. Duhet thënë qartë se asnje strategji apo zgjidhje ligjore nuk do t'i kënaqë të gjitha grupet etnike në BeH, sepse këndvështrimet e ndryshme për ngjarjet e viteve të nëntëdhjeta do të vazhdojnë edhe më tej të prodhojnë mospajtime në fushën e memorialëve, megjithatë është detyrë e secilit shtet që ta rregullojë këtë fushë, duke e parë atë si një nga të drejtat e garantuarar të viktimate për shkak të vuajtjeve që kanë përfjetuar. Mbetet të shpresohet se në të ardhmen e afërt do të jetë i mundur miratimi i ligjit i cili do të rregullojë gjithë fushën e memorialëve apo të paktën ngritjen e monumenteve në vendet e varrezave masive, për çka mund të gjenden shembuj në sistemet ligjore të shteteve fqinje.<sup>56</sup> Ndryshimet e konteksteve shoqërorë dhe politike në rajonin tonë, e me këtë edhe në BeH, duhet të çojnë ne ndryshimin e raporteve ndaj memorialëve dhe të kaluarës, bashkë me edukimin dhe informimin e vazhdueshëm, posaçërisht të gjeneratave të reja, për ngjarjet gjatë konflikteve të armatosura, në mënyrë që diçka e ngjashme të mos përsëritet në të ardhmen.

53 <http://www.famacollection.org/bhs/ç>

54 <http://www.srebrenica-mappinggenocide.com/bh-m/>

55 Vizioni i mekanizmit: Sigurimi i së drejtës për reparacion dhe ruajtja e kujtimit kolektiv për ngjarjet e periudhës 1992-1995, në mënyrë që të tejkalojen pasojat e shkeljeve të të drejtave universale të njeriut dhe të drejtës humanitare ndërkombëtare, rikthimi i dinjitetit të gjitha viktimate të luftës dhe sigurimi i rikthimit të tyre në shqëri. –Strategja e drejtësisë tranzicionale në Bosnjë dhe Hercegovinë për periudhën 2012-2016.

56 Republika e Kroacisë qysh në vitin 1996 miratoi **Ligjin për shënimin e vendeve të varrezave masive nga lufta e fundit** (NN 100/96) me qëllim që ta ruajë përrherë kujtimin për viktimat. Të gjitha çështjet e rëndësishme që lidhen me mënyrën e përcaktimit të vendit të varrezave masive dhe shënimit të tyre duke vendosur një përmendore unike, janë përcaktuar me ligj. Monumenti është vepër e skulptorit akademik Slavomir Drinkoviç dhe ka tekst identik ku thuhet se monumenti është ngritur në kujtim të mbrojtësve dhe civilëve kroatë të vrarë gjatë agresionit serbomadh kundër Republikës së Kroacisë, kurse në nënshkrim thuhet „nga kombi kroat“. Sidoqoftë, në Kroaci ka pasur edhe varreza masive ku viktima nuk ishin vetëm kroatët por edhe pjesëtarë të nacionaliteteve tjera, siç është, për shembull, varreza masive në Golubnjaç, nga e cila janë ekshumuar dhe identifikuar pjesëtarë të komunitet serbë dhe varreza masive Vasiq bare në Cetingrad, ku janë ekshumuar dhe identifikuar boshnjakët. Këto varreza janë në procesin e shënimit, por shtrohet pyetja: a është e përshtatshme që kudo të vendoset i njëjtë memorial? Gazetat kombëtare numër 100/96.

# Analizë krahasuese e teksteve të historisë

Sanjin Hamidičević/Nenad Mišković

## Hyrje

Ky hulumtim merret me përcaktimin e raporteve në mes përbajtjes së programit mësimor në tekstet e historisë dhe procesit të ballafaqimit me të kaluarën. Pyetja që shtrohet këtu është: nëse përbajtja e teksteve mësimore (shkollore) kontribuon në pranimin e fakteve për ngjarjet e së kaluarës në territorin e ish-Jugosllavisë apo jo, dhe nëse programet shkollore, ashtu siç paraqiten ngjarjet nga e kaluara e popujve, që jetojnë në BeH dhe Serbi në tekstet e historisë, i kontribuojnë pajtimit në shoqëritë e paskonfliktit në territorin e ish-RSFJ-së?

Duke konsideruar se programet mësimore në tekstet e lëndës së historisë, që shfrytëzohen në sistemet arsimore në Serbi dhe BeH, nuk i paraqesin ngjarjet në të njëjtën mënyrë apo në mënyrë të ngjashme, ne përpinqemi të theksojmë nevojën e rishikimit të teksteve mësimore në nivel rajonal, për të kontribuar në pajtimin e shoqërive të paskonfliktit në territorin e ish-RSFJ-së.

Kemi analizuar gjithsej 17 tekste shkollore për shkolla filllore dhe të mesme nga lënda e historisë (tre nga Serbia, katërmbëdhjetë nga BeH, nëntë nga të cilat në gjuhën boshnjake,

katër në shkollat ku mësimi zhvillohet në gjuhën kroate dhe një tekst shkollor nga Republika Serbe).

Edhe pse në shikim të parë mund të duket se mostra nuk është përcaktuar në mënyrë të duhur, për shkak të numrit jo të njëjtë të teksteve mësimore nga Serbia, dhe atyre në gjuhën boshnjake dhe kroate, kjo nuk qëndron. Specifika e sistemit arsimor në Bosnjë dhe Hercegovinë me numrin e madh të programeve të ndryshme arsimore dhe rrjedhimisht numër të madh të teksteve shkollore, kërkon që të analizohen shumë tekste të historisë. Nga ana tjetër, sistemi arsimor në Serbi është më i thjeshtë në krahasim me atë të BeH dhe për këtë arsy numri i teksteve mësimore që shfrytëzohen në sistemin arsimor është shumë më i vogël.

Përkundër faktit që mostra nuk është reprezentative, duke marrë parasysh të gjithë faktorët që ndikojnë në ofertën dhe shpërndarjen e teksteve mësimore, të dhënat ë shfrytëzuara në këtë analizë mund t'i konsiderojmë metodologjikisht korekte.

Në këtë hulumtim kemi analizuar vetëm disa pjesë të teksteve shkollore, që trajtojnë ngjarje të caktuara historike ku janë konfrontuar në mënyrë të drejtpërdrejt apo indirekte

Vendi i shfrytëzimit	Numri	Gjuha	Numri
Bosnja dhe Hercegovina	14	Boshnjake	9
Federata e Bosnjë dhe Hercegovinës	13	Kroate	4
Republika Serbe	1	Serbe	4
Serbi	3		

popujt nga territoret e ish-RSFJ-së apo ato që janë objekt diskutimesh publike në vendet e dala nga shteti dikur i përbashkët, në mënyrë që më pas t'i krahasojmë përbajtjet e këtyre teksteve përmes mënyrën e paraqitjes së ngjarjeve të zgjedhura historike: Lufta e Kosovës, Lufta e Parë Botërore (arsyeja e fillimit të saj), Shpërberja e Jugosllavisë (konfliktet e armatosura në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Kroaci), kriza në Kosovë dhe Metohi dhe Bombardimi i Jugosllavisë.

Lufta e Kosovës 1389.

Në tekstet shkollorë që janë në shfrytëzim në hapësirën e Bosnjë dhe Hercegovinës Lufta e Kosovës e viti 1389 përmendet në kontekst të depërtimit të ushtrisë osmane në Evropën Juglindore, prandaj kësaj ngjarjeje, në librat e historisë, i kushtohen mesatarisht 50 fjalë. Ngjarje paraqitet në përputhje me faktet historike, pa u dhënë rëndësi aspektave të panevojshme.

Në përgjithësi theksohet se ushtria osmane i mundi forcat serbe dhe të feudalëve tjerë Ballkanik, që pati për pasojë rënien e Serbisë në marrëdhënie vasale ndaj sultanit dhe Perandorisë Osmane. Më së shumti informacion gjemë në librin e historisë për klasën e katërt të shkollës fillore të botuesit ‘Bosanska riječ’ (‘Fjala boshnjake’), ku përmendet bashkëpunimi i primit Lazar dhe mbretit boshnjak Tvrtka, si dhe Vuk Brankoviqit, kryesisht në kontekstin se zotërimet e Vuk Brankoviqit ishin shndërruar në bazë ushtarake për veprimet në drejtim të Hungarisë, Bosnjës dhe Zetës. Në tekstin mësimor për vitin e parë të shkollave të mesme profesionale të botuesit ‘Enti për tekste dhe mjete mësimore’ nga Sarajeva Lindore, në pjesën kryesore të tekstit për luftën e Kosovës flitet për „kolosët serbë“ të cilët u „mblodhën [...] me qëllimin që t’iu kundërvihen turqve“<sup>57</sup>, ndërsa nën tekstin pëershkrues ku ilustrohet portreti i Lazar Hrebeljanovicit përmenden edhe kolosi serb Vuk Brankoviq dhe kolosi boshnjak Vlatko Vukoviq.

Një paraqitje interesante të ngjarjeve e gjejmë në librin shkollor për vitin e dytë të gjimnazit, të botuesit „Sarajevo publishing“ viti 2003, ku lidhet rënia e Maqedonisë me luftën në Fushë Kosovë. Gjithashtu është interesant konstatimi se për „luftën mitike është shkruar shumë [...] por, fakti se osmanët korrën fitore edhe përkundër vdekjes së Sulttan Muratit është e vërtetë e pakundërshtueshme<sup>58</sup>.

Nga të gjashtë tekstet shkollore të analizuara ku përmendet

Lufta në Fushë Kosovë, me së paku (një fjalë e vetme) për këtë ngjarje është shkruar në tekstin për vitin e dytë të gjimnazit të botuesit nga Mostari „Školska naklada“ („Humjet e ushtrisë serbe në Çrnomet dhe Kosovë u treguan sundimtarëve evropianë se nga Lindja po i kërcënonte një rrezik i madh nga osmanlinjtë.<sup>69</sup>)

Është analizuar edhe terminologjia e përdorur për pushtuesit dhe në katër tekste shkollore të destinuara për mësim në gjuhën boshnjake përdoret termi osmanlinjtë, në testet shkollore për nxënësit me mësim në gjuhën kroate përdoren emërtimet: turqit, osmanlinjtë turq dhe osmanlinjtë, përderisa në tekstet që janë në përdorim në entitetin boshnjako-hercegovas të Republikës Serbe në mënyrë eksplikite përdoret emërtimi turqit.

Gjendja është pak më ndryshe kur flitet për tekstet shkollorë që janë në përdorim në territorin e Republikës së Serbisë. Ajo që bie në sy me rastin e analizës së teksteve të historisë është se, ndonëse nuk mohohet e dhëna që ushtria turke fitoi në këtë betejë, kjo nuk thuhet në mënyrë eksplikite, por në plan të parë vendoset trimëria, rezistenca e madhe kundër ushtrisë turke disa herë më të fortë dhe vuajtjet e popullit serb.

Térheq vëmendjen fakti se Luftës së Kosovës i jepet shumë më tepër rëndësi se që kishte objektivisht për depërtimin e turqve në këtë territor. Nga ana tjetër, Luftës së Maricës, e cila i parapriu Luftës së Kosovës, i është kushtuar shumë më pak vëmendje dhe rëndësi, edhe pse sipas mendimit të shumicës së autorëve pikërisht ajo kishte rëndësi vendimtare në depërtimin e ushtrisë turke.

#### **Lufta e Parë Botërore (shkaku i fillimit të saj)**

Kur analizohen përkrimet e ngjarjeve historike të Luftës së Parë Botërore në tekstet mësimore që janë në përdorim në Serbi, eshtë veçanërisht interesante mënyra se si shihet në shkaktarin e drejtëpërdrejt të Luftës së Parë Botërore, respektivisht në atentatin ndaj trashëgimtarit të frontit austrohungarez, Franc Ferdinandit dhe gruas së tij, më 28 qershor të vitit 1914, të cilin e kryen anëtarët e organizatës "Mlada Bosna" ("Bosnja e Re") me në krye Gavrilo Principin. Në të tre tekstet shkollore të lëndës së historisë shkaku për fillimin e luftës eshtë dhënë në mënyrë të njëjtë, në një mësim që përfshinë 109 deri në 145 fjalë. Ajo që dallon në përbajtjen e këtyre teksteve të historisë, e që ka të bëjë me shkakun e

<sup>57</sup> Mira Shobot et al, *Historia pér vitin e I të shkollave të mesme profesionale*, (Sarajeva Lindore: Enti pér tekste dhe mjete mësimore, 2010), 87.

58 Elma Hashimbegović et al, *Historia (Historija Istorija Historij)* për vitin e II-të të gjimnazit, (Sarajevo: Sarajevo Publishing, 2003), 169.

<sup>59</sup> Franko Mirošević et al, *Historia 2*, (Mostar: Školska naklada. Zagreb: Školska knjiga, 2001), 126.

shpërthimit të Luftës së Parë Botërore, është përpjekja e autorëve të librit shkollor *Historia për klasën e tetë të shkollës fillore*, në botim të “Entit për tekste mësimore” që atentatorin Gavrilo Princip ta paraqesë si shtetas të Austro-Hungarisë, i cili nuk kishte kurrfarë bashkëpunimi e as lidhje me Serbinë.

*Si shkak për shpërthimin e Luftës së Parë Botërore ishte atentati i Sarajevës, më 28 qershori të vitit 1914, me ç'rast i riu serb nga Bosna dhe Hercegovina, Gavrilo Principi, vras trashëgimtarin e frontit austro-hungarez, Franc Ferdinandin. Qarqet luftënxitëse në Vjenë e aku-zuan Serbinë për organizimin e atentatit (edhe pse Gavrilo Principi ishte shtetas i Austro-Hungarisë)...<sup>60</sup>*

Nga analiza e librave shkollore të historisë, që janë në përdorim në territorin e BeH, konstatojmë se ecuria e ngjarjes së 28 qershorisë të vitit 1914 është shënuar, gjërësisht apo shkurtimisht, në të gjitha tekstet e analizuara. Në disa libra të historisë përmendet edhe tentimi për atentat i Nedeljko Çabrinoviqit ndaj Franc Ferdinandit, kurse në tekstet tjera jo. Prezantimi i kësaj ngjarjeje në librat shkollore është i ndryshëm, prej rreth 100-fjalësh deri në rreth 500 fjalë, ku vetëm në dy tekste shkollore gjemë tekst shtesë historik.

Posaçërisht është interesante mënyra se si karakterizohet Gavrilo Principi. Në tekstet shkollore për vitin e katërt të gjimnazit, të botuesit „Sarajevo publishing“ e vitit 2004, thuhet se Gavrilo Principi është nationalist serb, i cili e konsideronte „Franc Ferdinandin si rrezikun më të madh për idenë e bashkimit të serbëve dhe sllavëve të Jugut në përgjithësi, nën udhëheqjen serbe“<sup>61</sup>, përderisa në botimin e vitit 2007 ky përshkrim mungon, por është plotësuar me një paragraf të titulluar „Fjala e fundit e Nedeljko Çabrinoviqit, në gjykimin e atentatorëve“ i cili flet për rrethanat në të cilat atentatorëve u lindi ideja për të vrarë Franc Ferdinandin. Në librin e historisë për klasën e tetë të shkollës fillore të botuesit „Bosanska riječ“, viti 2007, në një fragment të posaçëm të nxjerrë nga transkripti i gjykimit të Gavrilo Principit, ai përshkruhet si nationalist jugosllav që dëshironte bashkimin e gjithë jugosllavëve. Gjithashtu, në librin e entitetit bosh-

njako-hercegovas të Republikës Serbe në tekstin përshkrues të ilustrimit të Gavrilo Principit shkruan se „kreu atentat i nxitur nga ideja jugosllave“<sup>62</sup>. Në librin e historisë së klasës së shtatë të shkollës fillore, të botuesit mostaras “Alfa” e vitit 2009, thuhet se të gjithë atentatorët ishin të kombësisë serbe, gjë që është në përputhje me faktet historike.

Gjithashtu ekzistojnë mospërputhje sa i përket kualifikimit të organizatës „Mlada Bosna“ („Bosna e Re“), anëtarët e së cilës e kryen atentatin: *organizatë e fshehtë, organizatë e fshehtë terroriste, organizatë revolucionare, organizatë revolutionare terroriste*, dhe „organizatë, e cila /vërejte e autorit/ luftoi me mjete terroriste kundër pushtetit austro-hungarez në Bosnjë dhe Hercegovinë“<sup>63</sup>.

Lidhjet e organizatës „Mlada Bosna“ me Mbretërinë e Serbisë përmenden në tre tekste mësimore. Në librin e historisë për klasën e tetë të shkollës fillore, të botuesit „Bosanska riječ“, theksohet se atentatorët kishin mbështetjen e „disa organizatave sekrete në Serbi“, përderisa në librin përvitin e katërt të gjimnazit, të botuesit „Školska knjiga“ („Libri shkollor“), shkruan se motivi i atentatit ishte konflikti i interesave në mes Austro-Hungarisë, të cilin Franc Ferdinand dëshironte ta riorganizojet, dhe Mbretërisë së Serbisë, e cila kishte për qëllim të shtrihet në territorin e Bosnjë dhe Hercegovinës dhe se pas saj qëndronte organizata sekrete revolucionare serbe „Bashkim ose vdekje“, por që më shumë njihej me emrin „Crna ruka“ (Dora e Zezë). Lidhjet mes tyre janë përmendur në mënyrë indirekte në tekstin e historisë për klasën e shtatë të botuar nga „Školska naklada“. Këto lidhje nuk përmenden në pjesën kryesore të tekstit, ku flitet mbi atentatin, por pranë fotografisë së Gavrilo Principit shkruan „...që nga viti 1912 jetoj në Serbi. Aty vendosi lidhje me organizatën e fshehtë, që kishte të njëjtat qëndrime sikur edhe ‘Mlada Bosna’“<sup>64</sup>, shkatërrimin e sundimit austro-hungarez në Bosnjë dhe Hercegovinë.

Kur bëhet fjalë par përfshirjen e drejtpërdrejt të autoriteteve të Mbretërisë së Serbisë në atentatin e Sarajevës, në një tekstu shkollor thuhet se ekzistonte dyshimi i pjesëmarrjes së qarqeve të caktuara ushtarake të Mbretërisë së Serbisë në

60 Gjorgje Gjuriq, Momcilo Pavloviq, *Historia për klasën e tetë të shkollës fillore*, (Beograd: Enti për tekste shkollore, 2011), 54.

61 Zijad Shehiq et al, *Historia (Historija Istorija Histori)* për vitin e katërt të gjimnazit, (Sarajevë: Sarajevo Publishing, 2004), 55.

62 Mira Shobot et al, *Historia për vitin e pare të shkollave të mesme profesionale*, (Sarajeva Lindore: Enti për tekste dhe mjete shkollore, 2010), 156.

63 Stjepan Bekavac et al, *Historia 7*, (Mostar: Alfa, 2009), 154.

64 Ivan Dukiq et al, *Historia 7*, (Mostar: Školska naklada. Zagreb: Školska knjiga, 2003), 131.

organizimin e atentatit, në një libër tjetër shkruan se asnjëherë nuk është sqaaruar nëse qeveria serbe ishte e përfshirë, përderisa në të tretin pohohet se Austro-Hungaria dyshonte në përfshirjen e saj, prandaj kërkoi hetime ku do të merrte pjesë edhe vetë.

Dihet se pas vrasjes së Franc Ferdinandit Austro-Hungaria dërgoi ultimatum ku mes tjerash thuhen se ajo dëshiron të zhvillojë hetime në territorin e Serbisë, por Mbretëria e Serbisë këtë ultimatum nuk e pranoi me çka nisi domino-efekti, që rezultoi me shpërthimin e Luftës së Parë Botërore, që përfshiu edhe vendet tjera në Evropë. Interesante është mënyra se si paraqitet ky ultimatum dhe çka thuhet se është prapavija e tij. Përderisa në shumicën e teksteve vetëm përmendet se bëhej fjalë për ultimatum të papranueshëm për Serbinë, në disa prej tyre bëhet lidhja në mes përzierjes së Mbretërisë së Serbisë në organizimin e atentatit dhe ultimatimit që pasoi, përderisa vetëm në tekstet e botuesit „Sarajevo publishing“ tërhiqet vërejtja në ngjarjet mes atentatit dhe kërkësës në formë ultimatumit, respektivisht thuhet se Austro-Hungaria qëllimi është dërgoi një kërkësë për të cilën paraprakisht e dinte se do të refuzohej, duke i hapur „rrugë zgjidhjes radikale“<sup>65</sup>. Në një nga librat shkollorë të analizuara, i cili është në përdorim në Republikën Serbe, nuk përmendet fare ultimatumit i Austro-Hungarisë, por vetëm thuhet se atentati ishte shkak për fillimin e Luftës së Parë Botërore.

Bazuar në mënyrën e paraqitjes së atentatit të Sarajevës në tetë tekstet e analizuara të historisë, mund të përfundojmë se përshkrimi është sipërfaqësor kurse disa fakte nuk janë përmendur me qëllim që t’iu përshtaten nevojave të politikës ditore. Interesant është fakti se nuk ekziston pajtueshmëri për karakterin e organizatës „Mlada Bosna“, kurse vetëm në tekstet mësimore të botuesit „Sarajevo publishing“ është treguar qëllimi i vërtetë i Austro-Hungarisë me rastin e kërkësës drejtuar Mbretërisë së Serbisë. Por, në të njëjtën kohë duhet përmendur se në tekstin e të njëjtët botues të vitit 2004, Gavrilo Principi karakterizohet si nationalist serb, që kishte për qëllim bashkimin e gjithë sllavëve të Jugut nën udhëheqjen serbe, përderisa në botimin e vitit 2007 ky karakterizim është tërhequr nga teksti. Vlen gjithashtu të përmendet se në tekstet mësimore të destinuara për shkollat ku mësimi zhvillohet në gjuhën kroate bëhet lidhja e aktivitetit të „Mlada Bosna“ me organizatat nga Mbretëria e Serbisë.

## Shpërbërja e Jugosllavisë

### Konfliktet e armatosura në territorin e Bosnjë e Hercegovinës, Kroacisë dhe Kosovës

E përbashkëta e të gjitha teksteve shkollorë të historisë në territorin e Serbisë është se shkatërrimi i Jugosllavisë shihet si një proces që daton nga lindja e RSFJ-së dhe konsiderohet se procesi shpërbërjes ka mundur vetëm të shtyhet. Autorët e të tre teksteve mësimore pajtohen se gjatë ekzistimit të Jugosllavisë çështjet kombëtare dhe fetare janë ndrydhur dhe se ka mbizotëruar frika nga paraqitja e nacionalizmave.

Në “Tekstin për klasën e tetë të shkollës filllore”, të autorëve Predrag Vajagiç dhe Nenad Stoshiq, kur flitet për shkaqet që çuan në shpërbërjen e Jugosllavisë përmenden partitë me ideologji dhe orientime nacionaliste që angazhoheshin për pavarësinë e republikave të tyre: Bashkësia Demokratike Kroate në Kroaci me Franjo Tuđmanin në krye dhe Partia e Aksionit Demokratik në Bosnjë dhe Hercegovinë, të cilën e udhëhiqte Alija Izetbegoviç.<sup>66</sup> Vlen të përmendet se në këtë tekstu nuk përmenden partitë në Serbi, Partia Socialiste e Serbisë, e cila në krye me liderin e saj Slobodan Miloševiq nuk është angazhuar për pavarësinë e Serbisë, por që pa mëdyshje ka ndikuar në shpërthimin e konfliktave të armatosura përmes përhapjes së nacionalizmit serb.

Gjithashtu, ajo që tërheq vëmendjen është njësia mësimore, që trajton pasojet e luftës në Kroaci dhe Bosnjë e Hercegovinë:

*Pasojet e këtyre luftërave ishin katastrofale për të gjithë banorët, pavarësisht përkatësisë së tyre nationale dhe fetare. Gjatë këtyre konfliktave pësoi një numër i madh i civilëve, u shkatërrua prona dhe u krye shpërndulja e dhunshme e popullsisë (spastrim etnik). Janë kryer krime të shumta nga të gjitha palët ndërluftuese. Numri i përgjithshëm i të vdekurve në Bosnjë dhe Hercegovinë vlerësohet në rreth 100.000, kurse në Kroaci ky numër është rreth 20.000. Fshatra të tërë janë djegur ndërsa civilët janë masakruar. Në konfliktet në Podrinjë u shuan 3.500 ushtarë dhe civilë serbë, më së shumti në Bratunac dhe rrëthinë. Masakra në Srebrenicë është krim i luftës dhe krim kundër njëzetimit, e kryer nga ushtria e Republikës Serbe me ndihmën e formacioneve paraushtarakë, ndaj ushtarëve dhe civilëve bosnjakë. Të dhënat për*

65 Zijad Shehiq et al, *Historia (Historia, istorija, povijest) përvitin e katërt gjimnaz*, (Sarajevo: Sarajevo Publishing, 2007), 64.

66 Predrag Vajaqiq, Nenad Stoshiq, *Tekst shkollor për klasën e tetë të shkollës filllore*, (Beograd: Shtëpia botuese „Klett“, 2011), 194-195.

*numrin e përgjithshëm të viktimate janë të diskutueshme. Sipas disave janë vrarë rrëth 8.000 njerëz, kurse disa të tjerë i vlerësojnë këto shifra si të tepruara. Në ndërkokë, komandanti i përgjithshëm i Ushtrisë së Republikës Serbe, Ratko Mladiç, i cili udhëhoqi operacionin për marrjen e Srebrenicës, dhe oficerë tjerë serbë janë akuzuar për krimet e luftës duke përfshirë edhe krimin e gjenocidit para Gjykatës Ndërkombëtare Penale për ish-Jugosllavinë. Më 26 shkurt 2007, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë në Hagë, duke vendosur sipas padisë së BeH kundër RFJ-së, e kualifikoi këtë krim si gjenocid, por nuk e lidhi Serbinë me këtë ngjarje. Disa oficerë dhe ushtarë të Republikës Serbe janë dënuar për këtë krim në Hagë...<sup>67</sup>*

Në pjesën e tekstit para se të përmendet krimi në Srebrenicë, flitet për numrin e viktimate nga radhët e popullit serb në afërsi të Srebrenicës, që janë rezultat i hulumtimit të kryer nga Milivoje Ivanisheviq, drejtor i Institutit të hulumtimin e vuajtjeve serbe dhe njëri nga anëtarët e ekipit mbrojtës të Radovan Karaxhiqit, i cili aktualisht po gjyket para Tribunalit të Hagës, në bazë të akuzave për krimet e luftës në Bosnjë dhe Hercegovinë. Duket se në këtë mënyrë bëhet përpjekje që të arsyetohet krimi në Srebrenicë dhe që ai të paraqitet si më pak i papranueshëm. Aspekti tjetër i patolueshëm është pazari me numrin e viktimate në Srebrenicë në një tekst shkollor, përkundër faktit se në akt gjykimet e shumta të Tribunalit të Hagës është vërtetuar se kishte më shumë se 7.000 viktima, përdherisa Komisioni i Qeverisë së Republikës Serbe vlerësoi numrin e viktimate të Srebrenicës në mes 7.000 dhe 8.000.<sup>68</sup> Loja me numrin e viktimate deri në njëfarë mase i zbut tmerret e krimeve. Një detaj që gjithsesi tërheq vëmendjen është se fjalët “Masakra e Srebrenicës” janë me shkronja bold. Edhe pse në vazhdim të tekstit thuhet se Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë në Hagë këtë krim e ka kualifikuar si gjenocid, lind dyshimi se të shkruarit e tekstit me bold është përpjekje për konstestimin e këtij kualifikimi. Problem tjetër është se në librin shkollor është futur një pohim i pasaktë se kinse Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë nuk e lidhi Serbinë me gjenocidin në Srebrenicë. E vërteta është se me vendimin e vitit 2007, Serbia është shpallur përgjegjëse për mosparandalimi

min e gjenocidit dhe mosdënimin e përgjegjësve, dhe rrjetë himisht është shpallur përgjegjëse për shkeljen e Konventës për parandalimin dhe dënimin e krimit të gjenocidit.<sup>69</sup>

Librat e historisë, që shfrytëzohen në Bosnjë dhe i Hercegovinë, kryesisht theksojnë se shpërbërja e RSFJ-së u paraqiti nga shfaqja e krizës ekonomike, procesi i demokratizimit dhe nacionalizmi. Si shembull i nacionalizmave të theksuar në veçanti merret marrëdhënia mes serbëve dhe shqiptarëve në Kosovë. Në tekstin shkollor për vitin e katërt të gjimnazit e botuesit „Sarajevo publishing“ e vitit 2004, konsiderohet se „qendra kryesore e përcarjeve nacionaliste, të cilat e shkatërruan Jugosllavinë gjendej në Serbi“<sup>70</sup>, kurse të njëjtën e gjemjë edhe në botimin e këtij teksti shkollor në vitin 2007. Aty thuhet se nacionalizmi në Serbi gjeti mbështetjen e akademikëve me Memorandumin e SANU (Akademia Serbe e Shkencave dhe Arteve) të vitit 1986, ku „vihet në dukje pozita e rëndë e Serbisë dhe kombit serb“ dhe hidhet poshtë vlerësimi për hegemoninë e Serbisë gjatë Jugosllavisë së parë. Përmendet ngecja ekonomike e Serbisë, [...] rezikimi i serbëve dhe pohohet se ekzistojnë forca të organizuara antiserbë<sup>71</sup>. Këtu duhet theksuar të dhënën interesante se në librin për vitin e katërt të gjimnazit të autorit Matkoviq, gjemjë edhe burimin historik, respektivisht pjesë nga Memorandumi i SANU, të përkthyera në gjuhën kroate.

Shfaqja e Slobodan Milosheviqit lidhet me mitingjet nacionaliste të organizuara nga ai, duke përgatitur kështu ambentin për heqjen e autonomisë së Kosovës dhe Vojvodinës. Në disa tekste shkollore theksohet pakënaqësia e kreut politik serb, i cili konsideronte se me Kushtetutën e vitit 1974 Serbia kishte humbur sovranitetin mbi territorin e vet.

Në tekstet e analizuara, autorët theksojnë se në Kongresin e XIV-të të Komitetit Qendror të Lidhjes Komuniste të Jugosllavisë u shfaqën dallime në mes përfaqësuesve të republikeve, përdherisa Matkoviq thotë se „delegatët nga Serbia dhe Mali i Zi treguan agresivitet të madh duke i sulmuar ashpër delegatët nga Kroacia dhe Slovenia“<sup>72</sup>.

Sjelljet nacionaliste të partive intensifikohen edhe më shumë

67 Gjorgje Gjuriq, Momčilo Pavloviq, *Historia për klasën e tetë të shkollës fillore*, (Beograd: Enti për tekste shkollore, 2011), 185-186.

68 Shtesë në Raportin e 11 qershoret 2004 mbi ngjarjet për dhe rrëth Srebrenicës, prej 10 deri më 19 korrik 1995.

69 Mund ta gjeni në: <http://www.icj-cij.org/docket/files/91/13685.pdf>.

70 Zijad Shehiq et al, *Historia (Historia, Istorija Povijest)* për vitin e katërt të gjimnazit, (Sarajevë: Sarajevo Publishing, 2004), 162.

71 Hrvoje Matkoviq, Franko Mirosheviq, Bozho Goluzha, dhe Ivica Sharac, *Historia 4*, (Mostar: Školska naklada, 2003), 264.

72 Hrvoje Matkoviq, Franko Mirosheviq, Bozho Goluzha, dhe Ivica Sharac, *Historia 4*, (Mostar: Školska naklada, 2003), 267.

me futjen e sistemit shumë-partiak, ku paraqitet tendenca për shkëputjen e republikave të caktuara. Në tekstin e historisë për klasën e tetë të autorit Valente thuhet se „platforma Izetbegoviq-Gligorov parashihet riorganizim të brendshëm rrënjos, të bazuara në raporte konfederative mes republikave“<sup>73</sup>, përderisa autori Matkoviq konsideron se „Republikat e Kroacisë, Sllovenisë, Bosnjë dhe Hercegovinës dhe Maqedonisë insistonin që kriza shtetërore të zgjidhet përmes marrëveshjes të bazuar në respektimin e veçantinë të se cilës republikë. Slobodan Milosheviqi, nga ana tjetër, përpinqej ta pamundësojë këtë, respektivisht kërkonte përfshirjen e republikave në bashkësinë jugosllave me organizim centralist...“<sup>74</sup>

Në tekstet e historisë dedikuar nxënësve me mësim në gjuhën boshnjake, zhvillimi i mëtejmë i ngjarjeve pasohet nga shpallja e pavarësisë së Sllovenisë dhe Kroacisë, referendumi në Bosnjë dhe Hercegovinë, njohja ndërkontrolluese në prill të vitit 1992 dhe pranimi në OKB, në maj të vitit 1992. Ngjarjet e mëvonshme janë përshkruar në librin e klasë së tetë nga botuesi „Bosanska knjiga“ („Libri boshnjak“), ku thuhet se pas miratimit të Memorandumit për Pavarësi nga Kuvendi i Bosnjë dhe Hercegovinës më 15 tetor 1991, „kryetari i atëhershëm i SDS, Radovan Karaxhiq, sot i akuzuar për krime lufte nga Gjykata Ndërkontrolluese në Hagë, kërcënoi hapur, para së gjithash kreun politik dhe popullin mysliman, se në rast të pavarësimit të Bosnjës dhe Hercegovinës do të shpërthejë lufta dhe populli mysliman do të zhduket nga këto hapësira“<sup>75</sup>. Gjithashtu theksohet se deputetët e SDS e lëshuan Kuvendin e BeH pas shpalljes së pavarësisë dhe formuan „kuvendin e veçantë ku miratuan Kushtetutën e ‘kombit serb në Bosnjë dhe Hercegovinë’ dhe e shpallën ‘entitetin kombëtar serb’ si njësi federative të mbetjes së Ju-

gosllavisë“<sup>76</sup>.

Interesante është e dhëna se në tekstin e historisë për vitin e katërt të gjimnazit, të botuesit „Bosanska knjiga“, gjemjë një fragment nga libri *Historia e Bosnjës* e vitit 1995, të autorit Noel Malcolm, i cili është më i gjatë se gjithë përshkrimi i ngjarjeve që lidhen me shpërbërjen e RSFJ-së dhe shpallices së Pavarësisë së Bosnjë dhe Hercegovinës. Në këtë fragment mes tjerash thuhet se „Milosheviqi kishte lidhje me planet pancerbe të Dobrica Qosiqit dhe Akademisë Serbe, kurse Tugjmani deklaroi se shumica e myslimanëve boshnjakë janë ‘pa dyshim me prejardhje kroate’ dhe se Bosnja dhe Hercegovina formon me Kroacinë ‘një terti të pandashme gjeografike dhe ekonomike’“, se është „e qartë që Milosheviqi po shkon drejt rivizatimit të kufijve“<sup>77</sup>, flitet për „propagandën nga Beogradit për ‘rrezikimin’ e serbëve në Bosnjë dhe Hercegovinë“<sup>78</sup>, pastaj se „partia SDS e Karaxhiqit ua ndaloj serbëve të merrnin pjesë në referendum dhe vendosi pengesa rrugëve në mënyrë që kutitë e votimit të mos sillen në territorët, që ishin nën autoritetin e tyre“<sup>79</sup>, dhe se pas rezultateve të referendumit „pjeshëtarët e formacioneve paraushtarake ngritën barrikada nëpër rrugë dhe u pozicionuan snajperë në afërsi të ndërtuesës së Kuvendit në Sarajevo“<sup>80</sup>.

Në librin shkollor të Matkovicit: *Historia 4*, për vitin e katërt të gjimnazit, i gjithë faji për këto ngjarje i përshkruhet Serbisë, respektivisht serbëve, posaçërisht përluftën, duke theksuar se „u nënshkruan disa armëpushime, por të gjitha këto i shkeli agresori serb“<sup>81</sup>, dhe se „agresori kreu krimi të padëgjuara: shkatërrroi vendbanime të tëra, kisha, monumente të kulturës, rrugë, granatoj spitale, ushtria serbe së bashku me çetnikët masakroi dhe vrau masovikisht ushtarët dhe civilët e zënë rob“<sup>82</sup>. Po theksojmë se në këtë tekst

73 Leonard Valenta, *Historia për klasën e tetë të shkollës fillore*, (Sarajevo: Bosanska riječ, 2007), 187.

74 Hrvoje Matkoviq, Franko Miroševiq, Bozho Goluzha, dhe Ivica Sharac, *Historia 4*, (Mostar: Školska naklada, 2003), 268

75 Hadzhija Hadzhiabdiq, Edis Dervishagiq, Alen Muliq, i Vahidin Mehiq, *Historia, libër shkollor për klasën e tetë të shkollës fillore*, (Tuzla: Bosanska riječ, 2008), 141.

76 Hadzhija Hadzhiabdiq, Edis Dervishagiq, Alen Muliq, i Vahidin Mehiq, *Historia, libër shkollor për klasën e tetë të shkollës fillore*, (Tuzla: Bosanska riječ, 2008), 141.

77 Hadzhija Hadzhiabdiq, Edis Dervishagiq, Alen Muliq, i Vahidin Mehiq, *Historia, libër shkollor për vitin e katërt të gjimnazit*, (Tuzla: Bosanska riječ, 2007), 174.

78 Hadzhija Hadzhiabdiq, Edis Dervishagiq, Alen Muliq, i Vahidin Mehiq, *Historia, libër shkollor për vitin e katërt të gjimnazit*, (Tuzla: Bosanska riječ, 2007), 174.

79 Hadzhija Hadzhiabdiq, Edis Dervishagiq, Alen Muliq, i Vahidin Mehiq, *Historia, libër shkollor për vitin e katërt të gjimnazit*, (Tuzla: Bosanska riječ, 2007), 174.

80 Hadzhija Hadzhiabdiq, Edis Dervishagiq, Alen Muliq, i Vahidin Mehiq, *Historia, libër shkollor për vitin e katërt të gjimnazit*, (Tuzla: Bosanska riječ, 2007), 174.

81 Hrvoje Matkoviq, Franko Miroševiq, Bozho Goluzha, i Ivica Sharac, *Historia 4*, Mostar: Školska naklada, 2003), 275.

shkollor trajtohen kapitujt e „Luftës atdhetare“ dhe „Luftës në Bosnjë dhe Hercegovinë“. Konflikti mes HVO (Këshilli kroat i mbrojtjes) dhe Armatës së Republikës së Bosnjë dhe Hercegovinës nuk përmendet fare, por flitet „për konflikt në të cilën secila palë përpinqej të dominojë“<sup>83</sup> në territorin e Bosnjës së Mesme. Thuhet se „në korrik (Karaxhiqi dhe rrethi i tij) mori nën kontroll nga OKB-ja zonat e mbrojtura të Zhepës dhe Srebrenicës, me ç'rast vranë disa mijëra myslimanë“<sup>84</sup>, dhe se pas kërcënimeve të NATO-s „serbët zunë rob 370 ushtarë të Kombeve të Bashkuara dhe i mbajtën si pengje, duke i lidhur nëpër pemë apo shtylla pranë objekteve të tyre ushtarake“<sup>85</sup>. Kapitulli përfundon me fjalinë: „Lufta, të cilën e filloj dhe e zhvilloi Sllobodan Milosheviqi nëpër hapësirat e ish-Jugosllavisë përfundoi me disfatën e konceptit serbomadh.“<sup>86</sup>

Një ekstrem tjeter, në përshkrimin e ngjarjeve që shoqëruan shkatërrimin e Jugosllavisë, e gjemjë në tekstin e historisë së entitetit boshnjako-hercegovas të Republikës Serbe, ku zhvillimet, që çuan në shpërbërjen e RSFJ-së lidhen me Kush-tetutën e viti 1974, në kontekstin e dhënies së statusit au-tonom për krahinat e Kosovës dhe Vojvodinës, ngjarje këto që prezantohen sikur „Vojvodina dhe Kosova të ishin ndarë nga Serbia“<sup>87</sup>. Udhëheqësia serbe në vitin 1987 „filloi të korrigojë padrjetësitë që i ishin bërë me Kushtetutën e viti 1974“<sup>88</sup>. Amendamentet në Kushtetutën e Serbisë të viti 1989 janë lidhur me „veprimet agresive të terroristëve shqiptarë dhe dëbimin e serbëve nga Kosova dhe Metohia“<sup>89</sup>, dhe se APJ parandaloi konfliktet eventuale në mes popu-latës serbe dhe shqiptare. Shpërbërja e RSFJ-së paraqitet si

rrjedhim logik i rënies së komunizmit, ku „rënia e sistemit njëpartiak në Jugosllavi shënoi edhe falimentimin e idesë për jetë të përbashkët“<sup>90</sup>. Shpallja e pavarësisë së Sllovenisë, e më pas edhe të Kroaci së „i frikësoi serbët në Kroaci“<sup>91</sup>, dhe se Kushtetuta e re kroate „ua mori serbëve statusin e popullit konstitutiv“<sup>92</sup>. Në pjesën, ku flitet për konfliktet e armatosura në territorin e ish-Jugosllavisë thuhet se lufta, e cila karakterizohet si nacionale dhe fetare, në Kroaci filloj në vitin 1991, kurse në Bosnjë dhe Hercegovinë vitin pasues.

Në dy-tre tekste shkollore serbe: 1. Pavloviq, Z., Bosniq Korica, J: *Mozaik i së kaluarës*, BIGZ školstvo, Beograd; 2. Gjuriq, Gj., Pavloviq, M: *Historia për klasën e tetë të shkollës fillore*, Enti për tekste mësimore, Beograd) përmenden dhe sqarohen konfliktet në Kosovë dhe Metohi në fund të viteve të 90-ta të shekullit të kaluar. Autorët përmenden se fuqitë perëndimore u kanë dhënë shqiptarëve mbështetje të hapur, megjithatë nuk tregohet se për ç'arsye ka ndodhur kjo. Në asnjërin nga tekstet në fjalë nuk përmenden viktimat civile të kombësisë shqiptare gjatë konfliktit në mes Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës me forcat e sigurisë.

*Aksionet e përditshme të armatosura të grupeve terroriste shqiptare, me emrin Ushtria Çlirimtare e Kosovës, banditizmi dhe konfliktet me forcat e rendit, në të cilat po pësonët një numër gjithnjë e më i madh i civilëve, e përkeqësuan dukshëm gjendjen në Kosovë. Në fund u përfshinë edhe vendet perëndimore, posaçërisht SHBA-të, duke u dhënë shqiptarëve përkrahje të hapur. Pas bisedimeve të pasuksesshme në Rambuje dhe Paris dhe refuzimit të palës serbe që të nënshkruaj kërkесat ultimata*

82 Hrvoje Matkoviq, Franko Miroševiq, Bozho Goluzha, i Ivica Sharac, *Historia 4*, (Mostar: Školska naklada, 2003), 275.

83 Hrvoje Matkoviq, Franko Miroševiq, Bozho Goluzha, dhe Ivica Sharac, *Historia 4*, (Mostar: Školska naklada, 2003), 281.

84 Hrvoje Matkoviq, Franko Miroševiq, Bozho Goluzha, dhe Ivica Sharac, *Historia 4*, (Mostar: Školska naklada, 2003), 282.

85 Hrvoje Matkoviq, Franko Miroševiq, Bozho Goluzha, dhe Ivica Sharac, *Historia 4*, (Mostar: Školska naklada, 2003), 282.

86 Hrvoje Matkoviq, Franko Miroševiq, Bozho Goluzha, dhe Ivica Sharac, *Historia 4*, (Mostar: Školska naklada, 2003), 283.

87 Mira Shobot et al, *Historia për vitin e pare të shkollave të mesme profesionale*, (Sarajevo Lindore: Enti për tekste dhe mjete shkollore, 2010), 217.

88 Mira Shobot et al, *Historia për vitin e pare të shkollave të mesme profesionale*, (Sarajevo Lindore: Enti për tekste dhe mjete shkollore, 2010), 217.

89 Mira Shobot et al, *Historia për vitin e pare të shkollave të mesme profesionale*, (Sarajevo Lindore: Enti për tekste dhe mjete shkollore, 2010), 217.

90 Mira Shobot et al, *Historia për vitin e pare të shkollave të mesme profesionale*, (Sarajevo Lindore: Enti për tekste dhe mjete shkollore, 2010), 218.

91 Mira Shobot et al, *Historia për vitin e pare të shkollave të mesme profesionale*, (Sarajevo Lindore: Enti për tekste dhe mjete shkollore, 2010), 218.

92 Mira Shobot et al, *Historia për vitin e pare të shkollave të mesme profesionale*, (Sarajevo Lindore: Enti për tekste dhe mjete shkollore, 2010), 218.

*mative për tërheqjen e ushtrisë dhe policisë nga Kosova, në shkurt të vitit 1999 pasoi agresioni i NATO-s, i cili zgjati nga 24 marsi deri më 10 qershor të vitit 1999 ...<sup>93</sup>*

Ajo, që bie në sy në një nga tekstet shkolllore është pjesa e rrumbullakuar në mënyrë të veçantë e mësimit, e cila sugjeron që t'iu kushtohet më shumë vëmendje kimeve të kryera ndaj serbëve:

*Pyesni nëse dikush nga familja apo rrethi juaj i afërt u shpërndau në territorin e Serbisë gjatë viteve të nëntëdhjetë. Flisni për luftën me dikë që ka marrë pjesë në të.<sup>94</sup>*

### Vërejtje përmbyllëse

Pothuajse në të gjitha tekstet e analizuara vihet re ajo që Dubravka Stojanoviq e quan „niveli i parë i konstruksionit sipërfaqësor të historisë“, e cila mund të quhet edhe faktografike. Autorët, në këtë nivel, „ua përshtatin faktet historike nevojave të politikës ditore“. Ashtu siç precizon Dubravka Stojanoviq në analizën e saj të teksteve mësimore serbe të fillim-viteve të 90-ta: „Më së shpeshti janë zbatuar tre metoda: disa fakte nga historia largohen, në disa fakte tjera insistoher më shumë se sa që i përgjigjet realitetit historik, kurse disa tjera deformohen deri në të pavërteta historike.“<sup>95</sup>

Metodat e konstruksionit sipërfaqësor të historisë janë përdorur pa dallim pothuajse në të gjithë tekstet e historisë dhe pothuajse në të gjitha njësítë mësimore që i kemi analizuar.

Në bazë të përbajtjes së analizuar, Lufta e Kosovës në tekstet serbe dhe në Republikën Serbe akoma vazhdon të paraqitet përmes idesë së „kombit-viktimit“, në vend të shqyrtimit objektiv të kësaj ngjarjeje historike. Gjithashtu, mbeten të hapura pyetjet, që lidhen me atentatin e Sarajevës, respektivisht mënyra se si paraqitet dhe kush ishte në të vërtetë Gavrilo Principi, personazh i organizatës „Mlada Bosna“ dhe cili ishte roli i Serbisë dhe Austro-Hungarisë në shpërthimin e Luftës së Parë Botërore. Kjo është posaçërisht me rëndësi, sepse pa studimin me themel të këtyre fakteve nuk mund të arrihet në qëndrimin se *terrorizmi* shfrytëzohet si prelud në krijimin e „Jugosllavisë serbe“.

Kur flitet për përbajtjen e teksteve mësimore, që kanë të bëjnë me shpërbërjen e Jugosllavisë, respektivisht për konfliktet e armatosura në territorin e ish RSFJ-së, mund të konkludojmë se gjendja nuk është e kënaqshme. Siç thuhet në reportin “Drejtësia tranzicionale në shtetet post-jugosllave – Raporti për vitin 2009” në shkollat filllore dhe të mesme të Serbisë dhe BeH-së mësohet për periudhën jo shumë të largët kur janë zhvilluar konfliktet e armatosura. Raporti thekson se ndonëse të gjitha tekstet janë liruar nga diskursi vulgar nationalist, pothuajse të gjitha janë të ngarkuara me një dozë, më të madhe apo më të vogël, të njëanshmërisë:

*Kjo i ka bërë ato joadekuate për edukimin e fëmijëve, i cili do të duhej të bazohet në respektimin e fakteve dhe interpretimin profesional dhe politikisht të paanshëm të tyre. Në tekste vërehet njëanshmëri në qasjen ndaj temave që lidhen me shpërbërjen e RSF të Jugosllavisë dhe konfliktet e armatosura. Përgjegjësia për shpërbërjen e dhunshme të Jugosllavisë është përshkruar ekskuluzivisht apo jo-proporcionalisht palës „tjetër“. Ndonëse shumica e teksteve nuk e konteston se edhe pjesëtarët e grupit etnik shumicë ishin përgjegjës për kryerjen e kimeve të luftës, këto kime janë përshkruar keq, pa përmendur të dhëna konkrete, për dallim nga përshkrimet e detajuara të kimeve për të cilat është përgjegjëse pala tjetër. Tekstet e historisë jo rrallë herë ia përshkruajnë palës tjetër përgjegjësinë për „spastrime etnike“ dhe lloje tjera të kimeve, kurse heshtin faktet se edhe pala e tyre ka kryer kime të tillë.<sup>96</sup>*

Me rekomandim të Këshillit të Evropës tekstet shkolllore në Bosnjë dhe Hercegovinë janë reviduar, me qëllim që të largohen mësimet që trajtonë këtë problematikë. Rishikimi i teksteve vihet re në rastin e librit të historisë për vitin e katërt të gjimnazit, të botuesit „Sarajevo Publishing“, në vitet 2004 dhe 2007, ku janë ndryshuar apo hequr tërësisht përbajtjet që kanë mund të ndikojnë në zgjimin e nacionalizmave mbrojtëse.

Problem shtesë paraqet edhe edukimi i gjeneratave të reja

93 Gjorgje Gjuriq, Momçilo Pavloviq, *Historia për klasën e tetë të shkollës filllore*, (Beograd: Enti për tekste shkolllore, 2011), 186.

94 Zoran Pavloviq, Jovo Bosniq Korica, *Mozaiq i së kaluarës*, (Beograd: BIGZ školstvo, 2011), 146.

95 Stojanoviq, Dubravka, *Konstruksioni i të kaluarës – rasti i teksteve mësimore serbe të historisë*. E shikuar më: 26.03.2013. Mund të gjendet në: <http://cpi.hr/download/links/hr/7008.pdf>.

96 *Drejtësia tranzicionale në vendet post-jugosllave – Raporti për vitin 2009*. E shikuar më: 26.03.2013. Mund të gjendet në: [http://www.hlc-rdc.org/wp-content/uploads/2012/04/Tranziciona\\_pravda\\_u\\_post-jugoslovenskim\\_zemljama-izvestaj\\_za\\_2009-\\_1\\_.pdf](http://www.hlc-rdc.org/wp-content/uploads/2012/04/Tranziciona_pravda_u_post-jugoslovenskim_zemljama-izvestaj_za_2009-_1_.pdf).

sipas idesë komb-viktimë. Në një nga tekstet mësimore në Serbi nxënësve u jepet për detyrë: *Pyesni nëse dikush nga familja apo rrethi juaj i afërt u shpërndal në territorin e Serbisë gjatë viteve të nëntëdhjeta. Flisni për luftën me dikë që ka marrë pjesë në të.*<sup>97</sup>

Insistimi në viktima serbe apo refugiatë serbë në Serbi nga shtetet përreth paraqet shembull të shkëlqyeshëm të përpjekjes për imponimin e idesë për kombin-viktimë. Rrëfimet e tillë zakonisht janë subjektive dhe përplot me ngarke-sa emotive dhe negative. Ato zakonisht shoqërohen me pëershkrime tmerruese mbi vuajtjet e pjesëtarëve të popullit serb. Informacionet e marra në këtë mënyrë, përpos që nuk kanë mbështetje historike, ngjallin frikë, tension dhe ankth te personat që i dëgjojnë këto tregime. Kjo mund të ketë pa-soja serioze për raportin e gjeneratave të reja ndaj kombeve fqinje, por edhe në vetë procesin e pajtimit. Prandaj me plotë të drejta Dubravka Stojanoviq përfundon analizën e saj në “*Konstruksioni i së kaluarës – rasti i teksteve mësimore serbe të historisë*”:

*Meqenëse në mënyrë të njëjtë brutale janë paraqitur edhe marrëdhëniet me popujt tjerë fqinj, mund të thuhet se tekstet shkollore të historisë zhvillojnë një model paranoik të vetëdijes historike që mund të përbëjë bazë solide për urejtje dhe përbuzje ndaj popujve fqinj, me çka mundësitet për keqkuptime, konflikte dhe revanshizma të tjera mbeten përherë të hapura. Duke konstruktuar dimensione të tillë të vetëdijes historike, arsimi merr funksionin e rëndësishëm mobilizues me veprim të vonuar, sepse kapitali i urejtjes dhe modeli i sjelljes së imponuara në vitet e hershme të jetës përcilënen edhe në të ardhmen, me çka zvogëlohet mundësia e ballafaqimit racional me të kaluarën dhe të tashmen.*<sup>98</sup>

Sistemi arsimor i veçantë, jounitar, i bazuar në vlera të përbashkëta, që ka ekzistuar në territorin e Bosnjës dhe Herce-

govinës, prej vitit 1992 gradualisht është shndërruar në tri sisteme të ndara arsimore „në fillim vetëm në emër, e pastaj edhe një varg karakteristikash tjera, [...] sistemi arsimor serb – i importuar nga Serbia, ai kroat – i importuar nga Kroacia, dhe ai boshnjak, sistemi arsimor i mëhershëm, i paraluftës, paksa i ndryshuar i Republikës së Bosnjës e Hercegovinës“<sup>99</sup>. Akademik Adila Pashaliq-Kreso është e mendimit se ndarjet nuk janë shfaqur e as nuk janë përhapur me fillimin e luftës në BeH, por konsideron se ato janë përgatitur, kultivuar dhe ruajtur me kujdes, kurse janë lansuar atëherë kur për këtë kishte nevojë – „si mjet shtesë për realizimin e qëllimeve dhe detyrave të luftës, të cilat në thelb kishin për qëllim ndarjen e BeH dhe bashkëngjitjen e territoreve të saj fqinj lindor dhe perëndimor“<sup>100</sup>. Pas nënshkrimit të Marrëveshjes paqësore të Dejtonit, kompetencat në sferën e arsimit u janë lënë niveleve më të ultë të pushtetit, respektivisht entiteteve, ndërsa në entitetin e Federatës së BeH këto kompetenca janë bartur edhe në kantone. Kështu që sot Bosnja dhe Hercegovina nuk ka Ministri të Arsimit në nivel qendror por, 13 ministri, ku secila ka të drejtë të marrë vendime për planprogramet dhe tekstet mësimore që përdoren. Kjo ka mundësuar që edhe në periudhën e pasluftës të vazhdohet me afirmimin e „grupit të lëndëve nacionale me qëllim të forcimit të vetëdijes dhe përkatësisë kombëtare [...] zhvlerësimin e tjerëve“, me ç'rast „në vend të afirmimit kombëtar [...] krijohet intolerancë dhe përqarje kombëtare“.<sup>101</sup>

Karakteristikë e të gjitha teksteve mësimore, të analizuara në BeH dhe Serbi, është tendenca e tyre për t'i paraqitur marrëdhëniet mes popujve fqinj si të paracaktuara për të qenë konfliktuze, se vazdimisht gjatë historisë janë karakterizuar me dallime, mospajtime dhe mosdurim të patejkaloreshëm. Me këtë synohet të imponohet pandryshueshmëria dhe përgjithësimi në perceptimin dhe karakterizimin e popullit tjetër për t'i arsyetuar konfliktet e armatosura, gjë që në mënyrë aktive e pengon arritjen e pajtimit.

97 Zoran Pavloviq, Jovo Bosniq Korica, *Mozaik i së kaluarës*, (Beograd: BIGZ školstvo, 2011), 146.

98 Stojanoviq, Dubravka. “cpi.hr.” Modifikuar për herë të fundit më 2013. E shfletuar në 26 mars 2013. <http://cpi.hr/download/links/hr/7008.pdf>.

99 Adila Pashaliq-Kreso, “Mutacioni shumëvjecar dhe rezistenca e virusit të ndarjeve të luftës në sistemin arsimor boshnjako-hercegovas „Bosnja dhe Hercegovina në rrugë drejt shtetit modern? Perspektiva dhe pengesa”, redaktor Azra Xhajiq, Christophe Solioz dhe Tobias K. Vogel (Sarajevë: Fondacioni Heinrich Böll, Zyra rajonale në Sarajevë, 2004), 184-185.

100 Adila Pashaliq-Kreso, “Mutacioni shumëvjecar dhe rezistenca e virusit të ndarjeve të luftës në sistemin arsimor boshnjako-hercegovas „Bosnja dhe Hercegovina në rrugë drejt shtetit modern? Perspektiva dhe pengesa”, redaktor Azra Xhajiq, Christophe Solioz dhe Tobias K. Vogel (Sarajevë: Fondacioni Heinrich Böll, Zyra rajonale në Sarajevë, 2004), 184.

101 Adila Pashaliq-Kreso, “Mutacioni shumëvjecar dhe rezistenca e virusit të ndarjeve të luftës në sistemin arsimor boshnjako-hercegovas „Bosnja dhe Hercegovina në rrugë drejt shtetit modern? Perspektiva dhe pengesa”, redaktor Azra Xhajiq, Christophe Solioz dhe Tobias K. Vogel (Sarajevë: Fondacioni Heinrich Böll, Zyra rajonale në Sarajevë, 2004), 187.

Dallimet në paraqitjen e ngjarjeve të ndodhura para më shumë se gjashtë dekadash, por që kishin ndikim të jashtëzakonshëm në shpërbërjen e Jugosllavisë të krijuar sipas idesë që ekzistonte në kohën e atentatit të Sarajevës, tregon se sa është i rëndësishëm studimi i së kaluarës të bazuar në fakte. Posaçërisht është me rëndësi që të studiohen

faktet, që lidhen me shpërbërjen e Jugosllavisë dhe konfliktet e armatosura në territorin e ish-RSFJ-së, në mënyrë që të pamundësohet shfrytëzimi i arsimit për ngjalljen e *urrejtjes ndaj tjetrit* tek pjesëtarët e gjeneratave që vijnë, si dhe është e nevojshme që tekstet mësimore të shkruhen në të njëjtën tavolinë.

# Të gjitha drejtësitë tranzicionale serbe

Miroslav Keveždi

## Hyrje

Qëllimi i këtij punimi është përcaktimi i parimeve bazë të drejtësisë tranzicionale në Serbi. Termin drejtësi tranzicionale e hasim relativisht rrallë në diskursin publik në Serbi, por edhe, ndonjëherë kur ai përmendet ose nuk kuptohet si duhet ose interpretohet në mënyrë të gabuar apo kalohet nëpër të si nëpër diçka të parëndësishme. Nga ana tjetër, ky term mund të jetë vendimtar për të kuptuar dinamikën shoqërore-politike të shoqërisë së Serbisë. Në bazë të qëndrimeve ndaj drejtësisë tranzicionale është e mundur të vlerësohen aktorët politikë dhe të bëhen parashikimet e lëvizjeve të ardhshme në skenën shoqërore-politike jo vetëm të Serbisë por edhe në rajon. Drejtësia tranzicionale është e rëndësishme në raportet ndërkombëtare në të njëjtën masë sa janë të rëndësishme edhe ndarjet shoqërore-politike dhe raportet e forcave të aktorëve politikë në Serbi të nxjerra si pas këtij parimi.

Mospranimi i problematikës së drejtësisë tranzicionale në shoqërinë serbe shihet edhe në mungesën relative të informacionit apo literaturës, e cila do të mund të ndihmonë në strukturimin e njohurive dhe qëndrimeve të publikut në raport me këtë çështje të rëndësishme. Në këtë punim qëndrimet tonë do t'i bazojmë në kornizën teorike të vendosur nga teoricieni norvegjez Jon Elster (Jon Elster) në librin e tij

*"Mbyllja e librave: Drejtësia Tranzicionale nga Perspektiva Historike"*, të publikuar në vitin 2004.<sup>102</sup> Këndvështrimet për drejtësinë tranzicionale, përpos në artikuj të ndryshëm, Elsteri i paraqiti edhe në librin *Ndëshkimi dhe Reparacioni në Tranzicionin Drejt Demokracisë*, të vitit 2006.<sup>103</sup> Teoria e tij për drejtësinë tranzicionale do të na shërbejë si bazë për shqyrtimin e kësaj problematike në Serbi, duke prekur një aspekt shumë të rëndësishëm të saj: faktin se në Serbi për drejtësinë tranzicionale mund të flitet në shumës. Në Serbi nuk ekziston vetëm një proces i drejtësisë tranzicionale por, ka disa të tillë. Secila drejtësi tranzicionale në praktikë iu referohet drejtësive tjera tranzicionale, kurse këto raporte e përcaktojnë politikën serbe, si atë të brendshme ashtu edhe të jashtme.

Prandaj, ky punim ka për qëllim përkufizimin e drejtësisë tranzicionale, përcaktimin e proceseve të drejtësisë tranzicionale prezente në Serbi dhe të raporteve mes tyre. Punimi nuk pretendon të nxjerrë konkluzione përfundimtare, por i qaset çështjes në atë mënyrë që tiparet karakteristike tëjenë hipotezat, vërtetimi i të cilave do të janë objektivat e hulumtimeve në të ardhmen.

## Teoria e drejtësisë tranzicionale sipas Jon Elster

Elster i qaset drejtësisë tranzicionale nga perspektiva historike, duke përmendur raste të drejtësisë tranzicionale

102 Elster, Jon. (2005) *Dhënia e llogarive – drejtësia tranzicionale nga perspektiva historike*. Beograd: Revista Rrethi Beogradas.

103 Elster, Jon. (2006) *Ndëshkimi dhe Reparacioni në Tranzicionin drejt Demokracisë*. New York: Cambridge University Press.

që në kohën e Greqisë antike, gjatë shekullit V para erës së re dhe në Francë pas Revolucionit të vitit 1789 (Elster, 2004), dhe duke vazhduar me numërimin e shembujve të ndryshëm nga periudha tjera historike, vecanërisht pas vitit 1945 (Elster, 2004, 2006). Ai zgjedh raste në bazë të cilave i përcakton elementet kryesore të drejtësisë tranzicionale sic janë struktura, kryesit, viktimat, kufizimet, emocionet dhe politika. Disa nga këto elemente që konsiderohen pjesë përbërëse e çdo drejtësie tranzicionale mund të ndryshojnë. Rasti i Serbisë sigurisht që i ka specifikat e veta, por mund të thuhet se ato janë gjithashtu varicione të elementeve të njohura, të përbashkëta abstrakte.

Sipas Elsterit „drejtësia tranzicionale përbëhet nga proceset e gjykimit, lustrimit dhe reparacioneve, të cilat zhvillohen pas tranzicionit të një regjimi politik në tjetrin“ (Elster, 2005:15). Edhe pse autor i shqyrtton edhe raste nga periudha antike, Elster tregon se historia moderne e drejtësisë, pas tranzicionit në demokraci, në thelb fillon me humbjen e Gjermanisë, Italisë dhe Japonisë në Luftën e Dytë Botërore, në vitin 1945 (Elster, 2005:91).

Gjatë shqyrtimit të drejtësisë tranzicionale, Elster para së gjithash konstaton se rënia e regjimeve autokratike do të shpie në situatë në të cilën regjimi do të përgjigjet për të këqijat e bëra në të kaluarën dhe do të shfaqet nevoja për ndërprerjen e ndikimit të tij në të ardhmen. Pyetja e dytë është se si të ndërtohet një regjim i ri dhe më i mirë. Pyetja e tretë, si t'iua qasemi viktimate të luftës. Këto pyetje të drejturna kah e kaluara janë në të vërtetë pyetjet për mënyrat se si përgjigjen shoqëritë ndaj krimeve dhe vuajtjeve.

Përfundimi i drejtësisë tranzicionale duhet të rezultojë me një varg vendimesh legislative, administrative dhe juridike. Për tu arritur rezultatet e përmendura duhet përgjigjur në disa pyetje themelore. Sipas Elsterit, pyetja e parë nga e cila varen gjitha pyetjet tjera është nëse duhet të merremi me

krimet e së kaluarës (në disa tranzacione është vendosur që të mos hapen çështjet nga e kaluara).<sup>104</sup> Nëse përgjigja është pozitive, atëherë pasojnë pyetjet për kryesit e krimeve, viktimat, kornizën kohore, përmasat e gjykimit dhe të ngashme. Pas përfundimit të konflikteve të armatosura, shtetet fituese mund të kërkojnë reparacione nga shtetet e mundura apo t'i ndëshkojnë ato në mënyrë individuale apo në grup. Qëllimi i reparacioneve mund të jetë gjithashtu edhe retribucioni<sup>105</sup> apo parandalimi, jo vetëm thjeshtë kompensimi i dëmit.

### Krimet dhe autorët e krimeve

Pas vendimit për të filluar ballafaqimi me të kaluarën, duhet vendosur çka do të konsiderohet krim dhe kush do të llogaritet autor i krimit. Përgjigjen në këtë pyetje e përcakton përkufizimi i fjalës akuzë. Krimet mund të përfshijnë katër kategori të individëve në bazë të aktiviteteve të tyre: e para, ekzistojnë ata që kanë dhënë urdhrin për kryerjen e veprave kriminale; e dyta, ekzistojnë ata që kanë zbatuar urdhrat; e treta, përgjegjësia mund t'iua pëershruhet edhe hallkave të ndërmjetme në zinxhirin komandues në mes atyre që jasin urdhra dhe atyre që i zbatojnë ato; e katerta, ndihmësit – ata që me vetëdije i lehtësojnë kryerjet e krimeve, për shembull – ata që e mbajnë viktiminë deri sa të tjerët e torturojnë (Elster, 2005:178-179).

Elster krijon tipologjinë e kryesve të krimeve të luftës në këtë mënyrë:

„Oportunistët, humbësit dhe keqdashësit, të gjithë janë të shtyrë nga dëshira për përfitim. Oportunistët kërkojnë përfitime materiale, ndërsa humbësit përfitime psikologjike që do t'i bënte të duken me rëndësi në sytë e tyre dhe të tjerëve, përderisa keqdashësit kënaqen duke parë armiqëtë dhe rivalët e tyre të poshtëruar. Megjithëse kategoria e humbësve mbivendoset me kategorinë e keqdashësve, asnjëri prej këtyre grupeve nuk mund të kategorizohet në tjetrin.

<sup>104</sup> Rastet e Spanjës gjatë vitit 1976-78 apo Brazilit, ku përbajtja nga hapja e çështjeve të krimeve vinte si pasojë e vetë-amnistimit të ushtrisë, kurse në Rodezi ajo u imponua nga qeveria britanike. „Në ish Bashkimin Sovjetik mungesa pothuajse e plotë e drejtësisë tranzicionale pas rënies së regjimit komunist nuk ishte pasojë e vendimit të ndërgjegjishëm kolektiv, por rezultat i mungesës së çfarëdo kërkese të organizuar për drejtësi.“ (Elster, 2005:176).

<sup>105</sup> Me retribucion nënkuptojmë ndëshkimin: „Koncepti i retribucionit nënkupton se krimineli e meriton dënimin sepse ka kryer ndonjë vepër të keqë morale apo shoqërore. Aspekti tjeter i retribucionit nënkupton se dënimini duhet të përcaktohet në bazë të dëmit që i është shkaktuar viktimës, e jo në bazë të fajit moral të kriminelit. Për dallim nga kjo, shkolla utilitariste beson se të gjitha ndëshkimet janë të këqija përfaktin se e pamundëson arritjen e lumturisë njerëzore. Ajo mund të justifikohet vetëm nëse përmes saj parandalohet ndonjë fatkeqësi apo dëm më i madh. Kjo është esenca e teorisë së zmbrapsjes/paralajmërimimit sipas të cilës ndëshkimi ka për qëllim parandalimin e kriminelit nga përsëritja e sulmeve të tij apo zmbrapsja e të tjerëve nga kryerja e veprave të ngashme.“ (Martin, 2003:397-398).

Konformistët janë të motivuar nga frika e humbjes materiale. Kjo nuk është thjesht ekivalent i dëshirës përpërfitim material, sepse për shumicën e njerëzve sakrifiki i karrierës është diçka shumë më serioze se sa shansi që karriera të ndërtohet.

Fanatikët dhe parimorët janë të ngjashëm me këto grupe përfaktin se veprimet e tyre udhëhiqen nga pasojat, por dallohen nga ato përfshak se motivimi i tyre më i rëndësishëm nuk buron vetvetiu nga pasojat. Parimorët dallohen nga fanatikët me gatishmërinë e tyre përfshak kur kuptojnë se çështja është e pavlefshme apo të mos i shërbejnë më asaj. Disa nga kryesit e veprave penale që transformohen nga rezistues hyjnë në këtë kategori. Mospërfillësit dallohen nga gjitha grupet tjera sepse arsyet përfshijnë motivet.“ (Elster, 2005:222-223)<sup>106</sup>

Në procesin e drejtësisë tranzicionale shtrohet pyetja se si të veprohet me kryesit e këtillë të veprave penale. Historia na mëson përfshikuesë se perzekutim, punë e detyruar, burgim, dënim me burgim me kusht, marrja e të drejtave qytetare dhe politike, humbja pas vdekjes e „statusit të viktimit“, konfiskimi dhe dënimë në të holla. Gjithashtu, kur bëhet fjalë përfshikuesë, duhet përcaktuar masat e nevojshme konkrete në bazë të tij cilave do të sanksionohen zyrtarët publik.

Kryesit e veprave penale që e kuptojnë se kanë bërë keq normalisht se e ndjejnë fajësinë. Ndjenja e fajësise ndikon që kryesi të pendohet në përpjekje përfshak kur kuptojnë se shkaktuar apo, nëse kjo është e mundur, që t'i shkaktohet vites një dëm i ngjashëm si mënyrë alternative e kthimit të „baraspeshës morale të universit“ (Elster, 2005:367).

## Viktimat

Kur bëhet fjalë përfshikuesë, duhet së pari

të vendoset se përfshak se cilat lloje të vuajtjeve do të jepet statusi i viktimit. Vuajtjet mund të janë materiale (humbja e pronës), personale (shkelja e të drejtave njerëzore) apo të prekshme (humbja e mundësive). Pastaj, duhet vendosur se cilin nga familjarët dhe anëtarët e varur të familjes së viktimitave „primare“ do ta përfshijmë në kuadër të viktimitave „sekondare“ (Elster, 2005:189-190).

Vuajtjet në formë të dëmit material shprehen përmes statusit të pronës. Ajo mund të jetë e paluajtshme dhe personale. Nëse është personale mund të jetë në formë të objekteve fizike apo mjeteve financiare. Një formë e dëmit material është shkatërrimi i pronës. Kjo formë e humbjes zakonisht „kompensohet me më pak zemërgjerësi se sa prona e konfiskuar“.<sup>107</sup> Një problem i ndjeshëm është çështja e pronësise së dyfishtë. Parimi udhëheqës në këtë rast duhet të jetë se prona, e cila nuk kontestohet brenda një numri të arsyeshëm të viteve duhet të jetë pronë e plotë, siç edhe përcaktohet sipas ligjeve të të gjithë popujve. Sa më shumë që të jetë i shprehur komponenti emotiv në kërkesat përfshikuesë, gjë që ndodh në shumicën e rasteve, dhe sa më shumë që emocionet të dobësohen me kohë, që gjithashtu ndodh shpeshherë, aq më shumë kemi arsyet përfshikuesë se me kalimin e kohës restitucioni do të bëhet më i rrallë.<sup>108</sup> Restitucioni i të mirave të grabitura është i drejtuar kah e kaluara dhe i bazuar në të drejtat. Zgjidhja alternative – kompensimi – është i drejtuar kah e ardhmja dhe është utilitariste (Elster, 2005:264-271).

Vuajtjet personale kanë të bëjnë me vitet e kaluara në burgje apo kampe të përqendrimit, ku viktimat jo vetëm që janë privuar nga liria, por shpesh edhe janë keqtrajtuar.

Në kuadër të vuajtjeve të padukshme (që nuk mund të prekshme) hyjnë mungesa apo humbja e mundësive. Gjatë kohës së regjimeve autokratike disa mundësi mund t'iu mohohen të gjithë qytetarëve, grupeve të caktuara apo të kufizohen vetëm përfshikuesë, që janë këtë privilegjuar. Alokimi i kompensimeve përfshikuesë mund të varet nga kohëzgjatja dhe

106 Elster thekson se llojet e ndryshme të kryeve provokojnë reaksione të ndryshme emocionale. Konformistët dhe mospërfillësit ngjallin zemërimin dhe indinjatë, fanatikët dhe keqdashësit urrejtje, oportunistët dhe humbësit përbuzje. Përderisa konformistët dhe mospërfillësit shkaktojnë këto emocione të caktuara përfshak të asaj që bëjnë, akterët e kategorive tjera nxisin reagime emocionale përfshak të asaj që janë. Në mesin e kësaj kategorie të dytë, fanatikët dhe keqdashësit na shtyjnë në urrejtje sepse janë të kqinj; oportunistët dhe humbësit ngjallin përbuzje sepse janë të dobët (Elster, 2005:224).

107 Elster përmend shembullin e Norvegjisë ku ligji kishte përfshikuar që t'i ndihmohet të mbijetuarve gjatë restaurimit, e jo që të kthehen pasuritë e paraluftës.

108 Kujtimet zbehen me kalimin e kohës. Emocionet do të zbehen në masën që kujtimet nxisin emocione. Kujtimi i ngjarjeve me ngarkesë emotive humbet më ngadalë. Emocionet e dobësojnë por nuk e eliminojnë harresën (Elster, 2005:342).

intensiteti i vuajtjeve të kaluara apo nga shkalla e nevojave të tanishme. Siç thekson Elster „kompensimi asnjëherë nuk është i mjaftueshëm, prandaj nevojitet të ekzistojë lidhja kauzale në mes dëmeve të pësuara në të kaluarën dhe nevojave të tanishme“ (Elster, 2005:286, 340).

Krimet që shkaktojnë vuajtje mund të provokojnë dy lloje të reagimeve te viktimat (apo palët e treta). E para, mund të shfaqet dëshira që autorëve të krimit t'u shkaktohen vuajtje sipas parimit „*sy për sy, dhëmb për dhëmb*“. E dyta, mund të ekzistojë dëshira që dëmi të anulohet, të paktën në një masë të caktuar apo për aq sa është e mundur. Në sistemet bashkëkohore juridike ndëshkimi nuk arsyetohet me nevojat e viktimateve. Dëmshpërbllimi për viktimat e krimeve është i ndarë nga dënimini i kryesve të krimeve (Elster, 2005:262).

Elster thekson se është e vështirë të anulohet dëmi i shkaktuar: „në vend të kësaj mund të përpinqemi që të vendoset gjendja e cila do të ekzistonte sot sikur të mos kishte ndodhur dëmi në fjalë“.<sup>109</sup>

## Emocionet

Emocionet kanë rol të rëndësishëm në përcaktimin e fuqisë së kërkësës për retribucion (ndëshkim). Elster pohon se emocionet e kanë „gjysmë-kohën e zbërthimit të shkurtër“, por thekson se ekzistojnë katër mekanizma, të cilat mund ta ngadalësojnë dobësimin e tyre. Këto janë: komunikimi në mes viktimateve të krimit, parimet e nderit që i mbajnë gjallë kujtimet deri sa të përmbushet etja për hakmarrje, mbetjet e dukshme fizike të krimeve si dhe vazhdimi i mëtejshëm i gjërave në gjendjen e shkaktuar nga krimet (Elster, 2005:348). Emocionet ndikojnë në motivim ku shquhen: dëshira për hakmarrje, dëshira për drejtësi retributive (ndëshkuese) substanciale dhe dëshira që të ndiqen parimet procedurale korrekte në zbatimin e drejtësisë substanciale. Arsyë shtesë për respektimin e sundimit të ligjit në drejtësinë tranzisionale është se liderët e rinx dëshirojnë që sa më shumë të distancohen nga veprimet e paligjshme të paraardhësve të tyre.<sup>110</sup> Megjithatë, shoqëritë e këtilla shpesh gjenden para dilemës nëse duhet të veprojnë në atë mënyrë duke u distancuar nga regjimi paraprak apo ta dënojnë ash-

për regjimin, ashtu siç e meriton. Demokracitë e reja mund ta zgjidhin këtë dilemë në një nga tre mënyrat e mëposhtme:

- duke insistuar në respektimin e parimeve themelore siç është ndalimi i miratimit të ligjeve retroaktive apo zgjatjes së afatit të parashkrimit/vjetritimit të lëndëve,
- regjimet e reja mund pranojnë hapur në mënyrë të sinqertë nevojën për shkeljen e këtyre parimeve në një situatë të paprecedent,
- më e zakonshmja, mund të „shfrytëzohen dredhitë dhe t'i kemi të dyja“ (Elster, 2005:361-363).

Elster e përmend kategorizimin e faktorëve që e rrisin apo zvogëlojnë kërkësën për drejtësi tranzisionale sipas Karlos Ninës. Kërkësën e rrisin: mizoria e krimeve të kryera, numri absolut dhe relativ i krimeve, identifikimi me viktimat, regjimi jodemokratik i imponuar nga një fuqi e huaj, përhapja e njohurive mbi krimet, mirëqenia absolute dhe relative e kryesve pas tranzacionit. Faktorët që e zvogëlojnë kërkësën për drejtësi tranzisionale janë koha e kaluar nga kryerja e veprës deri në gjykim, identifikimi i shoqërive me autorët e krimeve, gjërsia e përgjegjësisë, krimet që janë kryer nga kundërshtarët e regjimit dhe përfaqësuesit e regjimit dhe koha që ka kaluar nga tranzicioni deri te fillimi i gjykit (Elster, 2005:344).

## Struktura, kufizimet dhe politika

### Koha

Përpos vendimit se çka do të konsiderohet krim dhe kush do të konsiderohet kryes i krimit, është me rëndësi të merrët vendimi edhe për kornizën kohore, me fjalë tjera sa do të shkohet prapa në të kaluarën? Gjithashtu, shtrohet pyetja kur do të fillohet?

Duke pasur parasysh dimensionin kohor, Elster ofron këtë ndarje të drejtësisë tranzisionale:

- Drejtësia tranzisionale e drejtpërdrejt* (procedura fillon menjëherë pas tranzacionit dhe përfundon brenda pesë vitesh)
- Drejtësia tranzisionale e prolonguar* (procesi fillon pa shtyrje, në mënyrë që më pas të shtrihet në një periudhë të gjatë kohore derisa të zgjidhen çështjet. Ky proces

109 Sipas Elsterit ky kriter i gjendjes ekstreme nuk është adekuat meqenëse nuk merr parasysh vuajtjet të cilat kanë ndodhur gjatë periudhës në mes kohës kur ka ndodhur krimi dhe të tashmes (Elster, 2005:263).

110 Këtu duhet të jemi të kujdeshëm. Elster thekson deklaratën nga koha e Vaclav Havelit: „Bashkë me thirrjen për qeveri të pajtimit kombëtar ishte edhe thirrja ‘Ne nuk jemi si ata’ (Njesme jako oni). Skeptikët u përgjigjën me fjalët ‘Po, ne jemi budallenj’“ (Elster, 2005:376).

- është zhvilluar në Gjermani pas vitit 1945, sikurse edhe në shumicën e shteteve post-komuniste)
3. *Drejtësia tranzicionale e valës së dytë* (ka tre etapa ku pas procesit të drejtësisë tranzicionale të drejtëpërdrejt pason periudha e latentës, gjatë së cilës nuk ndërmerret asgjë, në mënyrë që disa dekada më vonë të ndërmerren masa tjera)
  4. *Drejtësia tranzicionale e shtyrë* (masat e para ndërmerren dhjetë apo më shumë se dhjetë vjet pas tranzicionit) (Elster, 2005:119).

Kur regjimi jodemokratik është jetëshkurtër manifestohet tendencia që kujtimet e krimeve dhe vuajtjeve të janë të freskëta, prandaj edhe kërkesat për ndëshkim janë më urgjente, kështu që përfillimin e drejtësisë tranzicionale duhet të pritet më pak (Elster, 2005:119-120). Paralajmërimi i drejtësisë së vendosur para se autorët të përfundojnë në burg, siç ishte rasti në hapësirat e ish Jugosllavisë<sup>111</sup>, mund ta vonojë tranzicionin duke e forcuar vullnetin për rezistencë të udhëheqësit diktatorial (Elster, 2005:149).

### Aktorët e drejtësisë tranzicionale

Vendimet kryesore me të cilat mund të ballafaqohen regjimet e reja gjatë drejtësisë tranzicionale janë: kë duhet nxjerrë para gjyqit, respektivisht kë duhet sanksionuar apo kompensuar dhe si duhet gjykuar, sanksionuar apo kompensuar.

Drejtësia tranzicionale mund të përfshijë disa fusha: institucionet mbinacionale, shtetet nacionale, organet korporative dhe individët. Në institucionet mbinacionale bëjnë pjesë Tribunali Ndërkombëtar Ushtarak në Nuremberg, Tribunali Ndërkombëtar Ushtarak për Lindjen e Largët dhe Tribunali Ndërkombëtar Penal për Krimet e Kryera në Ruandë dhe ish-Jugosllavisë. Në aktorët korpoartivë hyjnë organizatat (partitë politike dhe kishat), ndërmarrjet ekonomike, shoqatë profesionale dhe kishat.

Krimet e kryera nga regjimi paraprak krijojnë tre lloje të autorëve. Së pari, ekzistojnë autorët e krimeve, ata të cilët kanë kryer krimë në emër të regjimit autokratik. Së dyti, ekzistojnë viktima që kanë pësuar nga krimet. Së terti, ekzistojnë ata që kanë përfituar nga krimet. Kësaj ndarje

mund t'ia shtojmë edhe kategorinë e ndihmësve, të cilët janë përpjekur t'i zbusin apo parandalojnë krimet gjersa ato ishin duke ndodhur, sikurse edhe ata që kanë rezistuar, kanë luf tuar apo u janë kundërvënë autorëve të krimeve derisa këta ishin akoma në pushtet. Kategori tjetër janë neutralët, ata të cilët nuk janë as autorë të krimeve, as viktima, as ndihmës e as rezistues. Pas tranzicionit lajmërohen organizatorët dhe përfaqësuesit e drejtësisë tranzicionale apo promovuesit e saj. Këtu bëjnë pjesë aktorët politikë, që marrin vendimin përfillimin e lustracionit, gjykimeve dhe reparacioneve, dhe elementët laike (porotët, komitetet e lirimt dhe të ngjashme), të cilët mund të inkadrohen në zbatimin e vendimeve të tyre. Në kuptim më të gjerë, promovuesit janë më të zëshmit në kërkimin e drejtësisë. Gjykatësit dhe prokurorët mund të hyjnë në kuadër të kësaj kategorie nëse udhëhiqen nga motivet politike. Ekzistojnë edhe ata që e pengojnë drejtësinë tranzicionale, do të thotë individët që përpilen t'i kundërvihen këtij procesi, ta ndërpresin apo ta shtyjnë. Elster thekson se individi mund të shfaqet në disa kategori (Elster, 2005:156).

Elita që largohet nga skena politike, e cila u takon kryesve të krimeve, mund të mbështetet në fuqinë e saj ushtarake apo ekonomike përfituar imunitetin. Gjithashtu, mund të hyjë në politikë dhe të mbrohet me ndihmën e votave të votuesve të saj. Kjo strategji sipas Elsterit është e zbatueshme nëse regjimi autokratik ka qenë në fuqi përfi një kohë të mjaftueshme përfituar numër të madh të anëtarëve të partisë dhe bashkëpunëtorëve tjerë dhe nëse regjimi i ri ua mundëson atyre që të organizohen qoftë në formë të partive politike apo në formë të grupeve përfituar, të cilat mund të ushtrojnë ndikim në partitë ekzistuese (Elster, 2005:390). Qeveritë që vijnë pas ballafaqohen me sfida të posaçme: „Qeveria e Adenauerit është dashur të paguajë çmimin të dyfishtë. Në frontin shtëpiak ka paguar çminin përfituar që mos-ndëshkimit, të cilën e ka bërë me qëllim që të arrijë paqen e brendshme. Në frontin ndërkombëtar çminin që pagoi përfituar në botën perëndimore, ishte pagesa e reparacionit përfituar Izraelin“ (Elster, 2005:396). Sipas Elsterit aspekti kryesor i politikës së drejtësisë tranzicionale pas tranzicionit në Evropën Lindore ishte miratimi i Ligjit përfituar. Përfituar ky proces është i diskutueshëm. Ai tregon se pas Luftës së Dytë Botërore në Gjermani filloj

<sup>111</sup> Gjatë Luftës në Kosovë, në maj të vitit 1999, Gjykata Ndërkombëtare Penale përfituar ishte gjithashtu aktakuzën ndaj Milosheviqit përfituar që krimet kundërshtuan. Akuzat përfituar ishte gjithashtu gjatë Luftës së Konventës së Gjenevës, që kundërshtuan krimet e Hercegovinës, që përfituan në Bosnjë dhe Hercegovinë janë shtuar një vit e gjysmë më vonë. Shih: <http://www.hlc-rcd.org/images/stories/pdf/bilten/Bilten11.pdf> (shikuar më 21.03.2013).

procesi gjithëpërfsirës i pastrimit (de-nacifikimit), por rana ndjeshëm kur doli se realizimi i saj ishte i vështirë.<sup>112</sup>

## Konceptimi i drejtësisë

Në analizën që i bëri strukturën së drejtësisë tranzicionale, Elster insiston që së pari të përcaktohen konceptet e drejtësisë dhe së drejtës, të cilat përfqohen nga subjektet për të cilat flitet. Pasi të përcaktohet konceptimi i drejtësisë tranzicionale mund të kërkohen shkaqet dhe pasojat e saj, posaçërisht ndikimin që ka në sjellje. Në konceptimin e drejtësisë dhe veprimet qe lidhen me të kanë gjithsesi ndikim emocionet dhe interesat (Elster, 2005:133-134).

Kur bëhet fjalë për interesat duhet ditur se ekzistojnë shumë lloje, siç është interes i kryesve të krimeve, që t'i ikin ndjekjes penale, interesi i viktimateve, që të fitojnë kompensim dhe interesi i partive politike, që ta rrisin elektoratin e tyre. Në shumë raste interesat shkrihen me arsyet dhe pasionet e kuptueshme duke krijuar ideologji politike (Elster, 2005:137).

Ekziston edhe çështja e masave procedurale ndaj shtetit që është përgjegjës pér krimet. Elster merr shembullin e Gjermainisë kur thekson: „Nëse ndaj saj do të veprohej me butësi Gjermania do të kishte mjete pér nisjen e një lufte të re agresive, ndërsa po të mbahej një qëndrim i pamëshirshëm, do të kishte motiv të fortë që të niste luftë“ (Elster, 2005:320).

Dallogen tre forma institucionale të drejtësisë: drejtësia ligjore, drejtësia administrative dhe drejtësia politike. Drejtësia e pastër politike ndodh atëherë kur pushteti ekzekutiv (apo ndonjë fuqi okupuese) në mënyrë të njëanshme dhe pa mundësi ankesë identifikon autorët e krimit dhe vendos çka të bëjë më ta (Elster, 2005:138). Në skajin tjetër është drejtësia e pastër ligjore që ka katër karakteristika: e para, ligjet duhet të jenë sa më të qarta në mënyrë që t'iu zgrogëlohet mundësia gjykatave që t'i interpretojnë ato; e dyta, gjykatat duhet të jenë të ndara nga degët tjera të pushtetit; e treta, gjykatësit dhe porotët duhet të jenë të paanshëm kur e interpretojnë ligjin; e katërtë, drejtësia ligjore duhet t'i përbahet parimit të procedurës gjyqësorë të paraparë me ligj, posaçërisht parimit se gjykimi duhet të jetë publik, kurse në seancat gjyqësore duhet të marrin pjesë në mënyrë të barabartë akuza dhe mbrojtja; e drejta në zgjedhjen e avokatit; e

drejta në ankesë; pa zbatim retroaktiv të legjislacionit apo të ligjit; respektimi i dispozitave pér parashkrin; përcaktimi i përgjegjësisë individuale; prezumimi i pafajësisë duke ia hedh barrën e provës organit të akuzës; e drejta në gjykim të shpejtë (drejtësia e vonuar është drejtësi e mohuar); e drejta në shqyrtimin e duhur para marrjes së vendimit (drejtësia e shpejtë është gjithashtu drejtësi e mohuar) (Elster, 2005:140-142). Sipas Elsterit këto të drejta shkelen në mënyrë rutinore në drejtësinë tranzicionale, përderisa në „rrethanat normale“ kritere shkelen rrallë. Kur grumbullohen shumë shkelje apo kur shkelen kriteret themelore - drejtësia ligjore zëvendësohet me drejtësinë politike. Deri te kjo vjen në atë moment kur vëzhguesi mund të parashikojë me siguri të plotë përfundimin e të gjitha gjykimeve. Drejtësia ligjore kërkon që përfundimet të jenë të mbështjellë, deri në një farë mase, me vallon e pasigurisë (Elster, 2005:142).

Elster thekson se drejtësia tranzicionale, pothuajse gjithmonë, përfshinë edhe vendime procedurale që devijojnë nga standardi i „drejtësisë së pastër ligjore“. Këtu hyjnë: internimet joligjore, faji kolektiv, supozimi i fajësisë e jo i pafajësisë, zgjedhje e njëanshme e porotëve dhe gjykatësve, pabarazia mes akuzës dhe mbrojtjes, mosekzistimi i mekanizmit të ankesës, numri arbitrar i të akuzuarve, gjykatat speciale, marrëveshja mes prokurorisë dhe të akuzuarit, legjislacioni retroaktiv, zgjatja apo heqja e afatit të parashkrimit, shkurtimi i kohës së parashkrimit, drejtësia e vonuar, drejtësia e shpejtuar (Elster, 2005:192-197).

Pyetja me rëndësi është edhe peshimi i dënimit. Gjatë analizës së drejtësisë tranzicionale Elster konstaton se athinasit „erdhën në përfundim se trajtimi i ashpër nuk është në favor të qëllimit të drejtësisë, sepse i zemëron viktimat në vend që t'i tmerrojë ato“ (Elster, 2005:40). Elster përmend edhe rastet që tregojnë se „megjithëse restitucioni mund të korrigojë një të keqe historike, ai mund të krijojë edhe probleme të reja dhe, ironikisht, edhe padrejtësi“ (Elster, 2005:151).

Veprat e këqija nganjëherë mund të justifikohen, prandaj Elster dallon arsyetimin, kërkim-faljen dhe rrethanat lehtësuese. Kur ndonjë vepër e keqe arsyetohet, me këtë tregojmë se ajo nuk përbën krim. Kur një krim falet, falja tërheq përgjegjësinë penale pér veprimin (Elster, 2005:224).

<sup>112</sup> Ky proces u është lënë vetë gjermanëve, të cilët treguan shumë pak interesim të ballafaqohen me të kaluarën e tyre: „Deri në shkurt të vitit 1947 gjykatat gjermane kishin përpunuar diçka më shumë se gjysmën nga 11.674.152 e formularëve të plotësuar (Fragebogen). Nga këtë 6 milionë individë para gjyqit janë nxjerrë 168.696 prej tyre. Nga ky numër vetëm 339 janë kualifikuar si autorë të veprave të renda, 3.612 si autorë dhe 13.708 si autorë të veprave të lehta. Pjesa tjetër është kualifikuar në kategorinë 'bashkëpunëtorë pasiv' (Mitläufer) ose janë liruar nga akuzat“ (Elster, 2005:92).

## Rasti i Serbisë

Qëndrimet në lidhje me drejtësinë tranzicionale në Serbi mund të përmblidhen me sa vijon: 1. termi drejtësi tranzicionale në Serbi është kryesisht i panjohur për publikun e gjerë, 2. drejtësia tranzicionale është objekt interesimi i një rrathi të ngushtë të organizatave dhe individëve (pjese e sektorit civil), 3. drejtësia tranzicionale është subjekt themelor i praktikës së Serbisë si shtet, 4. praktika e shtetit të Serbisë që lidhet me drejtësinë tranzicionale është shumëfish kontraverze.

## Kuptimi i drejtësisë tranzicionale në Serbi

Nëse do ta pyesnim qytetarin e rëndomtë të Serbisë përkuptimin e termit "drejtësi tranzicionale", përgjigja më e shpeshtë do të ishte se ky term pëershkruan gjendjen në të cilën qytetarit, gjatë procesit të tranzacionit, nuk i është hequr asgjë nga të drejtat e tij, ashtu që nuk i është ekspozuar privatizimit të pandershëm, largimit nga puna apo ndonjë forme tjetër të mohimit të të drejtave sociale apo ekonomike. Ky perceptim i së drejtës tranzicionale vjen si pasojë e të kuptuarit të tranzacionit si proces, gjatë të cilit shoqëria dhe shumica e institucioneve të saj kalojnë nga sistemi socialist me ekonomi të planifikuar në sistemin e bazuar në ekonominë e tregut dhe pronën private.<sup>113</sup> Kjo pikëpamjet e shembullin e raporteve pronësore: supozojmë se shumica e qytetarëve me tranzicion nënkuption shiten e pronës shoqërore pronarëve të rinj, ndaj të cilëve mbajnë qëndrim relativisht pajtues, përderisa gjithashtu supozojmë se qytetarët në tranzicion rrallë e kuptojnë se pronën shoqërore duhet t'ua kthejmë pronarëve të mëparshëm, për të cilën kanë qëndrim më negativ.

Dy pikëpamjet e ndryshme mbi procesin tranzisional shihen në këto dy terma 'privatizimi' dhe 'kompensimi', të cilat në vetëdijen e qytetarëve mund te duket se janë në kundërthënie, megjithëse realisht (madje edhe zakonisht) ato mund të identifikoohen me njëri-tjetrin. Kjo mund të shpjegohet me shembullin e raporteve pronësore: supozojmë se shumica e qytetarëve me tranzicion nënkuption shiten e pronës shoqërore pronarëve të rinj, ndaj të cilëve mbajnë qëndrim relativisht pajtues, përderisa gjithashtu supozojmë se qytetarët në tranzicion rrallë e kuptojnë se pronën shoqërore duhet t'ua kthejmë pronarëve të mëparshëm, për të cilën kanë qëndrim më negativ.

Arsyeja për këtë është statusi kontravers i të kaluarës së Serbisë kur ekzistonte represioni shtetëror apo konflikti, që kërkonte drejtësi tranzicionale.<sup>117</sup> Në këtë drejtim mund të

113 Për shembull, në Studimin e Bankës Botërore *TRANZICIONI Dhjetë vitet e para - Analiza dhe mësimë nga Evropa Lindore dhe ish-Bashkimi Sovjetik* thuhet: „Përvoja e tranzacionit, që do të thotë kalimi nga planifikimi i centralizuar në ekonominë e tregut paraqet proces që nuk është parë në historinë e deritanishme dhe i cili është larg përfundimit në shumë vende të Evropës Lindore dhe ish-Bashkimit Sovjetik. [http://siteresources.worldbank.org/SERBIAEXTN/Resources/3009031106760681824/TRANZICIJA\\_Prvih\\_10\\_Godina.pdf](http://siteresources.worldbank.org/SERBIAEXTN/Resources/3009031106760681824/TRANZICIJA_Prvih_10_Godina.pdf) (e shikuar më 20.03.2013.)

114 <http://ictj.org/about/transitional-justice> (e shikuar 17.03.2013.)

115 Meri Kaldor thekson se dallimet e paqarta në mes shkeljes së të drejtave të njeriut që lidhen me luftën si dhunë politike në mes shteteve, apo grupeve të organizuara politike, apo që lidhet me krim të organizuar, që paraqet dhunë, të cilën për shkaqe personale e ushtrojnë grupet e organizuara, shpeshherë për shkak të përfitimeve personale.

116 <http://ictj.org/about/transitional-justice> (e shikuar më 17.03.2013.)

117 Me këtë rast duhet përmendur se mund të kthehemi disa shekuj mbrapa, le të themi në Luften e Kosovës të vitit 1389, e cila mbeti pjesë e vetëdijes mitike dhe ideologjisë nacionaliste që edhe sot është e pranishme në jetën politike dhe kulturore. Për fat të keq, sado e pabesueshme që mund të tingëllojë, pamë se disa krime të luftës janë arsyetur si hakmarrje ndaj „turqve“, që për pese shekuj kanë bërë zullum ndaj serbëve.

pohojmë se në Serbi kanë ekzistuar disa procese të drejtësive tranzicionale:

1. Drejtësia për viktimat e rregullimit shtetëror të para Luftës së Dytë Botërore, kur Partia Komuniste, në bazë të ideologjisë marksiste, e paraqet proletariatin si viktimë të ekspluatimit kapitalist (Marksi, Engelsi, 1958). Rrjedhimisht, ajo mendonte se është e drejtë të shfuqizohet represioni i borgjezisë ndaj proletariatit. Pasi fitoi fuqi politike gjatë Luftës së Dytë Botërore, Partia Komuniste erdhi në situatë që menjëherë pas lufte t'i zbatojë masat e nacionilizmit, sekuestrimit, rigrupimit dhe veprime tjera përmarrjen e pronës private nga pronarët e ligjshëm dhe shndërrimin e saj në pronë shoqërore<sup>118</sup>, dhe në këtë mënyrë shteti kaloi deri në fund në socializëm vetëqeverisës (supozohet se edhe sot një numër i madh i qytetarëve të Serbisë mendojnë se kjo ishte e drejtë). Këto veprime mund shihen si një formë e posaçme e drejtësisë tranzicionale revolucionare.
2. Drejtësia për viktimat gjatë kohës së Luftës së Dytë Botërore, gjatë kohës së luftës, Partia Komuniste u pozicionua me vendosmëri në planin antifashist, përdallim nga Ushtria e Mbretërisë Jugosllave, Lëvizja çetniqe apo fashiste të Dimitrije Ljotiqit dhe kolaboracionistik Milan Nediqit (Zeçeviq, Vuçeviq, 2011). Gjatë luftës ushtria partizane u konfrontua me okupatorët dhe bashkëpunëtorët e tyre dhe doli nga ajo në anën e fitimitarëve. Për shkak të viktimate që pësuan në luftë, u ndoqën dhe u persekutuan bashkëpunëtorët dhe ndihmësit e okupatorëve si kryes të krimeve. Mund të thuhet se në Serbi ka gjithnjë e më pak nga ata që mendojnë se kjo ishte e drejtë.
3. Drejtësia për viktimat e persekutimit komunist<sup>119</sup> – Projekti i Jugosllavisë së pasluftës kishte kundërshtarët e vet, të cilët përfunduan në vende siç është Goli Otoku. Shtrohet pyetja sa është apo sa ishte një gjë e tillë e drejtë. Gjatë shpërbërjes së RSF të Jugosllavisë, që u zhvillua paralelisht me rënien e murit të Berlinit dhe shkatërrimit të Bllokut të Lindjes, fillon procesi i tranzicionit në sistemin shumë-partiak. Në Serbi kontinuitetin e PK e merr Partia Socialiste e Serbisë me Sloboden Milosheviqin në krye. Për SPS-në mund të thuhet se nuk ishte shumë e interesuar për drejtësinë tranzionale, që nënkupton mos kompensimin e viktimate të komunizmit gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore.<sup>120</sup> Parti opozitare e SPS-së një kohë ishte Lëvizja monarkiste-çetniqe e Përtëritjes Serbe, që angazhohej për restaurimin e monarkisë dhe është krijuar me bashkëpunimin e Vuk Drashkoviqit<sup>121</sup> dhe Vojislav Sheshelit në vitin 1990. Me largimin e rrymës së Sheshelit, u krijuar Lëvizja Çetniqe Serbe, kurse më vonë edhe Partia Radikale Serbe. Bazuar në Memorandum mund të thuhet se Milosheviqi me politikën e tij është përpjekur ta përmirësoj pozitën e „pa drejtë“ të Serbëve në Jugosllavi. Kjo politikë e bëri SPS-në më të afërt me SRS-në çetniqe. Gjatë kohës së qeverisjes së Milosheviqit filloj shpërbërja e dhunshme e RSFJ-së, ku në anën serbe rol të rëndësishëm pati Ushtria e Jugosllavisë, policia, formacionet paraushtarake, mes të cilave edhe njësitë vullnetare, SRS dhe mbrojtja territoriale.
4. Drejtësia për viktimat e konflikteve të armatosura në ish Jugosllavi – Sipas vlerësimeve nga disa burime të paravarura, në luftërat në ish- Jugosllavi vdiqën rreth 130.000 njerëz.<sup>122</sup> Këto janë viktima të reja, që kërkojnë drejtësinë

118 Lista e akteve ligjore për konfiskim gjendet në: Ligjin për kthimin e pronës së konfiskuar dhe kompensim (“Gazeta zyrtare RS”, nr. 72/2011).

119 Këtu duhet të përmendim edhe një formë të çuditshme të kërkuesave përdicë që kushtimi do të mund ta quajmë kërkuesë për drejtësi tranzicionale. Bëhet fjalë për Memorandumin e Akademisë Serbe të Shkencave dhe Arteve të fundit të vitit 1986, në të cilin kombi serb u prezantua si viktimi e projektit jugosllav. Në aspektin politik qëndrimi ndaj Memorandumit ishte një nga arsyet e ndarjes së Ivan Stamboliqit nga Sloboden Milosheviqin në Kuvendin e VIII të Komitetit Qendror të Lidhjes së Komunistëve të Serbisë, të mbajtur në shtator të vitit 1987. Shih:[http://www.pescanik.info/images/stories/pdf/memo/memorandum\\_santu.pdf](http://www.pescanik.info/images/stories/pdf/memo/memorandum_santu.pdf)

120 Për shembull, edhe pse Kisha Ortodokse Serbe ishte qenësishet e interesuar që t'i kthehet prona, të cilën ia kishin marrë gjatë kohës së komunizmit, Ligji për kishat dhe bashkësítet fetar u miratua në vitin 2006, gjatë kohës së qeverisjes së Vojislav Koshtunicës, e pas tij edhe Ligji për kthimin (restitucionin) e pronave kishave dhe bashkësive fetare. Ligji për kthimin e pronës së marrë dhe kompensim është miratuar në vitin 2011 nga Qeveria e Mirko Cvetkoviqit.

121 Drashkoviq ishte në pushtet në postin e zëvendëskryeministrit të Republikës Federative të Jugosllavisë, prej datës 18 janar 1999 deri më 28 prill 1999, gjatë kohës së konfliktit të Kosovës dhe bombardimeve të NATO-s.

122 <http://www.hlc-rdc.org/?cat=266> (e shikuar më 20.03.2013.)

e tyre tranzicionale. Meri Kaldor e përshkruan luftën në hapësirat e ish-RSF të Jugosllavisë si luftë të „re“: „Luftërat e reja përshkruhen si luftëra të brendshme ose luftëra qytetare, apo edhe si ‘konflikte të intensitetit të ulët’. Sidoqoftë, edhe pse shumica e këtyre luftërave ishin të karakterit lokal, në to janë përfshirë një numër i madh i kanaleve ndërkombëtare, ashtu që është e vështirë të ruhet dallimi në mes të brendshmes dhe të jashtmes, në mes agresionit (sulmit nga vendi), apo mes lokales dhe globales“ (Kaldor, 2005:14). Për shkak të këtyre paqartësive shtrohet pyetja: kur flitet për ngjarjet e viteve të 90-ta bëhet fjalë për luftë apo luftëra? Nëse flitet për luftëra atëherë këto janë konflikte të armatosura në ish-republikat e RSFJ-së, Slloveni, Kroaci, Bosnjë dhe Hercegovinë dhe bombardimi i Serbisë nga ana e NATO-s në vitin 1999. Kësaj liste duhet shtuar edhe konfliktin në ish-Krahinën Autonome të Kosovës dhe „konfliktin e Preshevës“ në vitin 2001, si *par excellence* e luftërave qytetare.

5. Drejtësia për viktimat e regjimit të Millosheviqit për një nga liderët e partisë opozitare, Vuk Drashkoviq, dhe bashkëpunëtorët e tij të ngushtë, të cilët ishin viktima të atentateve dhe rrahjeve, nga dora e institucioneve shtetërore. Ivan Stamboliq, kundërshtar i Millosheviqit, gjithashtu u vra nga ana e regjimit. Viktima të regjimit ishin edhe opozitarët tjerë si anëtarët e organizatës Otpor (Rezitenca) etj. Nga qytetarët tjerë të Serbisë viktima të regjimit ishin edhe pjesëtarët e pakicave kombëtare, me shtetet amë të të cilëve „Serbia nuk ishte në luftë“, boshnjakët, kroatët dhe shqiptarët. „Vetëm sa përkujtim do të themi se gjatë periudhës 1991-95 në Vojvodinë u vranë dhe (ose) u zhdukën 25 kroatë, u shkatërruan në themel dy kisha katolike (Vashice dhe Novi Banovci), kurse kishte edhe disa dhjetëra dëmtime të objekteve me anë të mjeteve shpërthyse“ (Zhigmanov, 2011:37-38.). Për shkak të këtyre krimeve, Vojislav Sheshel u akuzua nga Gjykata Ndërkombëtare Penale për ish-Jugosllavinë.<sup>123</sup>

### Viktimat dhe autorët në drejtësitë tranzicionale në Serbi

Lista e viktimave, kandidatë për drejtësi tranzicionale, në Serbi është e gjatë: pronarët e kapitalit të paraluftës, prole-

tariati, partizanët, çetnikët, bashkëpunëtorët e okupatorit, fashistët vendorë, banorët e shteteve të okupuara, viktimat e persekutimit komunist të pasluftës, serbët, viktima të luftërave të viteve të 90-ta, opozita kundër Millosheviqit. Për Serbinë është karakteristike se lista e viktimave mund të kuptohet edhe si listë e kryesve të krimit. Qëndrimi mbi atë se kënd duhet kompensuar dhe prej nga duhet filluar kompensimi mund, kushtimisht, të merret si masë për përcaktimin e vendit të partive në spektrin politik të Serbisë. E majta zakonisht është interesuar për drejtësi për viktimat e konflikteve të armatosura në ish-Jugosllavi dhe drejtësi për viktimat e regjimit të Millosheviqit. Në të djathtë janë ata që kërkojnë drejtësi për pronarët e kapitalit të paraluftës, për ata që janë paditur si fashistë, për viktimat e persekutimit komunist, me një fjalë për serbët. Mund të thuhet se sot proletariatin më nuk e përfaqëson (pothuajse) askush. Kjo na bënë të pohojmë se në Serbi ekzistojnë dy drejtësi tranzicionale të djaththa dhe dy të majta.

Në vitin 2011 Serbia nisi procesin e restitucionit me miratin e Ligjit për kthimin e pronës se marrë dhe kompensim. Sipas këtij ligji pothuajse të gjitha viktimat e drejtësisë tranzicionale të dytë dhe të tretë do të kompensohen, kurse të drejtë për kthim të pronës apo kompensim nuk kanë: 1) personat fizikë – shtetasit e huaj, pasardhësit e tyre ligjorë, detyrimin për kompensimin e të cilëve e ka marrë shteti i huaj në bazë të marrëveshjes ndërkombëtare; 2) personat fizikë – shtetasit e huaj, respektivisht pasardhësit e tyre ligjor, të cilët janë kompensuar ose u është njojur e drejta për kthimin e pronës në bazë të ligjeve të shteteve përkatëse, edhe në mungesë të marrëveshjes ndërkombëtare; 3) pjesëtarët e forcave okupatore që kanë vepruar në territorin e Republikës së Serbisë gjatë Kohës së Luftës së Dytë Botërore, sikurse edhe pasardhësit e tyre.<sup>124</sup>

Pyetja, që shtrohet, është se a janë fashistët vendorë dhe bashkëpunëtorët e tyre pjesëtarë të forcave okupatore? Sipas logjikës fashistët vendorë nuk mund të janë forca okupuese edhe pse janë bashkëpunëtorë të okupatorit. Sipas përkufizimit të ligjit do të kompensohen të gjithë ata, që kanë luftuar kundër partizanëve, por që nuk ishin okupatorë të jashtëm. Megjithatë, një nga kushtet e restitucionit (kompensimit) është ekzistimi i vendimit për rehabilitim (neni 42), bazuar në Ligjin për rehabilitim, i cili është miratuar në vitin 2006.<sup>125</sup> Në përputhje me këtë ligj bëhet

123 <http://www.icty.org/case/seselj/4#ind> (e shikuar më 21.03.2013)

124 Ligji për kthimin e pasurisë së marrë dhe kompensim (“Gazeta zyrtare RS”, Nr. 72/2011).

125 Ligji për rehabilitim (“Gazeta zyrtare RS”, Nr. 33/2006).

rehabilitimi i personave të cilët janë privuar nga liria apo ndonjë e drejtë tjetër për shkaqe politike ose ideologjike pa vendime gjyqësore apo administrative, ose me vendime gjyqësore apo administrative, nga 6 prilli 1941 deri më 25 prill 2006, të cilët kanë pasur vendbanim në territorin e Republikës së Serbisë. Mund të thuhet se në këtë moment karakteri i Serbisë si shtet, që vlerëson antifashizmin, është në duart e gjykatësve.<sup>126</sup> Në përputhje me ligjin e përmendur do të kompensohen pronarët, të cilëve u është marrë prona, proces ky që i përgjigjet tranzacionit nga socializmi në kapitalizëm.

Kur flitet për të majtën dhe interesat e saj për drejtësi për viktimat e regjimit të Millosheviqit dhe viktimat e konflikteve të armatosura në ish-Jugosllavi, atëherë mund të përmendet miratimi i Ligjit për lustrim, si një nga të arriturat e saj.<sup>127</sup> Ky ligj, sipas të gjitha gjasave, do të bëhet pjesë e historisë këtë vit, kur të përfundojë zyrtarisht zbatimi i tij.<sup>128</sup> Dispozitat e këtij ligji zbatohen në të gjitha rastet e shkeljeve të të drejtave të njeriut të kryera pas 23 marsit të vitit 1976, ditën e hyrjes në fuqi të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat e Qytetare dhe Politike, sipas kushteve të përcaktuara me këtë ligj. Gjatë dhjetë vjetve të ekzistimit të tij, ligji nuk është zbatuar kurrë.<sup>129</sup> Moszbatimi i ligjit në fjalë ka legitimuar të gjithë ata persona ndaj të cilëve ai do të mund dhe do

të duhej të aplikohet. Kjo do të thotë se për sa kohë që nuk kerkohet llogari ndaj përgjegjësve, politikisht ata nuk janë përgjegjës. Nga ky aspekt, pushteti i vendosur pas pesë tetorit nuk ka bërë ndonjë ndryshim, prandaj mund të shtrohet pyetja: nëse dhe në c'masë është iniciuar tranzicioni?<sup>130</sup>

Për viktimat e konflikteve të luftës në ish-Jugosllavi është miratuar Ligji për organizimin dhe kompetencat e organeve shtetërore në proceset kundër kryesve të krimeve të luftës.<sup>131</sup> Deri më 12 mars 2013 para Prokurorisë për krimet e luftës janë proceduar gjithsej 395 persona, kurse janë akuzuar 152 persona, që fajesoherën për 2.894 viktima. Proseset kanë të bëjnë me krimet përlindët *Ovçara, Gjakova, Zvornik, Shkorpionët, Suha Reka, Velika Peratovica, Medak, Slunj, Podujevë, Banski Kovacevac, Stara Gradishka, Stari Majdan, Tenja, Rastovac*, etj.<sup>132</sup>

Përveç kësaj, është miratuar Ligji për bashkëpunimin e Serbisë dhe Malit të Zi me Tribunalin Ndërkombëtar për ndjekjen penale të personave përgjegjës për shkelje të rënda të së drejtës humanitare ndërkombëtare të kryera në territorët e ish Jugosllavisë prej vitit 1991.<sup>133</sup> Bashkëpunimi me Tribunalin e Hagës është vendosur në mënyrë të vazhdueshme si kusht për aderimin e Serbisë në Bashkimin Evropian. Serbia e plotësoi këtë kusht gjatë vitit 2011.<sup>134</sup>

126 „Gjendemi në kohën kur pasardhësit dhe ihtarët e kolaboracionizmit dhe bashkëpunimit me okupatorët fashistë gjatë kohës së Luftës së Dytë Botërore, me ndihmën e pushtetit, me të gjitha mjetet po bëjnë rehabilitimin juridik, politik, shoqëror, moral dhe klasor të bartësve të tyre“, „Është shqetësues agresiviteti me të cilën po bëhet kjo dhe mungesa e parimeve dhe masave themelore historike, që i detyron të gjithë ata që merren me histori“ (Zeceviq, Vučević, 2011:5).

127 Ligji mbi përgjegjësinë për shkeljen e të drejtave të njeriut (“Gazeta zyrtare RS”, Nr. 58/2003 i 61/2003).

128 Ligji fillon të zbatohet tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi, respektivisht nga 11 shtatori 2003 dhe zbatohet për dhjetë vjet, nga dita e hyrjes në fuqi, respektivisht deri më 11 shtator të vitit 2013.

129 Komisioni për lustrim është formuar në vitin 2003. Megjithatë, ai asnjëherë nuk është kompletuar në përbërje të plotë e as që ka pasur kushtet themelore për punë, kurse për shkak të mungesës së përkrahjes nga qeveria pothuajse të gjithë anëtarët e këtij organi kanë dhënë dorëheqje në vitin 2004. Se sa i rëndësishëm ishte lustrimi ndoshta më së miri tregon e dhëna se këto dorëheqje asnjëherë nuk janë shqyrtaar në parlament.

130 Këtu duhet përmendur fatin e Zoran Gjingsiqit, kryeministrin e parë të Serbisë demokratike, i cili është vrarë nga pjesëtarët e Njësisë për operacione speciale (një nga aktorët e konflikteve të armatosura në hapësirat e ish RSFJ-së). Pas vrasje së tij, sidomos në mungesë të tematizimit të kontekstit politik të vrasjes, qasja ndaj tranzacionit ishte e tillë që Gjykatës së Hagës t'i dorëzohen kryesit e kërkuar të krimave, përderisa drejtësia tranzicionale në Serbi është shmangur dhe lënë anash.

131 Ligji për organizimin dhe kompetencat e organeve në procedurën kundër kryesve të krimeve të luftës (“Gazeta zyrtare RS”, br. 67/2003).

132 [http://www.tuzilastvorz.org.rs/html\\_trz/predmeti\\_cir.htm](http://www.tuzilastvorz.org.rs/html_trz/predmeti_cir.htm) (e shikuar më 22.03.2013)

133 Ligji për bashkëpunimin e Serbisë dhe Malit të Zi me Tribunalin Ndërkombëtar për ndjekjen penale të personave përgjegjës për shkeljet e rënda të së drejtës humanitare ndërkombëtare, të kryera në territorët e ish Jugosllavisë, prej vitit 1991 (“Gazeta zyrtare e RFJ-së”, Nr. 18/2002 dhe “Gazeta Zyrtae SMZ”, Nr. 16/2003).

134 „Bramerc: Plotësohet kushti kryesor për BE“ në: <http://www.vestionline.com/Vesti/Srbija/154505/Bramerc-Ispunjen-kljucni-uslov-za-EU> (e shikuar me datë: 21.03.2013.)

## Viktimat e konfliktit dhe autorët e kimeve në hapësirat e ish-Jugosllavisë, që kanë të bëjnë me Serbinë

Kur bëhet fjalë për viktimat e konfliktit në hapësirat e ish-RSFJ-së e konsiderojmë të rëndësishëm faktin se viktimat kryesisht nuk janë shtetas të Serbisë apo se vendet e krimit rrallë ndodhen në territorin e Serbisë (pa Kosovën). Proseset e drejtësisë tranzicionale zakonisht zbatohen në kuadër të një shteti pas ndryshimit të regjimit apo ishin rezultat i konflikteve mes shteteve ekzistuese. Gjendjet ku konflikti dhe represioni janë zhvilluar, në të njëjtën kohë me shpërbërjen e shtetit, i konsiderojmë specifike. Për këtë arsyen evoja për tribunal ndërkombëtar është evidente.

E dhëna se vendet e krimit ndodhen kryesisht jashtë Serbisë dhe se vendet primare të kryerjes së kimeve nuk janë në Serbi konsiderohet e rëndësishme dhe në vetëdijen e publikut nuk ekziston përvaja e vuajtjeve (deri në momentin e bombardimeve të NATO-s). Kjo ndikon që të mos ketë empati për viktimat e konflikteve të nxitura nga regjimi i Millosheviqit. Besojmë se kjo ndikon edhe në moskuptimin dhe mungesën e empatisë kur bëhet fjalë për aktorët e drejtësisë tranzicionale, si për shembull ata që iu kundërvunë Millosheviqit. Një ndryshim i madh në vetëdijen e publikut ndodhi kur u zbuluan varrezat masive në Batajnici, Petrovo Sello apo në liqenin Peruçac, në të cilat ishin varrosur trupat e shqiptarëve të Kosovës. Megjithatë, ende ekziston përshtypja se „e gjithë kjo“ ka ndodhur diku tjetër, dhe se Serbia nuk ka të bëjë „më të“. Mekanizmat shoqëror të inhibimit janë ende shumë të fuqishëm.

Në përputhje me sa u tha më lartë, i vetmi mekanizëm në Republikën e Serbisë që u jep të drejtë në përkrahje materiale viktimate të shkeljeve të të drejtave të njeriut në të kaluarën është Ligji për të drejtat e invalidëve civilë të luftës.<sup>135</sup> Megjithatë, ligji ka të bëjë vetëm me viktimat, shtetas të Serbisë, ndaj të cilëve, gjatë konfliktit të armatosur, kanë ushtruar dhunë pjesëtarët e palëve armiqësore, kurse i përrash-ton viktimat e kimeve të kryera nga pjesëtarët e Ministrisë së Punëve të Brendshme (MUP) të Republikës së Serbisë, Ushtrisë Popullore të Jugosllavisë (JNA) dhe Ushtrisë së Jugosllavisë (VJ), qofshin ata shtetas të Serbisë apo të huaj (Kandiq, 2011:3).

Ndarja që ka bërë Elsteri në fanatikë, oportunistë dhe konformistë është relativisht e vështirë të shfrytëzohet pa kryerjen e një hulumtimi kualitativ. Gjeneralizimi i përgjithshëm shpie në stereotipizime. Grupet e ndryshme të plaçkitësve që kanë vepruar në fushëbeteja mund t'i klasifikojmë si oportunistë. Mes tyre ka pasur me siguri edhe keqdashës dhe humbës, sidomos në mesin e pjesëtarëve të formacioneve paraushtarake. Te shumica e qytetarëve të Serbisë mbretëronte një qëndrim i çuditshëm konformist në formë te frikës se diçka po humbet (Kosova, „Vendi i shenjtë serb“...). Kjo frikë mund të shihet si rezultat i makinerisë ideologjike nacionaliste të Millosheviqit, para së gjithash asaj mediale. Gjithashtu ekziston konvergjimi i konformizmit dhe fanatizmit në Serbi. Frika nga humbja është plotësisht komplementare me mbrojtjen fanatike, që shihet në shembullin e Kosovës. Në mesin e aktorëve fanatikë mund t'i përfshijmë, kushtmisht, edhe përfaqësuesit e Kishës Ortodokse Serbe, partitë politike si SRS (DSS do të ishte formë e fashizmit „në dorëz“, çetnikët, gardët vullnetare, shoqatat djathtiste, akademikë të caktuar dhe të ngjashëm.

Për viktimat flitet rrallë në publik. Viktimat e huaja nuk na interesojnë shumë kurse „ne“ jemi viktima të komplotit ndërkombëtar, i cili po na rrëmben territoret. Kriteret në bazë të cilave Prokuroria për kime lufte inicion procedurat është i diskutueshëm.<sup>136</sup> Në Serbi nuk është e pranishme ndjenja se në këtë mënyrë, mes tjerash, duhet të kompensohen edhe „të tjerët“ për vuajtjet e pësuara në hapësirat e ish-Jugosllavisë. Sipas këndvështrimit të Elsterit kjo do të thotë se ndjenja e fajt nuk është e pranishme. Për fat të keq, praktika e ndëshkimit të autorëve të kimeve të luftës në një mjesid të tillë forcon bindjen te publiku për serbët si viktima. Kjo nuk i kontribuon normalizimit të marrëdhënieve si në rajon ashtu edhe në vetë Serbinë.

Gjithashtu e konsiderojmë të rëndësishme lidhshmërinë e proceseve të ndryshme të drejtësive tranzicionale të përmendura. Aktorët përsëriten nga tranzicioni në tranzicion, por në role të ndryshme. Për shembull, roli i komunistëve iu kontribuon polemikave dhe moskuptimeve. Komunistët ishin kundër fashistëve dhe luftuan kundër çetnikëve gjatë kohës së Luftës së Dytë Botërore. Viteve të nëntëdhjeta, nga

135 Ligji për të drejtat të invalidëve civilë të luftës „Gazeta zyrtare RS“, Nr. 52/96.

136 „Ka pasur vetëm një numër të vogël të gjykimeve në krasim me institucionet në Bosnjë dhe Kroaci. Për këtë mungesë të përparimit ka disa arsy, duke përfshirë edhe resurset e pamjaftueshme të Prokurorisë për Krime të Luftës si dhe bashkëpunimit joadekuat për zbulimin e kimeve në mes Prokurorisë dhe Shërbimit Policor Serb, që reflektohet në nismat e pamjaftueshme për iniciimin e hetimeve për krime lufte“ në: PËRKUNDËR RRETHANAVE: Procedurat penale për krime të luftës në Serbi (2007): [http://wcjp.unicri.it/proceedings/docs/ICTJ\\_WC%20Prosecutions%20in%20Serbia\\_2007\\_bcs.pdf](http://wcjp.unicri.it/proceedings/docs/ICTJ_WC%20Prosecutions%20in%20Serbia_2007_bcs.pdf)

PK është ndarë krahu nationalist nën udhëheqjen e Milosheviqit. Ky krah nuk e kishte problem të hyjë në koalicion me Partinë Radikale të Serbisë, të cilën e udhëheq vojvoda çetnik Vojislav Sheshel. Kryetar i Serbisë sot është vojvoda çetnik Tomislav Nikoliq, përderisa koalicioni në pushtet përsëri përbëhet nga përfaqësuesit e partive që udhëhiqin vendin viteve të 90-ta (SPS dhe radikalët e deridjeshëm – SNS). Në esencë ekziston kontinuitet i bashkëpunëtorëve fashistë në historinë serbe. Perceptimi i tyre në Kroaci dhe BeH është jashtëzakonisht negativ (sikurse edhe te pjesa e publikut me orientime antifashiste në Serbi). Ky kontinuitet e vë në pyetje edhe vetë tranziconin, nëse ai ekziston kur të gjithë ata janë aty, në pushtet?

## Përfundimi

Pyetjet e Elsterit se si të krijohen kushtet që pas rënies së regjimit autokratik ai të mbahet përgjegjës dhe të ndërpritet ndikimi i tij në të ardhmen, me fjalë tjera si të krijohet një regjim i ri dhe më i mirë në Serbi, duket sikur kanë gjetur përgjigje gjysmake. Disa përfaqësues të regjimit të Milosheviqit janë nxjerrë para drejtësisë dhe është ndërprerë ndikimi i tyre. Përkundër kësaj, fitohet përshtypja se ndikimi i përgjithshëm i regjimit nuk ka humbur.

Ndalimi i plotë individual i përfaqësuesve të regjimit shpeshherë është bërë me mjete joligjore. Për shembull, Sllobodan Milosheviqi vdiq gjatë kohës sa po gjykohej në Hagë. Gruaja e tij, Mirjana Markoviq, kryetare e së Majtës Jugoslave, nuk është në vuajtje të dënimit të shqiptuar në mënyrë liiore, por ndodhet jashtë vendit, në mënyrë të tillë që më shumë i përgjigjet ostracizmit antik se sa marrëdhënieve juridike të shekullit XXI (ashtu siç duam ta paramendojmë). Përfaqësuesit e Partisë Socialiste të Serbisë dhe partive tjera, që ishin në pushtet gjatë viteve të '90-ta, janë në pushtet edhe sot. Tërheqja kuptimplotë nga politika e përfaqësuesve të regjimit është e diskutueshme dhe kjo problematikë sot parashtrohet përmes fjalisë naive të 'pjekurisë politike' të aktorëve të SPS-së dhe partive tjera. Lustrim nuk ka pasur dhe meqë nuk ka pasur as që do të ketë.

Krijimi i një regjimi të ri dhe më të mirë nuk dha përgjigje adekuate në kuptim të reformave në sistemin e sigurisë, arsimit, gjyqësorit apo në media. Vetëm në rastin e mediave mund të konstatohet se gjatë kohës së Milosheviqit kishte numër më të madh të mediave, të cilat ishin më pak të varura ekonomikisht apo politikisht se sa mediat e sotshme. Disa nga penat më të mira të gazetarisë së lirë përpinqen më të madhe për të mbijetuar apo janë zhdurur. Në strukturat tjera duket sikur ka ardhur në shprehje kompromisi, mosdija apo mosgatishmëria për reforma, gjë që e ka vënë në py-

etje gjithë procesin e tranzacionit dhe i shndërron proceset në diçka që vetëm shëmbellen me tranzicionin, gjendemi në tranzicion që nuk është i tillë.

Përgjigja në pyetjen se si të sillemi me viktimat e regjimit është e vështirë nëse regjimi nuk përkufizohet si autokratik dhe nëse nuk ndodh distancimi i mjafthueshëm nga ai. Me fjalë tjera, aktorët e kohërave të konflikteve të armatosura të viteve të 90-ta janë kthyer në pushtet dhe po bëjnë gjithçka që të mos e përsërisin gabimin që e bëri pushteti demokratik me moskryerjen e lustracionit. Përmes veprimit politik garniturat e tanishme në pushtet do t'i bëjnë përgjegjës pushtarët e kaluar për qeverisjen gjatë kohës së tyre, dhe në bazë të kësaj pritet që t'i bartin pasoja (për shembull: përgjendjen e keqe ekonomike në Krahinën Autonome të Vojvodinës akuzohet qeverisja e demokratëve, e jo centralistët, të cilët para dy dekadave e hoqën autonominë e Vojvodinës, kjo do të çojë në presione që demokratët ta lëshojnë pushtetin në krahinë dhe në zvogëlimin e mëtejshëm të autonominë strukturelle të saj).

Emocionet e mbajtura gjallë gjatë dhe menjëherë pas viteve të 90-ta tashmë janë „gjysmë të zërthyer“. Komunikimi në mes viktimate të Serbi pothuajse nuk është i pranishëm, mbetjet e dukshme fizike të shkatërrimeve gjenden në anën jetët të kufirit, ndërsa nëse shkatërrimet janë në anën tonë kjo flet se ne ishim viktima (bombardimet e NATO-s). Manipulimi politik ia përshkruan pasojet e përgjithshme të ngjarjeve të viteve të 90-ta, që edhe sot janë të dukshme, qeverive post-Milosheviqiane se sa vetes.

Intensiteti i kërkeseve për drejtësi tranzicionale në Serbi zvogëlohet me reduktimin e llahtarës së krimeve të kryera (për shembull: numri dhe karakteri i viktimate në Srebrenicë), fshehjen e informacionit për numrin dhe karakterin e krimeve, intensifikimin e paraqitjes vetëm të vvetves si viktimi, mosvënien në pyetje të pasurisë dhe mirëqenies së profiterëve të luftës dhe gjithë të tjerëve, që kanë përfituar nga ngjarjet e luftës. Drejtësi tranzicionale në Serbi nuk i shkon për shtati fakti se nga koha e krimeve po kalon gjithnjë e më shumë kohë, që shoqëria po identifikohet me kryerësit e krimeve dhe se nuk është krijuar masa kritike e nevojshme në shoqëri që do të insistonte për zbatimin e këtij procesi.

Interesi i partive për ta shtuar elektoratin e tyre ndikon që ato të mbajnë qëndrim kompromisi në raport me politikat e udhëhequra nga regjimet e kaluara, kështu që partitë ia përshtatin qëndrimet e veta profitit të votuesve të krijuar gjatë viteve të 90-ta, duke mos marrë rolin e liderit, por duke iu përshtatur trupit votues.

Në të njëjtën kohë po zhvillohen edhe proceset tjera të drejtësisë tranzicionale. Proseset e restitucioni dhe rehabilitimit edhe më shumë po e forcojnë të djathtën ekonomike dhe politike. Këto interesa përpushten me interesat e partive që një kohë ishin opozitë ndaj regjimit të Milosheviqit, të painteresuara për restitucion dhe tranzicion (Lëvizja e Përtëritjes Serbe). Sot partitë e tillë si SPO dhe DSS fare lehtë hyjnë në marrëveshje të përbashkëta me Partinë Përparimtare të Serbisë dhe Partinë Socialiste të Serbisë, që len më pak parti në opozitë se sa gjatë kohës së Milosheviqit.

Mund të thuhet se po të mos ndodhë lëvizja e shpejtë dhe e tepruar djathtas në gjysmën e dytë të viteve të 80-ta, Serbia do t'i qasej normalisht kompensimit të viktimate të Luftës së Dytë Botërore dhe viktimate të persekutimit komunist. Këtë periudhë megjithatë e karakterizon tendencia e poli-

tikës së Milosheviqit që tranzicioni të shihet ashtu siç është në Rusi, ku nuk kishte kërkesa të tillë. Kjo ishte arsyja që partitë si SPO të mbeten në opozitë. Megjithatë, kërkuesat për restitucionin e këtyre aktorëve ekzistojnë dhe po plotësohen, përderisa obligimet ndaj viktimate të konflikteve në ish-Jugosllavi dhe viktimate të regjimit të Milosheviqit nuk janë plotësuar sa duhet.

Për drejtësi të plotë tranzicionale për viktimat e regjimit të Milosheviqit në Serbi dhe viktimat e konfliktit në ish-Jugosllavi do të kishte shpresë po të vendosej e ashtuquajtura drejtësia tranzicionale e valës së dytë. Pjetja që shtrohet është nëse dhe si do të krijohen forcat shoqërore dhe raportet brenda kontekstit të përshkruar që ajo të ndodhë, meqenëse drejtësive tranzicionale të djaththa do t'i pengojnë proceset e drejtësive tranzicionale të majta.

# Ballafaqimi me të kaluarën në Kosovë dhe KOMRA

Besart Lumi

## Hyrje

Në territorin e ish- Jugosllavisë u zhvilluan një seri e ngjarjeve tragjike gjatë viteve '90. Luftërat në Bosnie dhe Hercegovinë, Kroaci dhe Kosovë lanë pas më shumë se një qind mijë njerëz të vrarë, me mijëra janë plagosur ose janë viktima të formave të tjera të dhunës. Ndërsa edhe në vitin 2013 mbisin të pagjetur më shumë se 14 mijë njerëz. Në kuadër të këtyre viktimave, një numër i madh janë civil si fëmijë, gra, të moshuar të cilët nuk ishin të përfshirë në ushtri apo luftë. Qytete të tëra u shkatërruan e u dogjën, njerëzit u vranë ose u larguan nga shtëpitë, shumë prej të cilëve nuk u ktheyen kurrë.

Në anën tjetër, udhëheqës ushtarak e politik u sollën para drejtësisë. Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish – Jugosllavi (ICTY), i themeluar enkas për të gjykuar kryesit e krimeve të rënda të bëra gjatë luftërave këto hapësira, ka gjykuar persona nga më të rëndësishmit të cilët kanë qenë përgjegjës për krime lufte e gjenocid. ICTY ngriti mëse 161 aktakuza për persona të ndryshëm që ishin përgjegjës për krime të ndryshme të ndodhura në Bosnie, Kroaci apo Kosovë. Shumë nga ta u dënuan dhe vuajnë dënimet edhe në këtë kohë.

Pas përfundimit të luftërave, u aktivizuan edhe gjykata vendase, të cilat ngritën një numër të konsiderueshëm të rasteve të krimeve të luftës në ish Jugosllavi. Këto gjykime ishin të drejtuara kryesisht ndaj ushtarakeve të cilët ishin përgjegjës direkt për vrasje të caktuara gjatë periudhës së luftës.

Edhe pse ICTY kreu një punë jashtëzakonisht të rëndësishme në gjykimin e krerëve ushtarak e politik, në procesin

e ballafaqimit me të kaluarën, rajoni ende ka mbetur shumë prapa. Lirim i Haradinaj dhe Gotovina ishte pasqyrë e situatës në rajon: shqiptarët dhe kroatët duke festuar dhe serbët në anën tjetër duke kritikuar Tribunalin si të njëanshëm. Edhe rasti i fundit i lirimit të Perishiç e theksoi këtë, dhe kështu mbetur shumë punë për tu bërë në këtë hapësirë.

Punimi im tenton të trajtojë temën e Ballafaqimit me të Kaluarën në Kosovë dhe nevojën për t'u krijuar një Komision i cili në fokus të vetin do të kishte viktimat. Pas përfundimit të luftës dhe gjykit të disa udhëheqësve, janë pikërisht viktimat të cilët kanë mbetur anash. Edhe pse ideja për KOMRA është që të jetë rajonale, unë do ta analizojë rëndësinë e saj nga perspektiva e Kosovës.

Në mënyrë që të krijohet një pasqyrë më e qartë e nevojës për KOMRA, unë fillimisht do të paraqes se si janë zbatuar mekanizmat e Drejtësisë Tranzicionale në Kosovë, cila ka qenë veprimtaria e institucioneve shtetërore dhe shoqërisë civile në këtë drejtim dhe në fund do të paraqes zhvillimet për Nismën për KOMRA dhe argumentet se pse është e rëndësishme një Nismë e tillë. Për të parë progresin e arritur në Kosovë në fushën e Drejtësisë Tranzicionale, është e rëndësishme të shihet në pikë të shkurtra implementimi dhe zhvillimi i mekanizmave të këtij procesi në shtetin e Kosovës. E konsideroj të rëndësishëm edhe një vështrim të shkurtër të ngjarjeve që kanë karakterizuar Kosovën në periudhat para dha pas luftës.

## Drejtësia Tranzicionale në Kosovë: vështrim i shkurtër

Koncepti i drejtësisë Tranzicionale në Kosovë, filloj të përdo-

ret në mënyrë intensive që nga përfundimi i luftës. E njohur si një mënyrë që të adresohen shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut në të kaluarën, në mënyrë që kombet në konflikt të lëvizin drejt paqës së qëndrueshme dhe pajtimin eventual, Drejtësia Tranzicionale ka një rol shumë të rëndësishëm për shoqërinë në Kosovë. Është shumë e rëndësishme të lidhet me sundimin e ligjit në të kaluarën në mënyrë që të paraqitet një pasqyrë më e mirë se ku qëndron Kosova në procesin e ballafaqimit me të kaluarën dhe Drejtësinë Tranzicionale.

Pas përfundimit të luftës së Dytë Botërore, Kosova kishte mbetur në Jugosllavi. Shqiptarët e Kosovës në vazhdimësi kanë provuar ta përmirësojnë pozitën e tyre brenda Jugosllavisë (lëvizjet e vitit 1968, 1981, 1988, 1989) duke kërkuar të drejta të barabarta me të gjithë qytetarët e tjerë. Edhe pse kërkohet përmirësim i rrëthanave, ndodhi e kundërtat. Pas ndryshimeve kushtetutese të vitit 1989, Kosovës iu hoqën shumë të drejta. Qindra mijëra njerëz u larguan nga puna padrejtësish. Shkollat dhe spitalet u mbyllën. Në këtë kohë pati shkelje të mëdha të të drejtave të njeriut dhe diskriminim të shqiptarëve të Kosovës. Në këtë kohë në Kosovë funksiononte sistem paralel që përfshinte ekonominë, edukimin dhe shëndetësinë. Kjo periudhë zgjati për 10 vjet, deri në fillimin e rezistencës ushtarake nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës.

Pas luftës, Kosova u ballafaqua me vakum institucional. Aty u vendos një mision ndërkombëtarë i cili ende kryen disa funksione në Kosovë. Ky ishte misioni i Kombëve të Bashkuara (UNMIK). Menjëherë pas luftës, nuk kishte respektim të sistemit gjyqësor dhe pushtetit ekzekutiv. Mungonin mekanizmat e llogaridhënjës. UNMIK-u themeloi institucionet dhe procedoi disa krime që kishin ndodhur gjatë luftës. Megjithë rastet që u trajtuan nga Gjykatat e Kosovës, rolin më të rëndësishëm në sjelljen para drejtësisë të kriminelëve e pati Tribunal Penal Ndërkombëtarë për ish Jugosllavi.

Duke pasur parasysh shtyllat kryesore të Drejtësisë Tranzicionale, siç janë mekanizmat për gjetjen e së vërtetës, gjykimi i kryesve të krimeve, reperacionet dhe reforma institucionale, Kosova mbetet shume larg nga ajo që duhet të arrijë. Sa i përket reperacioneve, vetëm së fundi ka filluar të shënohet progres në asistencën e viktimave dhe familjarëve të tyre.. Situatë më e mirë nuk është as në aspektin e reformës institucionale. Sa i përket mekanizmave për gjetjen e

së vërtetës, nismat kryesisht vijnë nga organizatat jo – qeveritare. Mirëpo këto nisma do t'i prezantojë më detajisht në vazhdim të këtij punimi.

### Mekanizmat qeveritar për ballafaqim me të kaluarën

Qeveria e Republikës së Kosovës dhe institucione të tjera vendimmarrëse kanë bërë disa përpjekje për të përbushur detyrat e veta në fushën e Drejtësisë Tranzicionale. Kuvendi i Kosovës ka miratuar ligjin për Personat e Pagjetur<sup>137</sup>, i cili ka për qëllim të mbrojë të drejtat dhe interesat e personave të zhdukur dhe familjarëve të tyre, në veçanti të drejtën e familjarëve për të ditur fatin e personave të zhdukur, të cilët u zhdukën gjatë periudhës 1 janar 1998 deri me 31 dhjetor 2000, si pasojë e luftës në Kosovë në vitet 1998 – 1999. Ky ligj gjithashtu themelon Komisionin Qeveritar për persona të zhdukur, i cili ka për detyrë të udheheq, të mbikqyrë dhe koordinon aktivitetet me institucionet vendore. Komisioni gjithashtu ka përgjegjësi të bashkëpunojë me Institucionet dhe Organizatat ndërkombëtare në lidhje me zbardhjen e fatit të personave të zhdukur si rezultat i luftës së viteve 1998 – 1999, pavarësisht përkatësisë etnike, religjionit apo statusit ushtarak apo civil<sup>138</sup>.

Në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë është themeluar Instituti për për Hulumtimin e Krimeve të Luftës në Kosovë është institucion publik hulumtues me qëllim të mbledhjes, sistematizimit, përpunimit dhe publikimit të dhënavë për krime kundër paqes, krime të luftës, krime kundër njerëzimit dhe akteve të gjenocidit të kryera në Kosovë gjatë vitit 1998, deri në qershori të vitit 1999. Ky Institut do të veprojë në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë dhe ka filluar punën me 1 Qershor 2011<sup>139</sup>.

Së fundmi, Qeveria e Republikës së Kosovës ka marrë vendim për themelin e Grupit Punues Ndërministror për Ballafaqim me të Kaluarën dhe Pajtimin (GP BmKP). Në këtë Grup Punues do të përfshihen përfaqësues nga Qeveria, Zyra e Presidentit, Instituti për Hulumtimin e Krimeve të Luftës, Komisioni për gjuhë dhe tetë anëtarë nga shoqëria civile. Udhëheqës do të jetë Zyra e Kryeministrit.

Qëllimi i Grupit Punues është ballafaqimi me shkeljet massive të të drejtave të njeriut dhe shkeljet e rënda të së drejtës humanitare ndërkombëtare në të kaluarën në Kosovë që përfshin luftën e fundit dhe periudhën e tranzicionit,

137 Ligji Nr. 04/L-023 për persona të zhdukur, Kuvendi i Kosovës.

138 Po aty.

139 Mund të gjindet në: <http://www.md-ks.org/?page=1,180>.

duke marrë parasysh pikëpamjet e të gjitha komuniteteve në Kosovë, me qëllim të promovohet pajtimi dhe paqja e qëndrueshme, në mes tjerash, duke siguruar përgjegjëshmërinë, arritjen e drejtësisë, ofrimin e kompensimit për viktimat, lehtësimin e kërkimit të së vërtetës, promovimin e shërimit, marrjen e të gjitha masave të nevojshme për të rikthyer besimin në institucionet e shtetit dhe zbatimin e sundimit të ligjit në përputhje me të ndrejtën ndërkomëtare për të drejtat e njeriut dhe standartet e drejtësisë tranzicionale<sup>140</sup>

Në përgjithësi, nismat e Institucioneve të Kosovës kanë luajtur një rol të rendësishëm në shprehjen e gatishmërisë së organeve udhëheqëse për adresimin e çështjeve të Drejtësisë Tranzicionale. Megjithatë, funksionimi i tyre nuk ka qenë në mënyrën më të mirë dhe ende lë hapësirë për t'u përmirësuar.

### Roli i shoqërisë civile në ballafaqim me të kaluarën në Kosovë

Shoqëria civile mbetet pothuajse e vetme në nxitjen e mekanizmave për ballafaqim me të kaluarën në Kosovë. Edhe pse shumë i limituar, vlen të përmendët kontributi i organizatave jo-qeveritare të cilat për shumë vite punojnë në këtë fushë. Pa dyshim që rol kyç zë Fondi për të Drejtën Humanitare (HLC). HLC për vite të tëra ka dokumentuar të dhënat për viktimat e luftës në Kosovë dhe është duke i publikuar në Librin Kosovar të Kujtesës<sup>141</sup>.

Rëndësia e Librit Kosovar të Kujtesës përveç dokumentimit të numrit të të vrarëve, është edhe të dhënat më të detajuara lidhur me kohën kur një person është vrarë, rrethanat, vendi e informata të tjera. Kjo i jep viktimate dinjitet dhe është jashtëzakonisht e rëndësishme për të ditur të vërtetën.

Sa i përket çështjes së personave të pagjetur, një kontribut të madh ka dhënë Komiteti Ndërkombëtarë për Personat e Pagjetur (ICMP), që ndihmon në zbardhjen e fatit të personave të pagjetur përmes testeve të ADN-së, po ashtu edhe në përkrahje të shoqatave të familjeve të personave të pagjetur. Sa i përket shoqërisë civile, Nisma e të rinjve për të drejtat e njeriut në Kosovë (YIHR KS), që nga viti 2007 në vazhdimësi ka organizuar aksione të ndryshme për të adresuar përgjegjësinë te institucionet në lidhje me zbardhjen e fatit të të pagjeturve.

Disa nga aksionet e realizuara nga YIHR KS dhe aktivistët e

vet, janë "Muri" i ndërtuar vitin 2011 në qendër të Prishtinës<sup>142</sup>. Në këtë mur u shënuan emrat e të gjithë personave për të cilët nuk dihet se ku janë 13 vjet nga përfundimi i luftës. Paraqitja e këtij muri solli reagime të mëdha pasi që në të u vendosën edhe emrat e personave të komunitetit serb, të cilët nuk janë gjetur dhe nuk dihet përfatim e tyre. Madje, disa nga shoqatat e familjarëve të personave të pagjetur kanë kërcënuar organizatën YIHR KS se do të shembin murin në rast se nuk fshihen emrat. YIHR KS gjithashtu ka bërë disa aksione të tjera simbolike duke shënuar ditën kombëtare përfatim e pagjetur (27 Prill) dhe ditën ndërkombëtare (30 Gusht). Një organizatë tjeter që ka punuar në këtë drejtim është edhe Integra, e cila ka grumbulluar storje të ndryshme të viktimateve dhe i ka përbledhur ato në video.

Mungesa e organizatave të shoqërisë civile që punojnë në fushën e ballafaqimit me të kaluarën, i hap rrugën Nismës për KOMRA.

### Nisma për KOMRA

Një grup i aktivistëve dhe aktivisteve për të drejtat e njeriut, pas më shumë se një dekade punë në fushën e drejtësisë tranzicionale dhe mbrotjes së viktimateve, kishin vendosur të ngrisin idenë e themelimit të një Komisioni i cili do të vinte në qendër të vëmendjes viktimat e luftërave që shpien në shpërbërjen e Jugosllavisë. Në këtë periudhë, ishin sjell para drejtësisë dhe dhënies së përgjegjësisë disa nga ata që ishin përgjegjës për krime të rënda kundër njerëzimit, përmes Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish Jugosllavi dhe disa gjyqeve kombëtare të cilët kishin dënuar udhëheqës të rëndësishëm politik dhe ushtarak.

Motivimi erdhi nga nevoja që viktimate përfatim e qenë në fokus të ballafaqimit me të kaluarën dhe drejtësisë tranzicionale, si dhe nevoja që zëri i tyre të dëgjohej, nevojë kjo që vazhdon të mbetej madhe. Ishte viti 2008 kur grupe të shoqërisë civile nga i tërë rajoni i ish – Jugosllavisë propozuan krijimin e një Koalicionin për krijimin e një Komisioni Rajonal për vendosjen e faktave përfatim e luftës dhe shkeljet e tjera serioze të të drejtave të njeriut të kryera në territorin e ish Jugosllavisë në vitet 1991 – 2001. Qëllimi i këtij komisioni është të vërtetohen faktet përfatim e luftës dhe shkeljet e tona të njeriut që kishin ndodhur gjatë luftërave në Bosnje dhe Herzegovinë, Kroaci e Kosovë.

KOMRA, nëse do të themelohej, do të ishte Komisioni i

<sup>140</sup> Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për themelin e Grupit Punues Ndërministror përfatim e Ballafaqim me të Kaluarën dhe Pajtimin, Datë 4 qershor 2012, nr 03/77.

<sup>141</sup> [http://www.kosovomemorybook.org/?page\\_id=29&lang=zh](http://www.kosovomemorybook.org/?page_id=29&lang=zh).

parë rajonal, për arsyse se i tërë konflikti kishte ndodhur në përspektivë rajonale. Shumë viktima janë vrarë në një shtet, ndërsa kriminelët ende jetojnë në një shtet tjetër. Bashkëpunimi rajonal në mes të shteteve të ish – Jugosllavisë është shumë i nevojshëm, por një bashkëpunim i tillë nuk është lehtë i arritshëm duke i pasur parasysh luftërat dhe shkeljet masovike të, të drejtave të njeriut që kanë ndodhur në këtë rajon. Në mënyrë që të mirren të dhënët për të gjitha viktimat, të lejohet që zëri i viktimave të dëgjohet dhe të determinohen faktet objektive përrrethanat politike dhe sociale të cilat kanë dërguar në fillimin e luftës, është i nevojshëm një komision ndër-shtetëror, i pavarur dhe rajonal<sup>143</sup>.

KOMRA do të merret me përcaktimin e fakteve në lidhje me krimet e kryera por nuk do të krijojë kualifikime ligjore për krimet dhe nuk do të krijojë fajësinë penale të personave përgjegjës. Draft statuti që ju ishte dërguar përfaqësuesve të qeverive të rajonit ishte përgatitur në përpunë me legjislatcionin e vendeve të krijuara në territorin e ish Jugosllavisë.

KOMRA, ashtu siç ishte parashikuar në draft statutin, nuk e gjykon as nuk e ushtron pushtetin gjyqësor. KOMRA në të vërtetë është kompetente në vërtetimin e fakteve për krimet luftë dhe shkelje të tjera të rënda të të drejtave të njeriut, por nuk është kompetente për ta bërë në mënyrë definitive dhe gjithashtu nuk ka të drejtë të vendosë ndonjë sanksion. Kjo vërtetohet në nenin 46 të draft statutit të KOMRA-së, në të cilin në mënyrë eksplikite thuhet që të gjeturat e KOMRA nuk do të kenë efektin e vendimit të gjykatës dhe nuk do të rezikojnë të arriturat e procedurave gjyqësore.<sup>144</sup>

Per shumë vite Koalicioni për KOMRA ka organizuar Konsultime me grupe të ndryshme të shoqërive në rajon: Konsultime me të rinj, aktivistë të të drejtave të njeriut, artistë e shumë të tjerë. Përgjatë këtij procesi të Konsultimeve është diskutuar për idenë e KOMRA-së dhe në përgjithësi për ballafaqimin me të kaluarën dhe Drejtësinë Tranzicionale. Këto Konsultime janë organizuar në të gjitha shtetet e ish – Jugosllavisë. Koalicioni për KOMRA gjithashtu ka organizuar mbledhjen e mbi 500 000 nënshkrimeve të njerëzve të rajonit.<sup>145</sup>

Në procesin për themelimin e KOMRA-s, në mënyrë që të bëhet Institucionalizimi i Nismës, ka filluar formimi i Eikpit Rajonal të Avokuesve Publik, anëtarët e së cilët janë intelektual të respektuar dhe kredibil dhe aktivistë të të drejtave të njeriut. Rezultat i anagzhimeve të tyre është themelimi i grupit ndër-qeveritar rajonal të ekspertëve, të zgjedhur nga presidentë të shtatë shteteve, të cilët do të analizojnë draft statutin e KOMRA-së dhe analizojnë procedurat ligjore dhe kushtetuese për themelimin e KOMRA-së.

Sa i përket përkrahjes së themelimit të KOMRA-së në Kosovë, opinioni publik, shoqëria civile dhe shoqatat e familjarëve të viktimave të luftës në Kosovë jantë të ndarë sa i përket qëndrimeve për nevojën për të themeluar një Komision të tillë. Një numër i madh i organizatave jo – qeveritare dhe i shoqatave të familjeve të viktimave kanë përkrahur hapur idenë, duke marrur pjesë aktivisht në aktivitetet e ndryshme të organizuara ku edhe janë theksuar nevojën për të themeluar KOMRA-n. Disa shoqata të familjarëve madje kanë qenë promovues të vazhdueshëm të idesë së KOMRA-s, ndërkaq organizatat jo – qeveritare kanë kryer një rol shumë të rëndësishëm në organizimin e aktivitetave dhe promovimin e idesë. Në anën tjetër, ka edhe organizata e shoqata të cilët e kundërshtojnë krijimin e KOMRA-s duke thënë që në Kosova duhet të zgjedhë qasje nationale për tu ballafaquar me të kaluarën pa pasë nevojë për bashkëpunim me të tjerët.

Sidoqoftë, pavarësisht kërkesave, konsideroj që është shumë e rëndësishme që përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës të janë hapur pro themelimit të KOMRA-së. Edhe pse janë marrë disa hapa të vegjël në drejtim të trajtimit të çështjës për ballafaqim me të kaluarën, 13 vite pas luftës Kosova ende lë shumë për të dëshiruar në zbatimin e mekanizmave të drejtësisë tranzicionale. Faktet për luftën nuk janë vendosur ende, komunitetet që jetojnë në Kosovë ende kanë tregimë të kundërtë për krimet që kanë ndodhur, dhe një rol të rëndësishëm luan fakti që vetëm një numër relativisht i vogël i përgjegjësve janë dënuar për krimet që kanë bërë, që parandalon procesin e pajtimit, bazuar në fakte të krimave të vendosura dhe të pranuara. Mbi të gjitha, nevoja për të pasur qasje rajonale në ballafaqim me të kaluarën lehtë

142 [143 <http://www.zarekom.org/documents/Qestions-and-Answers.en.html>.](http://ks.yihr.org/ks/article/59>Youth-Initiative-for-Human-Rights-and-Nisma-Ime-My-Initiative-activists-marked-the-national-day-of-missing-persons.</a></p>
</div>
<div data-bbox=)

144 <http://www.zarekom.org/Propozim-Statuti-pr-KOMRA-s.sq.html>.

145 <http://www.zarekom.org/lajme/Grupi-zyrtar-rajonal-pr-KOMRA-n-e-ka-mbajtur-takimin-e-tij-t-par.sq.html>.

mund të shihet në raport me çështjen e personave të pagjetur, faktet të cilat nuk mund të vendosen pa bashkëunim adekuat me fqinjët.

## Konkluzioni

Nevoja për t'u ballafaquar me të kaluarën dhe krimet e luftës që kanë ndodhur në historinë e afërt të shteteve në territorin e ish Jugosllavisë është vendimtare në procesin e pajtimit në mes të popujve. Duke pasur parasysh komplecitetin e konflikteve, qasja rjonale e trajtimit të së kaluarës është qasja më e mirë për implementimin e mekanizmit për vendosjen e fakteve, edhe pse disa mekanizma të drejtësisë tranzicionale domosdomërish do të themelohen në nivel nacional. Deri më tanë kanë ekzistuar disa nisma për të themeluar Komisione nationale të së vërtetës, sikurse ajo për themelin e një Komisioni për të vërtetën dhe pajtimin në atëherë Republikën Federale të Jugosllavisë, e udhëhequr nga President, Vojislav Koshtunica, që rezultoj pa sukses.

Kosova, së bashku me shtetet e e tjera të rajoit, është e

nevojshme të ndërmarrin një qasje rjonale në procesin e themelimit të fakteve, krimeve të luftës dhe shkeljeve të tjera serioze të të drejtave të njeriut. Vetëm një qasje rjonale do të siguronte parandalimin e vetë-viktimidit, dhe pranojë viktimat e anës tjetër, vuajtjet e tyre dhe parandalimin e konflikteve të reja.

Përgjegjësia ju takon edhe shoqërisë civile, e cilat duhet të vazhdojë aktivisht dhe pandaluar të avokojë për të arritur drejtësinë për viktimave, pa marrë parasysh origjinën e tyre etnike.

KOMRA atëherë mbetet mundësia më e mirë e prezantuar deri më tanë që do të kujdeset dhe ka përfokus nevojat e viktimave, dhe të sigurojë që zëri i tyre të dëgjohet para përfaqësuesve të komuniteteve që u shkaktuan padrejtësi. Vetëm në këtë mënyrë, do të përmbushet një obligim ndaj gjeneratave të ardhshme – që e vërteta për krimet të tregohet, ngaqë kjo është e vetmja mënyrë e suksesshme për të parandaluar konflikte të ardhshme për çështjet e pazgjidhura nga e kaluara.

# Komisionet e së vërtetës në Serbi

Branka Milinčić

## Hyrje

Paqja është vlera më e madhe e një shoqërie dhe parakusht përparrimin dhe mirëqenien e tij.

Përkundër kësaj, dekadën e fundit të shekullit të njëzet e kanë shënuar më shumë se njëqind e dhjetë luftëra nga të cilat shtatë ishin në mes shteteve të ndryshme, kurse nëntë ishin konflikte brenda shtetit me ndërhyrje nga jashtë. Një nga pasojat është fakti se sot në botë ka rrëth 14.2 milionë refugiatë, që paraqet rrëth 0,21% të popullsisë së botës. Fatkeqësish, të dhëna të tilla shkatërruese nuk janë karakteristikë vetëm e shekullin të njëzetë, por zhvillime të tilla na kanë përcjellë gjatë gjithë historisë. Rrëth 15 milionë të vrarët gjatë periudhës 1914 dhe 1918 në masë të madhe kanë ndikuar që kjo luftë të quhet e Madhe, por ky rekord i zi u tejkalua gjatë Luftës së Dytë Botërore kur u shënuan më shumë se 50 milionë viktima (nga të cilat 22 milionë ishin ushtarë). Numri i madh i viktimateve nuk është veçori vetëm e luftërave botërore. Revolucioni i tetorit në Rusi ka marrë 9 milionë viktima (800 000 ushtarë), konflikti në Sudan (1983-2005) rrëth 1.9 milion, kurse në Republikën Demokratike të Kongos nga viti 1998 deri në ditët e sotme kanë humbur jetën 3.8 milionë njerëz. Me përfundimin e konfliktit fillojnë përpjekjet për rindërtimin e serishëm të shoqërisë dhe vendosjes së themelive përfundimtare afatgjate. Teoria e drejtësisë tranzicionale merret me masat që i ndërmarrin shtetet pas periudhës së konfliktit dhe shkeljeve ma-

sive të të drejtave të njeriut. Kjo teori është e përafërt me idenë përfundimtare të ballafaqimin me të kaluarën. Themele të saj janë tri të drejta nga e drejta ndërkombëtare, të cilat u takojnë viktimate: e drejta në drejtësi, e drejta përfundimtare së viktimateve: e drejta realizohen përmes këtyre mekanizmave të drejtësisë tranzicionale: gjykit e kryerësve (përgjegjësve), komisioneve përfundimtare së viktimateve, kompensimit të dëmit dhe reformave të institucioneve. Të gjithë këta mekanizma i kontribuojnë procesit të realizimit të të drejtave të viktimateve, por ky punim do të fokusohet vetëm në njërin mekanizëm përfundimtare: komisionet e së vërtetës. Sipas mendimit të Pablo de Grif komisionet e së vërtetës janë "mjitet themelor përfundimtare së vërtetës në drejtësinë tranzicionale".<sup>146</sup> Pa tregimin e së vërtetës nuk ka as sundim të ligjt, themel i shoqërisë demokratike. Pranimi i së vërtetës në shoqëritë tranzicionale është tregues i gatishmërisë së pushtetit të ri përfundimtare praktikën e zëvendësimit të elitës, do të stimulojë debatin përfundimtare së viktimateve, do të promovojë të kuptuarit më të mirë të sundimit të ligjit dhe do të kthejë besimin në institucionet, posaçërisht me heqjen e atyre përfaqësuesve të institucioneve shtetërore që kanë marrë pjesë në shkeljen e të drejtave të njeriut.

E drejta përfundimtare së vërtetës në Serbi realizohet përmes Gjykatës Ndërkombëtare Penale përfundimtare së viktimateve vendore gjyqësore dhe organizatave jo-qeveritare, të cilat grumbullojnë të dhëna në lidhje me shkeljet e të drejtave të vërtetës.

146 Pablo de Grieff, *Tregimi i së vërtetës dhe sundimi i ligjit*, faqe 183.

jtave të njeriut. Kompania Ipsos Public Affairs për nevojat e misionit të OSBE-së në Serbi dhe Qendrës për të drejtat e njeriut në Beograd, në tetor të vitit 2011 ka realizuar një hulumtim mbi qëndrimet e qytetarëve të Serbisë në lidhje me krimet e luftës, Gjykatën Ndërkombëtare Penale për ishçJugosllavinë dhe gjyqësorin vendor. Rezultatet kanë treguar se 66% e qytetarëve konsideron se themelimi i Gjykatës Ndërkombëtare nuk ishte i nevojshëm, 44% mendojnë se qëllimi kryesor i gjykimeve ishte akuzimi i serbëve për krimet, që kishin ndodhur dhe, për më tepër, 73% e qytetarëve besojnë se Gjykata ka qëndrim të ndryshëm ndaj të akuzuarve për krime luftë, varësish nga përkatësia e tyre etnike. Qytetarët gjithashtu konsiderojnë se gjykimet e Tribunalit nuk do t'i kontribuojnë zbulimit të së vërtetës në lidhje me konfliktet (49% thonë jo, 33% pjesërisht dhe 11% konsiderojnë se do t'i kontribuojë asaj).

Janë inkurajuese të dhënat mbi qëndrimet e qytetarëve në lidhje me rëndësinë e pajtimit mes shteteve pasuese të ish-RSFJ-së. Në lidhje me këtë pyetje nuk kanë qëndrim 7% e qytetarëve, 21% besojnë se pajtimi është thelbësor për raportet e ardhshme mes këtyre shteteve, sepse pa pajtim është e pamundur të ndërtohen raporte të besimit të ndërsjellë dhe tolerantë, 28% janë përgjigjur se pajtimi është i rëndësishëm, 30% mendojnë se do të ishte mirë të arrihet pajtimi dhe 14% e qytetarëve konsiderojnë se pajtimi nuk është i rëndësishëm, por duhet të harrohen ngjarjet dhe shtetet duhet të kthehen kah e ardhma.

Në pyetjen se a është e nevojshme të themelohet organ që do të merret me zbulimin e së vërtetës dhe pajtimin, 44% të respondentëve janë pajtar, 36% nuk janë pajtar dhe 22% nuk kishin përgjigje. Një pjesë e hulumtimit, i cila ka analizuar qëndrimet dhe njohjen e konfliktit të periudhës 1992-1995, ka treguar se qytetarët e Serbisë kanë pasqyrën e shtrimbëruar në lidhje me të kaluarën. Plotë 69% e qytetarëve besojnë se viktimat më të mëdha në këto konflikte ishin serbët (13% mendojnë se ishin boshnjakët, 1% kroatët, 1% shqiptarët dhe 16% nuk kanë dhënë përgjigje), përdërsa 40% e qytetarëve konsiderojnë se përgjegjës janë kroatët, 17% shqiptarët 10% boshnjakët dhe vetëm 7% serbët. Se çka ka ndodhur në Srebrenicë dhe sa njerëz kanë humbur jetën atje ka njohuri vetëm 15% e qytetarëve të pyetur. Ipsos ka

hulumtuar edhe qëndrimet e qytetarëve në lidhje me krimet e luftës, të cilat janë kryer nga palët e ndryshme në konflikt. Rezultatet tregojnë se qytetarët të cilët besojnë se këto ngjarje kanë ndodhur nuk janë gjithmonë të bindur se bëhet fjalë për krime luftë.<sup>147</sup>

Të dhënat e këtij hulumtimi tregojnë se në Serbi është i domosdoshëm një proces i pavarur i verifikimit të fakteve për periudhën 1991-2001, i cili do t'i mundëson qytetarëve të ballafaqohen me të vërtetën dhe krimet e kryera gjatë kësaj periudhe. Procesi i tillë është i domosdoshëm edhe për kthimin dhe pranimin e dinjitetit të viktimave, respektimin e të drejtave të tyre dhe vendosjen e themeleve për paqe afatgjate në rajon. Në këtë punim do të analizojmë dy shembuj, një institucion dhe një iniciativë për krijimin e procesit të përcaktimit të fakteve në hapësirat e Serbisë: Komisionin për të vërtetën dhe pajtimin i Republikës Federale të Jugosllavisë dhe Iniciativën për themelimin e Komisionit Rajonal për vërtetimin e fakteve për krimet e luftës dhe shkeljeve tjera të rënda të të drejtave të njeriut të kryera në territorin e ish-Jugosllavisë, gjatë periudhës 1991-2001 (KOMRA).

### Komisionet e së vërtetës

Komisionet e së vërtetës paraqiten me emra të ndryshëm: Komisioni kombëtar për hulumtimin e personave të zhdukur (Argjentina), Komisioni kombëtar për të vërtetën dhe pajtimin (Kili), Zyra për dokumentimin dhe hulumtimin e krimeve të komunistëve (Çekia). Teoria e drejtësisë tranzicionale nuk harton rregulla, të cilat pastaj duhet zbatuar nga komisionet, por thekson se çdo komision duhet t'i përshtatet shoqërisë, në të cilën kanë ndodhur shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut. Megjithatë, analiza e komisioneve të themeluara ka treguar se është e mundur të nxirren disa parime dhe elemente të përbashkëta, pa të cilat nuk është e mundur puna e suksesshme e komisionit.

Si kusht i parë, zakonisht theksohet se është e nevojshme „të ekzistojë minimumi i gatishmërisë politike: politikanët, ata të cilët gjatë gjithë procesit kanë rolin e tyre, të gjithë ata duhet ta kenë mundësinë të arrijnë konsensus rrëth idesë për kërkimit e së vërtetës dhe duhet të besojnë se institucionet, të cilat do të krijohen do të jenë sa duhet objektive, neutrale dhe profesionale për t'i dëgjuar të gjithë zërat e

<sup>147</sup> Janë analizuar qëndrimet e qytetarëve për 20 krime të ndodhura në këto hapësira. Si ilustrim po përmendim rastin e parë dhe të fundit.

Rasti i parë: UÇK ka kryer krime në Kosovë gjatë konfliktit të vitit 1999. Për këtë kishin dëgjuar 85% të respondentëve, 82% besojnë se kjo me të vërtetë ka ndodhur, kurse 78% konsiderojnë se bëhet fjalë për krime luftë. Shembulli tjetër ka të bëjë me dhunimin sistematik të grave myslimanë në Foçë, të cilat u kryen nga ushtarët e APJ-së në vitin 1992. Vetëm 33% kishte dëgjuar për këtë krim, 18% besojnë se kjo ka ndodhur, kurse vetëm 16% e respondentëve janë të bindur se kjo përbën krim të luftës.

tyre<sup>148</sup>. Së dyti, është e nevojshme të definohen qartë qëllimet e komisionit, natyra e shkeljeve të të drejtave të njeriut, me të cilat do të merret komisioni dhe periudha kohore e përfshirë në hulumtim. Kjo kërkesë synon të parandalojë vendosjen e qëllimeve joreale për komisionin dhe me këtë të paracaktojë mossuksesin e tij. Përfshirja e të gjitha rasteve të shkeljes së të drejtave të njeriut nuk është e mundur, prandaj komisionet merren vetëm me format e rënda të shkeljeve të tillë, ose siç ishte rasti i Argjentinës, përqendrohen vetëm në një krim të caktuar, më së shpeshti në krimin, i cili ka qenë karakteristikë për dhunën e ushtruar në të kaluarën (siç është rasti me zhdukjet e dhunshme). Gjithashtu, nuk hulumtohen ngjarjet, të cilat kanë ndodhur në të kaluarën e largët, për shkak se është e pamundur të gjinden viktimat apo dëshmitarët. Kërkesa tjetër, që duhet ta përbushin ata që e formojnë komisionin është krijimi i mekanizmave, të cilët do ta mundësojnë punën e komisionit. Vërtetimi i fakteve nënkuption analizën e të gjitha dokumenteve në dispozicion, por me prioritet janë bisedat me viktimat, dëshmitarët dhe kryesit e veprave. Krahasimi i disa burimeve është i nevojshëm për të evituar konfuzionin dhe të pavërtetën. Në dispozicion të komisionit duhet të vihen arkivat e institucioneve të ndryshme shtetërore. Në rast se kjo nuk ndodhë, vihet në pikëpyetje kushti i parë, kërkesa për konsensus mbi domosdoshmërinë e kërkimit të së vërtetës. Mungesa e qasjes në dokumente tregon se ende ekzistojnë grupe në shoqëri, të cilat nuk janë të gatshme të ballafaqohen me të vërtetën, por janë të gatshme ta rrezikojnë këtë ballafaqim. Çështja e motivimit të viktimate dhe kryesve për të dhënë deklarata pranë komisionit shpesh është temë e diskutimeve të komisioneve të së vërtetës. Viktimat vetë vendosin nëse dëshirojnë të japid deklaratë apo jo. Bazuar në shembujt e deritanishëm të komisioneve, të dyshuarit për kryerjen e krimeve nxiten të bashkëpunojnë me komisionin përmes dhënies së amnistisë apo uljes së dënimit me burgim, apo duke parashikuar refuzimin për të dhënë deklaratë si veprim të dënueshëm. Rregulli i radhës, rëndësinë e të cilit e ka treguar praktika, është përgatitja e raportit përfundimtar. Raporti përfundimtar është dokument, të cilin e përgatit

komisioni në bazë të të dhënave tek të cilat është arritur dhe zakonisht përfshin dy pjesë: pjesa e parë ku përmblidhen faktet e vërtetuara mbi shkeljet e të drejtave të njeriut dhe modelet (skemat) e shkeljeve të drejtave të njeriut<sup>149</sup> dhe pjesa e dytë që përmban rekomandime për reformën shtetërore dhe shoqërore për të parandaluar përsëritjen e këtyre shkeljeve. Kusht për punë efikase të komisionit janë edhe resurset njerëzore dhe materiale.

### Komisioni për të vërtetën dhe pajtim në Republikën Federale të Jugosllavisë (RFJ)

Gati gjashtë muaj pas rrëzimit të regjimit të Slobodan Milosheviqit, më 29 mars 2001, kryetari i Republikës Federale të Jugosllavisë, Vojislav Koshtunica shpalli një dekret për themelimin e Komisionit për të vërtetën dhe pajtim. Me dekret janë emëruar 19 anëtarë të Komisionit: Radovan Bigoviq, Mirjana Vasoviq, Tibor Varadi, Svetlana Velmar-Jankoviq, Mihajlo Vojvodiq, Gjogjrije Vukoviq, peshkopi Sava Vukoviq, Vojin Dimitrijeviq, Ljubodrag Dimiq, Slavoljub Gjukiq, Aleksandar Lojpur, Boshko Mijatoviq, Radmila Nakarada, Predrag Palavestra, Latinka Peroviq, Zoran Stankoviq, Svetozar Stojanoviq, Darko Tanaskoviq dhe Sulejman Hrnjica.<sup>150</sup> Përveç anëtarëve të komisionit, dekreti përbante edhe detyrat që duhej t'i kryente Komisioni, me vërejtjen se dokumentin programor dhe organizativ duhet ta miratojnë vetë anëtarët. Kryetari Koshtunica para Komisionit vendosi këto qëllime:

1. Organizimi i punës hulumtuese në zbulimin e fakteve për konfliktet shoqërore, ndërnacionale dhe politike, të cilat kanë çuar në luftë dhe ndriçimin e shkaqeve të këtyre ngjarjeve,
2. Informimi i publikut vendor dhe ndërkombëtar për punën dhe rezultatet e tij, dhe
3. Vendosja e bashkëpunimit me komisionet dhe organet e ngjashme në shtetet fqinje dhe jashtë vendit me qëllim të shkëmbimit të përvojave në punë.<sup>151</sup>

148 Forumi për drejtësinë tranzicionale, faqe 35, <http://www.hlc-rdc.org/wp-content/uploads/2013/02/Forum-4.pdf>

149 Komisionet nuk i publikojnë të gjitha shkeljet individuale të të drejtave të njeriut, por i theksojnë vetëm rastet karakteristike.

150 Që në prill të vitit 2001, Komisionin e lëshuan Vojin Dimitrijeviq dhe Latinka Peroviq, kurse vitin tjetër u tërhoq edhe Tibor Varadi, përderisa peshkopi Sava Vukoviq ndërrroi jetë. Në nëntor të vitit 2002, Kryetari Koshtunica, me kërkesë të anëtarëve tjerë të Komisionit, në vend të tyre emëroi anëtarët e rinj: Mira Bleham, Gjorgje Vukadinoviq, Miomir Dashiq, Mustafa Jusufspahiq, Andrija Kopiloviq, Emir Kusturica, Ljubisha Lazareviq, Slobodan Reliqi dhe Ljiljana Smajloviq.

151 Vendimin mbi themelimin e Komisionit për të vërtetën dhe pajtim mund ta gjeni në: <http://www.usip.org/files/file/resources/collections/commissions/Serbia&Motenegro-Charter.pdf>

Parimet kryesore të punës së komisionit janë miratuar në takimet e 17 prillit dhe 20 dhjetorit të vitit 2001, ndërsa dokumenti kryesor programor në janar të vitit 2002. Dokumenti kryesor programor ka definuar qëllimet në këtë mënyrë: „Komisioni ka për qëllim nxitjen dhe organizimin e hulumtimit; a) mbi shkaktarët kryesorë politik, ekonomik, shoqëror dhe moral të shpërbërjes së RSFJ-së; b) mbi luftërat dhe konfliktet tjera në hapësirat e ish Jugosllavisë, të cilat kanë shkaktuar viktima të mëdha njerëzore, spastrim etnik, ikjen e njerëzve, kampet e përqendrimit, rënien ekonomike dhe shkatërrim, demolimin e monumenteve të kulturës, paraqitjen e diktaturës, izolimin ndërkombëtar të vendit, kriminalizimin e përgjithshëm të shoqërisë; v) mbi shkeljet e të drejtave të njeriut dhe të drejtës ndërkombëtare publike, humanitare dhe të luftës.“<sup>152</sup> Me qëllim të përmbushjes së këtyre detyrave u formuan tre grupe punuese: grupei për hulumtimin e ngjarjeve dhe proceseve kyçe historike; grupei për hulumtimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut, të drejtës humanitare dhe të luftës; dhe grupei për hulumtimin e ndikimit të faktorëve të jashtëm. Në maj të vitit 2003 qëllimi i miratuar edhe një dokument i rendësishëm për punën e komisionit: Drafti preliminar i programit të Komisionit shtetëror për të vërtetën dhe besimin, por ky komision asnjëherë nuk ka filluar të punojë. Me shpalljen e Bashkësisë Shtetërore të Serbisë dhe Malit të Zi, Komisioni ka pushuar së ekzistuar. Puna e tij nuk ka përfunduar me ndonjë raport, prandaj nuk mund të vlerësojmë përfundimet tek të cilat kanë ardhur anëtarët e komisionit. Sido që të jetë, Komisioni për të vërtetën dhe besimin i kryetarit Koshtunica mund të analizohet në bazë të kushteve të përcaktuara që duhet t'i përbush një komision, e të cilat janë paraqitur më lartë.

Problemi paraqitet që në kushtin e parë. Konsensusi në mes politikanëve dhe gjithë atyre të përfshirë në konflikt nuk ka mundur të ekzistojë sepse Komisioni është formuar vetëm për territorin e RFJ-së.<sup>153</sup> Shtetet tjera, të krijuara pas shpërbërjes së Jugosllavisë, nuk kanë marrë pjesë në krijimin e Komisionit. Është e qartë se nga këndvështrimi i Kroacisë, Bosnjë dhe Hercegovinës, Maqedonisë dhe Sllovenisë ky Komision nuk mund të shihej si objektiv dhe neutral për vlerësimin e shkaktarëve të konfliktit dhe shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut në gjithë territorin e ish Jugosllavisë. Përveç kësaj, është në pikëpyetje edhe konsensusi rrëth idesë së kërkimit të vërtetës në vetë RFJ, sepse në momentin e themelimit të

Komisionit në shtet nuk ka “diskutime të hapura, kompetente dhe të gjera mbi krimet gjatë luftërave të kaluara”.<sup>154</sup> Arsyja e dytë pse ky Komision është e vështirë të konsiderohet si komision për të vërtetën janë qëllimet dhe detyrat e parashtruara. Detyrat e komisionit ishin përcaktuar në mënyrë shumë të gjerë. Nuk e kontestojmë rëndësinë e vërtetimit të shkaktarëve të konfliktit, por kjo nuk mund të jetë detyra e vetme e një Komisionit për të vërtetën. Qëllimi i tij duhej të ishte hulumtimi dhe dokumentimi i formave të rënda të shkeljeve të të drejtave të njeriut dhe së drejtës humanitare. Por, le të kthehem i në vërejtjen e parë (mospërfshirjen e të gjitha palëve të interesuara në formimin e komisionit) dhe po parashtojmë pyetjen se a do të mund të hulumtonë ky Komision plotësisht shkeljet e të drejtave të njeriut, a do të mund të arrinte tek të gjitha viktimat, kryesit, dëshmitarët dhe dokumentet e nevojshme për t'i mësuar faktet? Mekanizmat, të cilët është dashur t'i aplikojë komisioni përfshijnë: dëgjimet publike, deklaratat e dëshmitarëve, viktimate dhe kryesve, analiza e dokumenteve, kurse mënyra e sigurimit të bashkëpunimit më dëshmitarët përfshinte autorizimin e komisionit që t'i ftojë dëshmitarët në biseda dhe ofrimin e mbrojtjes ligjore dhe fizike për viktimat dhe dëshmitarët. Raporti, edhe pse i planifikuar me draftin preliminar të programit, nuk u hartua asnjëherë. Ishte parashikuar që puna e komisionit të financohet nga buxheti i shtetit, me mundësi të pranimit të donacioneve (por pas aprovimit të koordinatorit të komisionit dhe kabinetit të kryetarit). Për shqyrtimin e punës së këtij organi është e rëndësishme të përmendet se me planin buxhetor ishte paraparë që komisioni të punonte për tri vite me mundësi vazhdimi të mandatit, me qëllim të përbushjes së obligimeve të marra. Duke pasur parasysh se për më shumë se tri vite, sa ka ekzistuar ky komision, as që kishte filluar puna drejt përbushjes së qëllimeve të përcaktuara, atëherë me të drejtë mund të konkludojmë së ky kusht nuk është përbushur sepse buxheti i paraparë nuk do të mund t'i mbulonte shpenzimet e punës. Në bazë të gjithë kësaj mund të vijmë në përfundim së komisioni i vitit 2001, për shkak të mënyrës së themelimit dhe qëllimeve të tij nuk mund të radhitet në listën e komisioneve për të vërtetën. Me këtë rast duhet shtuar se edhe puna e këtij komisioni ishte jashtëzakonisht e pasuksesshme sepse për tri vite nuk është miratuar as programi në bazë të cilit do të mund arriheshin qëllimet e përcaktuara.

<sup>152</sup> Dejan Iliq, *Komisioni jugosllav për të vërtetën dhe pajtimin 2001*, <http://www.fabrikaknjiga.co.rs/rec/73/53.pdf>, faqe 64.

<sup>153</sup> Në vendimin për krijimin e komisionit, si qëllim i tretë është theksuar bashkëpunimi me komisionet dhe organet e ngjashme në rajon, por kjo vetëm për shkëmbimin e përvojave në punë dhe jo për qëllim të verifikimit të përbashkët të fakteve.

<sup>154</sup> Slobodanka Ast, *Ballafaqimi i vështirë*, Vreme, 12.04.2001, <http://www.vreme.com/cms/view.php?id=96154>

## Iniciativa pér themelimin e Komisionit rajonal pér vërtetimin e fakteve mbi krimet e luftës dhe shkeljet tjera të rënda të drejtave të njeriut në hapësirat e RSFJ së dikurshme

Mbi rëndësinë e themelimit të Komisionit pér të vërtetën në Serbi kemi folur në pjesën e parë. Tentativa e parë pér themelimin e një organi të tillë nga ana e kryetarit të RSJ, Vojislav Koshtunica, nuk ishte e suksesshme. Si përgjigje në nevojën pér vërtetimin e fakteve dhe numrit relativisht të vogël të proceseve gjyqësore pér krimet e luftës në raport me numrin e viktimateve dhe krimet e kryera në ish-Jugosllavi, në vendet e postJugosllavisë u shfaq iniciativa pér krijimin e komisionit rajonal. Ideja pér një qasje rajonale në vërtetimin e fakteve ka ardhur si rezultat i punës së organizatave joqeveritare, Qendrës hulumtuese-dokumentuese nga Bosnja dhe Hercegovina, Documenta nga Kroacia dhe Fondit pér të Drejtë Humanitare nga Serbia.<sup>155</sup> Kanë pasuar Forumet rajonale pér drejtësinë tranzicionale (2006, 2007 dhe dy forume të mbajtura gjatë vitit 2008) si dhe konsultimet rajonale dhe nationale me grupe të ndryshme të shoqërisë, me gazetarë, organizata të shoqërisë civile, të rinj, studentë, artistë, shoqata të viktimateve, shoqata të veteranëve, bashkësi fetare dhe ekspertë. Në forumin e katërt rajonal pér drejtësinë tranzicionale të mbajtur në Prishtinë, në tetor të vitit 2008, është themeluar Koalicioni pér mbështetjen e iniciativës pér themelimin e KOMRA-s. Sot këtë koalicion e përbëjnë më shumë se 1880 organizata dhe individë.<sup>156</sup>

Faza e parë e themelimit të KOMRA-s, faza konsultative, ka përfunduar me miratimin e propozimstatutit të KOMRA-s në Kuvendin e Koalicionit pér KOMRA-n, më 26 mars të vitit 2011. Me propozimstatutin është paraparë që KOMRA të jetë organizatë ndërkombëtare (neni2), me seli në Sarajevë (neni4), themeluesit e së cilës janë shtetet që dolën nga shpërbërja e Jugosllavisë: Serbia, Kroacia, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Maqedonia, Sllovenia dhe Kosova. Komisioni duhet të ketë 20 anëtarë dhe atë pesë nga B dhe H, nga tre nga Kroacia, Serbia dhe Kosova dhe nga dy anëtarë nga Mali i Zi, Maqedonia dhe Sllovenia ( neni 23). Është paraparë që anëtarët të zgjidhen nga komisionet përzgjedhëse të formuar në mënyrën e paraparë me statut dhe sipas procedurës së përcaktuar me statut, kurse në përzgjedhje

do të merrnin pjesë në mënyrë të barabartë institucionet e vendit dhe organizatat joqeveritare (nenet 26-29). Kriteret pér zgjedhjen e anëtarëve janë paraparë në mënyrë precise (neni 24) dhe prej tyre dhe personelit mbështetës kërkohet vetëdijesim i lartë, pavarësi dhe paanshmëri (neni 35). Qëllimit e KOMRA-s sipas propozimstatutit (neni 13) janë:

1. të vërtetojë faktet pér krimet e luftës dhe shkeljet tjera të rënda të të drejtave të njeriut të kryera në hapësirat e RSFJsë, në periudhën nga 1 janari i vitit 1991 deri më 31 dhjetor të vitit 2001, rrethanat politike dhe shoqërore, të cilat kanë ndikuar në kryerjen e këtyre veprave dhe pasojat, të cilat janë rrjedhojë e krimeve dhe shkeljeve të të drejtave;
2. të pranojë padrejtësitë që u janë shkaktuar viktimateve, me qëllim të ndërtimit të kulturës së solidaritetit dhe bashkëndjenjës pér viktimat;
3. të kontribuojë në realizimin e të drejtave të viktimateve;
4. të kontribuojë që elitat politike dhe shoqëritë në palët kontraktuese të pranojnë faktet pér krimet e luftës dhe shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut;
5. të kontribuojë në ndriçimin e fatit të personave të zhdukur;
6. të kontribuojë në pengimin e përsëritjes së krimeve dhe shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut.

Është planifikuar që ky komision rajonal të merret me krimet e luftës dhe shkeljet e tjera të rënda të të drejtave të njeriut të kryera në territorin e ish-Jugosllavisë gjatë periudhës 1991-2001. Për arritjen e qëllimeve, propozuesit kanë vënë në dispozicion të komisionit mekanizmat siç janë: marraja e deklaratave nga dëshmitarët, përfaqësuesit e institucioneve dhe kryesve (neni 17), grumbullimi i dokumentacionit relevant (neni 18), hulumtimi në terren (neni 19), dëgjimet publike (neni 20) dhe mbajtja e sesioneve tematike (neni 21). Janë paraparë mekanizma, të cilët duhet të sigurojnë bashkëpunimin me dëshmitarët dhe kryesit si dhe qasje në dokumentacion (nenet 11,17,48 dhe 49), është përcaktuar mënyra e financimit të komisionit (neni 42), dhe pas tri viteve të punës së tij, KOMRA duhet të përfundonte me përgatitjen e raportit përfundimtar, i cili do të përfshinte: hyrjen, faktet relevante pér krimet e luftës dhe shkeljet tjera të rënda të të drejtave të njeriut, regjistrat me humbjet

155 Këto organizata nënshkruan *Protokollin pér bashkëpunim në dokumentimin e krimeve të luftës dhe kundër mosndëshkimit* në prill të vitit 2004.

156 Për më shumë informata pér fazën konsultative të REKOM-it shih: *Procesi konsultativ mbi përcaktimin e fakteve pér krimet e luftës dhe shkeljet tjera të rënda të të drejtave të njeriut të kryera në territorin e RSFJ-së së dikurshme*, [http://www.zarekom.org/uploads/documents/2011/07/i\\_1575/f\\_1/f\\_2871\\_sr.pdf](http://www.zarekom.org/uploads/documents/2011/07/i_1575/f_1/f_2871_sr.pdf)

njerëzore, vendet e burgimit, personat e burgosur dhe ata që janë torturuar si dhe pjesën e rekomandimeve (nenet 44, 45 dhe 46).

Me miratimin e propozimstatutit ka mbaruar faza e konsultimeve dhe ka filluar faza e institucionalizimit të Iniciativës për themelimin e KOMRA-s. Është formuar ekipi rajonal i avokuesve publik, detyrë e të cilëve është promovimi i idesë së KOMRA-s para politikanëve dhe ngritja e vetëdijes dhe mbështetjes së shoqërisë për KOMRA-n. Deri më sot është arritur të fitohet mbështetja e kryetarit të Malit të Zi, Kroacisë, Maqedonisë dhe Kosovës, Përfaqësuesit të lartë për Bosnjë dhe Hercegovinë, derisa në Serbi KOMRA ende nuk ka fituar mbështetjen e élites politike.

Mungesa e përkrahjes nga politikanët në Serbi vë në pyetje rregullin e parë, të cilin duhet ta plotësojnë komisionet e së vërtetës. Për dallim nga Komisioni i Koshtunicës për të vërtetën dhe pajtimin, KOMRA gjëzon përkrahjen e gjerë të shoqërisë civile nga gjithë territorët e ish-RSFJ-së, por për të filluar me punë duhet të ketë pëlqimin e të gjitha shteteve. Pëlqimi i pushtetit është esencial sepse shtetet pasuese të RSFJ-së duhet ta nënshkruajnë marrëveshjen ndërkombëtare për themelimin KOMRA-s. Ky komision i plotëson të gjitha kërkosat tjera që kërkohen për komisionin e së vërtetës. Qëllimet janë përkufizuara në nenin 13 të propozimstatutit, kurse një shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut numërohen (neni 1): vrasjet, sklavërimi, burgimi i paligjshëm, torturimi, zhdukjet e dhunshme, deportimi dhe zhvendosja e dhunshme e banorëve, diskriminimi sistematik sikurse edhe shkeljet tjera të të drejtave të njeriut të parapara me konventat ndërkombëtar për të drejtat e njeriut, të cilat i obligojnë të gjitha shtetet palë në marrëveshje, e për të cilat Komisioni vlerëson se për nga veçoritë dhe pasojat e tyre kanë karakter "të shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut". Autorët e propozimstatutit u përcaktuan për dy mënyra për të siguruar bashkëpunimin me të gjithë personat që mund të ndihmojnë në zbulimin e faktave. Mënyra e parë është ngritja e kallëzimeve penale për të siguruar prezencën e personit, kurse tjetra nxitja duke autorizuar Komisionin që t'iu propozojë kryesve falje të pjesëshme apo zbutje të dënimit, me kusht që kjo të mos bie ndesh me ligjin dhe nësse kryesi i jep Komisionit të dhëna të rëndësishme. Për financimin e kësaj nisme do të ishin përgjegjëse shtetet e krijuara në

territorin e RSFJ-së, kurse një pjesë e mjeteve do të mund të sigurohej nga donacionet e organizatave ndërkombëtare dhe personat juridik vendor.<sup>157</sup> Komisioni do të duhej që ta publikojë Raportin përfundimtar tre muaj para përfundimit të mandatit të tij. Parashihet që raporti iku dorëzohet shefave të shteteve kontraktuese, kurse duhet të jetë edhe në dispozicion të publikut.

Të përfundojmë: në bazë të kritereve të përcaktuara më herët, mund të themi se nëse elitat politike në shtetet e krijuara pas shpërbërjes së RSFJ-së pajtohen me themelimin e KOMRA-s, në këto hapësira do të formohet komisioni i parë i së vërtetën, i cili ka parakushte të mira për punë të suksesshme.

## Përfundim

Komisionet e së vërtetës janë mekanizma të drejtësisë tranzicionale, të cilët mund të ndihmojnë në masë të madhe në ndërtimin e paqes në shoqëritë e paskonflikitit. Në fokusin e interesimit të tij gjenden viktimat, kurse qëllimi është të shqiptojë dënimë por të hulumtojë shkeljet e të drejtave të njeriut, dhe si të tilla ato nuk i zëvendësojnë gjykatat, por vetëm i plotësojnë ato. Kryetari i Argentinës, Raul Alfonsin, për komisionin e së vërtetës në vendin e tij theksoi: „Qëllimi ynë nuk ishte aq shumë të dënojmë por, të parandalojmë: të sigurojmë që ajo që ka ndodhur të mos përsëritet në të ardhme.“<sup>158</sup> Serbia akoma nuk e ka shfrytëzuar këtë mekanizëm për ballafaqim me të kaluarën. Përpjekja e parë, në të cilën janë shpenzuar më shumë se tre vite, nuk kishte themelë të mira për punë dhe pas vetes nuk la gjurmë (me përjashtim të hutimit të qytetarëve që merren me hulumtimin e çështjeve të komisioneve të së vërtetës). Shansi i dytë, KOMRA, është shumë më mirë e menduar dhe ka gjasa të shkëlqyeshme për plotësimin e qëllimeve të saj. Megjithatë, hulumtimi i opinionit publik në Serbi, në vitin 2011 tregoi se për KOMRA-n nuk kishin dëgjuar 75% e të pyeturve, ndërsa nga ata 25% që kishin dëgjuar 20% e përkrahin punën e Komisionit, 36% kryesisht e përkrahin, 22% po dhe jo, 5% kryesisht jo dhe 17% nuk e përkrahin. Për KOMRA-n në Serbi akoma nuk është deklaruar as qeveria, prandaj na mbetet vetëm të shpresojmë se Ekipi rajonal i avokuesve publikë do ta përmbrush qëllimin e vet dhe se Serbia dhe rajoni do ta kenë komisionin e parë të së vërtetës.

<sup>157</sup> Në propozimstatut nuk thuhet se sa përqind të buxhetit do ta përbijnë donacionet. Përkundër faktit se donacionet janë të mirëseardhura, për shkak të gjendjes së keqe financiare të shteteve themeluese të KOMRA-s, konsiderojmë se ky komision nuk duhet të mbështetet në donacione (posaçërisht jo për shpenzimet e planifikuar), por se të gjitha shpenzimet e saj duhet të mbulohen nga shtetet themeluese.

<sup>158</sup> Raul Alfonsin, *Kurrë më në Argentinë*, Zhurnali i Demokracisë volumi 4, Nr. 1 (1993), faqe 378.

# Rasti Haradinaj dhe të tjerët

Genc Nimoni

Më 04 mars 2005, prokurorja Carla del Ponte, në Tribunalin Penal Ndërkontrollor për ish-Jugosllavinë, paraqiti aktakuzë kundër Ramush Haradinajt, Idriz Balajt dhe Lah Brahimajt.

Tre të pandehurit u akuzuan për krime kundër njerëzimit dhe për shkelje të ligjeve dhe zakoneve të luftës duke i ngarkuar me 37 pikë të aktakuzës.<sup>159</sup>

## Historik i shkurtër për të akuzuarit

Ramush Haradinaj (1968) i njohur me nofkën "Smajl" ka lindur në Gllogjan të komunës së Deçanit. Gjatë kohës së luftës ishte komandant në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës (tutje UÇK), në zonën e Dukagjinit. Zona Operative e Dukagjinit, përfshinte një territor mjaft të madh të komunave të Pejës, Deçanit, Gjakovës, Istogut, Klinës. Haradinaj mbahti pozitën e komandantit deri në përfundimin e luftës në mes të UÇK-së dhe forcave serbe. Pas përfundimit të luftës, në qershor 1999 dhe pas transformimit dhe çmilitarizimit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe shëndrimit të saj në Trupat Mbrotëse të Kosovës, në shtator 1999, (tutje TMK), Haradinaj iu bashkua TMK-së dhe u bë komandant në Grupin e Dytë Rajonal të TMK-së, me qendër në Prizren. Në vitin 2000 Haradinaj tërhoqi nga TMK-ja për të formuar partinë e tij politike Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës

(tutje AAK). Ndërsa në kohën e ngritjes së aktakuzës, Haradinaj po mbante pozitën e kryeministrit në institucionet e përkohëshme të vetëqeverisjes, të cilat ishin krijuar nga Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (tutje UNMIK). Pasi që aktakuza u bë publike, Haradinaj dha dorëheqje nga qeveria dhe u nis për në Hagë.<sup>160</sup>

Idriz Balaj (1971) i njohur me nofkën "Togeri", ka lindur në fshatin Gllarevë të komunës së Klinës. Balaj gjatë kohës së luftës ka qenë pjesëtarë i UÇK-së. Ai mbajti pozitën të komandantit të njësitetit special, i njohur si "Shqiponjat e zeza". Kjo njësi speciale ishte krijuar për të ndërhyrë shpejt në rastet të caktuara. Pas përfundimit të luftës Balaj u inkadrua në TMK dhe mbante gradën major. Idriz Balaj është akuzuar dhe denuar në vitin 2002 nga Gjykata e Qarkut në Pejë për vepra penale të kryera pas luftës, për të cilat ai e u denua me burgim prej 13-vjetësh. Në kohën kur Tribunali Penal Ndërkontrollor për ish-Jugosllavinë kishte filluar procedurat kundër të pandehurve, Balaj ishte në vuajtje të denimit.<sup>161</sup>

Lah Brahimaj (1970), i njohur me mofkën "Magjupi", ka lindur në fshatin Jabllanicë të komunës së Gjakovës. Brahimaj është i afërm i ngshtë me Ramush Haradinajn. Gjatë kohës së luftës Brahimaj ishte pjestarë i UÇK-së dhe vepronte si zëvendëskomandant i Shtabit Operativ të Dukagjinit. Në

159 Sipas aktakuzës kundër Ramush Haradinaj, Idriz Balaj dhe Lahi Brahimaj, e ngritur nga prokurorja e Tribunalit të Hages Carla Del Ponte me 4 mars 2005.

160 [http://www.icty.org/x/cases/haradinaj/cis/sq/cis\\_haradinaj\\_et\\_al.pdf](http://www.icty.org/x/cases/haradinaj/cis/sq/cis_haradinaj_et_al.pdf).

161 Ibid.

atë kohë ai ishte ndërlidhësi në mes Zonës Operative të Dukagjinit me Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së. Në kohën kur u arrestua, Brahimaj ishte oficer me gradë në TMK.<sup>162</sup>

## Aktakuza

Të pandehurit në aktakuzën e prokurores Del Ponte akuzohen se, në mes 01 marsit 1998 dhe 30 shtatorit 1998 në Kosovë, duke vepruar apo mosvepruar kishin kryer krimë kundër njerëzimit dhe kishin shkelur ligjet dhe zakonet e luftës.<sup>163</sup>

Në këtë kohë në Kosovë ishte duke u zhvilluar lufta në mes UÇK-së dhe forcave serbe. Dhe sipas aktakuzës së prokurores Del Ponte, viktimat, për të cilat akuzohen të pandehurit, nuk kishin marrë pjesë aktive në luftë dhe ishin civilë serbë ose jo serbë dhe bashkëpunëtorë të serbëve.<sup>164</sup> Sipas aktakuzës nga viktimat kishte edhe civilë shqiptarë e romë, për të cilët UÇK-ja besonte se nuk po bashkëpunonin me të ose po i bën rezistencë asaj.<sup>165</sup> Këto viktima u vunë në shënjestë për përndjekje dhe keqtrajtim, duke përfshirë edhe kërcënime, rrëmbime, burgime, rrahje, tortura dhe vrasje. Të gjithë aktakuzët thuhet se krimet kundër njerëzimit ishin një sulm sistematik kundër popullatës civile serbe, shqiptare, rome dhe egjiptiane që u bë në komunat e Deçanit, Pejës, Gjakovës, Istogut dhe Klinës. Ndërsa veprimet dhe mosveprimet e të pandehurve konsideroheshin se ishin bërë që t'i diskriminonin viktimat në bazë fetare, politike, ose racore.<sup>166</sup>

Të pandehurit, sipas aktakuzës, individualisht, akuzohen se kanë planifikuar, nxitur, urdhëruar, kryer ose kanë ndihmuar në kryerjen e krimeve kundër njëzimit dhe shkeljen e rregullave të luftës. Pretendimet e prokurorisë, në aktakuzë, ishin se të pandehurit përbënin një ndërmarrje të përbashkët kriminale.<sup>167</sup>

Ndërmarrja e përbashkët kriminale thuhet se ka filluar në prill të 1998, ose edhe më herët dhe vazhdoi deri në shtator 1998. Anëtarët e kësaj ndërmarrjeje kriminale, në aktakuzë, thuhet se janë të akuzuarit, bashkë me ushtarë të tjera të

UÇK-së, që kanë marrë pjesë në ndërmarrje kriminale në mënyrë të ndërgjegjshme me qëllim që t'i kryejnë krimet e përshkruara në aktakuzë, në mesin e të cilëve edhe Daut Haradinaj, Frashër Haradinaj, Shkëlzen Haradinaj, Nasim Haradinaj, Zeqir Nimonaj, Luan Përvorfi, Krist Përvorfi, Nazim Brahimaj, Naser Brahimaj, Alush Agushi, Myftar Brahimaj, Pjetër Shala, Arbnor Zejneli dhe Azem Veseli.<sup>168</sup>

Aktakuza ngarkonte Ramush Haradinajn se mori pjesë në ndërmarrje të përbashkët kriminale ndër të tjera: nëpërmjet këtyre veprimeve ose mosveprimeve si komandant i Zonës Operative të Dukagjinit, ka mundësuar që UÇK-ja, nën kontrollin e tij, të vepronët në mënyrë të strukturuar dhe të disiplinuar, duke kontrolluar, planifikuar dhe organizuar operacionet e UÇK-së, duke lejuar që UÇK-ja, nën drejtimin e tij, të krijonte një sistem përrëmbime, vrasje, burgosje dhe forma të tjera të keqtrajtimit të civilëve serbë, shqiptarë dhe romë/egjiptianë, të cilët bashkëpunonin ose mendohej se bashkëpunonin me forcat serbe ose nuk e përkrahnin UÇK-në, duke përashtuar të gjithë rivalët e forcave të UÇK-së, si Forcat e Armatosura të Republikës së Kosovës (FARK) nga Zona Operative e Dukagjinit, me qëllim që t'u siguronte ushtarëve të tij mundësinë për të mbizotëruar në zonë dhe për të përndjekur civilë, duke e përdorur shtëpinë e vet si qendër operative dhe duke i shfrytëzuar burimet e tjera të familjes Haradinaj dhe përkrahjen e anëtarëve të familjes së tij për të fuqizuar më tej pushtetin e tij, duke synuar, ndër të tjera, zbatimin e ndërmarrjes së përbashkët kriminale, duke përfshirë edhe përndjekjen e civilëve, duke miratuar krijimin e njësisë "Shqiponjat e Zeza" që kreu sulme ndaj civilëve dhe i keqtrajtoi ata, duke emëruar dhe mbajtur të bashkakuzuarin Idriz Balaj, si komandant të "Shqiponjave të Zeza", duke emëruar Lahi Brahimajn dhe më pas, Nazmi Brahimajn si zëvendëskomandant të Shtabit Operativ të Dukagjinit dhe si ushtarak përgjegjës i UÇK-së në objektin e burgut të Jabllanicës, ku u mbajtën dhe u keqtrajtuan civilë, duke planifikuar, ngritur dhe vënë në funksionim objektin e burgut në Jabllanicë, i cili u përdor për mbajtjen e paligjshme dhe keqtrajtimin e civilëve; duke miratuar dhe inkurajuar sjelljen kriminale të të bashkakuzuarve të tij dhe ushtarëve të UÇK-së, kur ai ishte i pranishëm në objektin

<sup>162</sup> Ibid.

<sup>163</sup> Aktakuza e datës 4 mars 2005, Lënda Nr. IT-04-84-I. <http://www.icty.org/x/cases/haradinaj/ind/sq/050304.htm>.

<sup>164</sup> Ibid, 15.

<sup>165</sup> Ibid, 16.

<sup>166</sup> Aktakuza e datës 4 mars 2005, aktakuza e përgjithshme.

<sup>167</sup> Aktakuza e datës 4 mars 2005, pjesa e përgjegjësisë individuale, 21.

<sup>168</sup> Aktakuza e datës 4 mars 2005, pikat prej 20 – 25 të pjesës së përgjegjësisë individuale.

e burgut në Jabllanicë, duke kontrolluar burgosjen, lirimin, ose trajtimin mjekësor të civilëve të mbajtur nga UÇK-ja në Zonën Operative të Dukagjinit, përfshirë objektin e burgut të Jabllanicës, duke miratuar dhe inkurajuar sjelljen kriminale të të bashkakuzuarve të tij dhe të vartësve të tjerë në Zonën Operative të Dukagjinit, në vende si objekti i burgut në Jabllanicë, duke dhënë miratimin e tij të heshtur përekzekutimin e personave të burgosur dhe nëpërmjet vepprimeve dhe mosveprimeve të tij në veprimtaritë kriminale të përshkruara në këtë aktakuzë, ku ai nxiti, urdhëroi, kreu ose ndihmoi dhe inkurajoi krimet e përshkruara në aktakuzë.<sup>169</sup>

Aktakuza ngarkonte edhe Idriz Balajn se mori pjesë në ndërmarrjen e përbashkët kriminale, ndër të tjera, nëpërmjet këtyre vepprimeve ose mosveprimeve: duke bashkëpunuar ngushtë si komandant i "Shqiponjave të Zeza" me Ramush Haradinajn dhe duke dhënë përkrahje të drejtpërdrejtë operative për veprimtaritë kriminale të UÇK-së në Zonën Operative të Dukagjinit, duke miratuar dhe inkurajuar sjelljen kriminale të anëtarëve të "Shqiponjave të Zeza" që ishin vartësit e tij dhe atë të anëtarëve të tjerë të UÇK-së, duke miratuar dhe inkurajuar sjelljen kriminale të të bashkakuzuarve të tij dhe ushtarëve të tjerë të UÇK-së në objektin e burgut në Jabllanicë, nëpërmjet vepprimeve dhe mosveprimeve të tij në veprimtaritë kriminale të përshkruara në këtë aktakuzë, ku ai planifikoi, kreu, ose ndihmoi dhe inkurajoi krimet e përshkruara sipas aktakuzës.

Po ashtu, edhe Lahi Brahimaj akuzohej se mori pjesë në ndërmarrjen e përbashkët kriminale, ndër të tjera, nëpërmjet këtyre vepprimeve ose mosveprimeve: duke bashkëpunuar ngushtë si zëvendëskomandant i Shtabit Operativ të Dukagjinit dhe si komandant në UÇK-së me Ramush Haradinajn dhe duke dhënë përkrahje të drejtpërdrejtë operative për veprimtaritë kriminale të UÇK-së në Zonën Operative të Dukagjinit, duke drejtuar objektin e burgut në Jabllanicë, së paku prej prillit 1998 deri më 5 korrik 1998 ose rreth kësaj date, për zbatimin e ndërmarrjes së përbashkët kriminale nëpërmjet burgosjes dhe keqtrajtimit të civilëve, duke miratuar dhe inkurajuar sjelljen kriminale të të bashkakuzuarve të tij dhe të ushtarëve të tjerë të UÇK-së në objektin e burgut në Jabllanicë gjatë asaj periudhe kohore dhe më pas, së paku deri në mes të shtatorit 1998, duke miratuar dhe

inkurajuar sjelljen kriminale të ushtarëve të UÇK-së, ndërta edhe të policisë ushtarakë dhe persona të tjerë, të cilët sulmuan dhe ndryshe keqtrajtuan civilë në Zonën Operative të Dukagjinit, dhe prej vepprimeve dhe mosveprimeve të tij në veprimtaritë kriminale të përshkruara në këtë aktakuzë, ai planifikoi, nxiti, urdhëroi, kreu ose ndihmoi dhe inkurajoi krimet e përshkruara në aktakuzë.<sup>170</sup>

"Ky qëllim, i cili domosdoshmërisht mundëson kryerjen e krimeve kundër njerëzimit dhe shkeljen e ligjeve ose zakoneve të luftës, ishte konsolidimi i kontrollit të plotë të Ushtirisë Çlirimtare të Kosovës mbi Zonën Operative të Dukagjinit të UÇK-së nëpërmjet sulmeve dhe përndjekjeve të drejtuara ndaj pjesëve të caktuara të popullatës civile të atjeshme: dmth. largimi i paligjshëm i civilëve serbë prej ragonit dhe shtypja me forcë dhe dhunë e çdo bashkëpunimi të vërtetë ose në dukje me serbët nga ana e civilëve shqiptarë ose romë të atjeshëm. Qëllimi kriminal përfshinte kërcënimet, rrëmbimet, burgimet, rrahjet, torturat dhe vrasjet e civilëve, që u vunë në shënjestër, në shkelje të Neneve 3 dhe 5 të Statutit të Tribunalit" thuhet në aktakuzë".<sup>171</sup>

Gjatë muajve të mëvonshëm, brenda Zonës së Dukagjinit, UÇK-ja, nën komandën dhe kontrollin Haradinajt, vazhdoi me sulme të ngjashme ndaj civilëve serbë dhe romë-egjiptianë, dhe ndaj civilëve shqiptarë, që konsideroheshin si bashkëpunëtorë thuhej në aktakuzë, dhe të cilët nuk merrnin pjesë në luftime. Sipas aktakuzës UÇK-ja, nën udhëheqjen e Haradinajt, thuhet se ka kryer shumë rrëmbime në zonën e Dukagjinit, dhe dhjetëra civilë u zhdukën. Midis marsit dhe shtatorit 1998, në komunat e Zonës së Dukagjinit, përvëç atyre, që janë përmendur në këtë aktakuzë, së paku 25 policë serbë u vunë në shënjestër dhe më shumë se 60 civilë, serbë dhe shqiptarë, u rrëmbyen dhe më pas shumë prej tyre u vranë.<sup>172</sup>

Më 4 korrik 1998, Haradinaj akuzohej se bashkë me ushtarët e Shtabit të tij në Gllogjan, rrahën, poshtëruan dhe lënduan rëndë katër anëtarë të FARK-ut, të cilët po kalonin nëpër këtë rajon për të marrë një kontingjent armësh që do të vinte nga Shqipëria.<sup>173</sup>

Që prej gjysmës së dytë të majit 1998, në këtë shtab në Jabl-

<sup>169</sup> Ibid.

<sup>170</sup> Aktakuza e datës 4 mars 2005, pikat prej 26 – 30 – Ndërmarrja e përbashkët kriminale.

<sup>171</sup> Aktakuza e datës 4 mars 2005; <http://www.icty.org/x/cases/haradinaj/ind/sq/050304.htm>.

<sup>172</sup> Ibid, 35.

<sup>173</sup> Ibid, 36.

lanicë u ngrit një qendër e improvizuar burgimi. Nga kjo kohë deri në gusht 1998 atje u mbajtën, rrahën dhe torturuan të paktën 12 persona, të identifikuar dhe katër të paidentifikuar, të gjithë mospjesëmarrës në luftime. Për njérin dihet që ka vdekur si pasojë e rrahjeve në qendrën e burgimit të UÇK-së në Jabllanicë. Të tjerët janë ende të zhdukur.<sup>174</sup>

Gjatë fundit të gushtit dhe fillimit të shtatorit 1998, forcat serbe nisën një kundërofensivë dhe rimorën përkohësisht rajonin rrëth Gllogjanit. Një ekip serb i mjekësisë ligjore për vendin e krimtit kreu një hetim afër kanalit që shkon në Liqenin e Radoniqit, në fermën *Ekonomia* në Irzniq dhe në rrugën që shkon në fshatin Dashinoc. Më 12 shtator 1998, sipas aktakuzës, ekipi gjeti së paku 30 kufoma ose mbetje të pjesshme të kufomave në rajonin e kanalit të Liqenit të Radoniqit, gjashtë kufoma në fermën *Ekonomia* dhe të paktën tri kufoma në rrugën që çon ne Dashinoc.<sup>175</sup>

Disa prej këtyre mbetjeve të kufomave janë identifikuar si civilë serbë, romë dhe shqiptarë, të cilët u zhdukën midis prillit dhe pjesës së parë të shtatorit 1998 në rajonin e Dukagjinit.<sup>176</sup>

Dymbëdhjetë prej mbetjeve të gjetura në vendet e sipërpërmendura u identifikuani prej autoriteteve serbe me anë të procedurave tradicionale të identifikimit. Sipas aktakuzës këtu përfshihen: Vukosava Markoviq dhe Darinka Kovaç, Milovan Vllahoviq, Millosh Radunoviq, Sllobodan Radosheviq, Hajiullah Gashi, Isuf Hoxha, Ilira Frrokaj, Tush Frrokaj, Ilia Antiq, Haxhi Seferaj, Vellizar Stoshiq, Safet Kuqi, Zdravko Radunoviq dhe Pal Krasniqi. Megjithatë, ende pa u identifikuar kanë mbetur edhe 22 trupa, të cilat duket se kanë shenja dhune.<sup>177</sup>

### Fillimi i gjykimit dhe aktgjykimi I

Paraqitura e parë e të tre të akuzuarve u bë para Gjykatësit Carmel Agius, më 14 mars 2005. Secili nga të akuzuarit u deklarua se nuk ishte fajtor për akuzat.<sup>178</sup>

Në vendimin e saj, të datës 03 prill të vitit 2008, Dhoma Gjyqësore e shpall Ramush Haradinajn të pafajshëm për të gjitha pikat e Aktakuzës. Dhoma Gjyqësore urdhëroi gjithashtu që Ramush Haradinaj të lirohet menjëherë nga Njësia e Paraburgimit të Kombeve të Bashkuara. Dhoma Gjyqësore, me përfjashtim të Gjykatësit Höpfel, e shpall Idriz Balajn të pafajshëm për të gjitha pikat e Aktakuzës.<sup>179</sup>

Ndryshe nga dy të parët, Dhoma Gjyqësore e shpallë Lahi Brahimajn fajtor për akuzat e mëposhtme të Aktakuzës: Pika 28: torturë si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës; Pika 32: Torturë dhe trajtim mizor si shkelje e ligjeve apo zakoneve të luftës; por e shpall Lahi Brahimajn të pafajshëm për të gjitha pikat e tjera të Aktakuzës.

Përfundimisht Dhoma Gjyqësore e dënon Lahi Brahimajn me një dënim 6 vjet burg.<sup>180</sup>

Në arsyetimin e saj Dhoma Gjyqësore ka dëgjuar dëshmi në lidhje me një numër relativisht të pakët incidentesh. Për më tepër, dëshmitë shpeshherë nuk kanë kaq të sakta sa të mund të përcaktohet se kush ishte apo ishin përgjegjës për incidentet dhe nëse incidentet në fjalë ishin pjesë të një sulmi më të madh kundër popullsisë civile.<sup>181</sup>

Provat e paraqitura lidhur me pretendimin në Aktakuzë se UÇK-ja rrëmbeu 60 civilë dhe më vonë vranë shumë prej tyre, nuk mjaftojnë për të vërtetuar se u rrëmbyen kaq civilë, se shumë prej tyre u vranë dhe se UÇK-ja mban përgjegjësinë për veprimet e pretenduara. Provat tregojnë se shumë njerëz në zonë kishin dëgjuar për incidente të veçanta të lartpërmendura, dhe me gjasë kjo do të ketë përhapur panik në popullsinë serbe, dhe si pasojë do të ketë ndikuar në ikjen e serbëve prej shtëpive të tyre.<sup>182</sup>

143

Ndër dëshmitarët e shumtë, dëshmoi edhe dëshmitari 60. Ai dëshmoi se në fillim të vitit 1998, ishin nëntë shtëpi serbe në Dashinoc të komunës së Deçanit, por në fillim të marsit 1998, serbët e fshatit dhe të fshatrave përreth filluan të lar-

<sup>174</sup> Ibid, 37.

<sup>175</sup> Ibid, 40.

<sup>176</sup> Ibid, 39.

<sup>177</sup> Paraqitura e faktëve - Aktakuza e datës 4 mars 2005.

<sup>178</sup> Paraqitura e parë e Haradinajt dhe të tjerëve para Tribunalit: <http://www.youtube.com/watch?v=2l8m73MzmmU>.

<sup>179</sup> Aktgjykimi i Tribunalit të Hagës i datës 3 prill 2008 - Lënda Nr.: IT-04-84-T; <http://www.icty.org/x/cases/haradinaj/tjug/sq/080403.pdf>.

<sup>180</sup> Ibid.

<sup>181</sup> Aktgjykimi i Tribunalit të Hagës i datës 3 prill 2008 - Lënda Nr.: IT-04-84-T.

<sup>182</sup> Aktgjykimi i Tribunalit të Hagës i datës 3 prill 2008 - Lënda Nr.: IT-04-84-T – Përfundimi, pika 118.

goleshin nga frika prej UÇK-së. Fqinjë serbë u përpoqën të bindnin dëshmitarin se ishte më e sigurt që ai të shkonte në një vend tjetër dhe të mos rrinte aty.<sup>183</sup>

Në bazë të provave të marra Dhoma Gjyqësore përfundon se keqtrajtimi, transferimi i dhunshëm dhe vrasja e civilëve serbë dhe romë dhe të civilëve shqiptarë të Kosovës, të cilët konsideroheshin si bashkëpunëtorë të forcave serbe, ose ndryshe si mospërkrashës të UÇK-së (qoftë si grupe të veçanta apo bashkërisht), nuk ishin në një shkallë apo shpeshtësi të tillë që të mundësojnë përfundimin se u krye një sulm kundër popullsisë civile.

Gjithashtu Dhoma Gjyqësore konkludon se disa viktima u zgjodhën kryesisht për shkaqe individuale, për shembull se kishin apo mendohej se kishin lidhje me pushtetin serb apo për arsyë të tjera, dhe jo si anëtarë të popullsisë civile.<sup>184</sup>

Dëshmitë e drejtëpdrejta, që disponon Dhoma Gjyqësore, sipas saj nuk janë të mjaftueshme për të arritur në përfundimin se ka ekzistuar një ndërmarrje e përbashkët kriminale, qëllimi i së cilës ka qenë kryerja e krimeve kundër njerëzimit të paraqitura në Aktakuzë.<sup>185</sup>

### **Apelimi i aktgjykimit**

144

Por, vendimin e Dhomës Gjyqësore e apeloi Prokuroria, po ashtu edhe Brahimaj. Prokuroria u ankua ndaj këtij vendimi me 21 qershori të vitit 2008, duke kërkuar rigjykim të pjesshëm të rastit Haradinaj dhe bashkëluftëtarëve të tij, Idriz Balaj e Lahi Ibrahimaj, me arsyetimin se i kishin dy dëshmitarë kyç, të cilët sipas tyre kishin qenë të frikësuar të dëshmojnë më herët.

Seanca mbi apelimet u zhvillua më 28 tetor 2009. Në pikën e parë të apelit të saj Prokuroria argumentoi se Dhoma Gjyqësore gaboi kur refuzoi kérkesat e Prokurorisë për kohë shtesë për shfrytëzimin e të gjitha hapave të arsyeshme për të mundësuar dhënie dëshmie prej dy dëshmitarëve kyç dhe urdhëroi mbylljen e procedimit të çështjes së Prokurorisë para marrjes së këtyre masave të arsyeshme.

Prokuroria pretendoi se këta dëshmitarë zotëronin prova të drejtëpdrejta në lidhje me fajësinë e të tre të akuzuarve, dhe këta dëshmitarë refuzuan të dëshmonin për shkak të kërcënimive dhe frikës. Rrjedhimisht në parashtrimin e vet Prokuroria kërkoi rigjykim në lidhje me disa pika.<sup>186</sup>

Në pikën e dytë të apelit të saj, Prokuroria kundërshtoi dhënien e pafajësisë Idriz Balajt prej Dhomës Gjyqësore në lidhje me ndihmë dhe inkurajim në vrasjen e tri grave duke argumentuar se Dhoma Gjyqësore gaboi kur konkludoi se nuk ishin plotësuar kushtet e synimit kriminal dhe veprimit të fajshëm të ndihmës dhe inkurajimit. Dhoma e Apelit nuk ka konstatuar gabim në zbatimin e standardeve ligjore për ndihmë dhe inkurajim nga ana e Dhomës Gjyqësore dhe rrëdhimi i hedh poshtë këtë pikë. Në pikën e tretë të apelit, Prokuroria kundërshton konkluzionet e Dhomës Gjyqësore në lidhje me përdhunimin, torturimin dhe trajtimin mizor të Dëshmitares 61 dhe trajtimin mizor të Dëshmitarit 1.<sup>187</sup>

Për arsyet e shtjelluara në Aktgjykim, Dhoma e Apelit e rrëzoit argumentin e Prokurorisë dhe la në fuqi pafajësinë e Z. Balaj në lidhje me këtë pikë. Pas analizimit të provave në dispozicion të Dhomës Gjyqësore, Dhoma e Apelit gjykoi se megjithëse Dëshmitari 1 nuk ishte viktimë e një veprimi ose mosveprimi të qëllimshëm me pasojë vuajtjeje të rëndë fizike, trajtimi i shkaktoi atij vuajtje të rëndë mendore dhe përbënte sulm të rëndë kundër dinjitetit njerëzor të Dëshmitarit 1, i cili u neutralizua duke e hedhur në një pus dhe u veçua prej bashkëshortes së tij, e cila ndodhej në duar të ushtarëve të armatosur të UÇK-së. Rrjedhimisht Dhoma e Apelit miratoi pjesërisht pikën e apelit të Prokurorisë dhe rrëzoit konkluzionin e Dhomës Gjyqësore se trajtimi i Dëshmitarit 1 nuk përbënte trajtim mizor. Mirëpo megjithëse Prokuroria provoi se ushtarët e UÇK-së kryen trajtim mizor kundër Dëshmitarit 1, nuk u provua se Z. Balaj ishte përgjegjës në lidhje me trajtimin mizor për format e përgjegjësisë pretenduar prej Prokurorisë. Rrjedhimisht Dhoma e Apelit lë në fuqi pafajësinë e Z. Balaj në lidhje me këtë pikë. Më tej vijojmë me nëntëmbëdhjetë pikat e apelit të Lahi Brahimajt, ku ai kërkon që Dhoma e Apelit të shfuqizojë verdiktin e fajësisë së tij në lidhje me torturimin dhe trajtimin mizor të Dëshmitarëve 6 dhe 3 dhe kundërshton dënimin e tij.<sup>188</sup>

183 Ibid.

184 Aktgjykimi i Tribunalit të Hagës i datës 3 prill 2008 - Lënda Nr. IT-04-84-T – Përfundimi, pika 122.

185 Aktgjykimi i Tribunalit të Hagës i datës 3 prill 2008 - Lënda Nr. IT-04-84-T – Përfundimi, pika 475.

186 Lënda IT-04-84; [http://www.icty.org/x/cases/haradinaj/cis/sq/cis\\_haradinaj\\_et\\_al.pdf](http://www.icty.org/x/cases/haradinaj/cis/sq/cis_haradinaj_et_al.pdf).

187 Aktgjykimi i Dhomës së Apelit – Përbledhje e aktgjykimit, 21 korrik 2010; <http://www.icty.org/x/cases/haradinaj/acjug/sq/100721.pdf>.

188 Ibid.

Në pikat 1 dhe 2 të apelit, Z. Brahimaj pretendon se Dhoma Gjyqësore bëri gabime të shumta kur konkludoi se ai ishte përgjegjës për torturimin e Dëshmitarit 6. Për arsyet e parashtruara në Aktgjykim, Dhoma e Apelit i hedh poshtë këto pika. Në pikat 3-8 të apelit, Z. Brahimaj ngrit kundërshtime të shumta ndaj konkluzioneve të Dhomës Gjyqësore se ai ishte përgjegjës për torturimin dhe trajtimin mizor të Dëshmitarit 3. Për arsyet e parashtruara në Aktgjykim, Dhoma e Apelit i hedh poshtë këto pika. Në pikën 9 të apelit, Z. Brahimaj parashtron se Dhoma Gjyqësore gaboi në verdiktin e fajësisë së tij për torturimin e Dëshmitarit 3, me arsyetimin se Prokuroria nuk mundi të provojë domosdoshmërinë e ndonjë prej motiveve të keqtrajtimit të Dëshmitarit 3 për fajësinë e torturimit. Dhoma e Apelit ka konkluduar se Prokuroria nuk argumentoi fakte materiale për një prej motiveve që përbëjnë bazën e fajësimit për torturim dhe se Dhoma Gjyqësore kishte gabuar sepse Zotit Brahimaj nuk iu dha paralajmërimi i duhur për bazën e akuzës së fajësisë së torturimit.

Për arsyet e parashtruara në Aktgjykim, Dhoma e Apelit i hedh poshtë këto pika dhe lë në fuqi dënimin e Z. Brahimaj.<sup>189</sup>

### Kthimi i rastit në rigjykim

Në lidhje me apelimin e Prokurorisë, Apeli miraotn Pikën 1 të Apelit të Prokurorisë, me përjashtim të gjykatësit Robinson, dhe shfuqizon vendimin e Dhomës Gjyqësore:<sup>190</sup>

- (a) që shpalli të pafajshëm Ramush Haradinajn dhe Idriz Balajn për pjesëmarrje në një ndërmarrje të përbashkët kriminale për kryerjen e kimeve në shtabin dhe burgun e UÇK-së në Jabllanicë në lidhje me Pikat 24, 26, 28, 30, 32, dhe 34 të Aktakuzës;
- (b) që shpalli të pafajshëm Lahi Brahimajn për pjesëmarrje në një ndërmarrje të përbashkët kriminale për kryerjen e kimeve në shtabin dhe burgun e UÇK-së në Jabllanicë në lidhje me Pikat 24, 26, 30, dhe 34 të Aktakuzës;
- (c) që liroi prej përgjegjësisë penale individuale Ramush Haradinajn, Idriz Balajn, dhe Lahi Brahimajn në lidhje

me Pikat 24 dhe 34 të Aktakuzës; dhe

- (d) që liroi prej përgjegjësisë penale individuale Lahi Brahimajn në lidhje me Pikën 26 të Aktakuzës, dhe urdhëron që Ramush Haradinaj, Idriz Balaj, dhe Lahi Brahimaj të rigjykohen në lidhje me këto pika.

Apeli hedh poshtë Pikën 2 të Apelit të Prokurorisë, miraton pjesërisht dhe hedh poshtë pjesërisht, Pikën 3 të Apelit të Prokurorisë dhe lë në fuqi pafajësinë e Idriz Balajt në lidhje me Pikën 37.

Në lidhje me apelin e Lahi Brahimajt, hedh poshtë Pikat 1-8, miraton pjesërisht dhe hedh poshtë pjesërisht, Pikën 9 të Apelit të Lahi Brahimajt dhe lë në fuqi fajësinë e Lahi Brahimajt në lidhje me Pikën 28. Apeli gjithashtu hedh poshtë Pikat 10-19 të Apelimit të Lahi Brahimajt; lë në fuqi dënimin e Lahi Brahimajt.<sup>191</sup>

### Shpallja e Aktgjykimit II

Por, pas rigjykimit Dhoma e Apelit shpalli vendimin e saj me 29 nëntor 2012, ku të gjithë të pandehurit u shpallën të pafajshëm në të gjitha pikat e akuzës. Dhoma urdhëroi lirimin e të gjithë të pandehurve. Dy dëshmitarët e ashtuquajtur ‘kyç’ nga Prokuroria, kurrë nuk performuan! Njëri nuk erdhi kur u thirr, ndërsa tjetri e ndërrroi deklaratën kur erdhi në gjykim, duke u dënuar kështu 2 muaj burg për ndërrimin e deklaratës së dhënë fillimisht në Prokurori.<sup>192</sup>

Dhoma e Gjykatësve konkludoi se “Prokuroria nuk paraqiti dëshmi të drejtërdrejtë për të provuar se krimet e vërtetuara u kryen në kuadër të Ndërrmarrjeve të Përbashkëta Kriminale” dhe shqyrtoi provat nga Prokuroria për të provuar këtë pretendim.<sup>193</sup>

Dhoma përfundoi se Haradinaj, Balaj dhe Brahimaj nuk janë penalisht përgjegjës si pjesëtarë të Ndërrmarrjes së Përbashkët Kriminale-së, për krimet e akuzuara në Aktakuzë, për çka i liroi tërësisht nga të gjitha pikat e aktakuzës.<sup>194</sup>

<sup>189</sup> Aktgjyki i Dhomës së Apelit – Përbledhje e aktgjykimit, 21 korrik 2010; <http://www.icty.org/x/cases/haradinaj/acjug/sq/100721.pdf>.

<sup>190</sup> Lënda IT-04-84; [http://www.icty.org/x/cases/haradinaj/cis/sq/cis\\_haradinaj\\_et\\_al.pdf](http://www.icty.org/x/cases/haradinaj/cis/sq/cis_haradinaj_et_al.pdf).

<sup>191</sup> Ibid.

<sup>192</sup> Aktgjyki i Dhomës Gjyqësore, 29 nëntor 2012 - [http://www.icty.org/x/cases/haradinaj/tjug/sq/121129\\_summary.pdf](http://www.icty.org/x/cases/haradinaj/tjug/sq/121129_summary.pdf).

<sup>193</sup> Ibid.

<sup>194</sup> Aktgjyki i Dhomës Gjyqësore, 29 nëntor 2012 - [http://www.icty.org/x/cases/haradinaj/tjug/sq/121129\\_summary.pdf](http://www.icty.org/x/cases/haradinaj/tjug/sq/121129_summary.pdf).

# Drejtësia tranzicionale në Serbi – Komisionet për verifikimin e së vërtetës

Danijela Ranković

## Hyrje

Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë u zhduk në luftërat e zhvilluara në republikat dhe krahinën e saj gjatë periudhës prej vitit 1991 deri në vitin 2001. Konfliktet e armatosura të zhvilluara në Slloveni (qershori-korrik 1991), Kroaci (1991-1995), Bosnjë dhe Hercegovinë (1992-1995), Kosovë (1998-1999) dhe në Maqedoni (janar-gusht 2001) u karakterizuan me shkelje masive të të drejtave të njeriut dhe shkelje të rëndë të së drejtës ndërkombëtare humanitare, gjenocid, spastrime etnike, përndjekje dhe deportime të disa qindra mijëra civilëve dhe lanë pas vetes më shumë se 100.000 viktima. Trashëgimia e së kaluarës/luftës paraqet barrë të rëndë për shoqëritë e ndara nacionale të RSFJ-së, të cilat përpiken t'i rregullojnë shtetet e tyre sipas parimeve të demokrative funksionale. Në përpjekje për t'u ballafaquar me trashëgiminë e dhembjes, zemërimit dhe shkeljeve të të drejtave si pasojë e konfliktive, shtetet u janë kthyer një varg mekanizmave të ndryshëm tranzisionale. Drejtësia tranzicionale si mjet npërmjet të cilët shoqëritë në tranzicion luftojnë me trashëgiminë e shkeljeve masive të të drejtave të njeriut në të kaluarën, u ofron shoqërive të pasluftës mekanizmat e vetme të njohura, të provuara dhe bashkëkohore, të cilat u mundësojnë qytetarëve/qytetareve ballafaqimin me të kaluarën/luftën, drejtësi për viktimat, kuptimin dhe pranimin e përgjegjësisë për politikën e luftës si parakusht i domosdoshëm për parandalimin e përsëritjes së krimeve në të ardhmen.

Serbia ka lëshuar shumë mundësi që t'i qaset ballafaqimit me të kaluarën dhe t'i përgatis mekanizmat e drejtësiesë tranzicionale me qëllim të krijimit të parakushteve për vërtetimin e fakteve për konfliktet e armatosura në ish-Jugo-

sllavi dhe marrjen e përgjegjësive për krimet e kryera gjatë këtyre luftërave. Moskuptimi i drejtësisë tranzicionale dhe mungesa e çfarëdo qëllimi të sinqertë të elitave politike në Serbi, që të merren me proceset e ripërtëritjes shoqërore çoi në vendosjen e kulturës së mohimit të rolit të Serbisë në luftërat në ish-Jugosllavi. Ky mohim është më i shprehur në diskursin politik, mediat, sistemin juridik dhe shkollar. Shteti e Serbisë, regjimi i të cilit gjatë luftërave të viteve të 90-ta udhëhoqi politikën e luftës, nuk është në gjendje të ballafaqohet me vërtetësinë e përgjegjësisë serbe për shpërbërjen e Jugosllavisë dhe luftërat që shpërtheny më pas, e as të dënojë politikën nacionaliste dhe në këtë mënyrë të disancohet nga ajo.

Mekanizmat e drejtësisë tranzicionale, të cilat pushteti dhe shoqëria civile i shfrytëzojnë për ballafaqim me shkeljet e rëndë të të drejtave të njeriut, të kryera në të kaluarën janë: gjykimet, komisionet e së vërtetës, programet e reparaçioneve dhe reformat institucionale (ilustracioni dhe verifikimi).

Mbështetja joadekuate politike për institucionet përgjegjëse për zbatimin e masave të drejtësisë tranzicionale reflektohen edhe në punën e tyre. Për këtë flasin edhe të dhënat nga raporti „Drejtësia tranzicionale në vendet post-jugosllave: Raport për vitin 2010-2011“ për vendosjen sistematike të drejtësisë tranzicionale në vendet e dala nga Jugosllavia e Fondit për të Drejtën Humanitare, e përgatitur në bashkëpunim me Fondin për të Drejtën Humanitare në Kosovë, shoqatën „Drejtësia tranzicionale, përgjegjësia dhe kujtesa në Bosnie dhe Hercegovinë“, Qendrën për demokraci dhe drejtësi tranzicionale, Iniciativën e të rinjve për të drejtat e njeriut dhe Qendrën për hulumtim dhe politik-bërje (Cen-

ter for Research and Policy Making). Të dhënat tregojnë se gjykimet pér krimet tē luftës paraqesin formën më tē rëndësishme tē drejtësisë tranzicionale nē shtetet e dala nga Jugosllavia. Vërejtja kryesore që i bëhet punës së gjyqësorit nē lidhje me krimet e luftës është mos-efikasiteti.<sup>195</sup>

Rezultatet e gjykimeve pér krimet e luftës nē Serbi janë tē tillë që aktgjykimet nuk kanë sjellë drejtësi pér viktimat, e as publiku nē Serbi nuk është njoftuar pér krimet e kryera nga pjesëtarët e forcave ushtarake dhe policore tē Serbisë. Sankcionimi joadekuat i kryesve tē veprave penale tē krimeve tē luftës bashkë me gjykimet jotransparente pasqyrohen nē qëndrimet e qytetarëve tē Serbisë. Hulumtimet e opinionit publik<sup>196</sup> tregojnë se shumica e qytetarëve dhe qytetareve tē Serbisë (82%) nuk janë tē njoftuar apo dinë fare pak pér punën e Prokurorisë pér Krimet tē Luftës, pérderisa 85% e respondentëve nuk janë nē gjendje tē përmenden asnjë rast tē gjykimit pér krimet tē luftës para gjykatave vendore.

Krijimi i Gjykatës Ndërkombe të Penale pér ish-Jugosllavinë (GjNPJ) kishte pér qëllim që tē sillen para drejtësisë personat përgjegjës pér shkeljet e renda tē së drejtës ndërkombe të humanitare nē territorin e ish-Jugosllavisë dhe nē këtë ményrë tē kontribuojë nē parandalimin e kryerjes së krimeve nē tē ardhmen si dhe vendosjen dhe ruanjtjen e paqes. Pjesa më e madhe e aktgjykimeve tē shpallura nga Tribunali ndihmoi nē ndërprerjen e zinxhirit tē mohimeve tē krimeve dhe mosndëshkimit dhe u vërtetuan faktet dhe përgjegjësitë pér krimet e kryera nē vitet e 90-ta. Tribunali u dha viktimate satisfaksion sepse vuri para drejtësisë individët përgjegjës pér krimet e luftës nē përputhje me përgjegjësitë që kishin dhe përcaktoi përgjegjësinë penale individuale karakteristikat kryesore tē së cilës janë përgjegjësia direkte dhe komanduese.

Hulumtimi i opinionit publik nē Serbi tregon se faktet e vërtetuara nga Tribunali nuk kanë arritur tek ata nē ményrën e duhur dhe pér këtë arsy nuk kanë pasur ndikim te qytetarët dhe qytetaret e Serbisë. Shumica e qytetarëve dhe qytetareve nē Serbi (66%) konsiderojnë se krijimi i Tribunalit tē Hagës ishte i panevojshëm, pérderisa qëndrimin se qëllimi kryesor i gjykimeve pér krimet tē luftës para këtij Tribunalit është që gjithë fajin pér krimet e luftës ta hedh mbi serbët e ndajnë 40% e qytetarëve, kurse krahasuar me hulumtimet e kryera viteve tē kaluara është rritur edhe përqindja e atyre që konsiderojnë se nuk duhet bashkëpunuar me Tribunalin sepse ky bashkëpunim nuk solli asgjë tē mirë. Në raport me vitin 2009 është rritur ndjeshëm përqindja e qytetarëve që mendojnë se Serbia duhet t'i ndihmojë serbëve tē akuzuar nē Hagë, nga 34% nē 43%. Gjysma e respondentëve janë tē mendimit se Radovan Karadxhiq dhe Ratko Mladiç nuk janë përgjegjës pér krimet pér tē cilat po gjykojnë para Tribunalit, pérderisa 23% e respondentëve mendojnë se Mladiçi është përgjegjës. Rezultatet tregojnë se 49% e respondentëve janë tē mendimit se Tribunalit nuk ndihmon nē zbulimin e tē vërtetës edhe pse 90% e qytetarëve nuk ka lexuar asnjë aktgjykim tē Tribunalit, kurse 62% e respondentëve nuk i përcjellin gjykimet apo këtë e bëjnë rrallë. Nga viti nē vit po zvogëlohet numri i njerëzve që e dinë diçka pér krimet e kryera nē territorin e ish-Jugosllavisë ose mund t'i përmenden disa nga këto ngjarje, kurse 49% mendojnë se vrasjet e boshnjakëve nē Srebrenicë përbëjnë gjenocid, që është pér 12% më pak se nē vitin 2009.

Vendimet gjyqësore janë vetëm një pjesë e procesit kompleks tē masave tē drejtësisë tranzicionale, ku përfshihen edhe aktivitetet tjera joligjore. Përpjekjet serioze, siç ishte Ligji pér përgjegjësitë pér shkeljet e tē drejtave tē njeriut (Ligji pér lustracion, 2003) dhe Komisioni pér tē vërtetën

195 Gjykimet zgjasin shumë, tē démtuarit nuk janë tē informuar pér rrjedhën e procedurës; numri i procedurave tē reja është i vogël, nē legjislacionin e Republikës së Serbisë nuk ekziston institucioni i përgjegjësisë komanduese dhe pér këtë arsy nuk është e harmonizuar me standardet e vendosura nga GjNPJ sa i përket përgjegjësisë komanduese; hetimet tē cilat i përgatit dhe inicion Prokuroria pér Krimet tē Luftës e Republikës së Serbisë (PKL) zgjasin shumë dhe nē një numër tē konsiderueshëm tē rasteve nuk rezultojnë me ngritje tē aktakuzës; është praktikë e PKL që ta ndryshojë aktakuzën para marrjes së vendimit, duke e zvogëluar përgjegjësinë e tē akuzuarve nē pozita komanduese; Gjykata e Apelit nē Beograd vërteton vendimet pér burgime afatshkurta tē gjykatave tē shkallës së parë; mbrojtja e dëshmitarëve-bashkëpunëtorëve është shqetësuese sepse njësia pér mbrojtjen e dëshmitarëve funksionin si grup pér presion, i cili ka pér detyrë t'i parandalojë pjesëtarët e ushtrisë dhe policisë tē dëshmojnë pér krimet tē luftës; qëndrimi indiferent i Qeverisë së Serbisë shihet edhe nē mjetet financiare tē dedikuara pér punën e Këshillit dhe Prokurorisë pér krimet luftë. Burimi: „Drejtësia tranzicionale pér vendet post-jugosllave: Raport pér vitin 2010-2011“ pér vendosjen sistematike tē drejtësisë tranzicionale nē vendet post-jugosllave, Fondi pér tē Drejtës Humanitare, 2012.

196 Hulumtimi „Qëndrimet ndaj çështjeve tē krimeve tē luftës, GjNPJ dhe gjyqësorit nacional“, Qendra beogradase pér tē drejta tē njeriut dhe Misioni i OSBE-së nē Serbi, 2011.

dhe pajtim, dështuan keq. Në mungesë të përpjekjeve të gjera për vërtetimin e fakteve dhe emërtimin e përgjegjësve, hapat e ndërmarrë deri më tanë mbisin shumë larg nga procesi i vërtetë i ballafaqimit me të kaluarën.<sup>197</sup>

### Komisionet e së vërtetës

Komisionet e së vërtetës janë organe zyrtare jashtëgjyqësore, të përkohshme, të krijuara me qëllim të hulumtimit të shkeljeve të të drejtave të njeriut apo shkeljeve të së drejtës humanitare ndërkomëtare, që kanë për detyrë të hulumtojnë, raportojnë apo propozojnë reforma dhe t'i pranojnë zyrtarisht krimet e kryera në të kaluarën, të cilat janë heshtur apo mohuar. Detyra e tyre themelore është të ofrojnë përshkrim të besueshëm të shkeljeve të të drejtave të kryera në të kaluarën dhe të sigurojnë njohjen e vuajtjeve të viktimateve, dëshmitë e të cilëve janë burimi më i rëndësishëm për hulumtim. Komisionet e së vërtetës paraqesin platformë publike për viktimat e shkeljeve të të drejtave të njeriut, në mënyrë që ato të tregojnë për vuajtjet që i kanë përfjetuar, të cilat në periudhën e kaluar janë mohuar apo relativizuar. Pikërisht dëshmitë publike të viktimateve<sup>198</sup> ishin masë e domosdoshme përmes së cilës shprehet respekti për dinjitetin e viktimateve, nxitet solidariteti qytetar përmes të kuptuarit të vuajtjeve universale njerëzore dhe debat i gjerë për vuajtjet e njerëzve, të cilat më parë ishin përjashtuar nga diskursi publik. Mes qëllimeve tjera të komisioneve të së vërtetës vend të rëndësishëm zënë edhe pranimi publik i krimit nga përfaqësuesit e shtetit dhe gjestet përcjellëse të kërkim-faljes. Komisioni i së vërtetës mund t'i ketë disa apo të gjitha (pesë) qëllimet kryesore (megjithëse në disa prej tyre theksi mund të vihet më shumë): të zbulojë, ndriçojë dhe pranojë zyrtarisht shkeljet e të drejtave në të kaluarën; t'i përgjigjet nevojave të posaçme të viktimateve; t'i kontribuojë drejtësisë dhe përcaktimit të përgjegjësisë; të paraqesë në vija të trasha përgjegjësinë institucionale dhe të rekomandojë reforma; të inkurajojë pajtimin dhe të zbusë polemikat rrithë të kaluarës.<sup>199</sup>

### Të ndriçojë dhe të pranojë të vërtetën

Verifikimi zyrtar i fakteve për shkeljet e të drejtave të njeriut

në të kaluarën nënkuption prezantimin e materialeve mirë të dokumentuara për ngjarjet shpesh të kontestuara, sqarinë e ngjarjeve problematike dhe përshkrimin e detajuar të skemave të dhunës. Qëllimi kryesor i ndriçimit të ngjarjeve të dhunshme është që shoqëria ta ndërpresë heshtjen për periudhën e kontestuar dhe të dhunshme historike dhe momhimin e saj.

Në mënyrë që të ofrojë përshkrime të besueshme të shkeljeve të të drejtave të njeriut në të kaluarën, komisionet organizojnë dëgjime publike të përfjetimeve të viktimateve. Për dëgjimet publike përdoret edhe shprehja "tregimi i së vërtetës" nëpërmjet të cilët theksohet se çdo përfjetim që ka të bëjë me shkeljen e të drejtave të njeriut është e vërtetë e padiskutueshëm. Dëgjimi, shënim i dëshmitës së viktimateve të shkeljeve të të drejtave të njeriut, siç tregojnë përvojat e komisioneve tjera të së vërtetës, mund të paraqesin satisfaksion për viktimat. Edhe pse përpjekjet për verifikimin e së vërtetës shkaktojnë tronditje të mëdha në shoqëri, posaçërisht atje ku ajo fshihet apo ekzistojnë disa të vërteta zyrtare, komisioni i bazon gjetjet e veta në radhë të parë në dëshminë e drejtëpërdrejt të viktimateve.

Për disa viktima dhe të mbijetuar, komisioni i së vërtetës nuk paraqet ndonjë të vërtetë të re por e pranon zyrtarisht të vërtetën që ata e dinë. Përmes procedurës së grumbullimit të dëshmive dhe publikimit të raporteve zyrtare, komisioni vërteton zyrtarisht faktet e heshtura për një kohë të gjatë.<sup>200</sup>

Përvojat e Komisionit jug-afrikan tregojnë se dëgjimet publike kanë ndikuar që publiku t'i kuptojë më mirë vuajtjet e viktimateve, ndërsa për disa viktima këto procese mund të shërbejnë si katarzë apo kenë veprim shërues<sup>201</sup>. Mundësia që vuajtjet e viktimateve të pranohen publikisht dhe atyre t'i u kthehet dinjiteti njerëzor edhe përmes masave tjera të drejtësisë tranzicionale është kontribut i vlefshëm i komisionit të së vërtetës për të drejtën humanitare.

Kërkesa për të vërtetën si përgjigje ndaj keqpërdorimeve të përhapura të të drejtave të njeriut në të kaluarën, pjesërisht vjen si pasojë e qasjes së kufizuar gjyqësore në drejtësinë

197 Konferenca „Ballafaqimi me të kaluarën në Serbi: Çka më tutje?“ në organizim të Fondit "Biljana Kovacević-Vučo", Fondit "Heinrich Böll" dhe Qendrës për dekontaminim kulturor, 19-20 janar 2012.

198 „Për dëshmitë publike para Komisionit afrikano-jugor të së vërtetës dhe pajtimit, flitet si për një përvojë pas së cilës askush, asnjëherë më nuk ka mundur të mohojë krimet e ndodhura në të kaluarën e këtij kombi.“ (Bogdan Ivanisheviq, studim komparativ i efekteve të komisionit të së vërtetës, Qendra Ndërkomëtare për Drejtësi Tranzicionale, 2009. str. 2)

199 Priscilla Hayner, „Pse komisionet e së vërtetës“, në: *Të vërtetat e pathëna*, Samizdat B92, Beograd 2003.

200 Priscilla Hayner, ibid.

201 Priscilla Hayner, ibid.

tranzicionale. Procesi gjyqësor normalisht se përqendrohet në veprat e posaçme të individëve të posaçëm dhe synon që të largojë theksin nga e përgjithshmja. Propozimi për themelimin e Komisionit për të vërtetën përkundër ekzistimit të Tribunalit mund të krijojë përshtypjen se vetë Tribunali nuk merret me vërtetimin e të vërtetës. Faktet, të cilat i konfirmon gjykata kanë autoritet dhe luajnë rol të rëndësishëm historik, por për shkak të vetë natyrës së gjykimit, të vërtetat në bazë të këtyre fakteve janë të lidhura ngushtë me rastet e krimeve individuale për të cilat akuzohen persona të caktuar. Për dallim nga kjo, karakteristikë e përbashkët e mandatave të komisioneve të ndryshme të së vërtetës është kërkesa që të analizohet dhe raportohet jo vetëm për shkeljet e të drejtave të kryera nga persona të caktuar, por edhe për kontekstin e gjerë në të cilën ndodhin ato, duke shqyrtaur në veçanti elementet strukturore të qeverisë, forcat e sigurisë dhe institucionet tjera të qeverisë, të cilat kanë mundësuar që shkeljet e tillë të të drejtave të njeriut të ndodhin. Komisioni për verifikimin e të vërtetës ka potencial që të ndriçoje sektorë të tërë të shoqërisë, të cilët në asnjë rast tjetër nuk do të gjendeshin në fokus të ndjekjes penale. Pjesë e hulumtimit të tyre mund të jetë analiza e rolit të mediave, gjykatave, intelektualëve apo institucioneve fetare. Komisioni, në bazë të vlerësimit të tij, mund të propozojë hapa konkretë që kanë të bëjnë me ristrukturimin e shoqërisë, trajtimin e shkeljes së të drejtave të njeriut në të kaluarën dhe parandalimin e përsëritjes së tyre.

Tregimet e së vërtetës para komisioneve kanë për qëllim t'i kontribuojnë drejtësisë dhe përgjegjësisë, kështu që komisionet me punën e tyre i kontribuojnë luftës kundër mosndëshkimit, e cila në pjesën më të madhe bie në domenin e gjyqësorit. Përpos vërtetimit gjyqësor të përgjegjësisë penale të individëve për vepra të caktuara që kanë të bëjnë me shkeljen e të drejtave të njeriut, grupin më të madh me interes për punën e komisionit e përbëjnë qytetarët, që nuk e dinë apo refuzojnë ta kuptojnë dhe pranojnë të vërtetën për shkeljet e të drejtave të njeriut në të kaluarën. Komisionet shpeshherë në kuadër të mandatit të tyre kanë për detyrë t'i interpretojnë faktet e verifikuara për krimet dhe shkeljet e të drejtave të njeriut dhe të sqarojnë pse kanë ndodhur krimet dhe cilat rrethana politike dhe shoqërore kanë ndikuar në kryerjen e këtyre veprave. Është e nevojshme që shoqëritë në tranzicion, të cilave u dedikohet ra-

porti, të dinë jo vetëm faktet për shkeljen e të drejtave, por edhe të kuptojnë se cilat rrethana politiko-shoqërore kanë ndikuar në natyrën tepër të shëmtuar të konfliktit. Është e nevojshme që qytetarët ta gjejnë rrugën për ta pranuar dhe kuptuar shkakun e vuajtjeve dhe për të shmangur gabimet e njëjtë në të ardhmen. „Të kuptuarit, natyrisht, nuk do të thotë mohimin e mizorisë, krijimin e precedentit nga e pashembullta apo sqarimin e dukurive përmes gjithë atyre analogjive dhe përgjithësimeve aq sa më nuk ndihet ndikimi i realitetit. [...] Të kuptuarit është shqyrtimi dhe mbajtja e vetëdijshme e barrës, të cilën na e kanë ngarkuar ngjarjet, pa mohime dhe pa përulje, sikur gjithë ajo që ngjau në të vërtetë nuk mund të ndodhë ndryshe. Shkurtimisht, të kuptosh do të thotë të jesh gati të përballesh me realitetin dhe ta kundërshtosh atë pa hezitim, çfarëdo qoftë ai“.<sup>202</sup>

Qëllimi i interpretimit të fakteve dhe rrethanave, në të cilat ka ardhur deri te kryerja e krimeve dhe shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut në të kaluarën, duhet të fokusohet në procesin e autorefleksionit të qytetarëve. Nëse një shoqëri dëshiron apo duhet të zhvillohet si shoqëri moderne qytetare, e bazuar në respektimin e të drejtave të njeriut, atëherë të gjithë ata që dëshirojnë të jenë qytetarë të saj duhet të ballafaqohen me të vërtetën për atë që ka ndodhur „në emër të tyre“, duke pranuar se ajo, në asnjë mënyrë, nuk nënkupton pajtimin e tyre të heshtur me ngjarjet e tillë. „Bashkëpunimi me regjimin buron nga vetë statusi qytetar, i cili u takon individëve, kurse pjekuria politike qytetare mund ta arrihet dhe pranohet vetëm nëse pranohet përgjegjësia qytetare.“<sup>203</sup>

Si ndikon pranimi i përgjegjësisë për krimet e kryera në të kaluarën në kthimin e besimit mes bashkëkombësve dhe në zvogëlimin e frikës se krimet mund të përsëriten? Sa dhe çfarë është roli i tregimit të së vërtetës në këtë proces?

Pablo de Greiff<sup>204</sup> mbron tezën se tregimi i të vërtetës para komisioneve krijon mundësinë që besimi të rikthehet apo të fitohet përsëri. Besimi i viktimateve është shkatërruar nga përvojat e dhunshme dhe keqpërdorimet, prandaj një pjesë e viktimateve kanë frikë se e kaluara mund të përsëritet. Frika e tyre është specifike dhe mund të lidhet me faktin që identitetet politike të (disa) qytetarëve janë formuar në vlerat që kanë mundësuar shkeljen e të drejtave të njeriut në të kaluarën. Si mund të ruhet besimi në situatën kur dikush

202 Hana Arent, *Burimet e totalitarizmit*, Feministička 94, 1998, str. xviii-xix

203 Dasha Duhacek, *Barra e kohës tonë*, Qarku i Beogradit, Qendra për studime të grave dhe hulumtime gjinore, Beograd, 2010.

204 Pablo de Greiff, “Tregimi i së vërtetës dhe sundimi i ligjit,” në *Tregimi i të vërtetave: Tregimi i të vërtetës dhe ndërtimi i paqes në shoqatat e pas-konfliktit*, Notre Dame: University Of Notre Dame Press, 2006.

dyshon që të tjerët akoma janë të prirë që, qoftë për shkak të intolerancës së hapur apo thjesht për shkak të dobësisë, t'i përsërisin krimet? Pablo de Greiff pohon se tregimi i të vërtetës, kujtesa dhe pranimi publik i të vërtetës për shkeljet e të drejtave të njeriut në të kaluarën mund të konsiderohen filesa e përpjekjeve për plotësimin e kërkësës për vendosjen e besimit shoqërор. Përpjekja e institucionalizuar për ballafaqim me të kaluarën mund të shikohet nga ana e atyre që ishin viktimi e dhunës si përpjekje pozitive për t'u ndarë nga e kaluara, për t'u kupltuar skemat afatgjate të socializimit dhe pér të filluar një projekt të ri politik. Grupin e dytë i njerëzve që mund të përfitojë nga tregimi i të vërtetës e përbëjnë ata që nuk janë aq shumë të shqetësuar për përsëritjen e së kaluarës, por që thonë se pavarësish asaj se çka mund të ndodhë në të ardhmen ne kemi detyrime (përgjegjësi) ndaj atyre që kanë pësuar. Ata duan që vuajtjet e tyre të njihen, jo për shkak të frikës nga përsëritja e dhunës, por për shkak të asaj që kanë duruar. Besimi shoqërор mes të gjitha palëve mund të rritet nëse vullneti për t'i kujtuar të gjithë ata që pësuan dhe tregimi i të vërtetës janë shprehje e gatishmërisë që gjërat në të ardhmen të bëhen ndryshe.

### Komisioni për të vërtetën dhe pajtim i Republikës Federale të Jugosllavisë

Komisioni për të Vërtetën dhe Pajtim eshtë themeluar me dekretin e Kryetarit të Republikës së atëherëshme Federale të Jugosllavisë, Vojislav Koshtunica, më 29 mars 2001,<sup>205</sup> me iniciativën e Goran Svilanoviqit, ministër i atëherëshëm i Punëve të Jashtme të RFJ-së dhe Kryetar i Lidhjes Qytetare të Serbisë.<sup>206</sup> Vendimi për themelimin e Komisionit erdhi parpritur, duke anashkaluar proceset, iniciativat dhe dialogun e pëershkuar dhe të rekonduar.<sup>207</sup> Në vendim thuhet se Komisioni krijohet për shkak të nevojës për të shqyrtaur shkaqet dhe ecuritë e konfliktive që çuan në luftëra dhe shpërbërjen e RSFJ-së, për t'i zbuluar faktet për ngjarjet

në gjithë hapësirën ku janë zhvilluar konflikte dhe shkelje të shumta të ligjeve të luftës, të drejtës humanitare dhe të drejtave të njeriut, që kanë rezultuar me një numër të madh të viktimate njerëzore dhe shkatërrime të mëdha materiale, në mënyrë që të ndodhë ballafaqimi me të vërtetën dhe pajtimi i përgjithshëm „mes shteteve dhe kombeve në rajon“. Anëtarët/anëtarët e Komisionit, gjithsej 19, i emërtoi kryetari në kuadër të Vendimit për themelimin e tij. Nuk ka të dhëna publike për mënyrën dhe kriteret sipas të cilave janë zgjedhur anëtarët e Komisionit.

Në bazë të deklaratave të anëtarëve të caktuar të Komisionit kuptojmë se pas aktit të themelimit të tij nuk ekzistonte plani i qartë për atë se çka do të duhej të bënte ky organ.<sup>208</sup> Dy javë pas mbledhjes së parë ceremoniale të Komisionit, më 15 prill 2001, Latinka Peroviq dhe Vojin Dimitrijeviq e lëshuan Komisionin. Ata i dërguan letra të hapura Kryetarit të RFJ-së, respektivisht themeluesit të Komisioni, përmes të cilave arsyetuan vendimin e tyre. Latinka Peroviq konsideronte se Komisioni nuk formohet në mënyrën në të cilën ai eshtë formuar, se krijimi i komisionit eshtë proces që bazoitet në kërkësën për ballafaqim me të kaluarën dhe kjo kërkësë duhet të burojë nga shoqëria. Ajo gjithashtu theksoi se nuk mund ta shohë veten në një komision shtetëror që eshtë shumë i institucionalizuar, mandati i të cilit nuk eshtë i qartë dhe pritet e saja ishin se Komisioni do të ishte plotësisht i pavarur në raport me themeluesin e tij, sikurse edhe në punën e tij. Më tej ajo vlerëson se strategjia e punës të këtij organi nuk eshtë e qartë dhe se aty nuk sheh ndonjë „plan serioz që të hyhet në rishikimin e përgjegjësisë së Serbisë për krimet e kryera në emër të shoqërisë serbe“.<sup>209</sup>

Vojin Dimitrijeviq theksoi, mes tjerash, se komisioni që gjykon për ngjarjet e zhvilluara jashtë territorit të Serbisë, kurse përbëhet ekskluzivisht nga qytetarë të Serbisë (në të cilën madje nuk ka asnje anëtar nga Mali i Zi), nuk ka si të

205 Vendimi mbi themelimin e Komisionit për të vërtetën dhe pajtim, Gazeta Zyrtare RFJ, nr. 15/2001.

206 Goran Svilanoviq e shihte Komisionin si mënyrë për ballafaqimin e publikut serb me dëshmitë për krimet e kryera në territorin e ish-Jugosllavisë në emër të interesit nacional serb dhe interesave tjerë, por njëkohësisht Komisionin e konsideronte si prelud në gjykimin e përgjegjësive për krimë, e asesi si alternativë për verifikimin e përgjegjësisë penale (Qendra Beogradase për të drejtat e njeriut, “Raporti për gjendjen e të drejtave të njeriut në Jugosllavi për vitin 2001”, Beograd 2002, faqe 284; Ana Krajnc dhe Emilija Marinkov, “komisioni për të vërtetën dhe pajtim”, në Përbledhje të punimeve të studentëve, Beograd 2005.)

207 “E drejta për të ditur të vërtetën” në Ndalimi i mosndëshkimit në Serbi: Mundësitàt dhe pengesat, Impunity Watch, 2008. faqe 26.

208 Bisedë me Latinka Peroviq, Slavoljub Gjukiq, Ljubodrag Dimiq, Vojinom Dimitrijeviq dhe Gordana Ristiq, anëtarët dhe anëtarët e dikurshëm të Komisionit për të vërtetën dhe pajtim të Republikës Federale të Jugosllavisë, të bëra gjatë viteve 2007 dhe 2008 nga Caslav Laziq, hulumtues IË/YIHR. Pjesë të bisedës janë publikuar në hulumtimin Ndalimi i mosndëshkimit në Serbi: Mundësitàt dhe pengesat, Impunity Watch, 2008.

209 Letrat janë publikuar në gazetën ditore “Danas”, letra e Vojin Dimitrijeviqit më 18.04.2001. kurse Latinka Peroviqit më 21.04.2001; Biseda me Latinka Peroviqin, *ibid*; Biseda me Vojin Dimitrijeviqin, *ibid*.

duket i paanshëm e as nuk ka mundësi të ketë qasje të duhur në dokumente, dëshmitarë dhe burime tjera që nuk gjenden në territorin e Serbisë. Në bazë të analizës së vendimit për themelim dhe materialet për mbledhjen e parë të Komisionit, Vojin Dimitrijeviq e shikon si problematike të dhënë se shteti ka bartur shumë pak kompetenca te Komisioni, të cilat nuk i është dhënë as mundësia të lëshojë fletëthirrje obliguese për dëshmitarët. Ai konsideronte se fusha e aktivitetit të komisionit të ardhshëm nuk ishte definuar në mënyrën e duhur, meqenëse ajo është tërësisht historike dhe e fokusuar në ngjarjet që i paraprindë shpërbërjes së RSFJ-së dhe se nuk është mirë që komisionit i është dhënë mandat të merret me shkaqet e konflikteve në vend të zbardhjes së krimeve:

*Shkaqet e luftës janë të ndryshme por rregullat e së drejtës humanitare janë një dhe gjatë konfliktit të armatosur ato duhet të respektohen si nga sulmuesi ashtu edhe i sulmuari. Siç mund të supozoni, mua si avokat më së shumti më intereson brutaliteti në luftërat tona. Megjithatë, pritet që Komisioni të verifikojë të vërteta të mëdha: unë kam frikë nga të Vërtetat e Mëdha sepse në emër të tyre dhe përfhapjen e tyre është zbatuar dhunë e egër. Pajtimi mund të fillojë me mjete shumë më modeste. Aty nuk janë me rëndësi qëllimet e as kush kishte të drejtë e kush jo, as se cila sjellje mund të shpjegohet dhe kuptohet (dhe ndoshta të arsyetohet), por vetëm kush ishte njerëzor e kush jonjerëzor.*

Vojin Dimitrijeviq është gjithashtu i mendimit se Komisionit i është caktuar një fushë shumë e gjerë dhe joreale e punës dhe sipas vlerësimit të tij kjo ngjallë frikë se me punën e këtij Komisioni vetëm do të komprometohej ideja e së vërtetës dhe pajtimit në hapësirat e ish- Jugosllavisë.

Mbledhja e parë e Komisionit është mbajtur më 17 prill 2001, në të cilën ai miratoi Rregullat themelore të punës (dokumentin programor).<sup>210</sup> Sipas këtij dokumenti, qëllimet themelore të punës së Komisionit janë:

1.1. Qëllimi i punës së Komisionit për të vërtetën dhe pajtim (në tekstin e mëtutjeshëm: Komisioni) është që

përmes ballafaqimit me të vërtetën për konfliktet në RSFJ dhe shtetet pasuese të saj, ku janë kryer krimet kundër paqes, shkelje të shumta të të drejtave të njeriut, të drejtës humanitare dhe të luftës, t'i kontribuojnë pajtimit të përgjithshëm brenda RF të Jugosllavisë dhe me popujt fqinj.

1.2. Komisioni ka për qëllim të analizojë në mënyrë të gjithashme dhe t'i përcaktojë shkaqet dhe ecuritë e konflikteve që çuan në shpërbërjen e RSFJ-së dhe në shpërthimin e luftës, duke provokuar vuajtje të tmerrshme njerëzore dhe shkatërrime të pronave në dekadën e kaluar.

Parashihej që Komisioni në kuadër të punës së tij të kryejë hulumtim „mbi krizën shtetërore dhe konfliktet shoqërore që çuan në luftë“ dhe „të përpinqet të ndriçoje zinxhirin e zhvillimeve shkak-pasojë, të cilët janë objekt i hulumtimit“. Komisioni kishte për detyrë që për punën e tij ta njoftojë publikun, si dhe të përpinqet të vendosë bashkëpunim me komisionet, organet dhe organizatat e ngjashme qeveritare dhe joqeveritare, vendore dhe të huaja. Garantohet pavarësia e Komisionit dhe anëtarëve të tij, por njëkohësisht Themeluesit (Kryetarit të Republikës) i jepen kompetenca që, me pajtimin e dy të tretave të anëtarëve të Komisionit, „të emërojë dhe shkarkojë anëtarët e Komisionit“.<sup>211</sup>

Me dokumentin e programit të Komisionit, të miratuar më 15 janar 2002, është përcaktuar se Komisioni duhet të synojë „verifikimin e së vërtetës, largimin e shumë shkaqeve dhe formave të keqkuptimeve dhe vendosjen e besimit mes grupeve shoqërorë dhe popujve“, kurse qëllimi i tij është të inkurajojë dhe organizojë hulumtimin e:

1. shkaqeve kryesore të rrënimit politik, ekonomik, shoqëror dhe moral të RSFJ-së;
2. luftërave dhe konflikteve tjera në territorin e ish-Jugosllavisë, të cilat shkaktuan viktima të shumta njerëzore, spastrime etnike, refugjatë, kampe të përqendrimit, shkatërrime ekonomike, rrënime të monumenteve të

210 Vendimi për themelim, *ibid.*

211 Rregullat e punës së Komisionit të marra nga teksti “Komisioni jugosllav për të vërtetën dhe pajtim 2001-?”, Dejan Iliq, “Fjala” nr.

73.19/2005, meqenëse dokumentet themelore për punën e Komisionit ishin në dispozicion për vizitorët në faqen e internetit të Komisionit për të vërtetën dhe pajtim në vjeshtë/dimër 2003/2004. Kur është shkruar teksti. Nga prilli i vitit 2004 faqja në internet e Komisionit për të vërtetën dhe pajtim nuk ekziston më.

- kulturës, paraqitjen e diktaturës, izolimin ndërkom-bëtar të vendit, kriminalizimin e përgjithshëm të shoqërisë;
3. shkeljen e të drejtave të njeriut dhe të drejtës ndërkom-bëtare publike dhe humanitare dhe ligjeve dhe zakoneve të luftës.<sup>212</sup>

Sipas mandatit, Komisionit i është dhënë një periudhë trevjeçare në kuadër të së cilës do të duhej ta përfundojë punën me të cilën është ngarkuar. Në fund të mandatit të tij, Komisioni do të duhej të publikojë raportin me rezultatet e hulumtimit të përgjithshëm dhe t'i komunikojë rekoman-dimet e veta pushtetit.

Më 28 maj 2002, komisioni organizoi një tryezë të rrumbullakët me emrin „Komisioni për të vërtetën dhe pajtim një vit më pas: ku kemi arritur dhe kah po shkojmë“. Kjo tryezë e rrumbullakët, sipas fjalëve te anëtarëve të Komisionit, ishte mundësi që planet e Komisionit t'i prezantohen publikut të gjërë. Pjesëmarrësit e tryezës së rrumbullakët kritikuan ash-për anëtarët e tij për mosaktivitet dhe mosgatishmérinë që të merren me krimet dhe shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut të kryera nga forcat serbe.

Në maj të viti 2003, anëtarët dhe anëtarët e Komisionit ia paraqiten publikut Draftin Preliminar të Programit të Komisionit shtetëror për të vërtetën dhe pajtim. Në pikën: 1. Ballafaqimi me të kaluarën“ thuhet se duhet përgatitur një raport për shkeljet masive të të drejtave të njeriut gjatë konfliktive në hapësirat e ish-Jugosllavisë të viteve të 90-ta. Dubrovniku, Vukovari, Sarajeva, Bjelina, Srebrenica, Shtrpce u përmendën si vende të krimit, të cilat ishin kryer nga pala serbe, pas së cilës pasonin krimet e forcave kroate të kryera në Kroaci dhe Bosnjë e Hercegovinë. Theksi në shkeljet e të drejtave të njeriut, mizoritë dhe shkatërrimet e viteve të 90-ta këtë herë ishte shumë më i fuqishëm se në dokumentet paraprake, ndoshta edhe si përgjigje në kritikat e dërguara në adresë të komisionit në tryezën e rrumbullakët. Në pikën 2 theksohet: „Raporti: Shkaqet e luftërave në Ballkanin Perëndimor të viteve të 90-ta“. Periuðha kohore që duhej të përfshinte analiza historike ishte impresive: përpos tjerash Komisioni „do të përpiqet të sqarojë prapavinë historike të krijimit të Mbretërisë së Serbëve, Kroatëve dhe

Sllovenëve (lëvizja jugosllave apo e sllavëve të jugut në Serbi, Kroaci dhe Slloveni në shekullin e 19-të); e më pas, „Lufta e Parë Botërore, ngritja e ideologjive totalitare në Evropë (komunizmi në Rusi, fashizmi në Itali dhe Gjermani, fitorja e fashizmit dhe lufta civile në Spanjë) dhe ndikimi i tyre në Mbretërinë Jugosllavisë (Diktatura e 6 janarit 1929, vrasja e Mbretit Aleksandër, vrasja e deputetit kroat Radiq në parlament, lëvizjet totalitare në vend, Lufta e Dytë Botërore“, deri në „sistemin e vetëqeverisjes socialiste“).<sup>213</sup>

Pas formimit të bashkësisë shtetërore të Serbisë dhe Malit të Zi (BSMZ)<sup>214</sup>, Këshilli i Ministrave të BSMZ asnjëherë nuk solli vendim zyrtar për fatin e Komisionit, shteti e la atë që të shuhet vetë, pa status të zgjidhur dhe pa mjete përvazhdimin e punës. Komisioni ndërprenë punën pa dorëzuar asnjë dokument zyrtar apo vendim për një gjë të tillë.

### **Shkaqet e mossuksesit të Komisionit për të vërtetën dhe pajtim të Republikës Federale të Jugosllavisë**

Gjatë krahasimit të qëllimeve dhe detyrave të këtij Komisioni, ashtu siç janë përcaktuar në dokumentet e tyre kryesore, me pesë qëllimet themelore të komisioneve për verifikimin e të vërtetës, ashtu siç jepen nga Priscilla Hayner, arrijmë në konkluzionet e mëposhtme:

*Qëllimi 1: Të zbulohen, ndriçohen dhe zyrtarisht të pranohen shkeljet e të drejtave në të kaluarën*<sup>215</sup>

Brengë kryesore e Komisionit jugosllav për të vërtetën, sipas mandatit të përcaktuar nga themeluesi, ishte zbulimi dhe ndriçimi i arsyeve dhe shkaqeve të konfliktit. Nga aspekti i të drejtave të njeriut, posaçërisht nga këndvështrimi i së drejtës tranzicionale dhe punës së Komisionit të së vërtetës, është e papranueshme që në plan të parë të vihen shkaqet e konfliktit duke nënverësuar faktet mbi shkeljet konkrete të të drejtave të njeriut dhe krimet e luftës, si dhe përcaktimin dhe përshkrimin e matricës së krimit dhe ngjarjes. Duke filloj me Vendimin e themelimit e deri në fund, Komisioni në dokumentet e veta, por edhe anëtarët e tij në raportet e tyre theksojnë nevojën e analizës dhe sqarimit të aspekteve të ndryshme që u paraprinë luftërave në Jugosllavi. Për këtë arsy mund të konkludohet se shkeljet serioze të të drejtave të njeriut dhe krimet e luftës së kryera gjatë konfliktive të

212 „Komisioni jugosllav për të vërtetën dhe pajtim 2001-?”, Dejan Iliq, *ibid*.

213 Dejan Iliq, „Komisioni jugosllav për të vërtetën dhe pajtim 2001-?”, *ibid*.

214 Karta e Kushtetutës së Bashkësisë Shtetërore të Serbisë dhe Malit të Zi dhe Ligji për zbatimin e Kartës Kushtetuese të Bashkësisë

Shtetërore të Serbisë dhe Malit të Zi, Gazeta Zyrtare BSMZ numri. I/2003, hyri në fuqi më 4.2.2003.

215 Priscilla Hayner, „Pse komisionet e së vërtetës“, në *Të vërtetat e pathëna*, Samizdat B92, Beograd 2003.

armatosura në ish-Jugosllavi ishin me rëndësi të dorës së dytë për Komisionin.

*Qëllimi 2: T'i përgjigjet nevojave të veçanta të viktimate<sup>216</sup>*

Viktimat e krimeve të luftës në ish-Jugosllavi nuk ishin në fokus të punës së Komisionit, çka mund të shihet edhe në bazë të dokumentacionit me të cilin është përcaktuar fushëveprimi i Komisionit. Komisioni nuk mbajti asnjë dëgjim publik të viktimate të shkeljeve të të drejtave të njeriut në të kaluarën, ndërsa anëtarët, anëtarët e Komisionit nuk kryen asnjë bisedë me viktimat. Me insistim të përfaqësuesve të organizatave të shoqërisë civile dhe organizatave për të drejtat e njeriut, gjatë vittit 2002 Komisioni paralajmëroi organizimin e dëgjimeve publike, projekti i grumbullimit të dëshmive që kanë të bëjnë me krimet më të rënda nga luftërat e kaluara, Srebrenica, Vukovari, Shtrpcia, Kosova, operacioni "Stuhia". Dëgjimet e paralajmëruara publike u shtynë për më vonë, por ato nuk u mbajtën kurrë.<sup>217</sup> Komisioni nuk kreua asnjë bisedë më viktimat e shkeljeve të të drejtave të njeriut. Në maj të vitit 2001, Alex Boraine, në emër të këshilltarit special të Komisionit, rekomandoi që Komisioni, përpos viktimate serbe, duhet të merret edhe me viktimat nga radhët e popujve tjerë në hapësirat e ish-Jugosllavisë, gjë që asnjëherë nuk ndodhi.<sup>218</sup>

*Qëllimi 3: T'i kontribuojë drejtësisë dhe përgjegjësisë<sup>219</sup>*

Ky qëllimi i Komisionit nuk ishte caktuar, kurse të vetmit që flisnin për përcaktimin e përgjegjësisë së Serbisë dhe krimet që ishin kryer në emër të shoqërisë serbe ishin Latinka Peroviq dhe Vojin Dimitrijeviq, anëtarë të Komisionit të cilët e braktisën atë pak pas themelimit, duke e përmendur edhe këtë si një nga arsyet e largimit.

*Qëllimi 4: Të paraqes në vija të trasha përgjegjësinë institucionale dhe të rekomandojë reforma<sup>220</sup>*

Meqenëse Komisioni as nuk e ka filluar e as nuk e ka përfunduar punën e tij, kështu që as nuk ka përgatitur raport, këto

qëllime nuk janë arritur.

*Qëllimi 5: Të inkurajojë pajtimin dhe të zbusë polemikat rreth së kaluarës<sup>221</sup>*

Vetë termi "pajtim" me kalimin e kohës i është nënshtuar interpretimeve dhe keqpërdorimeve të shumta, posaçërisht në rajonin e shteteve të dala nga Jugosllavia. Ky term mund të nënkuptojë reportin e drejtëpërdrejt në mes të individëve në bashkësitet lokale, reportin në mes qytetarëve të të njëjtë shtet, mirëkuptimin mes grupeve etnike, politike dhe shoqërore në nivel nacional, apo reportin në mes qytetarëve të shteteve të ndryshme, por edhe reportin e pranimit dhe pajtimit me përgjegjësitë për krimet e së kaluarës. Viktimat ndoshta nuk do ta konsiderojnë pajtimin si një nga qëllimet e këtij procesi.

Komisioni përcaktoi si një nga prioritet e punës së tij arritjen e pajtimit të përgjithshëm brenda RF të Jugosllavisë dhe mes shteteve fqinje, përmes ballafaqimit me të vërtetën për konfliktet në RSFJ dhe shtetet që u krijuan pas shpërbërjes së saj. Të kuptuarit e së vërtetës, ashtu siç e definoi Komisioni, duhet t'i kontribuojë pajtimit me popujt dhe shtetet fqinje dhe bashkësinë ndërkontinentare. Në bazë të kërkësës së përsëritur vazhdimit që „publiku i huaj“ të njoftohet për rezultatet e hulumtimit, me fjalë tjetë në „dialog me bashkësinë ndërkontinentare, organet dhe institucionet e saj (duke përfshirë edhe Tribunalin e Hagës)“, si dhe bazuar në deklaratat e disa anëtarëve të Komisionit, mund të përfundohet se qëllimi kryesor i Komisionit është të „pajtohet“ më bashkësinë ndërkontinentare. Komisioni nuk iu është drejtuar qytetarëve të Serbisë, as viktimate të bashkësive tjetra etnike – mesazhin e vet ai e ka përgatitur për publikun jashtë vendit.<sup>222</sup>

Për punën e Komisionit për të vërtetën dhe pajtim të RFJ-së janë bërë shumë kritika sepse ajo as nuk i është afuar të vërtetës e as nuk i ka kontribuar pajtimit. Avokuesit e të drejtave të njeriut shtyrjen e datës nga e cila duhet filluar hulumtimin e historisë një dekadë para fillimit të konflikteve

216 Priscilla Hayner, *ibid.*

217 Në arsyetim është thënë se Komisioni është i detyruar ta shtyjë vazhdimin e punës në organizimin e serisë së planifikuar të dëshmimive për shkak të mungesës së ndihmës së pritur financiare ("E drejta për ta ditur të vërtetën", në *Ndalimi i mosndëshkimit në Serbi: Mundësi dhe rekondime*, Impunity Watch, 2008. str. 34).

218 "E drejta për ta ditur të vërtetën", në *Ndalimi i mosndëshkimit në Serbi: Mundësi dhe rekondime*, Impunity Watch, 2008. str. 31.

219 Priscilla Hayner, *ibid.*

220 Priscilla Hayner, *ibid.*

221 Priscilla Hayner, *ibid.*

222 Dejan Iliq, "Komisioni jugosllav për të vërtetën dhe pajtim 2001-?", "Fjala" nr. 73.19/2005.

të armatosura, menjëherë e kuptuan si nevojë të Komisionit për të arsyetuar sjelljen e palës serbe pas shpërbërjes së Jugosllavisë. Duke pasur parasysh mënyrën e themelimit të Komisionit dhe kushtet e punës mund të përfundojmë se ai ishte destinuar të dështojë për shkak të narrativëve nacionale jashtë kornizave të së cilit assesi nuk ka mundur të dalë.<sup>223</sup>

Shfrytëzimi i komisionit për qëllime të forcimit dhe përhapjes së narrativit nationalist në lidhje me konfliktet rajonale ndikoi që për një kohë të komprometohet ideja e themelimit të komisionit të së vërtetës në territorin e ish-Jugosllavisë, të cilën ia doli ta korrigojë vetëm procesi konsultativ për themelimin e komisionit rajonal për verifikimin e fakteve për krimet e luftës dhe shkeljet tjera të rënda të të drejtave të njeriut të kryera në territorin e ish Jugosllavisë 1991-2001 (KOMRA).<sup>224</sup>

## Përfundimi

Të gjitha komisionet e së vërtetës kanë disa karakteristika të përbashkëta, megjithatë karakteristikat kryesore mbresin or ganet që nuk mund të themelohen sipas shablloneve të përcaktuara, sepse secili komision duhet të këtë përbërje që iu përgjigjet nevojave dhe mundësive të shoqërive të caktuara. Në procesin e gjerë të gjurmimit për të vërtetën, Komisioni duhet të ketë potencial ta konceptojë procesin që angazhon publikun e gjerë dhe i cili, me atë rast, inkurajon vendimarrësit, institucionet e caktuara, mediat dhe faktorët tjerë që ta rishikojnë rolin e tyre në dhunën e së kaluarës. Parakusht ideal për punë efikase dhe efektive të Komisionit të së vërtetës është që ai të lind nga brenda, nga nevojat e shoqërisë për ndryshim.

Është e pakuptimtë të pritet që komisioni t'u jap fund të gjitha mohimeve dhe gjenjeshtrave, e as nuk mund të pritet

që ndonjë komision të „zgjidhë“ të gjitha mospajtimet apo vlerësimet e ndryshme të historisë, posaçërisht atje ku historia është rrënjosur thellë, siç është rasti me ish-Jugosllavinë. „Gjithë çka mund të bëjë Komisioni për të vërtetën është të zvogëlojë numrin e gjenjeshtrave, të cilat, si interpretimi të pabazuara të ngjarjeve, do të mund të gjendeshin ne diskursin publik.“<sup>225</sup>

Në fund, Komisioni për verifikimin e të vërtetës nuk do të duhej të ketë si qëllim mbylljen e derës për të kaluarën, por hapjen e saj për një diskutim shumë më të gjerë dhe shqyr tim të sinqertë të gjithë asaj që ka ndodhur në të shkuarën, duke marrë parasysh të gjitha vështirësitet dhe kompleksitetin e saj.

Janë të shumta arsyet për mossuksesin e Komisionit për të vërtetën dhe pajtim të Republikës Federale të Jugosllavisë, megjithatë, një nga ato imponohet mbi të tjerat e është: mosnjohja dhe moskuptimi i konceptit të të drejtave të njeriut dhe të drejtës tranzicionale. Kur viktimat e krimeve të luftës nuk janë në qendër të vëmendjes së një komisioni, kur fshihet, nuk shihet apo refuzohet ballafaqimi me përgjegjësitet për pjesëmarrjen e shtetit të vet në konfliktet e armatosura, kur përpinqet të keqpërdoret institucioni i shtetit me qëllim të arsyetimit të rolit të vet në konfliktet e armatosura, kur nuk bëhet ndarja nga e kaluara me politikën që ka çuar në konflikte të armatosura, bëhet e qartë se nuk janë plotësuar kërkesat themelore të nevojshme për funksionimin e suksesshëm të cilidto mekanizëm të drejtësisë tranzicionale. Pikërisht kjo “mungesë” e ish Komisionit për të vërtetën të RFJ-së flet më së miri për potencialin e KOMRA-s, iniciativës për themelimin e komisionit të së vërtetës, e cila ka lindur si nevojë e brendshme e qytetarëve të shteteve post-jugosllave që të ballafaqohen me të kaluarën.

223 Narrativët bazë shpesh vendosin kritere sipas të cilëve përcaktohet nëse dikush brenda një grupei, bashkësie apo shoqërie të caktuar është apo nuk është anëtar i plotë: shumë thjesht, ato shërbejnë si mjete për mohimin politik apo juridik të statusit të qytetarit të barabartë të individive apo grupeve brenda shoqërisë. Përmes tyre vendosen raportet e forcës që krijojnë dallime.

224 Komisioni rajonal për verifikimin e fakteve për krimet e luftës dhe shkeljet tjera të rënda të të drejtave të njeriut në territorin e RSFJ-së së dikurshme.

225 Michael Ignatieff, „Artikuj rreth besimit“, në *Index mbi Censurën 5/96*, shtator 1996. <http://archive.niza.nl/uk/publications/001/ignatieff.htm>.

# Roli i mediave në procesin e përcaktimit të përgjegjësisë

Aida Džanović / Norbert Šinković

*"Nuk është krim vetëm vrasja, nuk është krim vetëm ajo që përmban aktakuza e Tribunalit të Hagës apo aktakuzat e ngritura nga gjykatat kombëtare: krimi është shumë më i gjerë, ai përfshinë edhe rrëthanat, në të cilin janë krijuar kushtet që mundësojnë të kalohet nga fjalët në veprime konkrete".*

Nataša Kandić

## Hyrje

Detyra e autorit të këtij teksti është të analizojë rolin e mediave në procesin e përcaktimit të përgjegjësisë. Nga kënd-vështrimi i autorit, përcaktimi i përgjegjësisë nuk mund të paramendohet pa kërkuar përgjegjësinë e mediave për luftërat e zhvilluara gjatë viteve të 90-ta në territorin e ish-Jugosllavisë. Literatura dhe titujt e shumtë që flasin për rolin e mediave në luftërat në hapësirat e ish-Jugosllavisë as nuk e vënë në dyshim e as nuk e kontestojnë rolin që luajti radio, televizioni dhe shtypi në nxitjen e luftës dhe atë si 'pjesë e vijës së parë të frontit' (Tompson Mark, 2000). Mediat kanë përgatitur luftën, kanë nxitur urejtjen dhe nëpërmjet të propagandës e kanë mbështetur dhe përcjellë atë nëpër 'ritmin e krimtit' (Mimica Aljosha, 2001). Kjo pjesëmarrje e mediave në dezorientimin, dezintegrin, desocializimin dhe dehumanizimin e përgjithshëm i ka shtyrë autorët e tekstit që t'i shqyrtojnë temat e përmendura. Në këtë analizë autorët nisen nga pyetja për të cilën nuk ka dilemë: a janë mediat përgjegjëse? Autorët theksojnë se përgjegjësia e mediave është e padiskutueshme dhe paraqet tezën fillestare. Nëse marrim parasysh materialet faktike të mbështetura nga përvaja dhe puna e gazetarëve, hulumtuesve dhe aktivistëve tjerë të shoqërisë nga të gjitha republikat e RSFJ-së,

të cilët kanë kontribuar me një numër të konsiderueshëm të artikujve në temën e rolit të mediave në luftërat e viteve të 90-ta, na duket e kotë përpjekja për analizën (ri)interpretuese të materialit dhe strukturës ekzistuese. Materiali i grumbulluar kryesisht flet për përgjegjësinë e padiskutueshme të shtypit dhe televizionit në skenarët e paraluftës, luftës por, edhe të pasluftës gjatë viteve të 90-ta.

Prandaj, si autorë të këtij punimi, në vend të interpretimeve kemi zgjedhur të analizojmë raportin mes pushtetit dhe medias. Theks të veçantë në këtë marrëdhënie do t'i kushtohet *diskursit*, të cilin e kemi futur në shqyrtim teorik përmes filozofit francez, Michel Foucault. Do ta shqyrtojmë rolin de/resocializuar të mediave, respektivisht do të shohim se si mund të shndërrrohen mediat nga bartës të propagandës dhe vlerave antidemokratike në 'pjesëmarrës aktiv në procesin e resocializimit' përmes rolit në përcaktimin e përgjegjësive (Shaciq Nermina, 2004). Në fund, në mënyrë që puna të mos mbetet ekskluzivisht në nivel të reflektive teorike, do të flasim edhe për Iniciativën për KOMRA-n, në të cilën autorët shohin mundësi për një rol më serioz të mediave në procesin e përcaktimit të përgjegjësisë përmes prezantimit medial të faktave për krimet e luftës dhe shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut, të së vërtetës mbi të zhdukurit, refugiatëve, të dëbuarve dhe të zhvendosurve. Elaborimin për KOMRA-n do ta përcjellë analiza krahasuese e iniciativës rajonale në shembullin Serbi – Bosnjë dhe Hercegovinë.

## Dispozitivi, diskursi, paradigma – vështrim teorik

*"... [Në propagandën] mediale rëndësinë më të madhe, ndoshta edhe vendimtare, e ka autoriteti i mediave si zë i pushtetit dhe i forcës, që ndoshta është edhe më i fuqishëm se*

*forca e argumenteve propaganduese dhe metodave dinake të sofistikuarat tē bindjes dhe shpërlarjes së trurit. Për [...] pjesën më të madhe tē publikut, televizioni dhe gazetaria janë në tērësi personifikim i autoritetit<sup>226</sup>, janë fjalët e etnologut Ivan Çoloviq në një nga tekstet ku flet pér rolin e mediave në shkatërrimin e Jugosllavisë, rolin e propagandës në këtë proces dhe mënyrën në tē cilin publiku i ka perceptuar informacionet e plasura përmes mediave. Janë pikërisht fjalët e këtij autori që shërbejnë si pikënisje e elaborimit sipas tē cilit diskursin e njohim si vendin kyç në raportet pushtet-media. Me qëllim që ta kompletojmë tē kuptuarit e plotë tē temës së tekstit, së pari do tē nisemi nga përcaktimi konceptual i diskursit. Kuptimi etimologjik i këtij termi rrjedh nga fjala latine *discursus* që do tē thotë fjalim, bisedë, diskutim. Ky eshtë shpjegimi më i thjeshtë i këtij termi. Nëse përcjellim veprat e linguistëve modern, siç eshtë Ferdinand de Saussure-a, apo veprat e themeluesit të teorisë biopolitike Michel Foucaultit, mund tē gjejmë edhe përkufizime më komplekse.*

Për këtë arsyen nuk do tē ndalemi vetëm në përkufizimin e thjeshtë tē *diskursit* si bisedë/ fjalim apo diskutime tē subjekteve që flasin, por ajo që do tē na interesojë më shumë eshtë si e folur ‘në veprim’, si lidhje e projektuar dhe qëllimtë e refleksioneve dhe artikulimeve, tē cilat si objekt i punës tonë përputhen në mënyrë tē përsosur me pasqyrën e mediave në Jugosllavinë e viteve të 90-ta. Nisemi nga përkufizimi i *diskursit*. Për tē kuptuar *diskursin* në kontekstin e punës tonë eshtë e domosdoshme t'i kthehem i termit tē Foucaultit tē *dispositivit*, sipas tē cilit diskursi eshtë një nga modalitetet e mundshme tē tij.

### Konkretnisht sipas Foucault:

1. *dispositivi* eshtë grup heterogen që përfshin tē gjitha: diskurset, institucionet, objektet, ligjet, masat polikore, propozimet filozofike gjuhësore dhe jo-gjuhësore. *Dispositivi*, si i tillë, eshtë rrjeti që vendoset në mes tē këtyre elementeve;
2. *dispositivi* ka gjithmonë një funksion tē caktuar strategik dhe gjithnjë eshtë i lidhur me raportin e forcave;
3. si i tillë, *dispositivi* rrjedh nga rapporti i forcës dhe dijes<sup>227</sup>. Siç shohim, Foucault e përfshinë diskursin si një nga elementet e *dispositivit*. Çka eshtë diskursi sipas Foucaultit?

‘Të kuptuarit e rregullave përmes tē cilëve formohen dhe përhapen objektet, subjektet, konceptet dhe fushat strategjike’ (Foucault sipas Tanja Petroviqit, 2010). Sipas antropologes sllovene Tanja Petroviq ‘struktura diskursive nuk eshtë vetëm entitet ‘kognitiv’ apo ‘kontemplativ’, por eshtë edhe praktikë artikuluese, e cila krijon dhe organizon rapportet shoqërore’ (Petroviq, 2010:69). Nëse i kthehem i objektit tē hulumtimit tonë, nëse u kthehem i mediave, rolit tē tyre në përhapjen e miteve, propagandës, urrejtjes, manipulimeve, do ta kuptojmë pse diskursin e kemi pikënisje tē analizës. Për fillim do t'u kushtojmë disa rreshta teksteve tē rubrikës së Politikës ‘Jehona dhe reagime’. Sipas fjalëve tē autores Radina Vuçetiq, ngjarjeve politike tē fundit tē viteve tē tetëdhjeta u eshtë bërë ‘jehonë’ në faqet e gazetës ditore Politika. ‘...mitingjet e serbëve dhe malazezëve nga Kosova tē shfaqura në formë tē ‘revolucionit antiburokratik’, miratimi i amendamenteve në Kushtetutën e RS tē Serbisë, keqësimi i gjendjes në Kosovë, mitingu në Ushqë dhe Zhuta Greda, greva e minatorëve shqiptarë në Stari Tërg [...] festimi i 600-vjetorit tē Betejës së Kosovës në Gazimestan, ngritia e çështjes së barazisë së serbëve në Kroaci [...] shkëputja e Sllovenisë...’ (Vuçetiq, 2001:13), kanë korresponduar me ‘jehonat’ e Politikës: *Ndodhi populli, Rrugë tē mbarë shokë, Populli serb i përcakton kufijtë e Serbisë, Bota nuk guxon ta harrojë krimin monstruoz kundër popullit serb* dhe tē njashme. Refleksionet e para pér qenien e veçantë, por tē ‘rezikuar’ kombëtare serbe dhe transmetuesit e parë tē intolerancës ndaj bashkatdhetarëve tjerë vijnë nga më shumë se ‘katër mijë tekste tē publikuara në periudhën gjatë tē viteve goxha tē stuhishme (politike).’ (Mimica, 2001:25).

Për çka flet kjo pamje? Flet pér një *diskurs* tē „gatuar“ gradualisht, para së gjithash përmes materialeve letrare – kua-zishkencore tē publikuara në gazeten më tē lexuar ditore, duke e përgatitur në këtë mënyrë terrenin pér veprime praktike. ‘Jehona dhe reagime’ përmenden si shembull eklatant i instrumentalizimit politik tē mediave. Për tē mos mbetur tē vetmuara në procesin e instrumentalizimit tē përgjithshëm nga ana e pushtetit tē asaj kohe, duhet përmendor edhe rolin e mediave elektronike. Skemat diskursive, tashmë pjesërisht tē formuara dhe tē përhapura me ritëm tē posaçëm, nga gazeta ditore ‘Politika’ i merr Ditari i dytë i Televisionit tē Beogradit dhe posaçërisht pjesa shtesë tē tij. Emisionet infor-

226 Coloviq, Ivan (1994): *Shpërthimi nga shëndeti*, Beograd, Qarku i Beogradit.

227 Në librin *Disiplina dhe ndëshkimi*, Michel Foucault na mëson se *forca* krijon *dituri*, se *forca* dhe *dituria* janë „implikuar drejtpërdrejt në njëri-tjetrin“ dhe se ‘nuk ka relacion tē forcës pa përcaktim korelativ tē ndonjë fushe tē njohurive, dhe as njohuri që në tē njëjtën kohë nuk presupozon dhe nuk krijon marrëdhënie force’ (Foucault, 1994:27).

mative (sidomos gjatë kohës së luftës në Kroaci dhe Bosnjë e Hercegovinë) e përforcuan fjalorin ekzistues të urrejtjes me fotografi dhe me zë.<sup>228</sup> Analizat e mediave të caktuar, përbajtjeve të tyre, mënyrës së si kanë shkruar, informuar dhe raportuar disa vite para fillimit të shpërbërjes së Jugosllavisë, tregojnë se uverturën e asaj që pasoi - shkatërrimi i përgjakshëm i shtetit, e kanë bërë pikërisht mediat. Ato nuk do të mund të vepronin në këtë mënyrë pa mbështetjen e strukturave politike në pushtet dhe këtu gjendet vendi kyç kur bëhet fjalë për diskursin e përmendur më herët, sepse 'diskursi paraqet një lloj të dominimit që e fut të folurit, rregullat dhe ndarjet në sistemin e dominimit dhe „mikrofizikën e pushtetit“ (Turen Alan, 2011:12). Diskursi është instrument në duart dominuesit, pushtetit, respektivisht shtetit. Në rastin konkret diskursi është instrument në duart e shtypit dhe mediave elektronike, të cilat janë 'dorë e zgjatur' e pushtetit. Pa diskurs, si bazë manipuluese në duart e strukturës politike në pushtet, 'pushtetin mikrofizik', të të cilin e përbëjnë mediat, 'farkimi i luftës' (Tompson, 2000) do të ishte i pamundur. Përmes prezantimeve, raporteve, artikujve, raportimeve (rubrikave, emisioneve TV), të cilat kanë pasur karakter propagandues dhe kuazishkencor, kryhet degradimi gradual i *tjetrit*. Të tjerët janë faktorë për rrezikimin e popullit serb, të tjerët i kanë pushtuar tokat serbe dhe kanë rrezikuar popullsinë serbe, Jugosllavia është projekt i 'shuarjes' së identitetit serb dhe të tjera<sup>229</sup>. Që diskurset e përmendura të kishin *jehonë* në mesin e masës së jo të shenjtë (në kuptim national) ishte e domosdoshme (de)konstruksioni i *tjetrit*. Kurse të tjerët janë definuar si *armiq par excellence*.

Në ekspozenë e titulluar "Shikimi i *tjetrit*", të autores Olivera Milosavljeviq, thuhet: "Në këtë mënyrë, Politika ka shkruar atë që ka folur elita, kurse populli mbante mirë në kujtesë se 'armiqte e serbëve serbët i bën serbë', apo se 'çështjet serbe i inicuan dhe i hapën të tjerët, na ngriten në këmbë duke na goditur, na kthjelluan duka na ofenduar'. Imazhet individuale për të 'tjerët' [...] janë krijuar atëherë kur politika ka diktuar nevojën për të gjetur ndonjë 'kokë turku'" (Milosavljeviq, 2001:81). Nëse i referohemi filozofit francez Jacques Derrida, do të na kujtohet teza *e variacionit* si burim i personalitetit dhe identitetit vatanak, të cilin ai e merr nga Lakani. Derrida thote: "Megjithatë, këto janë të kushtëzuara nga ekzistimi i përhershëm i atij *tjetrit* në të gjitha veprimet dhe sjelljet tona. Ky *tjetri*, si bazament i diskurzeve të

shumta nga fund-shekulli, është ai që bashkëpërcakton së *pari* subjektin (veten, mendjen, shpirtin...), të cilët identitetin e tyre nuk mund ta përcaktojnë vetëm se nga vjetvetja. Identiteti i veçantisë (personit, kombit apo kulturës) është i hapur ndaj *tjetrit*, dhe njëkohësisht është i hapur ndaj të *tjerëve*, respektivisht prej *tjetrit* (Krivak Marijan, 2008:119). Të tjerët janë elementë përbërëse të individualitetit 'tonë'. Nëse i kthehem funksionit stereotip manipulues të mediave para dhe gjatë viteve të 90-ta, do të shohim se *diskurset* e përmendura për 'variacionin' nuk kanë ndodhur rastësisht, pa refleksion të thellë historik. Stereotipet e futura në hapësirat e komunikimit publik, të cilat e kanë 'qartësuar' pamjen e armikut 'duke u mbështetur në argumentet e pashtershme historike për mosmarrëveshjet dhe konfliktet me ata' (Milosheviq Branislav, 2001:37). Kjo na shpie në një tezë tjetër të rendësishme sipas së cilës 'diskursin mund ta identifikojmë në bazë të mundësive të ndryshme, të cilat hapen për ringjalljen e temave ekzistuese' (Ilc Blazh, 2010:50). Reanimimi dhe riaktualizimi i diskurzeve ekzistuese për të tjerët si shumë më të ndryshëm, 'fajtorë' për humbjet historike, dhe 'prishësit' e integrimit dhe ekzistencës së të 'gjitha vendeve serbe', i ka kontribuar asaj që Foucault-i e vendos në sferën e shkencës dhe dijes: elitës intelektuale. Memorandumi i Akademisë Serbe të Shkencave dhe Arteve është produkt i akademikëve dhe njerëzve të kulturës. Përbajtja e Memorandumit të sipërpërmendor është 'gjurmë e paslyeshme e rolit të pandershëm të intelektualëve në krijimin dhe shpjegimin e stereotipave etnike të përhapjes së urrejtjes nationale dhe rishikimit të historiografisë' (Mimica, 2001:19). Shembullin e këtyre intelektualëve e ndjekin edhe autorët e librave me ndikim si dhe repertorët e teatrove beogradase. Të gjitha kanë të theksuar 'vulën nacionale': "Me gëzim shkon serbi ushtar", "Rënia e Perandorisë Serbe", 'Shpërngulja e serbëve'.... Në kulturën masive produksioni muzikor shoqërohet me titujt e këngëve 'patriotike': Kush thotë, kush gënjen se Serbia është e vogël", "Vidovdani", "Nga Topola deri në Ravna Gorë", "Do t'i vrasim, do t'i presim, kush nuk është me ne"... Pra, bëhet fjalë për mobilizimin e gjithë shoqërisë për të njëjtin qëllim, çlirim nga të tjerët, nga ata që janë të *tepërt*. Të gjithë mekanizmat e përmendur (mediat, akademia, kultura) paraqesin një lloj të 'pushtetit mikrofizik'.

Gjithë këto janë mekanizma latent heterogen përmes të

228 Për gazetarinë e luftës dhe mënyrën si kanë raportuar mediat gjatë kohës së luftës në Jugosllavi shihni më shumë në: 'Prodhimi i luftës', me autor Mark Tompson.

229 Për atë që u tha më sipër shihni në 'Jehona dhe reagime' (Koha kur foli populli), tryezë e rrumbullakët në organizim të Fondit par të Drejtën Humanitare, Beograd.

cilëve pushteti përpinqet të bëjë ‘propagandë’ mbi një populatë të caktuar. Përmes elaboratit mbi raportet pushtet-media, por edhe raportet e pushtetit dhe akademisë/kulturës, shohim ‘ndarjen e punëve’ nën kontrollin e drejtpërdrejt nga po ai pushtet. Populli duhej zgjuar dhe ‘vetëdijesuar’ kombëtarish, për këtë arsy e gjitha resurset e një shteti dhe shoqëria duhej vënë në ‘veprim’. Publiku i një shoqërie të tillë nuk ekzistonte, sepse pasoi ‘përsëritja tauntologjike e masave dhe konkluzioneve të përgjithshme’ (Milosheviq, 2001:41), të cilat janë krijuar nga diskursi politik dhe, do të thoshim, nga shfrytëzimi me mjeshtëri i diskursit në fjalë. Do të ishte e pandershme të kufizohemi vetëm në prezantimin e shtypit dhe mediave në Serbi para fillimit të viteve të 90-ta dhe të mos e përmendim rolin që kanë luajtur mediat në të gjitha republikat e ish-Jugosllavisë në falsifikimin dhe raportimin e rrejshëm gjatë kohës së luftërave të zhvilluara në Kroaci, Bosnjë dhe Hercegovinë, kurse diçka më vonë edhe në Kosovë. Për këtë ekzistonjë një numër i konsiderueshëm i studimeve në të cilat është përshkruar hollësishët roli i mediave të shtypura dhe elektronike në zgjerimin e territoreve dhe fushëbetejave të ‘fituara’. Për nevojat e këtij punimi është shfrytëzuar një nga këto studime, i titulluar ‘Prodhimi i luftës’ i autorit Mark Tompson.

*Dispozitivi* dhe *diskursi* në titullin e kapitullit kanë rëndësinë dhe vendin e tyre. Përmes shembullit të diskursit, të cilin e kemi shqyrtuar si një nga modalitetet e dispozitivit, jemi përpjekur ta tregojmë rolin që kanë luajtur mediat si pjesë e ‘pushtetit mikrofizik’ në mobilizimin e shoqërisë në filim të viteve të 90-ta. Me qëllim që mediat të mos mbeten të vetmuara në këtë proces, përmes disa rreshtave i kemi kushtuar vëmendje edhe asaj që klasifikohet në fushën e njohurisë dhe shkencës, akademisë dhe kulturës. Të gjithë mekanizmat e mobilizimit varen nga një faktor: pushteti. Prandaj diskursi ka vend kryesor në raportet pushtet-media. Megjithatë, edhe paradigma që përmendet në titullin e kapitullit ka vendin dhe rëndësinë e saj. Atë e huazojmë nga sociologu francez Alan Turen dhe ajo bart mendimin iluminist të paraqitjes. Për *paradigmën* Turen thotë: ‘Paradigma nuk është vetëm instrument në duart e pushtetit por, edhe në formimin e qëndrimit mbrojtës dhe kritik...’ (Turen, 2011). Paradigma e Alanit bazohet në qëndrimin kritik ndaj historisë në tërësi. Ai e sheh këtë në të ashtuquajturën *subjektivizim*, që nuk është asgjë tjetër përveç aftësia e qenieve njerëzore që ta formojnë dhe ndryshojnë vetveten, si individualist ashtu edhe kolektivisht. Nëse *diskursi* mund t’i shërbejë mbikëqyrjes dhe propagandës, *paradigma* vendos theksin te liria dhe të drejtat e njeriut. Për të evoluar nga *dis-*

*kursi* në *paradigmë*, si përbërës të ri të sistemit politik dhe ‘mikrofizikës së pushtetit’<sup>230</sup> potencial të tij, duhet të ballafaqohemi me të vërtetën dhe ta shohim atë në sy.

Për fillim, do të thoshte Gjuro Shushnjiq, duhet kthyer dinjitetin fjalëve tona. ‘Nëse ua kthejmë dinjitetin fjalëve tona, ka shpresë t’ia kthejmë dinjitetin vetes tonë’ (Shushnjiq, 1995:79).

### Roli de/resocializues i mediave – vështrim empirik

Ashtu siç kemi thënë në pjesën e parë të punimit, jemi të mendimit se KOMRA ka rol resocializues në vendet e krijuara pas shkatërrimit të RSFJ-së. Kur flasim për këtë nismë është me rëndësi të theksohet se bashkë me risocializimin e shoqërisë duhet bërë edhe risocializimi i mediave. Në këtë pjesë të punimit do t’i shqyrtojmë rezultatet e arritura përmes këtij procesi nga prizmi i mediave dhe me ndihmën e analizës kuantitativo-kualitative të diskursit. Teorienët konsiderojnë se diskursi paraqet një formë të përdorimit të gjuhës, siç është thënë më lartë. Ky përkufizim nganjëherë është shumë i ngushtë dhe jo gjithmonë adekuat. Thjesht, studimet e diskursit nuk e analizojnë gjithmonë ekskuluzivisht vetëm gjuhën, por kërkojnë të dinë se kush, si, pse dhe kur flet. Tekstet, sikurse edhe folura, kanë përfituesit, autorët dhe lexuesit e vet. Në komunikimin e shkruar apo interaksion me shkrin nuk kemi interaksion *ballë-për-ballë (face-to-face)*: lexuesit kanë rol më pasiv në këtë interaksion. Por, assesi nuk guxojmë ta nënverhësojmë këtë interaksion. Ai proces gjithashtu zhvillohet në një kontekst të caktuar, sikurse edhe akti i të folurit. Konteksti është një nga karakteristikat e gjendjes sociale apo komunikative që ka ndikim të konsiderueshëm në të folurit apo në tekst. Përveç kjo karakteristikë ndikon dukshëm që të bëhet një hap i madh i kalimit prej kuptimit të “prekshëm” të termit diskurs në atë abstrakt (Van Dijk, 1998:1-14). Kontekstin mund ta definojmë si “model të posaçëm mendor apo interpretim subjektiv të pjesëmarrësve për gjendjet (sociale, interaktive apo komunikative) në të cilat ata marrin pjesë” (Van Dijk, 2008:26). Konteksti në masë të madhe varet nga kultura në të cilën krijohet mesazhi i caktuar. Gazetat asnjëherë nuk lexohen në vakumin kulturor dhe social, sikurse që as përbajtjet tjera mediale nuk konsumohen pa faktorët e përmen-dur. Kuptimi i mesazhit kushtëzohet nga përvetësimi i kontekstit të përmendor kulturor. Në të vërtetë, kështu arrijmë deri në kontekstin e institucionalizuar, i cili është i domos-doshëm për ta kuptuar mesazhin.

230 Ku para së gjithash mendojmë në mediat.

Në pjesën e parë të punimit e kemi sqaruar lidhjen që ka ekzistuar dhe vazhdon të ekzistonjë në mes elitës politike dhe shoqërore dhe mediaive. Meqenëse në fokus të analizës sonë është diskursi medial, duhet thënë edhe atë se në shumicën e rasteve diskursi në media nënkuption ndarjen e kohës dhe vendit gjatë hartimit të tekstit dhe konsumimit të mesazhit.

Pikërisht për shkak të prolongimit të kohës së intereaksionit konteksti është me rëndësi sepse siguron stabilitetin e mesazhit (Talbot, 2007). Meqenëse tema e këtij punimi është ballafaqimi me të kaluarën nga prizmi i rolit të mediave që veprojnë në dy shtete (BeH dhe Serbi), është e nevojshme të përmendet edhe komunikimi ndër-kulturor. Kjo formë e komunikimit gjithmonë shënohet me shmangje nga normat e pritura të intereaksionit, që rezulton me burim për krijimin e stereotipave kulturore (Fetzer dhe Lauerbach, 2007). Ky stereotipizim është prezent në komunikimin publik në të njëjtën masë sikurse edhe në intereaksionet private.

Në vazhdim të punës do të përpinqemi që, me ndihmën e kësaj kornize teorike dhe rezultateve të analizës, të paraqesim mesazhet *dominuese/mainstream* të mediave në lidhje me iniciativën KOMRA, qëllimi i së cilës është të krijojë kushte për vendosjen e lidhjeve të reja mes shteteve të ish-Jugosllavisë, përmes krijimit të një Komisioni rajonal të pavarur, ndërshtetëror për vërtetimin e fakteve për të gjitha viktimat e krimeve të luftës dhe shkeljet tjera të rënda të të drejtave të njeriut, të kryera në territorin e ish RSFJ-së në periudhën 1991-2001.

#### **Metoda e hulumtimit është analiza kuantitativo-kualitative e përbajtjes së teksteve të kushtuara KOMRA-s.**


*Njësia e analizës* është teksti në tërësi duke përfshirë edhe mbi-titullin, titullin, nëntitullin, i cili është publikuar në sajtin e Radio Televizionit të Serbisë, Radio Televizionit të Republikës Serbe dhe Radio Televizionit të Bosnjë dhe Hercegovinës, në periudhën njëvjeçare pas fillimit të fushatës rajonale për përkrahjen e KOMRA-s (26 prill 2011), pa marrë parasysh zhanrin gazetaresk. Për nevoja të analizës është hartuar një *listë e posaçme e kodit* ku është regjistruar media, data, zhanri, gjatësia e tekstit, autorësia, lokacioni, shkaku, tema, perceptimi i viktimateve, subjekti, objekti dhe konteksti vlerësues.

*Korpusin* e analizës përbëjnë tekstet e publikuara në internet nga mediumet publike (Radio Televizioni i Serbisë, Radio Televizioni i Federatës së Bosnjë dhe Hercegovinës dhe Radio Televizioni i Republikës Serbe) gjatë periudhës njëvjeçare nga dita e fillimit të fushatës "Një milion nënshkrime për KOMRA-n". Periudha e analizuar është një vit, gjatë së cilës janë kontrolluar sajtet e televizioneve publike të Serbisë dhe BeH. Kërkimi është kryer përmes fjalëve kyçe

(KOMRA) dhe me ndihmën e përcaktuesit kohor. Përmes mostrës së formuar në këtë mënyrë jemi përpjekur të arrijmë tek testet, të cilat sipas shtëpisë mediale kanë merituar të jenë në dispozicion të publikut të gjërë përmes internetit. Numri i përgjithshëm i teksteve të detektuara është 12, ku RTS-ja ka publikuar 6, RTFBeH 4 kurse RTRS 2.

Nga kjo mund të përfundojmë se shtëpitë mediatike nuk ishin të interesuara për temën e themelimit të komisionit rajonal. Këtë e vërtetojnë edhe rezultatet e fituara dhe analizat e thella.

*Zhanri* është kategoria qendrore e analizës së diskursit. Zhanret përbëjnë modelin konvencional për zgjidhje komunikative të problemeve të caktuara. Këto probleme shoqërore përbëjnë strukturën e jashtme (sociale dhe institucionale) të zhanreve (Fetzer, Lauerbach, 2007). Kjo në të vërtetë do të thotë se gazetarët e zgjedhin zhanrin duke reaguar në informacione të caktuara, në vartësi nga vlerësimi se çfarë ndikimi dëshirojnë të arrijnë te auditoriumi në lidhje me këtë problem apo dukuri. Lajmi apo raporti i pastër pasqyron faktet e fuqishme në lidhje me temën, kurse reportazhi dhe komenti veprojnë më mirë në emocionet e pranuesve të mesazhit. Zhanri përcakton edhe pozicionin fillestare të leximit. Tekstet gjithmonë ofrojnë një diapazon të caktuar për pozicionin potencial të leximit, por propozojnë edhe interpretimin e preferuar për adoptimin e pozicionit "më të dëshirueshmë" (Fetzer, Lauerbach, 2007). Ndarja e përbajtjeve të analizuara sipas zhanrit reduktohet në dy kategori: kategoria e lajmit dhe e raportit. Këto zhanre të qarta faktografike tregojnë se mediat kanë qenë të fokusuar vetëm në disa fakte dhe deklarata dhe se nuk janë përpjekur që, në përputhje me rolin e tyre shoqëror si institucione publike, t'ia sqarojnë dhe t'ia ofrojnë thelbin e KOMRA-s auditoriumit të vet. Qasja e pastër faktografike vështirë se mund t'i ndihmojë sensibilizimin të publikut në lidhje me temën e ballafaqimit me të kaluarën, e as që mund ta paraqesë rëndësinë esenciale të këtyre nismave.



Grafikoni numër 1 – Ndarja sipas zhanreve

Gjatësia e tekstit luan rol të rëndësishëm në media. Nëse teksti është i gjatë, kjo është shenjë për lexuesit se tema është e rëndësishme, por nëse është i shkurtër, mesazhi që dërgohet është se lajmi i dhënë nuk luan rol të madh.


Gjatësia e teksteve në periudhën e përcjellë tregon se mediat ishin të interesuara për KOMRA në masën që ua lejojnë "kufijtë e zhanreve". Lajmi dhe raporti si kategori kanë kufizimet e tyre sepse nuk kanë vend për qasje analitike apo shqyrtim më të thollë të temës.

### Vendi (lokacioni)

Duke shqyrtuar lokacionin mund të përfundojmë se të gjitha mediat gjatë raportimit të tyre kanë mbetur "brenda kufijve të tyre shtetëror". Kështu për shembull, në raportet e RTS-së në vendin e parë ishte Beograd, RTFBeH-së pothuajse i interesonte vetëm Sarajeva, përderisa për RTRS-në kjo ishte Banjalluka. Ajo që bie në sy në këtë rezultat është fakti se asnje medie publike nuk u përpooq të shohë se si reagon publiku në shtetin apo entitetin fqinj. Kjo është në veçanti shqetësuese kur bëhet fjalë për BeH-në, ku njëri entitet në tërsë përrash-ton reagimet e entiteteve tjera në lidhje me KOMRA-n. Kjo flet për ndarje të thollë mes komuniteteve, aq sa edhe fakti se lufta e viteve të nëntëdhjetë, la gjurmë pothuajse në të gjitha familjet, nuk mund të jetë pikë e përbashkët për dialog.

### Shkaku

Nga shqyrtimi i rezultateve të fituara mund të përfundojmë se këto media gjatë periudhës së analizuar nuk kanë treguar asnje nismë në sajte e tyre për zgjerimin e temës që ofron KOMRA, por janë kufizuar ekskluzivisht në zhvillimet aktuale apo në konferanca për shtyp. Shqetësuese është e dhëna se mediat publike, të analizuara, janë treguar institucionë që nuk e respektojnë apo nuk e njohin rolin thelbësor të ekzistencës së tyre: krijimin e kohezionit përmes kanalizimit të rrymave të ndryshme në dialogun publik.



Grafikoni numër 2 – Shkaku


### Autorësia

Kjo kategori tregon angazhimin e gazetarit dhe shtëpisë mediatike që ta përbush detyrën e vet dhe të jetë pranë burimit të informacionit. Është për lëvdatë fakti që të gjitha mediat i kanë dërguar raportuesit e tyre në terren dhe në këtë mënyrë kemi marrë produkte burimore mediatike për ueb-faqe.

### Tema

Tema është segmenti tjetër i analizës. Kjo kategori është posaçërisht e rëndësishme kur dihet se mediat janë ato që ua imponojnë informacionet apo dukturitë e caktuara auditoriumit të vet. Ato i përcaktojnë kornizat për të cilat duhet të mendojë publiku.

Edhe pse në listën e kodeve kemi paraqitur një diapazon relativisht të gjërë të mundësive për prezantim, në tekstet e analizuara mediat i qasen iniciativës KOMRA vetëm si një nismë rajonale, duke nënverësuar rolin dhe qëllimin kryesor të saj dhe duke e paraqitur atë si një dukuri të përditëshme, gjë që duhet pranuar se nuk është e saktë, posaçërisht përfaktin se bëhet fjalë për një shoqëri të pas-konfliktit ku iniciativat e përbashkëta të shteteve të ish-Jugosllavisë janë shumë të rralla. Mediat nuk e kanë shfrytëzuar rastin të flasin për të kaluarën në dritën e fakteve dhe në këtë mënyrë ta risocializojnë jo vetëm shoqërinë, të cilës i drejtohen, por edhe vetveten.



Grafikoni numër 3 – Tema

### Viktimat dhe KOMRA

Karakteristikë e diskursit publik të vendeve të ish-Jugosllavisë është se rrallë flitet për të gjitha viktimat e luftës, kurse palët në konflikt insistojnë në humbjet "nga radhët e veta". Iniciativat, që kanë në fokus pozitën e viktimateve e jo kryesit e krimeve të luftës, janë të rralla, për këtë arsyesh ishte interesante të shihet se si janë trajtuar viktimat nga këto media

dhe a është shfrytëzuar KOMRA si mundësi për inicimin e dialogut publik për viktimat dhe pozitën e tyre.

Rezultatet e analizave tregojnë se viktimat, edhe pse formalisht figurojnë në tekste, nuk janë trajtuar si kategori që ka nevojë për mbështetje më të madhe shoqërore, por janë kthyer në nivelin e frazës së rëndomtë: "KOMRA është e rëndësishme për shkak të të gjitha viktimate".



Grafikoni numër 4 – Qasja ndaj viktimate në raporte

## Subjektet

Me subjekte nënkuftojmë ata aktorë në tekst, të cilët veprojnë, japin deklarata, flasin për tema të caktuara me aktorët tjera. Analiza ka treguar se rolin kryesor e kishin përfaqësuesit e sektorit joqeveritar, ata ishin pyetur dhe kishin dhënë deklarata në masën më të madhe. Në vendin e dytë janë politikanët. Ky rezultat është gjithsesi i pritshëm për faktin se KOMRA filloj pikërisht nga sektori i organizatave joqeveritare. Shqetësues është fakti që gjatë periudhës së analizuar publikut të gjerë nuk iu dha mundësia të flasë përkohës së dialogut publik me viktimat.

## Objektet

Si objekt në këtë punim janë shënuar të gjithë aktorët në tekst për të cilët flet subjekti. Në vendin e parë ishin iniciativa dhe viktimat. Mirëpo, siç e kemi përmendur, viktimat janë të pranishme në kuadër të "stereotipave", pa ndonjë analizë të detajuar pse është me rëndësi të përkrahet Iniciativa KOMRA.

## Vlerat e kontekstit

Kjo kategori tregon reportin e gazetarit ndaj temës. Analiza tregon se në produktet mediale kryesisht është prezent qëndrimi neutral, përderisa qëndrimet negative janë të pranishme në përqindje më të vogël.

Është interesante të përmendet se në dy tekste kemi hasur në qëndrime negative të gazetarit ndaj përbajtjes së tekstit: bëhet fjalë për një raport të sajtit RTFBeH-së ku thuhet "projekti i dështuar" KOMRA, përderisa teksti i dytë është nga sajti i RTRS-së në të cilën Organizata e familjeve të të burgosurve, luftëtarëve të vrarë dhe civilëve të zhdukur të Republikës Serbe u bëri thirrje këtyre kategorive të qytetarëve që të mos iu përgjigjen thirrjeve të Koalicionit për Komisionin Rajonal dhe të mos i jepin përkrahje kësaj iniciative.

## Përfundimi

Në këtë punim autorët ofruan kontekstualizimin e rolit të mediave gjatë periudhës së paralufutës dhe të luftës, në përpjekje që përmes dekonstruksionit të diskursit publik të tregojnë pozicionin kyç të mediave. Siç është thënë, diskursi i formuar nga elita politike dhe intelektuale që përmes mediave iu është prezantuar shoqërive në shtetet e ish-Jugosllavisë, ishte me rëndësi kyçë në rrugën e shpërbërjes së Jugosllavisë. Analizat e shumta të periudhës së luftës kanë treguar se mediat kanë luajtur rol aktiv në ngjarjet e përgjakshme, por edhe pas përfundimit të luftës së fillimit të demokratizimit të shoqërive ato nuk kanë kaluar ndryshimet e nevojshme që do t'iu mundesonin të shndërrohen nga organe publike të partive dhe rrymave ideologjike në shërbime publike në kuptim të vërtet të fjalës. Mediat e kanë tejkalojë me lehtësi rolin e tyre, duke u arsyetuar me instrumentalizim nga ana e pushtetit dhe politikës. Përmes analizës kemi treguar se diskursi publik as sot nuk është në shërbim të qytetarëve: ky diskurs nuk ka hapur çështjet kyçë të zhvillimit të shoqërisë, siç është ballafaqimi me të kaluarën. Problem shthesë është qëndrimi ndaj viktimate: mediat nuk i kuptojnë apo nuk duan t'i kuptojnë viktimat. Ato trajtohen si frazë e zakonshme që nuk e ka peshën e vet shoqërore. Punimi tërheq vërejtjen se çështja kryesore është hapja e dialogut publik në media për bashkësitet tjera të ish-Jugosllavisë dhe për domosdoshmërinë e ndryshimit të procesit të "getoizimit" të auditoriumit. Mediat publike të finançuara nga buxheti apo përmes parapagimit të RTV-së, kanë obligim ndaj komuniteteve të tyre që t'ju ndihmojnë në ballafaqimin me të kaluarën, me çka edhe vetë do të kalojnë rrugës së risocializimit. Esenca e pjesëmarrjes së mediave në procesin e risocializimit është "...kur nevoja (psikologjike) që objektivisht ekziston orientohet në drejtimin që i përgjigjet komunikuesit dhe marrësit" (Shaciq, 2004:139). Thënë më saktë, suksesi i procesit të risocializimit varet nga mënyra dhe metoda përmes së cilave vlerat e reja, të ndryshme nga ato të fituara më parë, 'implantohen' tek individi.

Mediat bëhen pjesëmarrës aktivë të procesit të risocial-

izimit atëherë kur ‘konsultohen’ me konsumuesit, që do të thotë përdoruesit e mediave, sepse mediat janë transmetues të nevojave dhe interesave të tyre. Kjo nënkuption rol më të theksuar të mediave në strukturën e aktorëve në diskurs: mediat nuk mund të jenë të nënshtuara

ekskluzivisht ndaj elitës politike dhe intelektuale, por duhet të marrin rol më aktiv në krijimin e shoqërisë, ash tu që, për fillim, të bëhen korrigjues të opinionit publik përmes krijimit të kornizave për reflektim mbi luftërat e viteve të nëntëdhjeta.

# Rasti Kleçka<sup>231</sup>

Florent Spahija

Aktakuza<sup>232</sup> ndaj dhjetëshes së njohur ishte konfirmuar me datën 26 gusht të viti 2011<sup>233</sup>. Ajo ngarkon Fatmir Limajn dhe nëntë të tjërët me krimë të luftës kundër popullatës civile dhe robërvë të luftës, të dënueshme me ish-Kodin penal të Jugosllavisë, ish-Ligjin penal të Kosovës si dhe Konventat e Gjenevës dhe protokollet e saj<sup>234</sup>.

Prokuroria Speciale e Kosovës, përkatësisht prokurori i EULEX-it, Maurizio Salustro, nga viti 2010 kishte filluar hetimet kundër tash të akuzuarve Fatmir Limaj, Nexhami Krasniqi, Naser Shala, Sabit Shala, Naser Krasniqi, Arben Krasniqi, Behlul Limaj, Bekim Shurdhaj, Shaban Shala dhe Refki Mazrreku.

## Po kush janë të akuzuarit dhe për çfarë saktësisht ngarkohen ata?

**Fatmir Limaj**<sup>235</sup> - Ka lindur me 4 shkurt 1971 në fshatin Banjë të Malishevës, jeton në Prishtinë, ka qenë pjesëtar dhe komandant i UÇK-së në Brigadën 121, i njohur me nofkën Çeliku ose Daja. Tani ushtron funksionin e deputetit të Kuvendit të Kosovës, me profesion është jurist. Limaj akuzohet në tre pika

të aktakuzës se në bashkëkryerje ka kryer krimë luftë kundër popullatës civile dhe të burgosurve të luftës dhe dy akuzat për krimë luftë kundër të burgosurve të luftës. Periudha, për të cilën Limaj akuzohet në aktakuzë, është nga janari i vitit 1999 deri në mesin e qershorit të vitit 1999. Pas luftës ai zhvilloi një karierë të suksesshme politike duke arritur deri në majat e pushtetit ndërkohë që i mbijetoi i pafajshëm një procesi gjyqësor për krimë luftë në Tribunalin e Hagës.

**Arben Krasniqi**<sup>236</sup> - I lindur më 5 tetor 1978 në fshatin Terpezë e Ulët e Malishevës. Krasniqi ka qenë pjesëtar i UÇK-së, në pozitën e rojës së burgut. Thuhet se ka jetuar një kohë në Zvicër, ku edhe ishte arrestuar për t'u ekstraduar në Kosovë. E pas ektradimit gjykatësi i procedurës paraprake ia caktoi masën e arrestit shtëpiak. Krasniqi akuzohet se në bashkëkryerje ka bërë krimë luftë kundër popullatës civile dhe robërvë të luftës. Sipas aktakuzës krimet janë kryer në Kleçkë, komuna e Lipjanit, nga janari i vitit 1999 deri në mesin e qershorit 1999.

**Naser Krasniqi**<sup>237</sup> - I lindur më 11 tetor 1973 në Rahovec, me banim në fshatin Banjë, ka qenë pjesëtar i UÇK-së, gjatë

231 Emri i është vendosur për shkak të qendrës së ndalimit, që ka qenë e pozicionuar në këtë fshat.

232 Aktakuza mban numrin e prokurorisë PPS.nr:07/2010.

233 Seanca e fundit për konfirmimin e aktakuzës është mbajtur në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, më datën 26 gusht 2011.

234 Aktakuza me numër PPS.nr:07/2010 e datës 25 korrik 2011.

235 Aktakuza me numër PPS.nr:07/2010 e datës 25 korrik 2011, faqe 9 dhe 10.

236 Aktakuza me numër PPS.nr:07/2010 e datës 25 korrik 2011, faqe 1 dhe 2.

237 Aktakuza me numër PPS.nr:07/2010 e datës 25 korrik 2011, faqe 3, 4 dhe 5.

luftës i njohur me nofkën "Bashkim Fino". Ka kryer punë menaxhuese në qendrën e paraburgimit në Kleçkë. Në aktakuzë thuhet se i njëjti ka qenë udhëheqës në Qendrën e Paraburgimit në Kleçkë, ku edhe akuzohet për gjashtë akuza, në bashkëkryerje, për krime lufte kundër të burgosurve të luftës. Sipas aktakuzës këto krime janë kryer nga mesi i janarit 1999 deri në mesin e qershorit 1999.

**Nexhami Krasniqi<sup>238</sup>** - I lindur më 16 tetor 1962 në fshatin Terpezë të Drenasit, jeton në Prizren, ka qenë pjesëtar i UÇK-së. Gjatë luftës ka përdorë nofkën "Skifteri 500". Ishte komandant i njësive të Policisë Ushtarake. I njëjti akuzohet në shtatë pika të aktakuzës dhe atë në një pikë për krime të luftës kundër popullatës civile dhe të burgosurve të luftës dhe gjashtë pika për krime lufte kundër të burgosurve të Luftës. Në aktakuzë thuhet se krimet janë kryer në periudhën nga mesi i janarit 1999 deri në mesin e qershorit 1999.

**Behlul Limaj<sup>239</sup>** - I lindur më 3 dhjetor 1965 në fshatin Banjë të Malishevës, ku edhe jeton. Ka qenë pjesëtar i UÇK-së dhe ka pasur rolin e komandantit. I njëjti akuzohet, në dy pika të aktakuzës, se në bashkëveprim ka kryer krime të luftës kundër popullatës civile dhe të burgosurve të luftës si dhe krime lufte kundër të burgosurve të luftës. Në aktakuzë si data të krimeve thuhet se janë periudha nga janari i vitit 1999 deri në mesin e qershorit 1999.

**Refki Mazrreku<sup>240</sup>** - I lindur më 29 tetor 1971 në Malishevë, ku edhe jeton, ka qenë pjesëtar i UÇK-së, i njohur me nofkën "Van Damme". Mazrreku në 2 pika të aktakuzës ngarkohet se në bashkëkryerje ka bërë krime të luftës kundër popullatës civile dhe krime të luftës kundër të burgosurve të luftës. Periudha për të cilën akuzohet Mazrreku është prilli i vitit 1999.

**Naser Shala<sup>241</sup>** – I lindur më 26 tetor 1972 në Banjë të Malishevë, ka qenë pjesëtar i UÇK-së i njohur me nofkën "Ftyra". Në aktakuzë thuhet se ka mbajtur një pozitë udhëheqëse në qendrën e paraburgimit në Kleçkë, si menaxher i këtij burgu. Shala akuzohet, në 6 pika të aktakuzës, se në bashkëkryerje ka kryer krime të luftës kundër popullatës civile dhe të burgosurve të luftës, katër akusa për krime lufte kundër të bur-

gosurve të luftës dhe një akuzë për krime të luftës kundër popullatës civile. Periudha për të cilën e akuzon prokuroria është janari i vitit 1999 dhe mesi i qershorit të 1999-të.

**Sabit Shala<sup>242</sup>** - Ka lindur më 10 qershor 1972 në fshatin Kleçkë të komunës së Lipjanit, ku edhe jeton. Ka qenë pjesëtar i UÇK-së, i njohur me nofkën "Cungi". Ka kryer punën e regjistruesit në qendrën e paraburgimit, ku ka regjistruar të burgosurit. Sabit Shala akuzohet për dy pika të aktakuzës dhe atë se në bashkëkryerje ka kryer krime të luftës kundër popullatës civile dhe të burgosurve të luftës dhe krime lufte kundër të burgosurve të luftës. Ndërsa periudha për të cilën akuzohet nga prokuroria është fillimi i vitit 1999 deri në mesin e qershorit 1999.

**Shaban Shala<sup>243</sup>** - Ka lindur më 19 mars 1958 në fshatin Kleçkë të komunës së Lipjanit ku edhe jeton, ka qenë pjesëtar i UÇK-së. Shaban Shala akuzohet për një pikë të aktakuzës dhe atë se në bashkëkryerje ka kryer krime të luftës kundër popullatës civile dhe të burgosurve të luftës. Periudha për të cilën akuzohet nga prokuroria është fillimi i vitit 1999 deri në mesin e qershorit të vitit 1999.

**Beslim Shurdhaj<sup>244</sup>** – I lindur më 29 gusht 1974 në fshatin Banjë të Malishevës, ka qenë pjesëtar i UÇK-së. Shurdhaj akuzohet për dy pika të aktakuzës dhe atë se në bashkëveprim ka kryer krime të luftës kundër popullatës civile dhe të burgosurve të luftës dhe krime lufte kundër të burgosurve të luftës. Ndërsa periudha për të cilën akuzohet nga prokuroria është fillimi i vitit 1999 deri në mesin e qershorit 1999.

### Nga nisi rasti Kleçka

Kur në pranverën e vitit 1998 Agim Zogaj kishte gjetur një pushkë dhe i ishte bashkangjitur UÇK-së, vështirë se do të kishte imagjinuar se një ditë do të hynte në luftë, saktësish, me bashkëluftëtarët e tij të atëhershëm.

Zogaj ka qenë vetëm një luftëtar i thjeshtë. Një, që komandantin e tij të brigadës, Fatmir Limajn, e ka çmuar deri në idolizim.

238 Aktakuza me numër PPS.nr:07/2010 e datës 25 korrik 2011, faqe 5, 6 dhe 7.

239 Aktakuza me numër PPS.nr:07/2010 e datës 25 korrik 2011, faqe 8 dhe 9.

240 Aktakuza me numër PPS.nr:07/2010 e datës 25 korrik 2011, faqe 10 dhe 11.

241 Aktakuza me numër PPS.nr:07/2010 e datës 25 korrik 2011, faqe 11, 12 dhe 13.

242 Aktakuza me numër PPS.nr:07/2010 e datës 25 korrik 2011, faqe 14.

243 Aktakuza me numër PPS.nr:07/2010 e datës 25 korrik 2011, faqe 15.

244 Aktakuza me numër PPS.nr:07/2010 e datës 25 korrik 2011, faqe 15 dhe 16.

I besueshëm ishte Zogaj dhe prandaj qe emëruar rojtar i burgut të improvizuar të Kleçkës.

Rojtari i burgut mbajti një bllok shënimesh në mënyrë sekrete, ku shkroi hollësi të të burgosurve: emrat, të dhënat personale, arsyet e burgimit, datat e pranimit, lirimit ose ekzekutimit. Shënimet i plotësoi me kujtesën e tij.

Kur plagët e luftës u qetësuan me kalimin e kohës, këto shënimë morën jetë e u shndërruan ngadalë në një rrëfim. Autori i saj u bë i njohur si Dëshmitari X<sup>245</sup>.

Rrëfimi i tij fillon me përshkrimin e vrasjes së Nebojsa Djuriçiqit dhe Veljko Markoviqit, dy oficerëve policorë serbë, të cilët u mbajtën në burg në Kleçkë për një periudhe të gjatë kohe dhe të cilët i ekzekutoi vetë me urdhër të, siç thotë, Fatmir Limajt rreth datës 4 ose 5 prill 1999.

Dëshmitari i tregoi EULEX'it për vendin e ekzekutimit - varrimit të dy trupave, të cilët më pastaj u gjenden pikërisht në vendin e përshkruar nga ai. Identitetet e tyre u vërtetuan nga një analizë e ADN-së, që u përputh me përshkrimin e dëshmitarit X. Autopsia e kryer tregon shkakun e vdekjes së këtyre dy viktimate (plagë nga të shtëna të shumëfishata me armë), gjithnjë në përputhje me tregimin X.

Dëshmitë treguan se si dëshmitari X kishte kryer vrasjen edhe të një serbi me një kosë, për çka tregoi dy vendndodhje të mundshme të ekzekutimit dhe varrimit të tij. Në vijim, një zhvarrosje coi në zbulimin e një varri masiv që përbante pesë trupa. Në të njëjtin varr, u gjend po ashtu një teh prerës. Autopsia e dy mbetjeve njerëzore, tregoi si shkak e vdekjes "prerje në qafë nga një instrument i mprehtë".

Dëshmia shpërfaqë se si dëshmitari bashkëpunues X<sup>246</sup>, kishte treguar se i njëjti varr masiv përbante trupat e katër të burgosurve tjerë serbë, të cilët ishin ekzekutuar më të shtëna kallashnikovësh. X shënoi edhe emrat dhe datat e lindjes së katër personave tashmë trupa të pajetë. Të katër trupat u gjenden në vendndodhjen e treguar dhe identitetet e tyre u konfirmuan nëpërmjet të analizave të ADN-së. Autopsia tregon se tre prej tyre ishin vrarë nga të shtëna armësh në kokë.

Ish-roja e burgut u siguroi hetuesve edhe dokumente zyrtare me origjinë nga UÇK-ja; si gjykimet e gjykatës ushtarake, vendimet disiplinore, listat e të burgosurve, kërkesat me shkrim, datat e burgosjes dhe lirimit të një sërë të burgosurish të ndaluar në burgun e Kleçkës.

Në një shënim të fundit të veçantë, dëshmitari X tregoi çështjet që ai kishte me Fatmir Limajn dhe njerëzit e tij pas lufte. Ai thotë se Limaj e detyroi atë të pranohej në një spital psikiatrik në mënyrë që të përgjëngeshtonte një deklaratë inkriminuese, që dëshmitari X kishte bërë në KFOR kundër tij.

Përveç dëshmive të dëshmitarit bashkëpunues X, aktakuza është e bazuar në dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë; si dëshmitarit Y, dëshmitari anonim I, dëshmitari A, dëshmitari anonim H, të cilat në bazë të aktakuzës janë përputhur me dëshmitë e dëshmitarit X.

Ditarët e dëshmitarit X ishin mbajtur sekret edhe pas luftës në shtëpinë e tij, përveç prej një njeriu tjetër, dëshmitarit Y, të cilët dëshmitari X i kishte treguar dhe kishte kërkuar nga ai që t'u dorëzonte këta ditarë organeve gjyqësore në rast se do t'i ndodhë diçka. Sipas aktakuzës, marrëdhëniet e dëshmitarit X me Limajn dhe grupin e tij, kishin ndryshuar pas luftës, sidomos pas hetimeve të Tribunalit të Hagës për ngjarjet e luftës në burgjet e Llapushnikut kundër Fatmir Limajt, Isak Musliut dhe Haradin Balajt.

Pas arrestimit të Limajt për në Hagë, njerëzit e tij shoqëruan dëshmitarin X në Shqipëri, thuhet në aktakuzë, me instrukcionet që të mos kthehej kurrë. Mirëpo, dëshmitari X, përkundër kësaj, u kthye në Kosovë duke mbajtur të fshehtë vendqëndrimin e tij dhe duke iu ikur kontakteve me grupin e Limajt.

Ndaj dëshmitarit bashkëpunues X kishte pasur atentate. Në qershor të vitit 2009 u qëllua dhe u plagos në shtëpinë e tij në Prizren. Gjithashtu, i njëjti, në korrik të vitit 2007 në veturën e tij kishte gjetur një granatë. Pas këtij rasti dëshmitari X ia dha një deklaratë gjithëpërfshirëse policisë së Kosovës rrëth marrëdhënieve të tij me Fatmir Limajn, grupin e tij dhe të gjitha kërcënimet që ai kishte bërë.<sup>247</sup>

<sup>245</sup> Deklaratat e dëshmitarit X para prokurorit me datën 4, 9, 11, 16 dhe 17 shkurt, 10, 16 dhe 25 mars, 9 qershor, 20 gusht, 5 dhe 7 tetor 2010. Dëshmitë e dëshmitarit X të dhëna para policisë 20 dhe 30 nëntor 2010 dhe 3 dhjetor 2010. Dëshmitë e dëshmitarit X para mbrojtjes së të akuzuarve më 5, 6, 7 dhe 9 korrik 2011.

<sup>246</sup> Dëshmitari Agim Zogaj, i njohur si dëshmitari X, u deklarua nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë, dëshmitar bashkëpunues më 25 gusht 2010.

<sup>247</sup> Aktakuza me numër PPS.nr:07/2010 e datës 25 korrik 2011, faqe 18.

Përpara prokurorit, dëshmitari X kishte dëshmuar se vël-lai i Fatmir Limajt, Demir Limaj, e kishte kërcënuar atë dhe familjen e tij me jetë, se nëse deklaron diçka në lidhje me luftën “do të hedh në erë ty dhe familjen tênde”. Kërcënimë tê tillë kishte marrë edhe nga njerëzit e tjerë të Limajt.<sup>248</sup>

Në muajin gusht, këtë vit, Limajt dhe nëntë bashkëluftëtarëve iu konfirmua aktakuza. Gati krejt ajo është mbështetur në deklaratat e dëshmitarit X, të cilat nga prokuroria konsiderohen si të besueshme dhe mjaft detajisht të përshkruara.

Sipas aktakuzës, Fatmir Limaj së bashku me të akuzuarit e tjerë në bashkëkryerje kanë “dhunuar integritetin trupor dhe shëndetin e një numri të papërcaktuar të civilëve serbë dhe shqiptarë dhe të burgosurve ushtarakë serbë, të paraburgosur në qendrën e paraburgimit në fshatin Kleçkë komuna e Lipjanit. Këta civilë serbë dhe shqiptarë dhe të burgosur ushtarakë serbë, sipas aktakuzës janë mbajtur në kushte çnjerëzore (që përfshinë mbajtjen e të burgosurve në zinxhir, ndërtësë të papërshtatshme, ftohtësi ekstreme, mungesë sanitimi, mungesë ushqimi dhe rrahje të shpeshta”. Akuzat për kryerjen e këtyre veprave përfshijnë periudhën nga janari 1999 deri në mesin e qershorit 1999.

20 nëntori i vitit 2009 e gjeti Agim Zogajt në policinë e EU-LLEX-it, tek dëshmonte për krimet e kryera në Kleçkë gjatë luftës. Më 4 shkurt 2010 Zogaj ishte në Prokurorinë Speciale të Kosovës duke dhënë dëshmi në cilësinë e të dyshuarit për krimet e Kleçkës. Marrja në pyetje e të dyshuarit Zogaj në PSRK vazhdoi edhe më 9, 11, 16 dhe 17 shkurt, pastaj 10, 16 dhe 25 mars, 9 qershor për të vazhduar me 20 gusht në këtë cilësi.

Prokurori special Maurizio Salustro, më 5 tetor, në zyrat e tij, e dëgjoi Zogajt në cilësinë e dëshmitarit. Nga kjo kohë prokuroria filloi procedurat që dëshmitari Zogaj të shpallet dëshmitar bashkëpunues në rastin Kleçka.

Gjykata pranoi kërkësën e prokurorisë që Zogaj të shpallet dëshmitar bashkëpunues, ndërsa prokurori dëshmitarin Zogaj e futi në programin e EULEX-it për dëshmitar të mbrojtur duke i dhënë edhe nofkën X.

### Aktakuza dhe fillimi i gjykimit

Fundi i gushtit të vitit 2011 gjeti Fatmir Limajt dhe 9 bash-

këluftëtarët e tij në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, para gjykatësit për konfirmimin e aktakuzës<sup>249</sup>.

Prokurori në fillim të gushtit në këtë Gjykatë paraqiti aktakuzën kundër Fatmir Limajt dhe të tjerëve, duke i akuzuar të gjithë për krimet e luftës kundër popullatës civile dhe të burgosurve të luftës. Më parë prokurori kishte kërkuar paraburgim dhe arrest shtëpiak për shumicën e të pandehurve, pos Fatmir Limaj, i cili deri në atë kohë konsiderohej se kishte imunitet.

Në fund të shtatorit Gjykata Kushtetuese sqaroi çështjen e imunitetit dhe vendimi i gjykatës për personat, që gjëzojnë imunitet, ishte se ata atë e gjzonin vetëm në kohën sa e kryerin detyrën në vendin e tyre të punës, pra vetëm gjatë orarit të punës.<sup>250</sup>

Rrjedhimisht, Gjykata Kushtetuese, i dha dritën e gjelbër prokurorit special Maurizio Salustro që të kërkonte arrestin shtëpiak për Fatmir Limajn. Gjykata në bazë të kërkesës së prokurorisë veproi dhe Limajt ia caktoi masën e arrestit shtëpiak, duke ia kufizuar kështu lirinë e lëvizjes dhe komunikimin me persona të tjerë.

Me këtë vendim, gjykata i pamundësoi Limajt që të paraqitej në Kuvendin e Kosovës dhe të mirrej me çështje që i takonin si deputet i Kuvendit. Që në fillim të tetorit i gjithë procesi gjyqësor para se të fillonte përjeton një goditje të rëndë. Në Gjermani gjendet i vetëvraë dëshmitari bashkëpunues i prokurorisë Agim Zogaj, i njohur për procesin si dëshmitari X.<sup>251</sup>

Tutje konfirmimi i aktakuzës ishte bërë dhe ishte caktuar kolegji i gjykatësve, që do të gjykonte çështjen, përbërje e cila ndryshoi para fillimit të seancave. Burime nga EULEX-i në atë kohë thanë se kjo ishte bërë për shkaqe personale të kryetarit të kolegjit, meqë ai do ta lente misionin e seanca do të zgjaste.

Ishte 11 nëntori i vitit 2011, data e fillimit të seancave për Rastin Kleçka.

Të gjithë të pandehurit, që në fillim të procesit, u deklaruan të pafajshëm për të gjitha pikat e aktakuzës. Kurse avokati i Limajt, Karim Khan, avokat nga Britania e Madhe i regjistruar në Kosovë vetëm për këtë rast, që në seancën e parë

248 Ibid.

